



KONTROLI I LARTË I SHTETIT
Raport përfundimtar për auditimin e ushtruar në Bashkinë Përmet

RAPORT PËRFUNDIMTAR I AUDITIMIT
“FINANCIAR”
TË USHTRUAR NË BASHKINË PËRMET

Tiranë, dhjetor 2022

Nr.	Përmbajtja	Faqe
	Legjenda dhe shkurtime	1-3
I.	PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE	4-10
1.	Përshkrim i shkurtër i Projektit të Auditimit	4-4
2.	Përshkrim i gjetjeve kryesore dhe rekomandimeve	4-8
3.	Konkluzioni i përgjithshëm dhe Opinioni i auditimit	8-10
II.	HYRJA	10-16
1.	Objekti i auditimit	10-12
2.	Qëllimi i auditimit	12-12
3.	Identifikimi i çështjes	13-13
4.	Përgjegjësitë e strukturave drejtuese	13-14
5.	Përgjegjësitë e audituesve	14-14
6.	Kriteret e vlerësimit	14-14
7.	Standardet e auditimit	14-15
8.	Metodat e auditimit	15-15
9.	Dokumentimi i auditimit	15-16
	III. PËRSHKRIMI I AUDITIMIT	16-115
10	-Informacion i përgjithshëm mbi subjektin	16-18
12	IV. Përshkrimi i auditimit, sipas drejtimeve të auditimit	19-85
11	1 Mbi menaxhimin financiar dhe kontrollin	19-25
12	2. Mbi planifikimin dhe zbatimin e planit të buxhetit	25-36
13	3. Niveli i realizimit të të ardhurave	37-46
13	4. Vlerësimi i raportimit financiar	46-64
14	5. Zbatimit të rekomandimeve të lëna në auditimet e mëparshme	65-85
	V. GJETJET DHE REKOMANDIMET	86-95
	VI. ANEKSE	96-115

SHKURTIME

AAJM	Aktive Afatgjata Jo Materiale
AAM	Aktive Afatgjata Materiale
AK	Autoritet Kontraktor
AQT	Aktive të Qëndrueshme të Trupëzuara
ASHK	Agjencia Shtetërore e Kadastrës
BOE	Bashkim i Operatorëve Ekonomikë
FZHR	Fondi i Zhvillimit të Rajoneve
GSM	Grupi i Menaxhimit Strategjik
IFAC	Federata Ndërkombëtare e Kontabilistëve
INOTSAI	Organizata Ndërkombëtare e Institucioneve Supreme të Auditimit
IPSAS	Standardeve Ndërkombëtare të Kontabilitetit të Sektorit Publik
ISA	Standardet Ndërkombëtare të Auditimit
ISSAI	Standardet Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit
IT	Teknologjia e Informacionit
KLSH	Kontrolli i Lartë i Shtetit
KPP	Komisioni i Prokurimit Publik
KVO	Komisioni i Vlerësimit të Ofertave
LPP	Ligji i Prokurimit Publik
MFK	Menaxhimi Financiar dhe Kontrolli
MAB	Manuali i Auditimit të Brendshëm
NA	Nëpunës Autorizues
NJA	Njësi Administrative
NJAB	Njësia e Auditimit të Brendshëm
NJP	Njësia e Prokurimit
NZ	Nëpunës Zbatues
OE	Operator Ekonomik
PF	Pasqyrat Financiare
QKB	Qendra Kombëtare e Biznesit
SHA	Shoqëri Anonime
SHPK	Shoqëri me Përgjegjësi të Kufizuar
SKK	Standardet Kombëtare të Kontabilitetit
UMF	Udhëzim i Ministrisë së Financave
VKB	Vendim i Këshillit Bashkiak
VKM	Vendim i Këshillit të Ministrave

I. PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE

1.Përshkrim i shkurtër i Projektit të Auditimit.

Në zbatim të Programit të Auditimit 802/1 prot., datë 02.09.2022, ndryshuar me shkresën nr 802/2 Prot., datë 30.09.2022 të miratuar nga Kryetari i KLSH-së, në subjektin Bashkia Përmet nga data 06.09.2022 deri në datën 07.10.2022, u krye “Auditim Financiar”, për periudhën nga 01.01.2021 deri më 31.12.2021 dhe u shtri mbi çështjet kryesore të veprimtarisë së institucionit si: menaxhimi financiar dhe kontrolli i brendshëm, planifikimi dhe zbatimi i buxhetit, vlerësimi i pasqyrave financiare, prokurimet publike dhe të ardhurat. Për përfitimin e rezultateve të auditimit, grupi i auditimit u mbështet mbi dy elementë: në sistemin e kontrollit të brendshëm dhe në punën konkrete mbi evidencat e auditimit, por kryesisht mbi këtë të fundit. Audituesit janë kujdesur që evidencat me të cilat kanë punuar për të argumentuar rezultatet e auditimit, të plotësonin tre cilësi: të ishin të përshtatshme (të kishin lidhje me çështjen që auditohet), të besueshme (burimi nga vjen evidenca të ketë besueshmëri) dhe të mjaftueshme (sasia e evidencës të jetë e mjaftueshme për arritjen e konkluzioneve të auditimit). Në përfundim të punës audituse në terren, nga grupi i auditimit janë mbajtur dhe protokolluar në subjekt 5 akt konstatime dhe një akt verifikim. Në datë 07.10.2022, nga grupi i auditimit të KLSH u zhvillua takimi për ballafaqim e problematikave në ambientet e Bashkisë Përmet me punonjësit e Bashkisë. Nga subjekti u paraqitën kundërshtitë për aktet e mbajtura. Pas hartimit të akteve të konstatimit dhe Projekt Raportit, nga subjekti i audituar janë bërë kundërshti, të cilat janë trajtuar nga grupi i auditimit dhe janë bërë pjesë të materialit në Projekt Raport dhe në Raportin Përfundimtar të Auditimit.

Auditimi në teren ka filluar në datën 05.09.2022 dhe ka përfunduar në datën 07.10.2022.

Projekt Raporti i auditimit është nisur në subjekt më shkresën nr. 802/4 prot., datë 18.11.2022 dhe me emailin e datës 19.12.2022 (të dhëna të subjektit). Bashkia Përmet ka kthyer përgjigje se është njohur me Projekt Raportin e auditimit dhe me shkresën nr. 2607 datës 16.12.2022.

Takimi përmbyllës midis punonjësve të Bashkisë Përmet dhe grupit të auditimit nuk u realizua pasi sipas me emailin e sipërcituar Bashkia Përmet ka shprehur dakortësinë mbi vazhdimin e procedurave pasi nuk u pa e arsyeshme zhvillimi i një takimi ballafaques.

2.Përshkrim i gjetjeve kryesore dhe rekomandimeve

Përmbledhje e gjetjes	Referenca me raportin përfundimtar	Rëndësia	Rekomandimi
Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i zbatimit të buxhetit lidhur me likuidimin e detyrimeve të prapambetura rezulton se Bashkia Përmet për zbatimin e vendimeve gjyqësore me objekt dëmshpërblim page për largime nga puna të punonjësve, për vitin 2021 ka shpenzuar vlerën 1,512,720 lekë , për 13 raste, të cilat përbëjnë shpenzime pa ekonomikitet, eficientë dhe efektivitet, pasi praktikisht për një pozicion pune paguhen dy persona. Nga praktikat e mësipërme të likuidimit u përzgjodhën për auditim mbi saktësinë dhe plotësinë e dokumentacionit financiar dhe ligjor, 29 prej tyre rezulton se ka mbetur pa u likuiduar vlera 9,998,558 lekë , vlerë e cila nuk është kontabilizuar në pasqyrat financiare të vitit 2021. Në mënyrë të detajuar detyrimet e prapambetura paraqiten në aneksin nr. 2 pika 2.4 bashkëlidhur projekt raportit të auditimit. Gjithashtu konstatohet se në 13 raste për likuidimet e subjekteve të	faqet 37-46	E lartë	Rekomandimi: Kryetari i Bashkisë Përmet të analizojë të gjitha rastet e vendimeve gjyqësore që do të zbatohet, me qëllim përcaktimin e shkaqeve që kane sjellë humbjen e çështjes gjyqësore. Rezultatet e analizës të shërbejnë për shmangien në të ardhmen të procedurave të gabuara të ndjekura për çështjen e largimit të punonjësve nga puna dhe çështje të tjera, me qëllim uljen e efekteve negative financiare në buxhet si dhe kontabilizimin e plotë të vlerës 9,998,558 lekë .

<p>mësipërme janë nxjerrë urdhrat përkatës nga titullari i institucionit, por nuk janë analizuar nga Kryetari i Bashkisë dhe nuk është kërkuar prej tij nxjerrja e përgjegjësive administrative për këto vendime. Analizimi i arsyeve të humbjeve të vendimeve gjyqësore dhe nxjerrja e përgjegjësive administrative për to, do të ndikonte pozitivisht në korrigjimin e praktikave të gabuara të ndjekura nga njësia vendore në proceset e largimit të punonjësve nga puna dhe për çështje të tjera gjyqësore, evidentimin e procedurave të bëra gabim, në kundërshtim me kuadrin rregullator në fuqi, e si rezultat shmangien e tyre në të ardhmen dhe uljen e shpenzimeve financiare negative në buxhet. Veprime dhe mosveprime janë në kundërshtim me pikën nr. 60, të UMFE nr. 9, datë 20.03.2018, “Për procedurat standarde të zbatimit të buxhetit”, i ndryshuar.</p>		
<p>Gjetje nga auditimi: Nga auditimi rezulton se Drejtoria e Taksave dhe Tarifave Vendore, nuk ka marrë masa të plota për arkëtimin e debitorëve, pasi në datën 31.12.2021 rezulton një vlerë e pa arkëtuar prej 22,459,166 lekë, e ardhur e munguar për buxhetin e Bashkisë Përmet, e krijuar nga mos pagesa e kategorisë së taksapaguesve familjarë dhe privat, respektivisht; - vlera 17,745,793 lekë, i përket subjekteve privat (biznesit i vogël, biznesit të madh dhe subjekte shtetërore) dhe vlera 4,047,397 lekë i përket abonentët familjar dhe gjoba në vlerën 665,976 lekë, ndërsa detyrimet e subjekteve dhe familjarëve të vitit ushtrimor 2021 janë në vlerën 5,390,741 lekë. Veprimet e mos veprimet e mësipërme janë në kundërshtim me Pikat 3,4, 5 dhe 5, të nenin 45 – “Çregjistrimi i subjekteve tatimore” dhe Kreun XI-Mbledhja me forcë e detyrimit tatimor të papaguar, të ligjit nr. 9920, datë 19.05.2008 “Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë”, me ndryshimet dhe Udhëzimit nr. 24, datë 02.09.2008 “Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë”, me ndryshime; ligjin nr. 7895, datë 27.01.1995, me ndryshimet e mëvonshme, neni 181 -Mospagimi i taksave dhe tatimeve.</p>	<p>faqet 37- 46</p>	<p>Rekomandimi: Drejtoria e Taksave dhe Tarifave Vendore, Bashkia Përmet, bazuar në nenin 70 pika 3 “E drejta për të nxjerrë njoftimin e vlerësimit tatimor”, të ligjit nr. 9920, datë 19.05.2008 “Për Procedurat tatimore në R.SH”, i ndryshuar, të marrë masa për nxjerrjen e njoftim vlerësimit tatimor për debitorët duke ndjekur të gjitha rrugët për arkëtimin e detyrimeve për taksat dhe tarifave vendore në vlerën 22,459,166 lekë, duke ndjekur procedurat si më poshtë vijon:</p> <p>a-Tu dërgohen bankave të nivelit të dytë urdhrat e bllokimit të llogarive bankare.</p> <p>b- Të dërgohet në Drejtorinë Rajonale të Transportit, kërkesa për vendosjen e barrës siguroese (për mjetet) dhe në AKSH (për pasuritë e paluajtshme).</p> <p>c-Në rast se bizneset private edhe pas njoftimeve zyrtare dhe dërgimit të urdhër bllokimeve në bankë nuk kryejnë pagesën e detyrimeve, pasi të merren masat administrative apo sekuestro, të bëhet kallëzim penal, bazuar në Kodin Penal të RSH, miratuar me ligjin nr. 7895, datë 27.1.1995 me ndryshimet e mëvonshme, neni 181 “Mospagimi i taksave dhe tatimeve”.</p> <p>d- Drejtoria e të Ardhurave Vendore Bashkia Përmet, në bashkëpunim me Njësitë Administrative, të evidentojë listat emërore të debitorëve familjarë në mënyrë elektronike,</p>

			duke të njoftojë nëpërmjet postës (dhe jo vetëm) familjet të cilët nuk kanë paguar detyrimet për taksën e tokës/ tarifën e pastrimit, ndriçimit, banesave dhe gjelbërimit.
<p>Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i kategorie të bizneseve për tregtimin e naftë bruto dhe nënprodukteve të saj si dhe pajisjen me lejet përkatëse të tregtimit dhe pagesat e tyre, rezulton se gjatë vitit 2021 kanë ushtruar aktivitetin e tregtimit me pakicë të karburanteve, gazit të lëngshëm të naftës, për automjetet, vajrave lubrifikantë dhe lëndëve djegëse për përdorim nga konsumatorët fundorë 6 subjekte, nga të cilët: Subjekti E. ShPK ka pezulluar aktivitetin që prej muajit mars kjo sipas Proces- Verbalit nr.10 date 02.03.2022. M. & L. e ka pezulluar aktivitetin në datë 02.03.2021 sipas ekstraktit historik, 6 nga këto subjekte nuk e kanë kryer pagesën për përsëritjen e licencave. Veprime dhe mosveprime bien në kundërshtim me VKM nr.970, datë 2.12.2015, për “Përcaktimin e procedurave dhe të kushteve për dhënien e licencave për tregtimin e naftës bruto dhe nënprodukteve të saj”, pika 14 dhe në kundërshtim me VKM nr. 344, datë 19.4.2017, “Për disa ndryshime dhe shtesa në VKM nr. 970, datë 2.12.2015, “Për përcaktimin e procedurave dhe të kushteve për dhënien e licencave për tregtimin e naftës bruto dhe nënprodukteve të saj”, pika 9. Të ardhurat e munguara janë në vlerën 3,300,000 lekë. Bashkia Përmet nuk ka aplikuar gjoba për fillimin e aktivitetit pa marrë licencën në kundërshtim me Paketën Fiskale të vitit 2021.</p>	faqet 37-46	E lartë	<p>Rekomandimi: Sektori i Taksave dhe Tarifave Vendore, të ndjekë të gjitha rrugët administrative e ligjore për arkëtimin e tarifës së patakshuar prej 3,300,000 lekë ndaj 6 subjekteve, sipas pasqyrës Aneks nr. 4 pika 2.6 bashkëlidhur raportit të auditimit.</p>
<p>Gjetje nga auditimi: Nga auditimi në lidhje me arkëtimin e të ardhurave nga dhënia me qira të ambienteve për periudhën 01.01.2021 deri me 31.12.2021, u konstatua se Bashkia Përmet ka lidhur 3 kontrata të reja “Për dhënien me qera të tokës bujqësore” të pandarë si dhe ka vazhduar me kontratat e mëparshme, duke i rinovuar afatin sipas kontratave fillestare. Sipas dokumentacionit të vënë në dispozicion rezulton se procesi i administrimit dhe mbledhje së të ardhurave nga kontratat e qirave administrohet nga <i>Sektori i Menaxhimit të pronave dhe Strehimit, i cili</i> administron 21 kontrata në vlerë 3,548,165 lekë në vite, prej të cilave nuk kanë shlyer detyrimet e kontratës 2 subjekte në vlerën gjithsej 781,938 lekë me pasojë të ardhura të munguara për buxhetin e njësisë vendore. Veprimet dhe mosveprimet janë në papajtueshmëri me nenin 12, të ligjit nr. 10296, datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, të ndryshuar dhe kushtet e kontratave të lidhura, VKM nr. 54, datë 5.2.2014 “Për përcaktimin e kritereve, të procedurës e të mënyrës së dhënies me qira, enfiteozë apo kontrata të tjera të pasurisë shtetërore”; etj. Në mënyrë të detajuar paraqitet në aneksin nr. 5 pika 2.6 bashkëlidhur projekt raportit të auditimit.</p>	faqet 37-46	E lartë	<p>Rekomandimi: Bashkia Përmet të marrë masa për të llogaritur detyrimin total të papaguar (duke llogaritur kamatëvonesat) dhe të kërkojë në rrugë ligjore arkëtimin e vlerës prej 781,938 lekë, duke llogaritur dhe shtuar vlerën e kamatëvonesave për të gjitha rastet e detyrimeve të pa arkëtuara në afat, duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative dhe procedurat e tjera në të gjitha shkallët e gjykimit ndaj debitorëve.</p>
<p>Gjetje nga auditimi: Në drejtim të vlerësimit të sistemit të menaxhimit financiar dhe kontrollit të brendshëm, konstatohet se nga Bashkia Përmet, nuk ka njohje dhe nuk është zbatuar ligji 10296, datë 08.07.2010 “Për menaxhimin</p>	faqet 19-25	E lartë	<p>Rekomandimi: Kryetari i Bashkisë Përmet, në cilësinë e Titullarit të Institucionit, Nëpunësit Autorizues, si dhe</p>

<p>financiar dhe kontrollin”, konkretisht:</p> <ul style="list-style-type: none"> - Nuk është ngritur një sistem efektiv i menaxhimit financiar dhe kontrollit të brendshëm, gjë e cila është reflektuar në mangësinë e plotë të rregullave të shkruara për funksionimin e institucionit. - Nga ana e titullarit nuk është hartuar një strategji e menaxhimit të riskut për vitin 2021, manuali dhe harta e proceseve të punës, gjurma e auditimit e cila duhet të përfshinte të paktën proceset kryesore që kontribuojnë në arritjen e objektivave të njësisë. <p>Nga ana e nëpunësit autorizues, nuk janë analizuar dhe përditësuar kontrollet që synojnë minimizimin e riskut dhe dokumentimin e tij, si dhe nuk janë regjistruar dhe raportuar masat e marra për parandalimin e këtyre fenomeneve.</p> <ul style="list-style-type: none"> - Në strukturën organizative nuk janë planifikuar pozicione me status “ekselent” dhe pozicione me status të “Grup i veçantë” në zbatim të Urdhrit të Kryeministrit si dhe vendosjen e një sistemi komunikimi që të ofrojë informacionin e duhur për të gjithë punonjësit, menaxherët e lartë dhe titullarin e njësisë. <p>Gjithashtu, u konstatua se një numër i konsiderueshëm punonjësish, kanë rregulluar marrëdhënien e punës sipas dispozitave të Kodit të Punës, ndërkohë që pozicionet e tyre të punës, evidentohen si pozicione me status “Nëpunës Civil” dhe për rrjedhojë rekrutimi i tyre është bërë në kundërshtim me ligjin.</p>		<p>Kryetarit të GMS-së, të hartoj strategjinë e riskut si dhe për aktivitetet dhe proceset kryesore të punës që zhvillohen në institucion, të hartohet gjurma e auditimit dhe harta e proceseve të punës.</p> <p>Rekomandimi: Sektori i Burimeve Njerëzore të marrë masa për rregullimin e pozicioneve të punës që trajtohen me status të nëpunësit civil, në të cilat janë emëruar punonjës sipas “Kodin e Punës”, të njoftojë DAP për procedurat e konkurrimit, duke zbatuar procedurat e përcaktuara në ligjin për Nëpunësin Civil si dhe të planifikoj pozicione me status “Ekselent” dhe pozicione me status të “Grup i veçantë” në zbatim të Urdhrit të Kryeministrit si dhe vendosjen e një sistemi komunikimi që të ofrojë informacionin e duhur për të gjithë punonjësit, menaxherët e lartë dhe titullarin e njësisë.</p>
<p>Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i zbatimit të veprimtarisë së Njësisë së Auditit të Brendshëm, u konstatua se për vitet 2021 Bashkia Përmet nuk ka Njësi të Auditit të Brendshëm dhe nuk ka lidhur kontratë me institucion tjetër për realizimin e këtij shërbimi. Veprime dhe mosveprime bien në kundërshtim me nenin 49 të ligjit 68/2017 “Për financat e vetëqeverisjes vendore”, si dhe pikën 1 të VKM nr.83, datë 03.02.2016 “Për miratimin e kriterëve të krijimit të Njësive të Auditimit të brendshëm në sektorin publik”, ku përcaktohet se në çdo njësi të vetëqeverisjes vendore krijohet Njësia e Auditimit të Brendshëm.</p>	<p>faqet 19-25</p> <p>E lartë</p>	<p>Rekomandimi: Kryetari i Bashkisë Përmet të marrë masa për organizimi i shërbimit të auditimit të brendshëm në bashki, duke krijuar Njësinë e Auditimit të Brendshëm brenda strukturës organizative të Bashkisë.</p>
<p>Gjetje nga auditimi: Në strukturën organizative të Sektorit të Taksave dhe Tarifave Vendore, Bashkia Përmet nuk është krijuar Sektori i Masave Shtrenguese si një nga sektorët më të rëndësishëm në STV Bashkia Përmet, pasi evidentohet se një numër i lartë i detyrimeve të pa arkëtuara (debitor), në vlerën 22,459,166 lekë, nga e cila: subjekte fizik/juridik në vlerë 17,745,793 lekë, si dhe abonentë familjarë në vlerë 4,047,397 lekë, Gjoha të ndryshme 665,976 lekë. Në rregulloren e brendshme të institucionit nuk është përcaktuar personi i cili duhet të ketë për detyrë ndjekjen e arkëtimeve nga agjentët tatimorë dhe mbajtjen e aktrakordimeve me ta, në lidhje me TFTH; Drejtoria e Përgjithshme të Buxhetit, Drejtoria e Menaxhimit të Buxhetit, pranë Ministrisë së Financave, në lidhje me rentën minerare; AKSH-ja, në lidhje me taksën e ndikimit në infrastrukturë dhe DRSHTRR Përmet, në lidhje me taksën vjetore të mjeteve të përdorura) derdhen</p>	<p>faqet 19-25</p> <p>E lartë</p>	<p>Rekomandimi: Kryetari i Bashkisë Përmet të marrë masa për të krijuar Sektori i Masave Shtrenguese, plotësimin e stafit me specialist të fushës dhe përshtatja e strukturës sipas natyrës së menaxhimit të të ardhurave.</p> <p>Rekomandimi: Struktura organizative e Sektorit të Taksave dhe Tarifave Vendore, të marrë masa për të kryer rakordim periodik mujor me agjentët tatimor sipas formularit përkatës të miratuar nga Ministria e Financave, për të evidentuar</p>

<p>automatikisht në fund të çdo muaji, për llogari të Bashkisë Përmet dhe konfirmohen nga Dega e thesarit Përmet. Veprimet dhe mosveprimet janë në kundërshtim me pikën (ç) të nenit 5 të ligjit nr. 9632, datë 30.10.2006 “Për sistemin e taksave vendore” i ndryshuar dhe në Kreun XI- “Mbledhja me forcë e detyrimit tatimor të papaguar”, nenet 88 – 104, të ligjit nr. 9920, datë 19.5.2008 “Për Procedurat Tatimore në RSH” me ndryshime, neni 7 “Të drejtat dhe detyrimet e agjentit të mbajtjes së tatimit” dhe me ligjin nr. 9632, datë 30.10.2006, “Për sistemin e taksave vendore” i ndryshuar, neni 15 “Parapagimi”, si dhe me UMF nr. 26, datë 04.09.2008 “Për taksat Kombëtare”.</p>			<p>gjendjen reale të të ardhurave që përfiton Bashkia Përmet nga taksat që mbledhen nga këta agjent. Në rast se agjentët tatimor nuk realizojnë saktë mbledhjen e të ardhurave, Bashkia Përmet të fillojë procedurat për penalizimin e tyre me 50% të shumës së plotë të taksave/tarifave të pa mbledhura apo të shmangura.</p>
<p>Gjetje nga auditimi: Nga auditimi rezultoi se në klasën 3 “Gjendja e inventarit qarkullues” të aktiveve qarkulluese paraqiten në mbyllje të vitit 2020 në vlerën 43,404,244 lekë dhe në mbyllje të vitit 2021 në vlerën 43,836,291 lekë, ku diferenca e tyre në rritje në vlerën prej 432,047 lekë. Vlerë e cila nuk rakordon me gjendjen e llogarisë 63 “Ndryshimi i gjendjeve të inventarit” në formatin nr.2 “Pasqyra e performancës financiare”. Veprimet dhe mosveprimet janë në kundërshtim me Udhëzimin e MFE nr.8 datë 09.03.2018 “Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme”, i ndryshuar.</p>	<p>faqet 46-64</p>	<p>E lartë</p>	<p>Rekomandim: Drejtoria e Financës të marrë masa që në mbyllje të pasqyrave financiare të vitit 2022 të pasqyrohet saktë llogaria 63 “Ndryshimi i gjendjeve të inventarit” në formatin nr.2 “Pasqyra e performancës financiare”.</p>
<p>Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i AQ të trupëzuara dhe të patrupëzuara për aktivet afatgjatë jo materiale dhe materiale, rezulton se më 31.12.2021 këto llogari kanë vlerat si vijon: llog.202 “Studime dhe Kërkime” në vlerën 459,486 lekë, llog. 210 “Toka, Troje, Terrene” në vlerën 5,896,567 lekë, llog. 212 “Ndërtesa Konstrukione” në vlerën 461,929,171 lekë; llog. 213 “Rrugë, rrjete, vepra ujore” në vlerën 264,221,237 lekë; llog.214 “Instalime teknike, makineri, pajisje, vegla pune” në vlerën 28,338,963 lekë. Për të gjitha llogarit e sipërcituara mungon regjistri analitik i aktiveve sipas formatit, ku për çdo aktiv të përmbajë të dhënat për veprimet ekonomike të kryera me to në vite si: viti i hyrjes, vendodhjen, përshkrimin e aktivitetit, vlerën e blerjes, vlerën e shpenzimeve kapitale të kryera në vitet e mëpasshme që sjellin rritje të vlerës së aktivitetit, vlerën e akumuluar të amortizimit dhe vlerën e mbetur. Amortizimi i AAGJ është llogaritur për grup aktivesh në total dhe jo aktiv për aktiv, duke mos përlllogaritur saktësisht amortizimin, pasi aktive të ndryshme kanë vlerë të ndryshme amortizimi të akumuluar sepse kanë kohë (vite) të ndryshme përdorimi. Nga testimet e kryera mbi përqindjet e aplikuar të normës së amortizimit mbi totalin e vlerave të mbetura sipas llogarive të klasës 20 dhe 21 rezulton se ka pasaktësi në përlllogaritjet e amortizimit vjetor të AAGJ Veprimet dhe mosveprimet janë në kundërshtim me Udhëzimin e MFE nr. 8, datë 9.3.2018 “Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme” i ndryshuar, Kreu III “Procedurat për përgatitjen, paraqitjen dhe konsolidimin e pasqyrave financiare në njësitë e qeverisjes së përgjithshme”, pika 36, Aneksi 1 “Analiza e detajuar e klasave të llogarive të kontabilitetit në sektorin publik” Pika 2. Klasa 2, “Aktivet afatgjata” (përbërja dhe trajtimi kontabël). UMF nr. 30 datë</p>	<p>faqet 46-64</p>	<p>E lartë</p>	<p>Rekomandim: Drejtoria Ekonomike në Bashkinë Përmet të marrë masa për kryerjen e inventarizimit të AAGJM, të krijojë dhe të mbajë regjistrin analitik aktiveve, ku të përmbajë të dhënat për veprimet ekonomike të kryera me to në vite si: viti i hyrjes, vendodhjen, përshkrimin e aktivitetit, vlerën e blerjes, vlerën e shpenzimeve kapitale të kryera në vitet e mëpasshme që sjellin rritje të vlerës së aktivitetit, vlerën e akumuluar të amortizimit dhe vlerën e mbetur. Të kryejë veprimet për përlllogaritjen e saktë të amortizimit aktiv për aktiv sipas të dhënave regjistrin të aktiveve, duke aplikuar normat e amortizimit të miratuara me qëllim saktësimin e vlerës së mbetur të AAGJ dhe reflektimi i të gjithë ndryshimeve në kontabilitet nëpërmjet sistemeve kontabël, duke pasqyruar saktë dhe realisht gjendjet e AAGJ në llogaritë përkatëse të klasës 20 dhe 21 në pasqyrat financiare.</p>

27.12.2011 “Për Menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik” kapitulli III, pika 30, kapitulli IV, pika 75.			
--	--	--	--

3. Konkluzioni dhe opinionit i auditimit

OPINIONI I AUDITIMIT

Opinionit i auditimit financiar.

Ne kemi audituar veprimtarinë e Bashkisë Përmet, përsa i takon shkallës së zbatueshmërisë të rregullave, ligjeve, termave dhe kushteve mbi të cilat është rënë dakord (kriteret e auditimit financiar në mbështetje të ligjit nr. 154/2014, miratuar në datën 27.11.2014 “Për Organizimin dhe Funksonimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit” dhe (ISSAI 4100) Rregulloren e Procedurave të Auditimit të KLSH dhe në Manualet e Auditimit.

Ne kemi audituar pasqyrat financiare përmbledhëse vjetore të konsoliduara të Bashkisë Përmet për vitin ushtrimor 2021, ku përfshihet pasqyra e pozicionit financiar, performancës financiare, pasqyra e flukseve monetare, ndryshimeve në aktivet neto/fondet neto etj., në bazë testimesh, të dokumenteve që mbështesin shumat dhe shpalosjet në to, ku u bë vlerësimi i parimeve kontabël të përdorura dhe vlerësimeve të bëra nga drejtuesit, si dhe vlerësimi i paraqitjes së përgjithshme të tyre si dhe shënimet dhe relacioni për llogaritë që shoqëronin këto pasqyra . Sipas opinionit tonë, pasi kemi marrë evidenca dhe dëshmitë mjaftueshme dhe të përshtatshme të auditimit, shprehim një opinion të pakualifikuar me theksim të çështjes për llogaritë vjetore të vitit 2021 të subjektit Bashkia Përmet, pasi veprimet përgjatë raportimit financiar dhe transaksionet e kryera për ekzekutimin e buxhetit, përveç rasteve të paraqitura në paragrafin e theksimit të çështjes, janë në përputhje me kuadrin ligjor në fuqi për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare, si dhe me ligjet dhe rregullat përkatëse të financave publike. Për përmirësimin e mëtejshëm të gjendjes janë adresuar disa çështje të cilat paraqiten te paragrafi “*Theksimi i Çështjes*”.

Baza për opinionin mbi pasqyrat financiare

Ne e kemi kryer auditimin tonë në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Auditimit të Sektorit Publik (ISSAI). Përgjegjësitë tona lidhur me këto standarde janë përshkruar më hollësisht në seksionin “Përgjegjësitë e Audituesit për Auditimin e Pasqyrave Financiare”, pjesë e raportit tonë përfundimtar. Ne jemi të pavarur kundrejt subjektit të audituar, e theksuar kjo në ISSAI-n 10- Deklarata e Meksikës mbi Pavarësinë e SAI-t, si dhe ISSAI 30- Kodi Etik, apo edhe çështje të tjera që lidhen me auditimin e pasqyrave financiare të një institucioni ndërkombëtar, të cilat janë përmendur në ISSAI-n 5000- Auditimi i Institucioneve Ndërkombëtare- Udhëzues për SAI-n. Ne i kemi përmbushur përgjegjësitë tona etike, në përputhje me standardet e sipërpërmendura. Gjithashtu në dhënien e opinionit ne kemi marrë në konsideratë vlerën e materialitetit prej 7,587 mijë lekë mbështetur në pasqyra e pozicionit financiar, pasqyra e performancës financiare, pasqyra e ndryshimeve në kapital, pasqyra e flukseve e mjeteve monetare, si dhe shpjegimet janë përfshirë në deklaratat financiare, të mara gjatë punës sonë audituese janë të mjaftueshme dhe të përshtatshme për të siguruar bazat për përgatitjen e *opinionit të pa modifikuar/kualifikuar me theksim të çështjes*.

Në dhënien e opinionit, ne kemi marrë në konsideratë :

- Gjendja e llogarisë së fondeve 7206 “Financim i pritshëm nga buxheti”, në pasqyrat financiare ka vlerën 0 lekë, e cila nuk rakordon me gjendjen e llogarisë 4342 “Operacione me shtetin (të drejta)” e cila paraqitet në vlerën 55,310,416 lekë.

- Gjendja e inventarit qarkullues” të aktiveve qarkulluese paraqiten në mbyllje të vitit 2020 në vlerën 43,404,244 lekë dhe në mbyllje të vitit 2021 në vlerën 43,836,291 lekë, ku diferenca e

tyre në rritje në vlerën prej 432,047 lekë nuk rakordon me gjendjen e llogarisë 63 “Ndryshimi i gjendjeve të inventarit” në formatin nr.2 “Pasqyra e performancës financiare”.

Amortizimi i AQ të Trupëzuara dhe të Patrupëzuara për aktivet afatgjatë jo materiale dhe materiale gjendje me 31.12.2021 në llogaritë: llog.202 “Studime dhe Kërkime” në vlerën 459,486 lekë, llog. 210 “Toka, Troje, Terrene” në vlerën 5,896,567 lekë , llog. 212 “Ndërtesa Konstruksiione” në vlerën 461,929,171 lekë; llog. 213 “Rrugë, rrjete, vepra ujore” në vlerën 264,221,237 lekë; llog.214 “Instalime teknike, makineri, pajisje, vegla pune” në vlerën 28,338,963 lekë. është llogaritur për grup aktivesh në total dhe jo aktiv për aktiv.

Përgjegjësitë e Drejtuesve të Bashkisë.

Strukturat drejtuese të Bashkisë Përmet, janë përgjegjëse për përdorimin e burimeve financiare në përputhje me politikat, ligjet dhe rregulloret e aplikuara (kriteret e vlerësimit). Ato janë përgjegjëse për zbatimin e gjithë kuadrit rregullator në prokurimin e fondeve publike. Gjithashtu, strukturat drejtuese të Bashkisë Përmet janë përgjegjëse për funksionimin e sistemit të kontrollit të brendshëm, që është i nevojshëm për përgatitjen e pasqyrave financiare, për të shmangur gabimet apo mashtrimet si dhe përgjegjës për drejtimin e kontrollin e procesit të raportimit financiar.

Përgjegjësitë e Audituesve të KLSH është që nëpërmjet auditimit të realizuar të krijojmë bindje, të cilat do të shprehen në opinionin e grupit të auditimit mbi saktësinë, vërtetësinë dhe besueshmërinë e hartimit të pasqyrave financiare dhe raportimit financiar, nëse pasqyrat financiare janë përgatitur në të gjitha aspektet materiale në përputhje me kuadrin e rregullator të raportimit financiar. Audituesi identifikon çështjet më të rëndësishme lidhur me auditimin e pasqyrave financiare dhe i përshkruan ato në raportin e auditimit. Siguria që jepet nga audituesi është një siguri e arsyeshme e cila është një nivel i lartë sigurie, por nuk garanton që auditimi i kryer në përputhje me standardet, mundëson identifikimin e çdo gabimi material apo anomalie që mund të ekzistojë.

II. HYRJE

Mbështetur në Ligjin nr. 154/2014, datë 27.11.2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”, në zbatim të Programit të Auditimit nr. 802/1 prot., datë 02.09.2022, ndryshuar me shkresën nr. 802/2 Prot., datë 30.09.2022 të miratuar nga Kryetari i KLSH-së, në subjektin Bashkia Përmet nga data 06.09.2022 deri në datën 07.10.2022, u krye “Auditim Financiar”, për periudhën nga 01.01.2021 deri më 31.12.2021, nga grupi i audituesve të Kontrollit të Lartë të Shtetit:

1. Z. H. I. .Përgjegjës Grupi;
2. Z. S. D.

Titulli: Auditim financiar.

Marrësi: Raporti i drejtohet subjektit të audituar, Bashkia Përmet.

1.Objektivat dhe Qëllimi i Auditimit

- Objektiv i auditimit financiar është dhënia e opinionit me siguri të arsyeshme, nëse për vitin 2021, transaksionet financiare dhe ngjarjet ekonomike janë raportuar drejt dhe saktë në pasqyrat financiare të subjektit të audituar, kjo referuar kuadrit ligjor të raportimit financiar në fuqi.
- Për auditimin financiar, qëllimi është të vlerësohet nëse rezultatet dhe gjendja financiare e

raportuar e subjektit që auditohet, si dhe përdorimi i burimeve janë paraqitur saktë dhe në përputhje me rregullat e raportimit financiar, si në fushën e të ardhurave dhe të shpenzimeve.

2. Identifikimi i çështjes

Raporti i Auditimit, synon të identifikojë përmbushjen e rolit të njësisë vendore dhe përgjegjësi të saj, që burojnë nga kuadri ligjor dhe dispozitat në fuqi, për përmirësimin e vazhdueshëm të punëve dhe shërbimeve në dobi të komunitetit, në funksion të zbatimit të strategjive që orientojnë zhvillimin e Bashkisë Përmet, si dhe përmirësimin e vazhdueshëm të cilësisë së shërbimit ndaj komunitetit në plotësimin e kërkesave dhe nevojave të tyre.

Saktësia, rregullshmëria, ndodhja e transaksioneve kontabël dhe regjistrimi i tyre me korrektësi dhe në përputhje me kuadrin e raportimit financiar në fuqi.

3. Përgjegjësitë e strukturave drejtuese

Kryetari i Bashkisë, znj. A. H., në cilësinë e Nëpunësit Autorizues dhe znj. E. K., Drejtor i Drejtorisë së Financë-Buxhet, Taksa e Tregje, në cilësinë e Nëpunësit Zbatues, janë përgjegjës për përgatitjen e pasqyrave financiare në përputhje me kuadrin normativ të zbatueshëm për raportimin financiar në sektorin publik dhe për mirëfunksionimin e sistemit të kontrollit të brendshëm, i cili garanton respektimin e kuadrit ligjor në fuqi, sipas përcaktimeve të ligjit nr. 139/2015, datë 17.12.2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, ligjit nr. 9936, datë 26.06.2008, “Për Menaxhimin e Sistemit Buxhetor në RSH”, i ndryshuar, ligjit nr. 10296, datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, etj.

4. Përgjegjësitë e audituesve

Përgjegjësia e grupit të auditimit është të shprehë konkluzionin dhe një opinion mbi çështjet që janë nën auditim. Auditimi është kryer në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Auditimit sipas INTOSAI-t. Këto standarde, kërkojnë që audituesit të respektojnë kërkesat etike, si dhe të planifikojnë dhe kryejnë auditimin me qëllim që të arrijnë nivelin e sigurisë së kërkuar.

Përgjegjësia jonë (e audituesve të KLSH-së), është që nëpërmjet auditimit të realizuar të krijohen bindjet, si dhe të shprehet opinionin i grupit të auditimit mbi aspektet që duhet të vlerësojë:

- Nëse shpenzimet janë realizuar në përputhje me ligjin e Buxhetit të Shtetit, me aktet përkatëse ligjore e nënligjore dhe me parimet e ligjit për menaxhimin financiar dhe kontrollin;
- Nëse janë zbatuar parimet e përgjithshme të sistemit të menaxhimit financiar në sektorin publik dhe të sjelljes së zyrtarëve të sektorit publik;
- Nëse janë zbatuar kërkesat e përcaktuara në ligjet dhe aktet normative përkatëse, si Ligji organik i buxhetit apo legjislacioni financiar, tatimor dhe vendor në fuqi, etj.;
- Interesin publik ose pritshmërinë publike (p.sh. shkelje të identifikuara nga media, ankesat, etj.).
- Fusha specifike të cilat janë objekt i fokusit për zbatimin e ligjit, etj.;

Në përputhje me ISSAI 1320 dhe ISSAI 1450, objektivi i audituesit është që të aplikojë konceptin e materialitetit në mënyrë korrekte gjatë planifikimit dhe kryerjes së auditimit. Auditimi përfshin kryerjen e procedurave për të marrë evidenca auditimi rreth praktikave administrative e financiare, si dhe rreth shumave dhe raportimit të shifrave në Pasqyrat Financiare. Procedurat e zgjedhura varen nga gjykimi i audituesit, duke përfshirë këtu edhe vlerësimin e rreziqeve nga gabimi material, qoftë për shkak të mashtrimit apo gabimit njerëzor. Gjatë procesit të vlerësimit të riskut, audituesit vlerësojnë nivelin e kontrollit të brendshëm përkatës në Bashkinë Përmet, në mënyrë që të programoheshin drejt procedurat e auditimit, të cilat janë të përshtatshme për kushtet e subjektit, por jo për qëllim të shprehjes së opinionit mbi efektivitetin e kontrollit të brendshëm të subjektit.

5. Kriteret e vlerësimit

- Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë;
- Ligji nr. 154/2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”;
- **Në fushën e buxhetit dhe administrimit financiar:**
 - Ligji nr. 24/2018, datë 10.05.2018 “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare”
 - Ligji nr. 9936, datë 26.06.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar;
 - Ligji nr. 9869, datë 04.02.2008 “Për huamarrjen e qeverisjes vendore”
 - Ligji nr. 48/2014, datë 24.04.2014 “Për pagesat e vonuara në detyrimet kontraktore e tregtare” ndryshuar me ligjin nr. 24/2015, datë 19.03.2015;
 - VKM 783 datë 22.11.2006 “Për përcaktimin e standardeve dhe rregullave kontabël”;
 - Udhëzimi i Ministrit të Financave nr. 35, datë 5.11.2008 “Për zbatimin e ligjit nr. 9869, datë 04.02.2008 “Për Huamarrjen e Qeverisjes Vendore”;
 - Udhëzimi i MF nr. 8, datë 29.03.2012 “Për procedurat standarde të përgatitjes së programit buxhetor afatmesëm”;
 - UMFE nr. 9, datë 20.03.2018 “Për Procedurat Standarde të Zbatimit të Buxhetit”, etj;
 - Udhëzimit i MF nr. 2, datë 02.06.2012 “Për procedurat standarde të zbatimit të buxhetit”, i ndryshuar;
 - Udhëzimi MFE nr. 8, datë 09.03.2018 “Për procedurën e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit e të pasqyrave financiare vjetore të njësive të Qeverisjes së Përgjithshme”;
 - Udhëzimi i Ministrisë së Financave nr. 5, datë 27.02.2014 “Për shlyerjen e detyrimeve të prapambetura” ndryshuar me udhëzimin nr. 5/1 datë 21.05.2014.
 - Udhëzimi i MF nr. 10/1, datë 28.02.2017 “Për përgatitjen e buxhetit vendor”;
 - Udhëzimin plotësues të Ministrisë Financave nr. 02, datë 10.01.2018 “Për buxhetin e vitit 2018”, pikat 82-91 “Detyrimet e prapambetura të Njësive të Vetëqeverisjes Vendore”;
 - Udhëzimin e Ministrisë Financave nr. 22, datë 30.07.2018 “Për procedurat standarde të monitorimit të buxhetit të Njësive të vetëqeverisjes vendore”;
 - Udhëzimi plotësues i Ministrisë Financave nr. 01, datë 17.01.2019 “Për buxhetin e vitit 2019”, pikat 106-110, “Detyrimet e prapambetura të Njësive të Vetëqeverisjes Vendore”, dhe pikat 116-117- Raportimi i detyrimeve të prapambetura në njësitë e qeverisjes vendore”.
 - Udhëzimi i përbashkët i Ministrisë Financave, Drejtorit të Përgjithshëm të Radiotelevizionit Shqiptar nr. 29, datë 18.12.2014 (Agjenti tatimor OSSHE faqe 4, “Për përcaktimin e tarifës së shërbimit për përdorimin e aparateve televizive”), Fletore zyrtare 196/2014;
- **Në fushën e mbajtjes Kontabilitetit dhe Hartimit të Pasqyrave Financiare:**
 - Ligji nr. 9228, datë 24.04.2004 “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare, i ndryshuar ligjin nr. 9477 datë 9.2.2006”, aktualisht i shfuqizuar;
 - VKM nr. 248, date 10.4.1998 “Për miratimin e planit kontabël publik, për organet e pushtetit lokal, institucionet shtetërore, qendrore dhe lokale, si dhe të njësive që varen prej tyre” i ndryshuar me VKM nr. 25, datë 20.01.2001;
 - VKM nr. 783, datë 22.11.2006 “Për përcaktimi i standardeve dhe të rregullave kontabël”;
 - VKM nr. 510, datë 10.06.2015 “Për miratimin e procedurave për transferimin e të drejtave dhe detyrimeve, personelit, aktiviteteve dhe çdo dokumentacion tjetër zyrtar në njësitë e qeverisjes vendore, të prekura nga riorganizimi administrativo-territorial”;
 - Udhëzimi i MF nr. 14, datë 28.12.2006 “Për përgatitjen dhe raportimin e pasqyrave financiare vjetore të vitit 2006 për institucionet qendrore, organet e pushtetit vendor dhe njësive që varen prej tyre si dhe të njësive të menaxhimit/zbatimit të projekteve e marrëveshjeve me donatore të huaja”;
 - Udhëzimi i MF nr. 08, datë 09.03.2018 “Për procedurën e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit e të pasqyrave financiare vjetore të njësive të Qeverisjes së Përgjithshme”, i ndryshuar;
 - Udhëzimi përbashkët i Ministrit të Çështjeve Vendore dhe Ministrit Financave nr. 3237 datë

16.07.2015 “Për procedurat afatet kohore standardet dhe kriteret e plotësimit të dokumentacionit të nevojshëm për riorganizimin administrativo-territorial”.

▪ **Në fushën e administrimit të taksave dhe tarifave vendore:**

- Ligji nr. 9920, datë 19.05.2008 “Për procedurat tatimore në RSH”, i ndryshuar”;
- Ligji nr. 9632, datë 30/10/2006 “Për Sistemin e Taksave Lokale”, i ndryshuar;
- Ligji nr. 9975, datë 28.7.2008, “Për Taksat Kombëtare”, i ndryshuar
- VKM nr. 170, datë 25.4.2002 “Për përcaktimin e procedurave dhe të kushteve për dhënien e lejeve e të autorizimeve për tregtimin e naftës, gazit e nënprodukteve të tyre”, me ndryshime;
- VKM nr. 1064, datë 22.12.2010, “Për disa ndryshime në VKM nr. 391, datë 21.06.2006 “Për përcaktimin e tarifave në sektorin e pyjeve dhe të kullotave”;
- Udhëzim i MF nr. 24, datë 02.9.2008 “Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar;

▪ **Në fushën e marrëdhënieve të punësimit dhe pagave:**

- Ligji nr. 7961, datë 12.07.1995 “Kodi i Punës i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar;
- Ligji nr. 152-2013, “Për Nëpunësin Civil”, i ndryshuar;
- Ligji nr. 10405, datë 24.3.2011, “Për kompetencat për caktimin e pagave dhe të shpërblimeve”, i ndryshuar;
- VKM nr. 187, datë 08.03.2017, “Për Miratimin e Strukturës dhe të Niveleve të Pagave të Nëpunësve Civilë”, i ndryshuar;
- VKM nr. 165, datë 02.03.2016, “Për Pagat e Vetëqeverisjes Vendore”, i ndryshuar;
- Rregullore e brendshme “Mbi Procedurat e auditimit në KLSH”;
- Rregullore e brendshme “Mbi organizimin dhe funksionimin administrativ KLS-së”;
- Rregullore e brendshme e organizimit dhe funksionimit të Këshillit Bashkiak dhe aparatit administrativ të Bashkisë.
- Vendimet e Këshillit Bashkiak dhe shprehja e ligjshmërisë nga Prefekti i Qarkut;
- Legjislacioni bazë dhe dytësor, dispozitat e tjera, si dhe kriteret përkatëse që janë përdorur dhe ju jemi referuar për kryerjen e vlerësimeve gjatë auditimit.

6. Standardet e auditimit

- ISSAI 100 “Parimet themelore të Auditimit të Sektorit Publik”, i cili përcakton parimet themelore për auditimin e sektorit publik në përgjithësi;
- ISSAI 2000-2899 “Udhëzues të Auditimit Financiar”;
- ISSAI 2300 “Planifikimi i auditimit të pasqyrave financiare”;
- INTOSAI GOV 9100 “Udhëzues mbi Standardet e Kontrollit të Brendshëm për Sektorin Publik” si dhe INTOSAI GOV 9110 “Udhëzues mbi raportimin e efektivitetit të kontrolleve të brendshëm”;
- ISSAI 400 “Parimet themelore të Auditimit të Përputhshmërisë”, i cili përcakton parimet themelore të ISSAI-t 100 dhe i zhvillon më tej ato duke i përshtatur me kontekstin specifik të auditimit të përputhshmërisë;
- ISSAI 4000 “Prezantim i përgjithshëm i Udhëzimeve për Auditimin e Përputhshmërisë”; si dhe ISSAI 4200 “Udhëzime për Auditimin e Përputhshmërisë”;
- INTOSAI “Për implementimin e Standardeve Ndërkombëtare të Auditimit, ISSAI mbi Auditimin e përputhshmërisë”; etj.
- Standardet Kombëtare të Kontabilitetit;
- Standardet Ndërkombëtare të Auditimit (SNA) të Federatës Ndërkombëtare të kontabilisteve IFAC;
- Manuali i Auditimit Financiar dhe i Përputhshmërisë të KLSH-së;
- Manuali i Auditimit të Brendshëm, etj.
- Standardet Ndërkombëtare të Auditimit mbi Raportimin e Audituesit të Pavarur, (IFAC);
- Praktika të mira të fushës, si manualet e Gjykatës Evropiane të Audituesve, Kërkesat e Udhërrëfyesit të IDI-t, etj.

7. Metodatat e auditimit

Auditimi i njëpasnjëshëm dhe me zgjedhje periudhash. Qasja audituese e KLSH-së është metodologji e bazuar në vlerësimin dhe menaxhimin e riskut të auditimit në subjektin që auditohet, e cila shërben për kryerjen e auditimit me efikasitet dhe efektivitet, duke u fokusuar në natyrën, kohën dhe shtrirjen e procedurave të auditimit në fushat materiale dhe që vlerësohen me nivel të lartë risku. Nën gjykimin profesional të audituesve të pavarur, për përzgjedhjen e kampioneve për ekzaminim, në zërat e shpenzimeve, u morën në konsideratë dy elementë:

- Risku i lidhur me shpenzimin specifik; dhe
- Pështja specifike që një zë shpenzimesh zë ndaj totalit të shpenzimeve të subjektit.

Ndjekja dhe zbatimi i hapave të mësipërm do të sjellin natyrshëm përcaktimin e elementëve kryesorë që do të ndiqen gjatë procesit të zbatimit të projektit të auditimit, nëpërmjet sigurimit të gjurmës së projektit të auditimit. Gjurma e auditimit është dokumentimi i procesit të realizimit të Projektit të Auditimit. Evidentimi i zbatimit të procedurave të auditimit nëpërmjet dokumentimit përfshin të gjitha fazat e kryerjes së Projektit të Auditimit që nga Planifikimi i Auditimit, Puna në Terren, Raportimi i Auditimit, Ndjekja e Rekomandimeve dhe Publikimi i Auditimit. Thëksojmë se nga ana jonë do të auditohen pothuajse të gjitha fondet, si më poshtë:

▪ **Kontrolli aritmetik**

Duke konsideruar faktin se në thelb, kontabiliteti konsiston në regjistrimin e fakteve në një formë numerike, si dhe në paraqitjen sintetike të tyre, por midis regjistrimit fillestar të fakteve dhe paraqitjes së tyre në formë sintetike (që është edhe qëllimi i kontabilitetit), bëhen një seri veprimesh të cilat kanë të bëjnë me evidentimin në llogari, mbartjet, klasifikimin dhe rigrupimin. Kontrolli aritmetik u krye me qëllim që të sigurohemi nëse veprimet e llogaritjes dhe të hedhjeve në llogaritë përkatëse, që përfundojnë me nxjerrjen e gjendjeve sintetike, nuk përmbajnë asnjë gabim (*Ditari i kontabilizimit të urdhër shpenzimeve*).

▪ **Kontrolli me anë të pjesëve justifikuese**

Edhe pse kontabilizimet nuk përmbajnë gabime aritmetike, ato mund të jenë të gabuara, nëse regjistrimet e bëra nuk korrespondojnë me realitetin. Nga kontrolli me zgjedhje të pjesëve justifikuese (*Urdhër shpenzimeve*) u konstatua se shifrat e kaluara kanë pasur justifikim të mjaftueshëm dokumentar, sipas kërkesave të UMF nr. 30, datë 27.12.2011 “*Mbi menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik*”, i ndryshuar.

▪ **Inspektimi fizik dhe kontrolli i gjendjeve ekzistuese**

Konsistoi në ekzaminimin e aktiveve, llogarive, librave kontabël etj. Kontrolli kontabël i ushtruar ekzaminoi përputhjen ndërmjet regjistrimit kontabël dhe pjesëve justifikuese përkatëse, por mbi ekzistencën reale të aktiveve në subjekt u konstatuan probleme. Gjithashtu, për të verifikuar kryerjen e saktë të inventarizimit fizik dhe përputhjet e tij me atë kontabël u krye mbikëqyrje fizike e magazinës.

▪ **Kontrolli i vlerësimeve**

Kontrolli i vlerësimeve përcaktoi nëse vlerat që u atribuohen gjendjeve ekzistuese janë të sakta, nëse pasuritë duhet të qëndrojnë në bilanc me vlerat që u janë vendosur atyre.

▪ **Konfirmimi nga të tretët**

Transaksionet e përzgjedhura për t’ju nënshtuar testeve të detajeve, u kryqëzuan me informacionin e gjeneruar nga Thesari dhe rakordimit periodike me ente dhe institucione të tjera shtetërore.

▪ **Kontrolli sipas një treguesi**

Përdorimi i treguesve statistikorë me qëllim që të kërkohen fakte ose të dhëna “jashtë normales”, të cilat përbëjnë tregues të parregullsisve kontabël. Mund të përmendim nëse ka: mungesë të pjesëve justifikuese, gabime të shpeshta në datat, numrat, referencat e brendshme, regjistrime pak të lexueshme, shifra të renditura keq, korrigjime të shumta të shifrave, etj.

- Intervista
- Raporte dhe Informacione
- Pyetësorët për vlerësimin e sistemeve të Kontrollit të Brendshëm dhe MFK

8. Praktikrat e ndjekura

Mbështetur në ISSAI 1315, objektivi i audituesit është identifikimi dhe vlerësimi i risqeve e anomalive materiale në pasqyrat financiare si edhe nivelin e pohimeve, nëpërmjet të kuptuarit të njësisë dhe mjedisit të saj, duke përfshirë kontrollin e brendshëm të njësisë dhe duke krijuar kështu bazën për hartimin dhe implementimin e përgjigjeve kundrejt risqeve të vlerësuara të gabimeve materiale.

Në këtë kontekst merr rëndësi vlerësimi i materialitetit në përputhje me ISSAI 1320 dhe ISSAI 1450, i cili përcakton nivelin e gabimit që audituesi konsideron të mundshëm për të influencuar te përdoruesit e pasqyrave financiare. Nisur nga gjykimi profesional i audituesit dhe ndjeshmëria e zonave të llogarisë, grupi i auditimit përcaktoi materialitetin në masën 2% për të gjitha zonat e llogarisë të planifikuara për t'u audituar, ku si bazë për llogaritjen e tij janë marrë shpenzimet për pagat (600), shpenzimet operative (602) dhe investimet (231).

Metodologjia e aplikuar gjatë planifikimit, konsiston në auditimin e të dhënave të siguruara nga vetë subjekti. Kemi ndërmarrë procedurat për vlerësimin e riskut (analiza), me qëllim sigurimin e nivelit të kërkuar të njohjes së riskut të brendshëm dhe riskut të kontrollit të subjektit. Informacion të vlefshëm administruam dhe nga procedurat e ndjekura nga vetë subjekti për vlerësimin e riskut, duke iu nënshtruar skepticizmit profesional nga ana e audituesve. Gjatë vlerësimeve u mbështetëm në Modelin e Riskut që aplikon KLSH-ja¹.

Nisur sa më sipër, jemi përpjekur të ruajmë nivelin e pranuar të Riskut të Auditimit prej 5%, duke shtuar nivelin e procedurave analitike (ISSAI 1520) dhe testeve thelbësore të kryera.

Në këtë kontekst, procedurat e ndjekura nga grupi i auditimit konsistojnë në analizat e marrëdhënieve ndërmjet informacionit financiar dhe jo financiar; inspektimeve që konsistojnë në regjistrimin e dokumenteve në regjistra/ditarë/partitarë ose në trajtë elektronike por edhe në inspektime fizike; në observime, të cilat kanë të bëjnë me analizën e proceseve ose procedurave të kryera nga të tjerë, me qëllim sigurimin e informacionit rreth performancës së proceseve/procedurave, por kjo mbetet e limituar deri në kohën kur ka ndodhur observimi; dhe së fundmi, kërkimi/hetimi që konsiston në kërkimin e informacionit të personat kompetentë dhe të mirëinformuar brenda dhe/ose jashtë njësisë shpenzuese.

9. Dokumentimi i auditimit

Nga audituesit u përgatit dokumentacioni i auditimit, i mjaftueshëm për të mundësuar dhe kuptuar natyrën, kohën dhe shtrirjen e procedurave të auditimit, të kryera në përputhje me standardet përkatëse dhe kërkesat ligjore dhe rregullatore të zbatueshme. Rezultatet e këtyre procedurave dhe evidencat e marra gjatë auditimit, si dhe çështje të tjera të rëndësishme që dolën gjatë auditimit, janë reflektuar në përfundimet e arritura në drejtim të tyre sipas gjykimit dhe skepticizmit profesional që audituesit ushtruan në arritjen e këtyre konkluzioneve. Ky dokumentacion është i përshtatshëm dhe i rëndësishëm për të konfirmuar dhe mbështetur opinionet dhe raportin e audituesve dhe ka shërbyer si një burim informacioni për përgatitjen e tyre. Në përfundim të auditimit në terren, mbi Akt-Konstatimet e mbajtura mbi bazën e të dhënave të grumbulluara, u përgatit ky Raport Auditimi.

Në kryerjen dhe dokumentimin e auditimit, u morrën në konsideratë parimet e mëposhtme të auditimit financiar:

- Etika dhe pavarësia;
- Kontrolli i cilësisë;
- Menaxhimi i grupit të auditimit dhe aftësive të tyre
- Parimet lidhur me konceptet bazë të auditimit.

Gjithashtu, në kryerjen dhe dokumentimin e auditimit, u kushtua një rëndësi e veçantë në lidhje

¹ Risku i Auditimit = Risku i qenësishëm * Risku i kontrollit * Risku i Zbulimit

me:

▪ **Pohimet rreth klasave të transaksioneve dhe ngjarjeve për periudhën nën auditim**

Përkatësia: Transaksionet dhe ngjarjet që janë të regjistruara kanë ndodhur dhe i përkasin subjektit.

Plotësia: Të gjitha transaksionet dhe ngjarjet që duhet të ishin regjistruar janë regjistruar.

Saktësia: Shumat dhe të dhënat e tjera në lidhje me transaksionet dhe ngjarjet e regjistruara janë regjistruar në mënyrë të përshtatshme.

Periudha: Transaksionet dhe ngjarjet janë regjistruar në periudhën e saktë kontabël.

Klasifikimi: Transaksionet dhe ngjarjet janë regjistruar në llogaritë e duhura.

Ligjshmëria dhe rregullsia: Janë në përputhje me ndarjet buxhetore në dispozicion.

▪ **Pohimet rreth gjendjeve të llogarive në fund të periudhës**

Ekzistenca: Asetet, detyrimet dhe interesat e kapitalit neto ekzistojnë.

Të drejtat dhe detyrimet: Subjekti mban ose kontrollon të drejtat për asetet dhe detyrimet.

Plotësia: Të gjitha asetet, detyrimet dhe interesat e kapitalit neto që duhet të ishin regjistruar janë regjistruar.

Vlerësimi dhe alokimi: Aktivitet, pasivitet dhe interesat e kapitali janë të përfshira në pasqyrat financiare dhe shumat përkatëse dhe ndonjë vlerësim ose alokim, rregullimet që rezultojnë janë të regjistruara.

▪ **Pohimet rreth prezantimit të shënimeve shpjeguese**

Transaksionet, të drejtat dhe detyrimet: Ngjarjet e paraqitura, transaksionet, si dhe çështje të tjera që kanë ndodhur i përkasin subjektit.

Plotësia: Të gjitha informacionet shpjeguese që duhet të ishin përfshirë në pasqyrat financiare janë përfshirë.

Klasifikimi dhe kuptueshmëria: Informacioni financiar është paraqitur në mënyrë të përshtatshme dhe shprehet qartë në shënimet shpjeguese.


Saktësia dhe vlerësimi: Informacioni financiar dhe të tjera është dhënë në mënyrë të drejtë dhe në sasi të duhur.

III. PËRSHKRIMI I AUDITIMIT

1. Informacion i përgjithshëm mbi subjektin

Auditimi në subjektin “Bashkia Përmet”, u krye në kuadër të planifikimit vjetor të subjekteve të përzgjedhura për t’u audituar. Nga audituesit u përgatit dokumentacioni i auditimit i mjaftueshëm për të mundësuar dhe kuptuar natyrën, kohën dhe shtrirjen e procedurave të auditimit në përputhje me standardet përkatëse dhe kërkesat e zbatueshme ligjore dhe rregullatore. Rezultatet e këtyre procedurave dhe evidencat e marra të auditimit, si dhe çështje të rëndësishme, që dolën gjatë auditimit, janë reflektuar në përfundimet e arritura në drejtim të tyre dhe gjykimet profesionale në arritjen e këtyre konkluzioneve. Ky dokumentacion është i përshatshëm dhe i rëndësishëm për të konfirmuar dhe mbështetur opinionet dhe raportin e audituesve dhe shërbeu si një burim informacioni për përgatitjen e tyre. Në përgatitjen e materialit dokumentar për planifikimin e auditimit, grupi auditimit i është referuar auditimeve e kryera në periudhat e mëparshme, dokumentacionit të kërkuar subjektit, të dhënat e grumbulluara për demografinë, fondet e realizuara nga kjo njësi vendore të publikuara në faqen e Thesarit të Ministrisë së Financave dhe të APP për realizimin e prokurimit me fonde publike dhe të ardhurat e veta. Bashkia Përmet është e organizuar dhe funksionon në bazë Ligjit nr. 139/2015, datë 17.12.2015 “Për Vetëqeverisjen Vendore” dhe Ligjit nr. 68/2017, datë 27.04.2017 “Për financat e vetëqeverisjes vendore”, Rregulloren e funksionimit të Këshillit Bashkiak, Rregulloren e Funksionimit dhe Organizimit të Bashkisë Përmet si dhe akteve të nxjerra nga Këshilli Bashkiak Përmet.

Profili i Bashkisë Përmet: Përmeti kufizohet në veri me bashkinë Skrapar, në lindje me bashkinë Kolonjë, në perëndim me bashkinë Libohovë dhe Këlcyrë. Kryeqendra e bashkisë është qyteti i Përmetit. Sipas Censurit të vitit 2011, bashkia ka një popullsi prej 10,614 banorësh. Ndërkohë që sipas Regjistrimit Civil, kjo bashki numëron 20.301 banorë. Bashkia e re shtrihet në një sipërfaqe prej 601.95 km² me një densitet prej 33.72 banorë/km². Kjo bashki përbëhet nga 5 njësi administrative. Bashkia e re ka nën administrimin e saj një qytet dhe 49 fshatra. Bashkia e Përmetit rrethohet nga pasuri të rralla natyrore e monumentale, por edhe historike, kisha dhe manastire të vjetra. Parku Kombëtar i Hotovës me bredhin e rrallë mesdhetar, banjat kuruese në Bënjë, kanionet e Bënjës dhe të Lengaricës, Shtëpia e vëllezërve Frashëri, Kishat e Leusës, Kosinës, Bualit, Bënjës pasohen nga disa ura tipike me harqe, ndërtime të shek. të XVIII-të si ajo e Katiut apo Bënjës. Këto pasuri natyrore e bëjnë bashkinë e Përmetit një destinacion të lakmueshëm për turistët shqiptarë dhe të huaj. Përmetarët merren me aktivitete të vogla tregtare, të cilat janë fragmentare dhe shpesh punësohen vetëm disa nga anëtarët e familjeve. Ndonëse sektori i turizmit është një nga sektorët kryesorë të zhvillimit ekonomik, ai ende ka pak zhvillim, kapacitete të vogla hotelerie në qytet dhe më pak shtëpi pritëse për turistët në fshatrat përreth. Zonat malore të Përmetit, ndonëse kanë hapësira të mëdha e të virgjëra që mund të shërbejnë për shëtitje dhe alpinizëm. Një nga pasuritë e rralla



të zonës, Ujërat Termale të Bënjës, gati 14 km larg qytetit të Përmetit.

Qyteti i Përmetit mori formë pas rregullimeve urbanistike të kryera në vitin 1964 dhe më pas njohu zhvillim të vogël demografik, kryesisht nga banorët që zbrisnin nga fshatrat përreth. Qyteti ka një arkitekturë tipike të periudhës socialiste, me pak ndërtime të reja. Përmeti është ndoshta qyteti me më shumë sipërfaqe të gjelbëruara e lulishte, që vazhdon të ruajë traditën e shëtitjeve të mbrëmjes.

Sfidat me të cilat përballet pushteti vendor pas ndarjes së re

Bashkia e Përmetit ka një strategji zhvillimi të hartuar me konsulence ndërkombëtare, e cila do të kërkojë një mbështetje të fuqishme financiare për t'u realizuar.

Të ardhurat në këtë bashki janë në nivele minimale dhe shpesh bashkia nuk arrin të paguajë as shërbimet për furnizim me energji të institucioneve të saj. Bashkisë do t'i duhet të shtojë lidhjet me programe ndërkombëtare për të thithur donatorë dhe mbështetur sektorin turistik. Ky sektor lidhet edhe me rritjen e tregut për produktet origjinale të zonës apo punimet artizanale. Po kështu, grupet turistike do t'i jepnin mbështetje turizmit familjar që ka nisur të aplikohet në disa zona në mënyrë spontane.

Bashkia duhet të gjejë mundësi të reja për punësimin e grave, sidomos në biznese të vogla prodhuese dhe me profilin e ri të zhvillojë sektorin e agrobiznesit, të vreshtarisë dhe prodhimit të verës. Disa kantina të verës janë në faliment prej problemeve në këtë treg apo investimeve me kredi, ndaj bashkia duhet të hartojë politika se si ky biznes të gjejë një frymëmarrje të re dhe të bëhet i qëndrueshëm.

Shërbimet shëndetësore kanë nevojë të përmirësohen, ndërsa spitali i Përmetit ka nevojë për një staf më profesional dhe për mirëmenaxhim të shërbimeve. Po kështu, sektori arsimor ka nevojë të ristrukturohet në funksion të mbështetjes së transportit të nxënësve dhe të përmirësimit të mjediseve shkollore.

Vështirësia Financiare

Nga auditimi është konstatuar se detyrimet e konstatuara në fund të vitit 2021 paraqitën në vlerën 6,164 mijë lekë (*të akumuluar*) dhe fondet e miratuara për shpenzime të këtij viti janë në vlerën 345,118 mijë lekë. Kjo situatë tregon se Bashkia Përmet nuk mund të konsiderohet në vështirësi financiare në fund të vitit ushtrimor 2021, pasi vlera e stokut të detyrimeve të papaguara ndaj palëve të treta është 1.79%, pra nën nivelin prej 25 % të shpenzimeve vjetore të miratuara, sipas nenit 56 "Vështirësia financiare" të ligjit nr. 68/2017, datë 27.04.2017 "Për financat e vetëqeverisjes vendore".

IV. Përshkrimi i rezultateve sipas drejtimeve të auditimit

1. Auditim mbi kontrollin e brendshëm financiar publik

Identifikimi dhe vlerësimi i nivelit të implementimit të komponentëve të MFK.

Në drejtim të vlerësimit të implementimit të komponentëve të menaxhimit financiar dhe kontrollit të brendshëm në Bashkinë Përmet, nga grupi i auditimit janë kryer verifikimet për implementimin dhe plotësimin e kërkesave në lidhje me funksionimin, përgjegjshmërinë menaxheriale, realizimit të objektivave të institucionit për të gjithë komponentët si: “Mjedisi i kontrollit”, “Menaxhimi i riskut”, “Aktivitetet e kontrollit”, “Informimi dhe Komunikimi” si dhe “Monitorimi”, në referim të nenit 19 të Ligjit nr. 10296, datë 8.7.2010 “Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin” i ndryshuar me ligjin nr. 110/2015 “Për disa shtesa dhe ndryshime”, ku titullari i njësisë në sektorin publik krijojnë dhe vlerësojnë sistemet e MFK-së nëpërmjet këtyre komponentëve të lidhur me njëri-tjetrin. Thelbi i MFK-së ka të bëjë me menaxhimin dhe kontrollin e të ardhurave, shpenzimeve, aktiveve, detyrimeve, procedurave të tenderimit dhe kontraktimit si dhe mënyrës së funksionimit të njësisë.

Titulli i gjetjes: Në Bashkinë Përmet ngritja dhe funksionimi i sistemit të kontrollit të brendshëm, nuk është në nivelin e kërkuar sipas dispozitave ligjore.

Situata: Mjedisi i kontrollit. (Në zbatim të kërkesave të nenin 20 të ligjit nr. 10296, datë 8.07.2010)

-Bashkia e Përmet, me vendimin e Kryetarit të Bashkisë zj. A. H. me Vendimin nr. 08 date 20.01.2021, *ka përditësuar rregulloren* për nivelin menaxhues dhe për punonjësit e tjerë të njësisë.

Për vitin 2021, numri i punonjësve, është miratuar me Vendim i Kryetarit të Bashkisë nr. 99 datë 30.12.2020. Miratuar në total numri 313 + 2 punonjësit të QKB = 315 punonjës gjithsej, në fakt janë paguar sipas listë pagesave gjithsej 308 punonjës , nuk ka tejkallim të numrit të punonjësve.

Bashkia Përmet ka miratuar Kodin Etik me Vendim nr. 09, datë 20.01.2021, bazuar në Ligjin nr. 9131 datë 08.09.2003 “Për Rregullat e Etikës në Administratën Publike”, Ligjin nr. 10296, Kreu III, neni 20 “Mjedisi i kontrollit”, pika 2/a dhe në Manualin për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin, të hartuar dhe miratuar nga Ministria e Financës, Kap II, pika 2.5.1 “Mjedisi i Kontrollit (ose mjedisi i brendshëm i njësisë)”.


Konstatohet se struktura organizative nuk ka pasur ndryshime nga viti në vit si dhe nga ana e drejtorive apo sektorëve janë hartuar rregullore të veçantë të funksionimit të tyre sipas kërkesave të nenit 20, të ligjit nr. 10296, datë 8.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin” të cilat janë përditësuar në rregulloren e Brendshme sipas vendimit të sipërcituar.

➤ Politikat menaxheriale dhe stili i Punës

Punësimi në Bashkinë e Përmet bëhet në zbatim të Ligjit nr.139/2015 “Për Vetëqeverisjen Vendore”, Ligjit nr.152/2013 “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar dhe Ligjit nr.7961 /1995 “Kodi i Punës i Republikës së Shqipërisë” i ndryshuar, VKM nr.243/2015 i ndryshuar me VKM nr.746/2018 Kreu I pika 1,2. Kjo procedurë rregullohet nga vet Strukturat e Bashkisë së Përmet:

- Drejtoria e Burimeve Njerëzore [DBNJ] është përgjegjëse për zbatimin e hapave të procedurës së punësimit sipas nenit 10 pika 1 e Ligjit nr.152/2013 “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar dhe VKM nr.243/2015 i ndryshuar Kreu II;
- Komiteti i Përhershëm i Pranimit [KPP] në zbatim të përcaktimeve në Kreun III të VKM nr.243/2015 i ndryshuar ;

- Kryetari i Bashkisë në zbatim të nenit 64 pika e,ë,f,g të Ligjit nr.139/2015 “Për Vetëqeverisjen Vendore”.



Skema e procedurës së punësimit

Strukturat përgjegjëse të Bashkisë së Përmes hartojnë në fillim të çdo viti planin vjetor të pranimit në shërbimin civil konform Ligjit nr.152/2015 “Për nëpunësin civil” neni 18, VKM nr. 108/2014 “Për planin vjetor të pranimit në shërbimin civil”, VKB “Mbi miratimin e numrit maksimal të punonjësve dhe nivelit të pagave të tyre” si dhe Vendimeve të Kryetarit “Për miratimin e strukturave organizative të Bashkisë së Përmes” për çdo vit ushtrimor.

Planet vjetore janë miratuar me vendimet e sipërcituara dhe janë hartuar mbi nevojat e institucionit për vitin e ri ushtrimor, duke detajuar emërtimin e pozicionit dhe të njësive përbërëse në strukturë. Publikimi i vendeve vakante nga ana e Bashkisë së Përmes bëhet në faqen zyrtare të saj, konform VKM nr.243/2015 “Për pranimin, lëvizjen paralele, periudhën e provës dhe emërimin në kategorinë ekzekutive” i ndryshuar Kreu II pika 6.

Përshkrimin e punës të çdo pozicioni si dhe kriteret që duhet të plotësohen nga kandidatët duhet të jenë të përshkruara në Rregulloren e brendshme të Bashkisë. DBNJ nga ana e saj pasi njihet me planin vjetor, ndjek procedurën nga shpallja e njoftimit deri në përfundimin e saj, duke zbatuar përcaktimet ligjore në fuqi, Ligjin nr.152/2015 “Për nëpunësin civil”, VKM nr.108/2014 “Për planin vjetor të pranimit në shërbimin civil”, VKM nr.243/2015 “Për pranimin, lëvizjen paralele, periudhën e provës dhe emërimin në kategorinë ekzekutive” i ndryshuar.

-Referuar kërkesave të VKM nr. 177 datë 08.03.2017, struktura e Bashkisë së Përmes, është miratuar me Vendim nr.7 datë 20.01.2021 të Kryetarit të Bashkisë të sipërcituara.

Sipas listë pagesave të muajve janar dhe dhjetor 2021 konstatohet se është zbatuar struktura sipas vendimeve miratues.

Listë pagesat janë të firmosura nga Përgjegjësi i Financës Zj.E. M. dhe nga Specialistet e pagave Zj. K. K. dhe specialistja Zj. V. N..

Është përgatitur përmbledhësja e listë pagesave e cila është e firmosur nga Drejtori i Financës Zj .E. K. dhe nga Kryetari Bashkisë Zj. A. H., ose i deleguari i tij. Janë mbajtur listë prezencat dhe janë të firmosura nga Përgjegjësi i Burimeve Njerëzore Zj. K. Ç. dhe nga Kryetari Bashkisë Zj. A. H.

Sipas strukturës së miratuar me Vendim të Kryetarit të Bashkisë Nr. 07 date 20.01.2021, i ndryshuar janë parashikuar 40 pozicione pune të cilat trajtohen me status të nëpunësit civil si vijon;

Nga 40 vende pune me statusin e nëpunësit civil, nga të cilat;:

- 1 (një) pozicion i kategorisë së lartë,
- 3 (tre) pozicione të kategorisë së mesme drejtues,
- 10 (dhjetë) pozicione të kategorisë së ulët drejtuese
- 22 (Njëzetë e dy) pozicione të kategorive ekzekutive.

Nga 4 vende pune të lira të paplotësuara me statusin e nëpunësit civil, si vijon;

- 0 (zero) pozicion i kategorisë së lartë
- 0 (zero) pozicione të kategorisë së mesme drejtues,
- 0 (zero) pozicione të kategorisë së ulët drejtuese

- 4 (katër) pozicione të kategorive ekzistuese

Nga auditimi rezulton se 2 pozicione pune të vlerësuara me status nëpunësi civil janë plotësuar me akte të përkohshme emërimi, për shkak se pavarësisht shpalljeve të vendeve të lira të punës, nuk ka patur aplikues ose mospërmbyesës së kritereve për emërimin sipas ligjit për shërbimin civil. Gjatë vitit 2021 nuk janë krijuar vende vakante në Bashkinë Përmet.

Konstatohet se numri i personelit në Bashkinë e Përmet referuar strukturave organizative, ka ardhur në rritje, por i paplotësuar sipas planit ndonëse edhe numri faktik i tyre ka ardhur në rritje. Në rregulloren e Bashkisë së Përmet përshkrimet e punës së çdo pozicioni në strukturën organizative, nuk shoqërohen me përcaktimin e kritereve të përgjithshme dhe atyre specifike të nevojshme/të domosdoshme, sipas përcaktimeve të ligjit nr.152/2013 “Për nëpunësin civil” i ndryshuar.

Konstatim se në strukturën e Bashkisë së Përmet nuk janë planifikuar pozicione me status “ekselent” në mos zbatim të Urdhrit të Kryeministrit nr.164 datë 05.10.2017; si dhe pozicione me status të “Grup i veçantë” ku përfshihen 17 (shtatëmbëdhjetë) nënkategori të ndryshme si: persona me aftësi të kufizuara, jetimë, komuniteteve të ndryshme (romë, egjiptianë etj) si personel administrativ, në kundërshtim kjo me Ligjin nr. 152/2013 “Për Nëpunësin Civil” i ndryshuar neni 5; Ligjin nr.93/2014 “Për Përfshirjen dhe Aksesueshmërinë e Personave me Aftësi të Kufizuara” neni 1/a; neni 2 pika a/b; neni 4 pika a/ b/ ë; Ligjin nr.15/2019 dt.13.03.2019“ Për Nxitjen e Punësimit” neni 3 pika 4 “Grupe të veçanta” (17 kategori sociale); neni 20 pika 1/a e 1/b; pika 2; pika 3.

➤ **Mbi trajnimin e punonjësve në Bashkinë e Përmet.**

Gjatë vitit 2021 janë ndjekur 45 trajnime në zoom dhe 5 me pjesëmarrje fizike për njohuritë e tyre në lidhje me Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin, për Procedurat e Prokurimit Publik, etj. Por nga Bashkia e Përmet nuk rezulton të jenë hartuar Plane vjetore trajnimesh për punonjësit e saj, por përzgjedhja e personelit për trajnim është realizuar nga Drejtoria e burimeve njerëzore ose nga vet punonjësit. Trajnimi i punonjësve është i nevojshëm për të garantuar minimizimin e akteve të parregullta, gabimeve dhe shpërdorimeve, si dhe për të kuptuar se direktivat e dhëna prej menaxherëve të njësisë kuptohen dhe arrihen nga punonjësit. Përgjegjësia e menaxhimit në garantimin e profesionalizmit të punonjësve të tij fillon me miratimin e politikave dhe praktikave të duhura që lidhen me burimet njerëzore dhe që reflektojnë angazhimin për: • Caktimin e nivelit të njohurive dhe aftësive që kërkohen për çdo pozicion pune; • Verifikimin e kualifikimeve të kandidatëve për vendet e punës; • Marrjen në punë dhe ngritjen në detyrë vetëm të atyre personave që kanë njohuritë dhe aftësitë në nivelet më të larta; • Futjen e programeve të trajnimit që ndihmojnë punonjësit të zgjerojnë njohuritë dhe aftësitë e tyre. • Kryerjen e analizave periodike për njohuritë dhe aftësitë e kërkuesve për çdo pozicion pune dhe mbështetur në këto analiza, hartimin e planeve periodike për trajnimin e punonjësve; • Zhvillimin e profesionalizmit menaxherial nëpërmjet trajnimeve dhe marrjes në konsideratë të aftësive menaxhuese gjatë procesit.

Konstatohet se për vitin 2022 Drejtoria e Burimeve Njerëzore në bashkinë Përmet me shkresën nr.1514/1 datë 20.05.2022 është hartuar plani vjetor i trajnimeve në përputhje me Ligjin nr. 10296 datë 8.07.2010 “Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin” dhe “Manualit për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin”.

2- Menaxhimi i riskut (Në zbatim të kërkesave të nenin 21 të ligjit nr. 10296, datë 8.07.2010). Nga Bashkia e Përmet janë hartuar dhe miratuar Regjistrat e Riskut, ku identifikohen risqet që vijnë nga burime të brendshme dhe risqe që vijnë nga burime të jashtme:

Regjistri i Riskut për periudhën objekt auditimi 01.01.2021 deri 31.12.2021 janë miratuar konform Ligjit 10296 dt.08.07.2010, Kreu III, neni 10 ndryshuar me Ligjin nr.110/2015 si dhe Udhëzimit nr.16 dt.20.07.2016 “Për përgjegjësitë dhe detyrat e koordinatorit të MFK dhe koordinatorit të riskut në njësitë publike”. Ky regjistër është i konsoliduari, bazuar në analizën

e riskut të çdo drejtorie dhe si Synim “Planifikimi dhe Përdorimi me efikasitet, efikasitet dhe transparencë të fondeve buxhetore në përputhje me misionin e Bashkisë së Përmet, për arritjen e objektivave”. Në këtë Regjistrë është paraqitur përshkrimi i risqeve për çdo drejtori, niveli i risqeve, kontrollat ekzistuese, veprimet e ndërmarra për të adresuar risqet, zotëruesi i riskut si dhe situatën e riskut pas detyrës së fundit, por nuk është pasqyruar mënyra apo rrugëzgjdhja e situatës në rastin e ndodhjes apo konstatimit të dukurisë.

Për vitin 2021, Me urdhrin nr. 05 datë 20.01.2021, është miratuar GMS si dhe është emëruar koordinatori i riskut, në Bashkinë Përmet znj. E. K., me shkresat përkatse ju është kërkuar drejtorive hartimi i regjistrit të riskut sipas drejtorive, në përputhje me kërkesat e neni 21 të ligjit nr. 10296, datë 8.07.2010.

Me urdhrat e sipërcituar është ngritur Grupi i menaxhimit strategjik ku kryetar i GSM është Kryetari i Bashkisë, Koordinator znj. E. K. dhe z. F. H. si Koordinator të Menaxhimit Financiar dhe Kontrollit.

Pranohet fakti se bashkimi i të gjitha njësive shpenzuese, jo në të gjitha drejtimet ka qenë i mirë përgatitur i cili nuk ka mirë funksionuar, për faktin se nuk është përgatitur në kohe infrastruktura e nevojshme, duke u bërë me tepër bashkim mekanik, duke mos dhënë efektet e duhura në plotësimin e objektivave në shërbim të komunitetit dhe mos krijuar kushtet për një administratë të njësive administrative të manovrueshme dhe eficiente në shërbim të komunitet Për rrjedhojë miratimi i gjurmës së auditimit sipas përcaktimeve në nenin 16, të ligjit nr. 10296, datë 8.07.2010, nuk është në nivelin e duhur.

Nuk janë miratuar gjurmët e auditimit në pajtueshmëri me kërkesat e UMF nr. 2, datë 6.02.2012 “Për procedurat standart të zbatimit të buxhetit” pika 40 dhe ligjit nr. 10296, datë 8.07.2010, neni 4 pika 19 “Gjurma e auditimit” përfaqëson rrjedhën e dokumentuar të transaksioneve financiare dhe të transaksioneve të tjera, nga fillimi deri në përfundim të tyre, që synon të ripërshkojë të gjitha veprimtaritë individuale dhe vendimmarrjen lidhur me to. Ajo përfshin mbajtjen e dokumentacionit, raportimin, kontabilitetin dhe sistemin e mbajtjes së dosjeve” dhe neni 16 pika 2.

-Konstatohet se urdhër shpenzimet nënshkruhen nga nëpunësi Autorizues dhe Nëpunësi Zbatuar si dhe nuk është deleguar e drejta e nënshkrimit të urdhër shpenzimeve për kryerje e transaksioneve, në referencë të nenit 21, pika 1,2 dhe 3, të ligjit nr. 10296, datë 08.07.2010 “Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin”.

Nga Kryetari i Bashkisë, nëpunësi autorizues dhe nëpunësi zbatues është punuar për të përmbushur qëllimet Bashkisë, siç janë parashtruar në raportin për menaxhimin financiar dhe Kontrollin, në pyetësorin e plotësuar “Për Menaxhimin financiar dhe kontrollin”, “Deklaratën e funksionimit të kontrollit brendshëm financiar publike”.

3-Veprimtaritë e kontrollit (Në zbatim të kërkesave të nenin 22 të ligjit nr. 10296, datë 8.07.2010).

Nga dokumentacioni që na u vu në dispozicion lidhur me takimet e detyrueshme vjetore të GMS, që referuar Ligjit nr.10296/2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin” dhe “Manualit të Menaxhimit financiar dhe kontrollin” citohet se “Grupi për Menaxhimin Strategjik duhet të mblidhet të paktën katër herë në vit. Vendimet e Grupit duhet të merren në mënyrë kolegjiale dhe objektive duke patur në vëmendje interesin publik dhe në përputhje me standardet etike të sektorit publik. Vendimet e Grupit duhet të pasqyrohen në dokumente dhe t’i vihen në dispozicion menaxhimit të njësive”

Konstatohet se Bashkia Përmet ka miratuar një plan pune vjetor të GMS lidhur me aktivitetet dhe çështjet që do të analizohen, si dhe grafikun e takimeve që do të zhvillohen nga ana e këtij grupi si dhe referuar procesverbaleve vendimeve të takimeve ka të dokumentuar takimet e GMS për vitin 2021 në përputhje me ligjit nr.10296/2010 “Për Menaxhimin financiar dhe Kontrollin” dhe “Manualit të menaxhimit financiar dhe Kontrollin”.

Strategjia e riskut përcakton mënyrën se si sillet institucioni ndaj risqeve dhe vendos kuadrin e përgjithshëm të procesit të menaxhimit të riskut. Strategjia e riskut e një njësie duhet të miratohet nga titullari i njësisë, e cila përgatitet nga NA dhe duhet t'u vihet në dispozicion punonjësve dhe të njihet prej tyre.

Duhet theksuar se në procesin e miratimit të planeve vjetore të punës, duhet të merren parasysh risqet më të rëndësishme që mund të ndikojnë në arritjen e objektivave të përcaktuara. Gjithashtu e rëndësishme është që të ketë një lidhje në mes të planeve vjetore të punës me planin strategjik të njësisë publike. Lidhjet e qarta midis planit strategjik, planit vjetor të punës dhe buxhetit vjetor shërbejnë si pikënisje për procesin e menaxhimit të riskut në çdo nivel të njësisë publike.

- Nga auditimi rezulton se në lidhje me *identifikimi i riskut, vlerësimi i riskut, adresimi i riskut dhe shqyrtimi i riskut*: Mungojnë raportet mbi mangësitë në sistemin e kontrollit të brendshëm të njësisë publike, për pasojë nuk ka as një plan menaxhimi për veprime korrigjuese, kur shfaqen mangësi në sistemin e kontrollit të brendshëm. -Mungon plani strategjik për monitorimin dhe arritjen e objektivave, në të cilën duhet të përfshiheshin aktivitetet, plan veprimet për arritjen e qëllimeve strategjike, duke përcaktuar dhe afatet përkatëse dhe sektorët me personat përgjegjës. *VKB nr. 6 date 31.01.2022* është miratuar dhe Plani i Integritetit për Bashkinë Përmet. Bashkia Përmet nuk ka te miratuar një strategji te mirëfilltë, por si pjese e Rregullores ne Nenin 7 te saj shprehen disa nga prioritetet strategjike. Gjithashtu prioritetet strategjike janë dhe pjese e PPV i cila është miratuar. Gjithashtu me VKB është miratuar PBA për periudhën 2022-2024.

Konstatohet se nga Bashkia Përmet Nuk është hartuar asnjë strategji për menaxhimin e riskut, në kundërshtim me nenin 21, pika 2 të ligjit nr. 10296, datë 08.07.2010 “Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin”, ku citohet se; “Titullari i njësisë publike miraton një strategji risku, e cila përditësohet çdo tre vjet ose sa herë që ka ndryshime thelbësore të mjedisit të riskut”.

Referuar Ligjit nr. 10296, datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, politikat dhe procedurat që vendosen, si parandaluese apo zbuluese në adresimin e risqeve sjellin arritjen e objektivave të institucionit. Bashkia Përmet nuk ka patur në strukturën e saj Auditin e Brendshëm, e cila sjell mungesën e vlerësimeve specifike për sistemet e kontrollit të brendshëm. Për dokumentacionin e financës nuk parashikohet dhe specifikohet ndonjë rregull i veçantë, por veprohet në bazë të legjislacionit për arkivat.

Në lidhje me parimin 11:“Njësia publike përzgjedh dhe zhvillon aktivitete të kontrollit të përgjithshme të kontrollit të teknologjisë”.

- Bashkia Përmet nuk ka procedura të përshtatshme për të siguruar IT të ndryshme në sektorë të ndryshëm si dhe nuk ka plan investimesh për programet e IT. Jo çdo sistem ka procedurën e vet të ruajtjes së të dhënave nga ndërhyrjet e paautorizuara. Gjithashtu nuk ka procedurë për ruajtjen e të dhënave të aktiveve. Mungon sistemi i IT dhe nuk ka një procedurë të përshtatshme për hedhjen e të dhënave në një sistem rezervë (back-up).

4- Informacioni dhe komunikimi (Në zbatim të kërkesave të nenin 23 të ligjit nr. 10296, datë 8.07.2010).

Bashkia Përmet disponon faqen e saj zyrtare në Web, ku pasqyrohet aktiviteti i saj. Komunikimi realizohet elektronikisht, verbalisht dhe në formë shkresore. Me subjektet komunikimi kryhet nëpërmjet telefonit, postës zyrtare apo elektronike. Grupi auditues konstaton se drejtorit kryesore përdorin email-it zyrtar të institucionit duke qënë se sistemi ofron një numër të kufizuar adresash email-i.

Titullari informohet nga drejtuesit e programeve nëpërmjet mbledhjeve, raporteve dhe relacioneve të ndryshme. Në Bashkinë Përmet punonjësit punojnë me këto sisteme informatike Word dhe Excel. Punonjësit komunikojnë drejtpërdrejtë me eprorët sipas shkallës hierarkike për probleme apo parregullsi, në rrugë elektronike.

Në lidhje me parimin 14: Njësia publike përdor komunikimin e brendshëm.

Në lidhje me parimin 15: Njësia publike përdor komunikimin e jashtëm.

5-Monitorimi (Në zbatim të kërkesave të nenin 24 të ligjit nr. 10296, datë 8.07.2010).

Bashkia Përmet i dërgon Ministrisë së Financave dhe të Ekonomisë, për periudhat Janar- Prill, Janar- Gusht dhe Janar- Dhjetor, në total tre raporte vjetore për ecurinë dhe realizimin e produkteve, masën e realizimit të shpenzimeve për vitin 2021. Raporti i monitorimit për periudhën Janar- Prill është dërguar në MFE: me komunikim me email, raporti i monitorimit për periudhën Janar- Gusht është dërguar në MFE me shkresën nr. 1306/2 datë 30.09.2021 dhe raporti i monitorimit për periudhën Janar- Gusht është dërguar në MFE me shkresën nr. 883 datë 18.03.2022.

Raporti për Funkcionimin e Cilësisë së Kontrollit të Brendshëm dhe Planin e Veprimit të Menaxhimit Financiar dhe Kontrollit janë dërguar në Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë, si dhe në Drejtorinë e Harmonizimit të Menaxhimit Financiar dhe Kontrollit për vitin 2021: Raportimi mbi aktivitetin e strukturave që ata drejtojnë, përmban informacione dhe evidenca të ndryshme, ku bazohet dhe Raporti vjetor i monitorimit i cili i dërgohet Ministrisë së Financave. Monitorimin e sistemit të Menaxhimit Financiar dhe Kontrollit, Bashkia Përmet e kryen bazuar në Rregulloren e Brendshme, dokumentin e PBA- ve si dhe raporteve të monitorimit.

Në Bashkinë Përmet mungojnë rregulla të brendshme të miratuara për monitorimin e Sistemit të Menaxhimit Financiar dhe Kontrollit. Në Bashkinë Përmet aktivitetet e vlerësimit të njësisë janë pjesërisht në përputhje me burimet dhe pjesërisht të përshtatshme për të përmbushur qëllimet për të cilat janë ngritur, pasi mungojnë Planet e Menaxhimit dhe Raportet e Zbatimit, mungojnë Indikatorët e Performancës si dhe Komiteti i Auditimit. - Një nga drejtimet e monitorimit kanë të bëjë me aktivitetin e Auditimit të Brendshëm në kundërshtim me kërkesat e nenin 24 të ligjit nr. 10296, datë 8.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”.

Kriteri:

Ligji nr. 10296, datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin” neni 4 pika 19 "Gjurma e auditimit", neni 21; UMF nr. 2, datë 6.02.2012 “Për procedurat standart të zbatimit të buxhetit” pika 40.

Shkaku:

Neglizhencë e drejtorive/sectorëve për hartimin e regjistrit të riskut, hartimin e strategjisë së riskut si dhe miratimin e gjurmëve të auditimit.

Ndikimi/Efekti:

Mungon ndarja e qartë e detyrave sipas drejtorive/sectorëve, mos identifikim i shkallës së riskut, mos trajnim efektiv për rritjet profesionale të stafit.

Rëndësia: *E mesme*

Rekomandimi:

Kryetari i Bashkisë Përmet, në cilësinë e Titullarit të Institucionit, Nëpunësit Autorizues, si dhe Kryetarit të GMS-së, duhet të marrë masa të menjëhershme për:

- Grupi i Menaxhimit Strategjik, të hartoj strategjia e riskut, si dhe për aktivitetet dhe proceset kryesore të punës që zhvillohen në institucion, të hartohet gjurma e auditimit dhe harta e proceseve të punës.

- Rregullimin e pozicioneve të punës për punonjësit të cilët sipas ligjit, duhet të trajtohen si “Nëpunës Civilë”, bazuar në ligjin “Për statusin e nëpunësit Civil”, por që janë trajtuar si punonjës bazuar në “Kodin e Punës”, si dhe të njoftojë DAP për procedurat e konkurrimit, duke zbatuar procedurat e përcaktuara në ligjin për Nëpunësin Civil.

- Sektori i Burimeve Njerëzore në strukturën organizative të planifikoj pozicione me status “ekselent” dhe pozicione me status të “Grup i veçantë” në zbatim të Urdhrit të Kryeministrit si dhe vendosjen e një sistemi komunikimi që të ofrojë informacionin e duhur për të gjithë punonjësit, menaxherët e lartë dhe titullarin e njësisë.

Rekomandimi: Kryetari i Bashkisë Përmet të marrë masa për organizimi i shërbimit të auditimit të brendshëm në bashki, duke krijuar Njësinë e Auditimit të Brendshëm brenda strukturës organizative të Bashkisë.

(Për problemet e mësipërme është mbajtur akt-konstatimin nr. 1, datë 07.10.2022)

2. Auditim mbi planifikimin, zbatimin dhe monitorimin e planit të buxhetit

2.1. Programimi PBA dhe programimi i buxhetit vjetor 2021;

2.2. Çelja e fondeve buxhetore të vitit dhe ndryshimet sipas akteve normative. Kontrolli i realizimit të shpenzimeve bazuar në nivelin e fonde të çelura;

2.3. Auditim mbi saktësinë e realizimit të treguesve buxhetorë dhe pasqyrimi në raportet e monitorimit.

Fondet e shpenzuara nga njësia vendore për shkak të situatës COVID -19, miratimi i këtyre fondeve sipas kuadrit rregullator në fuqi.

2.4. Vlerësimi i risqeve buxhetore nga niveli i faturave të palikujduara, vendimet gjyqësore, vendimet e shpronësimeve; (Faturat e palikuiduara të shoqërohen me listë analitike, të detajuara me numër fature dhe datë krijimi etj, sipas raportimit në MFE, ku të evidentohen detyrimet nga mungesa e burimeve të veta dhe detyrimet nga mungesa e alokimit të granteve si FZHR, Ministrinë e linjës etj.).

2.5. Çelja dhe ekzekutimi i fondeve të përfituara përmes FZHR, saktësia e raportimit buxhetor të tyre;

Në zbatim të programit të auditimit, u shqyrtua dokumentacioni si më poshtë:

Situacioni i shpenzimeve rakorduar me Degën e Thesarit;

- Situacioni i të ardhurave rakorduar me Degën e Thesarit’;
- PBA dhe buxheti vjetor;
- Raportet e monitorimit;
- Vendimet e Këshillit Bashkiak “Për miratimin e buxhetit të Bashkisë Përmet”;
- Vendime të tjera të Këshillit Bashkiak, në lidhje me ndryshimet buxhetore;
- Dokumente të bankës etj.

Nga shqyrtimi i dokumentacionit të sipërcituar konstatohet :

2.1. Programimi PBA dhe programimi i buxhetit vjetor për vitin 2021;

Nga auditimi i procedurave për përgatitjen PBA 2021-2023, u konstatua se janë realizuar fazat e përgatitjes, është bërë ngritja e grupit të punës, është bërë marrja e kërkesave për nevojat për punë, mall e shërbime, llogaritja e planifikimit për të ardhurat e veta, përcaktimi i tavaneve të shpenzimeve sipas programeve, etj.

Për hartimin e programeve buxhetore afatmesme dhe projektbuxhetet vjetore janë kryer konsultime me komunitetin dhe grupet e interesit në njësinë e vetëqeverisjes vendore. Buxhetet janë hartuar mbi bazën e kërkesave shkresore nga njësitë administrative, drejtoritë e shkollave, sektorët e bashkisë etj, gjë që vërteton se prej tyre janë marrë kërkesat për nevojat reale e mbi bazën e tyre dhe të buxhetit faktit të mundshëm janë përzgjedhur ato më prioritare.

Me Urdhrin nr. 86, datë 11.02.2020, është ngritur Grupi për Menaxhimin Strategjik (GMS) për përgatitjen e Programit Buxhetor Afatmesëm 2021- 2023.

Planifikimi i programit buxhetor afatmesëm 2021- 2023 është miratuar me Vendim të Këshillit Bashkiak, me nr. 74, datë 21.10.2020.

Miratimi i tavaneve të buxhetit afatmesëm 2021-2023 Vendim i Këshillit Bashkiak nr. 51, datë 11.08.2020, jashtë afatit të kërkesave të Ligjit nr. 68/2017 “Për financat e vetëqeverisjes vendore”, neni 37.

Vendimi i Këshillit Bashkiak me nr. 1, datë 31.01.2020, “Për vlerësimet dhe parashikimet afatmesme të të ardhurave të Bashkisë Përmet për vitet 2021-2023”, jo më vonë se 31 Janar,

brenda afatit të kërkesave të Ligjit nr. 68/2017 “Për financat e vetëqeverisjes vendore”, neni 34.

Këshilli Bashkiak Përmet ka marrë Vendimin për Miratimin e Kalendarit të përgatitjes së Programit Buxhetor Afatmesëm 2021- 2023 dhe Buxhetin Vjetor 2021, me Nr. 2, datë 31.01.2020, në mos zbatim të afateve të Ligjit nr. 68/2017 “Për financat e vetëqeverisjes vendore”, neni 33, e specifikuar brenda datës 31 Dhjetor.

Në buxhetin e vitit 2021 janë përfshirë edhe projektet nga fonde të huaja (për të cilat operohet me llogaritë speciale të çelura në bankat e Nivelit të Dytë) sipas udhëzimit Nr.35 dt.21.09.2020 “Për kontrollin, regjistrimin, përdorimin, rakordimin, raportimin dhe publikimin e fondeve të financimeve të huaja në kuadrin e marrëveshjeve ndërkombëtare” .

Në projekt buxhet 2021 është përfshirë vlerën 66,716,000 lekë dhe gjatë vitit është shtuar vlera prej 9,824,000 lekë (dy projekte të reja) me VKB nr.73 datë 01.11.2021.

Të dhënat për PBA dhe projekt buxhetet për vitin 2021 sipas tabelave në vijim:

	Emërtimi	Buxheti Faktik 2020	Faza e I PBA 2021	Faza e II PBA 2021	Projekt Buxhet 2021
600	Paga	133,211	124,979	124,979	153,108
601	Sigurime Shoqërore	22,517	25,055	25,055	24,444
602	Mallra dhe Shërbime të Tjera	43,288	38,890	38,890	55,477
605	Transferta Korente të Huaja				
606	Trans per Buxh. Fam. & Individ	5,160	8,380	8,380	8,311
I	Shpenzime Korrente	204,176	197,304	197,304	241,340
230	Kapitale të Patrupëzuara	90			1,300
231	Kapitale të Trupëzuara	30,125	44,050	44,050	91,979
	Shp. Kapitale me financim te brendshem	30,125	699,574	699,574	93,279
230	Kapitale të Patrupëzuara				
	Shpenzime Kapitale me financim te huaj	62,067	7,775	7,775	57,422
602	Mallra dhe Shërbime të Tjera				9,294
II	Shpenzime Kapitale	92,192	751,399	751,399	
III	Shpenzime nga Të ardhurat jashte limiti				
I+II +III	Totali I Shpenzimeve	296,368	948,703	948,703	401,335

Burimi: Drejtoria e financës

Në formë table paraqitet planifikimi bazë i buxhetit për vitin 2021 dhe ndryshimet në tabelën vijuese:

Njesia	Bashkia Përmet + Ndërmarjet e vartësisë Viti 2021								
	Art.	Emertimi	(1)	(2)	(3)	(4)	(6)	(7)=(6)-(5)	
			Fakti	PBA	Buxheti Vjetor	Buxheti Vjetor	Fakti	Diferenca	% e realizimit
			i vitit paraardhes	Plan Viti 2021	Plan Fillestar Viti 2021	Plan i Rishikuar Viti 2021	i 12-mujorit		
		Viti 2020							
600	Paga	133,211	124,979	153,108	154,675	143,639	11,036	93	
601	Sigurime Shoqërore	22,337	25,055	24,444	24,758	23,588	1,170	95	
600+601	Paga +Sigurime	155,728	150,034	177,552	179,433	167,227	12,206	93	
602	Mallra dhe Shërbime të Tjera	38,791	38,890	55,477	57,380	43,958	13,442	76	
603	Subvencione					-	-	-	
604	Transferta Korente të Brendshem	4,497		700	700	503	197	72	
605	Transferta Korente të Huaja					-			
606-609	Transf. per Buxh. Fam. & Individ	5,160	8,380	7,611	5,921	2,257	3,364	36	
602-609	Shpenzime operative	48,448	47,270	63,788	64,001	46,718	27,107	63	
	Shpenzime Korrente	204,176	197,304	241,340	243,434	213,945	39,323	84	

230	Kapitale të Patrupëzuara	90		1,300	1,300	30	1,270	2
231	Kapitale të Trupëzuara	30,035	751,399	91,979	96,958	30,867	66,091	32
<i>Totali</i>	<i>Shpenzime Kapitale</i>	30,125	751,399	93,279	98,258	30,897	67,361	31
<i>Totali (korrente + kapitale)</i>		234,301	948,703	334,619	341,692	244,842	96,850	72

Burimi: Drejtoria e financës

Për vitin 2021, buxheti bazë/fillestar vjetor (në bazë të vlerësimit të të ardhurave dhe të transfertave të pakushtëzuara, të përcaktuara në ligjin e buxhetit vjetor), është miratuar me VKB nr. 99 datë 30.12.2020, konfirmuar nga Institucioni i prefektit Qarkut me shkresën nr. 51/1 datë 19.01.2021.

Në këtë VKB, të ardhurat nga burimet e veta të planifikuara për vitin 2021 kanë vlerën 92,219 mijë lekë, transfertat e pakushtëzuar ka vlerën 140,074 mijë lekë, transfertat specifike në vlerën 102,326 lekë.

Në total të ardhurat kanë vlerën 334,619 mijë lekë, po ashtu edhe shpenzimet kanë vlerën 334.619 mijë lekë.

Gjatë vitit 2021, janë marrë gjithashtu edhe disa vendime të tjera të këshillit bashkiak të cilat kanë bërë që të ndryshojnë vlerat e buxhetit bazë (miratuar në dhjetor 2020). Këto ndryshime paraqiten si vijon:

- Nga këshilli bashkiak Përmet janë marrë vendime për miratimin e buxhetit shtese apo ndryshime të tij si me poshtë :

1.VKB nr,12 datë 02.02.2021 “Për miratimin e fondit që do të përdoret për përballimin e situatës emergjente që vazhdon nga përhapja e COVID-19”.

Të pakësohen fondet e planifikuara në strukturën 4,980 (emergjenca civile) në llogarinë 609 për “Blerje materiale mbrojtëse në kuadër të përballimit të situatës emergjente ndaj COVID-19”, në vlerën 600,000 lekë dhe të shtohen shpenzimet në vlerën 600,000 lekë në llogarinë 602.

2.VKB nr.13 datë 03.03.2021” Për një shtesë në VKB nr. 99 datë 30.12.2020 “ Për miratimin e buxhetit të bashkisë për vitin 2021“

- Të shtohen të ardhurat e bashkisë në vlerën 2,073,160 lekë
- Të shtohen shpenzimet sipas detajimeve të mëposhtme:

Grup	Kod.programi	Kapitull	Llog.ekonomike	Vlera
00	9120	01	600	1,566,706
00	9120	01	601	314,094
00	10460	05	6061005	183,360
00	10460	05	6029099	9,000

3.VKB nr.29 datë 14.04.2021 “ Për përdorimin e fondit rezervë për shpenzimin në zërin e studimit e vlerësimit paraprak të ndikimit në mjedis për projektin “ Ndërtim i Ujësjellësit Pacomit, Bashkia Përmet” në vlerën 30,000 lekë .

Të pakësohet fondi rezervë i planifikuar në strukturën 4980 në llogarinë 609 “ Për VMN Ndërtim i Ujësjellësit Pacomit”, në vlerën 30,000 lekë dhe të shtohet llogaria 230 për 30 000 lekë.

4.VKB nr.22 datë 14.04.2021 “ Për miratimin e përdorimit të fondit rezervë për shpenzime buxhetore të paplanifikuara” në vlerën 100,000 lekë.

- Të pakësohen fondet në strukturën 04980, llogaria 609 në vlerën 100,000 lekë
- Të shtohen shpenzimet në 602 në vlerën 100 000 lekë(blerja e Tabelës së basketbollit)

5.VKB nr.34 datë 02.06.2021 “ Për një ndryshim në VKB nr. 99 datë 30.12.2020 “Për pagesën e pikës së lidhjes së energjisë elektrike për stacionin e pompimit për rrjetin ujitës Bodar -Kutal.

- Të pakësohen fondet :

Grup	Kod.programi	Kapitull	Llog.ekonomike	Vlera
00	4240	01	6023200	135,000
00	4240	05	231	271,545

• Të shtohen fondet:

Grup	Kod.programi	Kapitull	Llog.ekonomike	Vlera
00	4240	01	6023200	135,000
00	4240	05	231	271,545

6.VKB nr.66 datë 29.09.2021 “Për miratimin e përdorimit të fondit rezervë për shpenzime buxhetore të paplanifikuara” në vlerën 130,000 lekë.(ndihme financiare për tre familje në nevojë)

- Të pakësohen fondet në strukturën 04980 ,llogaria 609 në vlerën 130,000 lekë
- Të shtohen shpenzimet në 606 në vlerën 130,000 lekë

7. VKB nr.670 datë 29.09.2021 “Për miratimin e përdorimit të fondit rezervë për shpenzime buxhetore të paplanifikuara” në vlerën 10 000 lekë (për dhënie shpërblim lindje)

- Të pakësohen fondet në strukturën 04980, llogaria 609 në vlerën 10,000 lekë
- Të shtohen shpenzimet në 606 në vlerën 10,000 lekë

8. VKB nr.73 datë 01.11.2021 “ Për disa shtesa në VKB nr.99 datë 30.12.2020 “Për miratimin e buxhetit të Bashkisë për vitin 2021“.

1.Të ardhurat e Bashkisë për vitin 2021, të shtohen me 5,000,000 lekë ,transfertë kjo nga Këshilli i Qarkut Gjirokastrë.

2.Shpenzimet e Bashkisë për vitin 2021, të shtohen me 5,000,000 lekë, sipas detajimeve të më poshtme:

Grup	Kod.programi	Kapitull	Llog.ekonomike	Vlera
00	4530	01	231	5,000,000

3.Të ardhurat e pritshme nga marrëveshjet ndërkombëtare (projektin MAPCULT) për vitin 2021, të shtohen me 9,824,000 lekë sipas tabelës së planit të të ardhurave 2021.

4.Shpenzimet për marrëveshjet ndërkombëtare (projekti MAPCULT) për vitin 2021,të shtohen me 9,824,000 lekë ky fond detajohet:

- (602) në vlerën 686,656 lekë
- (604) në vlerën 7,983,076 lekë
- (230) në vlerën 1,154,345 lekë

9.VKB nr.66 datë 29.09.2021 “Për miratimin e përdorimit të fondit rezervë për shpenzime buxhetore të paplanifikuara” në vlerën 60,000 lekë.(ndihme financiare për dy familje në nevojë)

- Të pakësohen fondet në strukturën 04980 ,llogaria 609 në vlerën 60,000 lekë
- Të shtohen shpenzimet në 606 në vlerën 60,000 lekë

10.VKB nr.79 datë 01.11.2021”Për miratimin e fondit për krijimin e rezervave material të domosdoshme për përballimin e situatave emergjente që në momentet e para për t’i ardhur në ndihmë komunitet” në vlerën 960,000 lekë.

2.2. Çelja e fondeve buxhetore të vitit dhe ndryshimet sipas akteve normative. Kontrolli i realizimit të shpenzimeve bazuar në nivelin e fonde të çelura.

-Krahasimi planeve buxhetore me PBA respektive:

PBA 2021-2023 me planin buxhetor 2021, paraqitet në tabelën e mëposhtme:

Në 000/lekë

Nr.	Emërtimi	Plan përfundimtar 2021	Sipas PBA 2021-2023	Ndryshimi
1	Shpenzime për pagat (600+601) (nga te ardhur e grant i pakush e spec)	179,433	150,034	-29,399
2	Shpenzime (602.604.609) (nga ardhura e grant i pakushtez e specif)	64,001	42,270	-21,731
3	Investime Bashkia (nga te ardhura e grant I pakushtez)	98,258	751,399	
4	Investime nga FZSH	0		
	Total I planit fillestar	341,692	948,703	
	Shtesat nga Pushteti Qendror			
5	Investime grant i kushtëzuar	40,060		
6	Shpenzime për pagat (600+601)	6,394		
7	Shpenzime (602.604.609)	90,532		
	<i>Grant i kushtëzuar</i>	<i>136,986</i>		
	Gjithsej	478,678	948,703	

Burimi: Nga përpunimi i të dhënave sipas planeve të paraqitura nga subjekti.

Nga auditimi konstatohet se ndryshimet midis planit buxhetor vjetor 2021 dhe planit vjetor 2021 në PBA vijnë si rezultat i shtesës së rritjes së pagës së edukatoreve me VKM nr. 1149, datë 24.12.2020 “Për ndryshime të vendimit nr. 175, datë. 08.03.2017 dhe pagës minimale në shkallë vendi, me VKM nr. 1025, datë 16.12.2020 “Për përcaktimin e pagës minimale në shkallë vendi”. -Transferata e pakushtëzuar dhe ajo sektoriale nuk ka qenë e planifikuar në nivel të barabartë në PBA me atë që është transferuar në plan buxhet të vitit 2021. Investimet dhe shpenzimet operative nga projektet nuk regjistrohen nga dega e Thesarit. Plani i investimeve për vitin buxhetor regjistrohet në thesar me kod projekti nga ministria e financave në momentin kur janë kryer procedurat e regjistrimit të kërkesë blerjes në Degën e Thesarit Përmet.

Gru p	Kodi		art	qark	lok	Emri i programit	Vlera vjetore plote	Shpenzime 2021	%
	Tit	Ka p							
0	8250	2	230	1128	135	Ekspertizë e jashtme për Digitalizimin e mbledhjes së të dhënave, konvertimin e mediave, softuerin e katalogimit, përkthimin e ndërfaqeve dhe faqes në internet, interloan dixhital, kryerjen e intervistave dhe transkriptimet e dokumenteve, botimin, takimet, ditët e informacionit, materialin e shtypur(Exploral)	4,901,638	0	0%
0	8250	2	231	1128	135	Pajisjeve kompjuterike, regjistruetit dhe skanerit të librave për Bibliotekën e Përmetit(Exploral)	1,175,720	1,165,732	99%
0	8250	2	231	1128	135	Blerja e mobiljeve për Bibliotekën e Përmetit(Exploral)	1,021,391	0	0%
0	8250	2	231	1128	135	Rinovim shtesë i gjerë për ndërtesën e Bibliotekës së Bashkisë të Përmetit sipas studimit(Exploral)	1,762,475	450,000	26%
0	8250	2	602	1128	135	Shpenzime operative	569,000	0	0%
						Totali EX.TOUR	9,430,224	1,615,732	17%
0	8250	2	230	1128	135	Ekspertizë e jashtme për Menaxhim, Publicitet, Konferencë, Shërbime TIK dhe specifikimet teknike për fushat e ngjitjes(Ex-Tour)	1,244,255	1,057,290	85%
0	8250	2	230	1128	135	Prodhimi i materialeve dhe mjeteve të komunikimit (Ex-Tour)	433,160	0	0%
0	8250	2	230	1128	135	Ekspertize e jashtme për organizimin e pjesëmarrjes dhe aktivitetet në Kampin Veror (Ex-Tour)	1,485,120	0	0%
0	8250	2	231	1128	135	Punimet e ndërtimit të fushave të Ngjitjes në Përmet(Ex-Tour)	2,970,240	449,517	15%
0	8250	2	602	1128	135	Shpenzime operative	651,000	0	0%
						Totali EX.TOUR	6,783,775	1,506,807	22%
0	8250	2	230	1128	135	Ekspertizë e jashtme për studime, punëtori, ditë të hapura, trajnime dhe veprime pilot për projektin Klubet e Biznesit(B.C)	4,616,372	1,423,585	31%
0	8250	2	230	1128	135	Ekspertize e jashtme për vizitat studimore(B.C)	1,076,712	0	0%
0	8250	2	231	1128	135	Blerja e mobiljeve, pajisjeve për zyre, kompjuterave, pajisjeve kompjuterike dhe	1,794,520	152,600	9%

						pajisjeve / programeve për karta për inkubatorët në Bashkinë e Përmetit(B.C)			
0	8250	2	231	1128	135	Rregullimet e dhomave për Inkubatorin në Bashkinë e Përmetit(B.C)	309,400	302,364	98%
0	8250	2	602	1128	135	Shpenzime operative	751,000	0	0%
Totali Business Clubs							8,548,004	1,878,549	22%
0	8250	2	230	1128	135	Ekspertizë e Jashtme për Menaxhimin e Projektit, Publicitetin, Atlasin Kulturor dhe modelet 3D (Stone Art)	4,826,640	0	0%
0	8250	2	230	1128	135	Punëtori e Përbashkët e Masonerisë së Gurit / Konferenca Finale / Dita e Informacionit (Stone art)	1,485,120	0	0%
0	8250	2	231	1128	135	Qendra dixhitale e ekspozitës (Stone Art)	1,856,400	0	0%
0	8250	2	231	1128	135	Rehabilitimi i Qendrës Kulturorë Permet (Stone Art)	4,789,029	2,540,000	53%
0	8250	2	602	1128	135	Shpenzime operative	532,000	0	0%
Totali STONE.ART							13,489,189	2,540,000	19%
0	8250	2	231	1128	135	Rikonstruksioni I Kinemase se qytetit Permet(IADSA)	21,674,076	17,133,720	79%
0	8250	2	604	1128	135	Transferime te shoqata C.	6,791,000	3,717,128	55%
					Tot li IAD SA		28,465,076	20,850,848	73%
0	10460	2	230	1128	135	Ekspertizë për menaxhim	1154000	0	0%
0	10460	2	230	1128	135	Shpenzime operative	687,000	0	0%
0	10460	2	230	1128	135	Transferata te shoqata U.	7,983,000	0	0%
Totali MAPCULT							9,824,000	0	0%
TOTALI							76,540,268	28,391,936	37%

Burimi: Bashkia Përmet

Plani përfundimtar i buxhetit ka diferenca prej 136,986 mijë lekë nga plani në PBA për shkak se në planin përfundimtar janë pasqyruar rritja e grantit të pakushtëzuar 136 milion lekë.

Në programet buxhetore është bërë shpërndarja e fondeve të vënë në dispozicion nga Pushteti Qendror të grandëve nëpërmjet transfertës së pakushtëzuar, transfertës së kushtëzuar dhe fondeve të krijuar nga burimet e veta, për kryerjen e funksioneve të veta, ato të deleguara dhe të përbashkëta si dhe shpërndarjen e fondeve të grandëve.

Ndarja e plan buxhetit dhe detajimi i tyre në nivel titulli, kapitulli, artikulli dhe nën artikulli është kryer në respektim të disiplinës buxhetore sipas strukturës dhe burimeve të financimit. Gjatë vitit si rezultat i çeljeve të reja në llogarinë e njësisë vendore në thesar, vlerat përkatëse të buxhetit vjetor kanë pësuar ndryshime në kuptimin e vlerës totale, pasi janë çelur fondet për funksionet e deleguara, grandëve qeveritare, ndihma ekonomike, gjendja civile, shpërblime lindje, etj., të cilat nuk kanë qenë të pasqyruara në çeljen fillestar të vitit.

Gjatë viteve janë kryer ndryshime në buxhet (shtesa/ pakësimi). Këto lëvizje në rastet e lëvizjeve brenda të njëjtit artikull dhe brenda programit janë kryer me urdhër të Titullarit në mbështetje të Udhëzimit nr.9 dt.20.03.2018”Për procedurat standarte të zbatimit të Buxhetit” pika 100 germa “b” dhe “c” ndërmjet zërave të shpenzimeve kapitale, brenda të njëjtit program, miratohen nga Kryetari i Njësisë së Qeverisjes Vendore, ndërsa lëvizjet nga programi në program dhe nga një artikull në tjetrin janë kryer me Vendim të KB.

- Planifikimi dhe detajimi i buxhetit në nivel artikulli dhe nën artikulli, është bërë sipas nevojave të paraqitura dhe kërkesave për fonde buxhetore, duke u bazuar në kërkesat e udhëzimeve përkatëse “Për procedurat standarde të zbatimit të buxhetit”.

- Akordimi fillestar i buxhetit dhe ndryshimet që kanë pësuar zërat e tij gjatë vitit, janë të rakorduar me Degën e Thesarit dhe janë të raportuara periodikisht pranë degës së Thesarit dhe në MFE. Situacionet e shpenzimeve janë të plotësuara sipas klasifikimit buxhetor për të gjithë periudhën e audituar. Fondet e akorduara në planet buxhetore dhe ndryshimet e bëra në periudha të ndryshme, janë evidentuar dhe janë ndjekur në dinamikë, në nivel titulli, kapitulli, artikulli dhe nën artikulli sipas shërbimeve dhe më vete për çdo njësi vartëse e sipas periudhave të planifikuara.

- Analiza e shpenzimeve buxhetore për artikuj dhe nën artikuj është bërë periodikisht mbi bazën e situacioneve mujore të konfirmuara nga Dega e Thesarit. Raportimi i realizimit të buxhetit është i shoqëruar me relacionin e realizimit të buxhetit duke argumentuar edhe shtesat e buxhetit gjatë periudhës ushtrimore për zërat e buxhetit të planifikuara dhe që nuk janë alokuar fonde që në fillim të çeljes së buxhetit.

Janë kryer ndryshime të vazhdueshme në buxhetin vjetor, veprime që tregojnë se planifikimi i buxhetit duhet të bëhet më i argumentuar, në mënyrë që gjatë vitit ndryshimet të jenë sa më të vogla.

2.3. Auditim mbi saktësinë e realizimit të treguesve buxhetor dhe pasqyrimi në raportet e monitorimit. Fondet e shpenzuara nga njësia vendore për shkak të situatës Covid-19, miratimi i këtyre fondeve sipas kuadrit rregullator në fuqi.

Për zbatimet e buxheteve është rakorduar çdo muaj me Degën e Thesarit, si për shpenzimet e kryera ashtu edhe për të ardhurat, duke mbajtur akt-rakordimet përkatëse. Janë ruajtur kufijtë e miratuar të shpenzimeve në total dhe për çdo artikull e nënartikull sipas klasifikimit ekonomik.

Pasqyra e realizimit të treguesve të buxhetit viti 2021, referuar akt-rakordimet me thesarin paraqitet në tabelën e mëposhtme:

Buxheti përfundimtar Plan-Fakt Bashkia Përmet, për vitin 2021. Në lekë										
Nr.	Përshkrimi Shpenzimeve	Plani	Fakti	Realizimi ne %	Burimi i financimit të shpenzimit					
					Nga të ardhurat e veta	% e realizimit nga të ardhurat	Nga Granti Qeveritar			
							Nga transfertat e pakushtëzuar	Nga transfertat e kushtëzuar specifike	Nga transfertat e kushtëzuar për funksionet e deleguara	Nga transfertat e kushtëzuar për investimet
1	Paga 600	160.300	147.788	92.2	14.222	9,6	82.056	49.361	2.150	
2	Sigurime shoqërore 601	25.528	24.281	95	1.420	5,8	14.540	7.629	692	
3	ShP. Operat 602+ F. Rezervë	59.911	44.247	71.3	17.494	39,6	14.595	12.157	0	
4	Subvencion Ujësjiellësi, etj. 603									
5	K. Q Emergj Civile 604 ,etj	6.373	2.230	41.5	200	9	2.030			
6	Nd/Ekonom invalid 606	90.532	89.704	99					89.704	
7	Mjete ne ruajtje 466									
8	Investime 230-231	129.211	71.122	51.4	9.466	13,3	12.425	9.335	39.896	
9	Shpenzime 605									
10	Interesa kredia 166									
11	Principali 651									
12	Shto, pakso sipas faktit në B.Përmet									
	Totali	471.855	379.372	78.7	42.802	11	125.646	78.482	132.442	

Burimi: Bashkia Përmet

Konstatohet se plani i buxhetit i gjeneruar nga thesari ka vlerën 471,855 mijë lekë e cila nuk përputhet me vlerën e planit të buxhetit të miratuar nga këshilli bashkiak që ka vlerën 401,335 mijë lekë, ose 70,502 mijë lekë më pak se plani buxheti i gjeneruar nga thesari.

Planifikimi i buxhetit për zërin e shpenzimeve (të ardhurat e veta vendore, transfertat e pakushtëzuar, si dhe granti) ka vlerën 471,855 mijë lekë, ndërsa realizimi 379,372 lekë, ose në masën 78%. Zëri shpenzime page është planifikuar në vlerën **160,300 mijë lekë** dhe është realizuar në vlerën **147788 mijë lekë**, ose në masën 92%, ndërsa zëri sigurime shoqërore është realizuar në masën 95%. Zëri shpenzime operative është planifikuar në vlerën **59,911mijë lekë**

dhe është realizuar në vlerën **44.247 mijë** lekë, ose në masën 51 %. Zëri shpenzime kapitale (artikulli 230 dhe 231) është planifikuar në vlerën **129,211 mijë** lekë dhe është realizuar në vlerën **71,122 mijë** lekë, ose në masën 51 %.

Titulli gjetjes: Planifikimi i procedurave për investime, shërbime dhe blerje malli.

Situata: Nga auditimi u konstatohet se realizimi i shpenzimeve buxhetore për vitin 2021 me të ardhurat e veta (pa transfertën e palushtëzuar) të Bashkisë Përmet ka diferenca të dukshme me vlerën e planifikuar. Planifikimi i shpenzimeve me të ardhurat e veta ka vlerën 471,855 mijë lekë, ndërsa realizimi 379,372 mijë lekë, ose në masën 78.7%. Niveli i realizimit të investimeve të planifikuara, i cili është zëri më kryesor i buxhetit në lidhje me ndikimin që ka në ofrimin e të mirave publike ndaj komunitetit, është akoma më i ulët se mesatarja e realizimit të buxhetit. Ky zë është planifikuar në vlerën **129,211 mijë** lekë, realizuar **71,122 mijë** lekë, ose në masën 51 %. Ky mos realizim vjen si rezultat i mosrealizimit të të ardhurave, që do të thotë se nga Bashkia Përmet në fillim të vitit buxhetor planifikohen angazhime buxhetore, duke mos u mbështetur në planifikime realiste të të ardhurave të veta nga taksat dhe tarifatat vendore dhe ky planifikim nuk korrigjohet gjatë vitit, duke mos përshtatur shpenzimet buxhetore të miratuara me të ardhurat reale të realizuara. Gjithashtu edhe gjatë vitit 2021 nuk është bërë analiza e zbatimit të buxhetit brenda muajit qershor dhe nuk është dalë në konkluzion nëse duhej rishikuar ose jo buxheti vjetor 2021.

Veprimet dhe mosveprimet e mësipërm janë në kundërshtim me pikën (a) të nenit 5, si dhe nenin 46 të ligjit nr. 68/2017 “Për financat e vetëqeverisjes vendore” ku thuhet: “Kryetari i njësisë së vetëqeverisjes vendore analizon zbatimin e buxhetit jo me vonë se data 30 qershor e çdo viti dhe, në rast se është e nevojshme, harton e propozon në këshillin e njësisë së vetëqeverisjes vendore ndryshimet në buxhet. Procedurat e shqyrtimit, miratimit dhe zbatimit të ndryshimeve u nënshtrohen të njëjtave rregulla të përcaktuara në nenet 5 dhe 40 të këtij ligji”. dhe ngarkojnë me përgjegjësi kryetaren e bashkisë Përmet znj. A. H., si dhe znj. E. K., me detyrë Drejtore e Financës.

Kriteri: Pikën (a) të nenit 5, si dhe nenin 46 të ligjit nr. 68/2017 “Për financat e vetëqeverisjes vendore”.

Shkaku: Lidhja e kontratave në fund të vitit, si dhe për vlerën e plotë të projektit dhe jo për nivelin e fondeve të buxhetuara për vitin përkatës.

Efekti: Mos realizim i investimeve të planifikuara.

Rëndësia: I Lartë.

Rekomandimi:

Kryetari i Bashkisë, Drejtoria e Financës dhe Buxhetit, si dhe Drejtoria e të Ardhurave Vendore, të marrin masa për një planifikim të studiuar të buxhetit, duke u mbështetur mbi parashikime të studiuar dhe realiste të të ardhurave. Mbi bazën e këtyre të ardhurave të parashikohet edhe plani shpenzimeve publike, me qëllim që këto shpenzime të kenë burime financimi të sigurt për tu realizuar. Nëse gjatë vitit ka mosrealizim të të ardhurave të planifikuara, atëherë Kryetari i Bashkisë, brenda afateve që përcakton kuadri rregullator në fuqi, të kërkojë korrigjimin e buxhetit nga këshilli bashkiak, me qëllim që të mos ketë diferenca midis planifikimit dhe realizimit të shpenzimeve.

Për sa është trajtuar në Akt konstatim, nga subjekti i audituar është paraqitur observacioni me shkresën nr. 3029 datë 14.10.2022, nga znj. E. K. në cilësinë e Drejtorit të Buxhet-Financës, protokolluar në KLSH me nr.802/3 datë 21.10.2022, ku janë shprehur komentet si më poshtë:

Observacion nga Subjekti i audituar: Ne nuk jemi dakort me konstatimin e sipërcituar pasi planifikimi i të ardhurave të bashkisë bëhet respektivisht sipas sektorëve që kanë për kompetencë ndjekjen dhe realizimin e këtyre të ardhurave (Specifikuar në Rregulloren e Brendshme ,Paketën fiskale dhe përskrimet e punës). Mendimet mbi raportin Vjetor të Monitorimit të Buxhetit 2021 dërguar nga MFE me shkresën nr. 5728 datë 27.03.2022

protokulluar me tonën me nr.1098 datë 06.04.2022 ngarkojnë me përgjegjësi GMS-në dhe Drejtuesit e Ekipit të Programeve. Gjatë vitit 2021 është analizuar dhe rishikuar tri herë buxheti kjo në zbatim me ligjin nr.68/2017 ‘Për financat e vetëqeverisjes vendore’, respektivisht; VKB nr.35 datë 02.06.2021 “ Për raportin e monitorimit të buxhetit për 4 mujorin e vitit 2021,Bashkia Përmet”

VKB nr.64 datë 29.09.2021 “Për raportin e monitorimit të buxhetit për 8 mujorin e vitit 2021,Bashkia Përmet”

VKB nr.01 datë 31.01.2022 “Për raportin e monitorimit të buxhetit për 12 mujorin e vitit 2021,Bashkia Përmet”

Qëndrimi i grupit të auditimit: Lidhur me observacionin e paraqitur nga ju merrn në konsiderat përsa i përket përgjegjësisë ndërsa përsa i përket analizimit të buxhetit nuk meret në konsiderat pasi raportet e sipërcituara janë raportet e monitorimit dhe në asnjë moment nuk është bërë analiza e zbatimit të buxhetit brenda muajit qershor dhe nuk është dalë në konkluzion nëse duhej rishikuar ose jo buxheti vjetor 2021 sipas pikën (a) të nenit 5, si dhe nenin 46 të ligjit nr. 68/2017 “Për financat e vetëqeverisjes vendore” ku thuhet: “Kryetari i njësisë së vetëqeverisjes vendore analizon zbatimin e buxhetit jo me vonë se data 30 qershor e çdo viti dhe, në rast se është e nevojshme, harton e propozon në këshillin e njësisë së vetëqeverisjes vendore ndryshimet në buxhet.

Fondet e shpenzuara për përballimin e situatës së pandemisë nga Covid 19

Në VKB-në Nr. 99 datë 30.12.2020 “Për buxhetin e Bashkisë viti 2021 dhe përcakimin e numrit të punonjësve të bashkisë, institucioneve dhe Njësi Administrative në varësi të saj” është miratuar për vitin 2021 fondi rezervë, i kontigjencës, si dhe fondi i emergjencës në total 4269 mijë lekë, si vijon:

- fondi rezervë nga granti në vlerën 410 mijë lekë;
- fondi rezervë nga të ardhurat në vlerën 590 mijë lekë;
- fondi kontigjencës nga granti në vlerën ...-.. lekë;
- fondi kontigjencës nga të ardhurat në vlerën ..- .lekë;
- fondi i emergjencës civile në vlerën 3,269 mijë lekë.

Ky fond është parashikuar në përputhje me nenin 65 të ligjit nr.45/2019 “Për mbrojtjen civile”, njësitë e vetëqeverisjes vendore duhet të parashikojnë nga burimet e veta të financimit për emergjencat civile, jo më pak se 1.7% të totalit të buxhetit. Pjesa tjetër e financimit për mbrojtjen civile do të mbulohet në formën e transfertës së kushtëzuar nga buxheti qendror në vitin buxhetor 2020”.

Në detyrim sa më sipër nga Bashkia Përmet në buxhetin e vitit 2021 është parashikuar fondi i emergjencës civile në vlerën 4,269 mijë lekë, në masën 1.7% të buxhetit.

Me shkresën nr.1650 prot., datë 24.03.2020, të Ministrit të Mbrojtjes me lëndë “Kërkesë për marrjen e masave urgjente për përdorimin e fondeve për mbrojtjen civile” (tepër urgjente), drejtuar të gjitha bashkive të vendit, thuhet “ Në mbështetje të nenin 65 të ligjit nr.45/2019 “Për mbrojtjen civile”, bashkitë për zvogëlimin e rrisht nga fatkeqësitë dhe mbrojtjen civile, mbështeten në parashikimin minimal prej 4% të totalit të buxhetit vjetor të tyre, të cilat sigurohen nga fondet e kushtëzuara të buxhetit të shtetit. Në këtë shkresë është kërkuar që bashkitë të raportojnë për vlerën e fondeve që kanë në dispozicion për mbrojtjen civile dhe sa për qind të buxhetit përbëjnë.

Në zbatim sa më sipër, me VKB nr., datë (konfirmuar nga Prefekti i Qarkut ... me shkresën nr., datë), është bërë ndryshimi në buxhetin e vitit 2021, i vlerës së fondit të emergjencës nga 1.7% në 4%, pra nga ... lekë, në .. lekë (4%*206,870). Fondet e shtuara për të plotësuar 4% janë marrë nga fondi rezervë dhe fondi i kontigjencës.

VKB nr. , datë : *Të miratojë ndryshimin në buxhet sipas tabelës bashkangjitur nga 1.7% në 4% (lidhur me fondin e emergjencës). Këto burime të përdoren sipas nevojave me urdhër të titullarit, mbështetur në procesverbalet e komisionit sipas vazhdimësisë.*

Pra, Bashkia Përmet ka pasur në dispozicion për të shpenzuar nga fondi i emergjencave për situatën Covid 19, vlerën 6,373 mijë lekë, prej të cilit është shpenzuar vlera 340,680 lekë, për 1 objekt prokurimi:

Fondi i emergjencës civile është përdorur sipas VKB nr,12 datë 02.02.2021 “Për miratimin e fondit që do të përdoret për përballimin e situatës emergjente që vazhdon nga përhapja e COVID-19”

1- *“Blerje materiale mbrojtëse në kuadër të përballimit të situatës emergjente ndaj COVID-19”*, në vlerën e kontratës 283,900 lekë pa TVSh, ose vlerën 340,680 lekë me TVSh, zhvilluar në muajin Mars 2021.

Me shkresën nr.19697 prot., datë 20.10.2020 të Sekretarit të Përgjithshëm të MFE protokolluar në Bashki me nr.13070 datë 22.10.2020 është bërë alokimi i transfertës specifike “Për mbrojtjen civile”, në vlerën 2,104,000 lekë, e cila nuk është shpenzuar gjatë vitit 2021.

Si përfundim, burimi i financimit të fondeve të planifikuara për shkak të situatës Covid 19, janë fondet “Për mbrojtjen civile”. Vlera e këtyre fondeve të miratuara dhe të shpenzuara paraqiten në tabelën e mëposhtme:

Në lekë

Nr	Burimi i financimit	Vlera e planifikuar	Vlera e shpenzuar për COVID	Vlera e pa shpenzuar
1	Transfertë e pakushtëzuar	3,679,000	340,680	3,338,320
2	Transfertë specifike (e kushtëzuar)	2,104,000		2,104,000
3	Të ardhurat e veta	590,000		590,000
	Total	6,373,000	340,680	6,032,320

Burimi: Bashkia Përmet

2.4.Vlerësimi i risqeve buxhetore nga niveli i faturave të palikujduara, vendimeve gjyqësore, vendimeve të shpronësimit dhe niveli i realizimit të të ardhurave (faturat e pa likujduara të shoqërohen me listë analitike të detajuar me nr. fature, datë krijimi etj., sipas raportimit në MFE)

Në mënyrë të përmbledhur paraqitet fondet e trazhuara për vitin 2021 dhe votin 2022.

Fondet e trashëguara në 31.12.2019 për përdorim në vitin 2020 sipas rakordimit me thesarin (Llog. 520 në bilanc pa pjesën e llog 466)	Fondet e trashëguara në 31.12.2020 për përdorim në vitin 2021 sipas rakordimit me thesarin (Llog. 520 në bilanc pa pjesën e llog 466)	Fondet e trashëguara në 31.12.2021 për përdorim në vitin 2022 sipas rakordimit me thesarin (Llog. 520 në bilanc pa pjesën e llog 466)
56.543.421	59.960.970	61.827.140

Detyrimet e prapambetura viti 2021

Në 000 lekë

Kodi i detyrimit te prapamb.	Emerimi i detyrimit te prapamb.	Detyrimi prapambetur progresiv më 31.12.2020	Vlera e paguar gjatë vitit 2021 për detyrimin e prapambetur (vlera e paguar për kolonën 3)	Vlera e detyrimeve të trashëguara të pa paguara më 31.12.2021 (pa detyrimet e krijuara gjatë 2020)	Detyrim i prapambetur i krijuar vetëm gjatë vitit 2021 (situata më 31.12.2021)	Vlera totale e detyrimeve të prapambetur pa më 31.12.2021

1	2	3	4	5=3-4	6	7=5+6
4864100	Vendim gjyqesor	1,717	100	1,617	1,757	1,617
4864200	Mallra e shërbime	2,347	0	2,346	0	2,347
486400	Investime FZHR	2,200	0	2,200	0	2,200
	Totali	6,264	100	6,164	1,757	6,164
Detyrime te prapambetura nga FZHR (Ministrite e linjës)						
	Detyrime në total	6,264	100	6,164	1,757	6,164

Burimi: Bashkia Përmet

Vlera e raportuar nga Bashkia Përmet në MFE për detyrimet e prapambetura në datën 31.12.2021 është **6,164 mijë lekë**, konfirmuar me shkresën nr. 599 datë 23.02.2022 drguar Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë; Drejtorisë së përgjithshme të Buxhetit dhe Borxhit Publik dhe Drejtorisë së Financave Vendore, e cila kuadron me detyrimet e paraqitura në pasqyrat financiare dërguar degës së Thesarit Përmet me shkresën 1017 datë 31.03.2022 të konfirmuara.

Stoku i detyrimit të mbetur rakordoon me vlerën e detyrimeve në sistemin e thesarit si vijon

NR	Emërtimi	Stoku në vlerë	Totali i shpenzimeve të miratuara për NJVQV-në	Stoku/Shpenzimeve totale të miratuara të NJVQV-së
I	Borxhe (a+b)	0		
a	Hua sfatgjatë	0		
a,1	Principali			
a,2	Interesi			
b	Hua afatshkurtër	0		
b,1	Hua			
b,2	Overdrafte			
b,3	Kredi të furnitorëve			
II	Detyrime (a+b+c)	6,164,101		1.79%
a	Shpenzime korrente	2,346,886		
a,1	Mallra dhe shërbime	2,346,886		
a,2	Paga dhe sigurime			
a,3	Të tjera			
b	Shenzime kapitale	2,200,102		
b,1	Insitucione buxhetore			
b,2	Subjekte private	2,200,102		
c	Vendime gjyqësore	1,617,113		
c,1	Marrëdhënie pune	1,617,113		
c,2	Mallra dhe shërbime			
c,3	Investime			
c,4	Të tjera			
III	Totali (I+II)	6,164,101	345,118,160	1.79%

Burimi: Bashkia Përmet

Vështirësia Financiare

Nga auditimi është konstatuar se detyrimet e konstatuara në fund të vitit 2021 paraqitën në vlerën 6,164 mijë lekë (*të akumuluar*) dhe fondet e miratuara për shpenzime të këtij viti janë në vlerën 345,118 mijë lekë. Kjo situatë tregon se Bashkia Përmet nuk mund të konsiderohet në vështirësi financiare në fund të vitit ushtrimor 2021, pasi vlera e stokut të detyrimeve të papaguara ndaj palëve të treta është 1.79%, pra nën nivelin prej 25 % të shpenzimeve vjetore të miratuara, sipas nenit 56 “Vështirësia financiare” të ligjit nr. 68/2017, datë 27.04.2017 “Për financat e vetëqeverisjes vendore”.

Titulli i gjetjes: *Vlera e stokut të detyrimeve të prapambetura dhe raportimi i tij në Ministrinë e Financës dhe Ekonomisë si dhe marrja e angazhimeve buxhetore pa pasur faonde në dispozicion.*

Situata: Bashkia Përmet në datën 01.01.2021 ka pasur si çelje të vitit ushtrimor detyrime të prapambetura progresive vlerën 6,264 mijë lekë, e cila ka si burim financimi të ardhurat e veta. Në planin e buxhetit vjetor 2021 është planifikuar për likuidim gjatë këtij viti vlera 2,000 mijë lekë, në datën 31.12.2021 vlera e detyrimeve të prapambetura me burim financimi të ardhurat e veta, krahasuar me këtë vlerë në fillim të vitit ushtrimor (01.01.2021), është ulur me 100 mijë lekë, ose në masën prej 1.5% duke ngelur pa u arkëtuar vlera 6,164 mijë lekë.

Për sa më sipër rezulton se marrja e angazhimeve buxhetore pa pasur fonde në dispozicion, e cila ka çuar në krijimin e detyrimeve të prapambetura është në kundërshtim me kërkesat e Udhëzimit të MFE nr.9, datë 20.03.2018 “Për procedurat standarde të zbatimit të buxhetit”, pika 153-162, Rubrika - Marrja e angazhimit dhe kryerja e shpenzimeve publike, detyrimet kontraktuale midis palëve, nenin 52 të ligjit nr.9936, datë 26.6.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, UMF nr. 5, datë 27.12.2014 “Për shlyerjen e detyrimeve të prapambetura”, pikat 82-91. Në mënyrë të detajuar deturimet e prapambetura paraqitën në aneksin nr. 2 pika 2.4 bashkëlidhur raportit të auditimit.

Për mos marrjen e masave të plota për likuidimin e detyrimeve të prapambetura dhe krijimi i detyrimeve të reja për vitin 2021, ngarkohet me përgjegjësi Kryetari i Bashkisë Përmet znj. A. H., në cilësinë e nëpunësit autorizues dhe znj. E. K., me detyrë Drejtor Financës, në cilësinë e nëpunësit zbatues.

Kriteri: Udhëzimit të MFE nr.9, datë 20.03.2018 “Për procedurat standarde të zbatimit të buxhetit”, pika 153-162, Rubrika - Marrja e angazhimit dhe kryerja e shpenzimeve publike, detyrimet kontraktuale midis palëve, nenin 52 të ligjit nr.9936, datë 26.6.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, UMF nr. 5, datë 27.12.2014 “Për shlyerjen e detyrimeve të prapambetura”, pikat 82-91.

Shkaku: Moszbatim i kuadrit rregullator të fushës.

Efkti: Mospasqyrimi real i stokut të detyrimeve të prapambetura.

Rëndësia: I Lartë.

Rekomandimi:

Kryetari i Bashkisë Përmet dhe Drejtorja e Financës dhe Buxhetit të marrin masa për likuidimin e detyrimeve ndaj të tretëve brenda afatit 30 ditor nga momenti i ardhjes së faturës. Lidhja e kontratës të bëhet vetëm pasi fondi të jetë në dispozicion në llogarinë e thesarit të autoritetit kontraktor, duke eliminuar në këtë mënyrë shkakun e krijimit të detyrimeve të reja prapambetura. Gjithashtu të merren masa për likuidimin e detyrimeve të prapambetura të krijuara në vitet e mëparshme.

Titulli i gjetjes: Efektet negative në buxhet si rezultat i likuidimit të vendimeve gjyqësore.

Situata: Nga auditimi i zbatimit të buxhetit lidhur me likuidimin e detyrimeve të prapambetura rezulton se Bashkia Përmet për zbatimin e vendimeve gjyqësore me objekt dëmshpërblim page për largime nga puna të punonjësve, për vitin 2021 ka shpenzuar vlerën **1,512,720 lekë**, për 13

raste, të cilat përbëjnë shpenzime pa ekonomikitet, eficiencë dhe efektivitet, pasi praktikisht për një pozicion pune paguhen dy persona. Nga praktikat e mësipërme të likuidimit u përzgjedhën për auditim mbi saktësinë dhe plotësinë e dokumentacionit financiar dhe ligjor, 29 prej tyre rezultojnë se ka mbetur pa u likuiduar vlera **9,998,558 lekë**. Vlerë e cila nuk është kontabilizuar në pasqyrat financiare të vitit 2021. Në mënyrë të detajuar detyrimet e prapambetura paraqiten në aneksin nr. 2 pika 2.4 bashkëlidhur raportit të auditimit. Gjithashtu konstatohet se në 13 raste për likuidimet e subjekteve të mësipërme janë nxjerrë urdhrat përkatës nga titullari i institucionit, por nuk janë analizuar nga Kryetari i Bashkisë dhe nuk është kërkuar prej tij nxjerrja e përgjegjësive administrative për këto vendime. Analizimi i arsyeve të humbjeve të vendimeve gjyqësore dhe nxjerrja e përgjegjësive administrative për to, do të ndikonte pozitivisht në korrigjimin e praktikave të gabuara të ndjekura nga njësia vendore në proceset e largimit të punonjësve nga puna dhe për çështje të tjera gjyqësore, evidentimin e procedurave të bëra gabim, në kundërshtim me kuadrin rregullator në fuqi, e si rezultat shmangien e tyre në të ardhmen dhe uljen e shpenzimeve financiare negative në buxhet.

Veprime dhe mosveprime janë në kundërshtim me pikën nr. 60, të UMFE nr. 9, datë 20.03.2018, “Për procedurat standarde të zbatimit të buxhetit”, i ndryshuar.

Kriteri: Nenin 2 në Ligjin nr.10296, datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, i ndryshuar; Pika 60 e Udhëzimit nr. 9, datë 20.03.2018 “Për procedurat standarde të zbatimit të buxhetit”, i ndryshuar.

Shkaku: Moszbatimi i kuadrit rregullator të fushës.

Efkti: Krijimi i detyrimeve të prapambetura, të cilat ndikojnë negativisht në buxhetin e Bashkisë Përmet.

Rëndësia: I Lartë.

Rekomandimi:

Kryetari i Bashkisë Përmet të analizojë të gjitha rastet e vendimeve gjyqësore që do të zbatohet, me qëllim përcaktimin e shkaqeve që kanë sjellë humbjen e çështjes gjyqësore. Rezultatet e analizës të shërbejnë për shmangien në të ardhmen të procedurave të gabuara të ndjekura për çështjen e largimit të punonjësve nga puna dhe çështje të tjera, me qëllim uljen e efekteve negative financiare në buxhet si dhe kontabilizimin e plotë të vlerës 9,998,558 lekë.

2.6. Niveli i realizimit të të ardhurave dhe mënyra e përdorimit të tyre. Vlerësimi i mbledhjes së të ardhurave në përputhje me dispozitat ligjore në fuqi. Evidentimi i detyrimeve tatimore të pa arkëtuara progresive dhe për secilin vit buxhetor sipas programit të auditimit.

➤ **Strukturat për administrimin dhe mbledhjen e taksave dhe tarifave vendore**

Për vitin 2021 numri i përgjithshëm i punonjësve është miratuar me VKB nr. 99 datë 30.12.2020 “Për miratimin e buxhetit të Bashkisë Përmet për vitin 2020”. dhe Vendim të Kryetarit të Bashkisë Nr. 07 date 20.01.2021 “Për miratimin e strukturës organizative” me ndryshime, ku përfshihet edhe struktura e Sektorit të Taksa-Tregjeve. Ky sektor përbëhet nga 11 punonjës, konkretisht 1 përgjegjës, 3 specialistë për Bashkinë Përmet dhe 7 punonjës në njësitet administrative. Në mënyrë të detajuar struktura organizative e sektorit të taksave dhe tarifave vendore për vitin 2021 paraqitet si në aneksin nr. 3 pika 2.6 bashkëlidhur raportit të auditimit.

Titulli gjetjes: Mangësitë e konstatuara në plotësimin e strukturës për administrimin dhe mbledhjen e taksave dhe tarifave vendore.

Situata: Konstatohet se: struktura organizative e Sektorit të Taksave dhe Tarifave Vendore, Bashkia Përmet ka probleme dhe nuk është në funksion të realizimit të të ardhurave, pasi nuk

është krijuar Sektori i Masave Shtrënguese si një nga sektorët më të rëndësishëm në DTV Bashkia Përmet, pasi evidentohet se një numër i lartë i detyrimeve të pa arkëtuara (debitor), në vlerën 22,459,166 lekë, nga e cila: subjekte fizik/juridik në vlerë 17,745,793 lekë, si dhe abonentë familjarë në vlerë 4,047,397 lekë, Gjoha të ndryshme **665,976** lekë. *Veprimet dhe mosveprimet janë në kundërshtim me pikën (ç) të nenit 5 të ligjit nr. 9632, datë 30.10.2006 “Për sistemin e taksave vendore” i ndryshuar dhe në Kreun XI- “Mbledhja me forcë e detyrimit tatimor të papaguar”, nenet 88 – 104, të ligjit nr. 9920, datë 19.5.2008 “Për Procedurat Tatimore në RSH” me ndryshime.*

Kriteri: Në përputhje me pikën (ç) të nenit 5 të ligjit nr. 9632, datë 30.10.2006 “Për sistemin e taksave vendore” i ndryshuar dhe në Kreun XI- “Mbledhja me forcë e detyrimit tatimor të papaguar”, nenet 29 pika 1, 88 – 104, të ligjit nr. 9920, datë 19.5.2008 “Për Procedurat Tatimore në RSH” me ndryshime.

Ndikimi/Efekti: Mungesa e stafit dhe mos përshtatja e strukturës më natyrën e menaxhimit të të ardhurave, çojnë në mos realizim të të ardhurave dhe mungesë të tyre në buxheti e Bashkisë Përmet.

Shkaku: Mos njohja e kuadrit ligjorë për ,menaxhimit e të ardhurave nga instancat drejtues Bashkia Përmet.

Rëndësia: i lartë

Rekomandimi: Kryetari i Bashkisë Përmet në bashkëpunim me Sektorin e Burimeve Njerëzore të marrë masa për të krijuar Sektori i Masave Shtrënguese plotësimin e stafit me specialit të fushës dhe përshtatja e strukturës sipas natyrës së menaxhimit të të ardhurave.

➤ **Parashikimi dhe realizimi i taksave dhe tarifave vendore sipas llojeve**

Titulli i gjetjes: *Performancë e dobët në planifikimin dhe realizimin e disa zërave të të ardhurave për periudhën objekt auditimi.*

Situata: Për vitin 2021, është planifikuar si e ardhur vlera 57,032 mijë lekë dhe është realizuar në vlerën 60,277 mijë lekë, të ardhurat paraqiten të realizuara ndaj planit fillestar në masën 106 % ky tejkalim i planit të të ardhurave vjen si rezultat i dy transfertave respektivisht; vlera prej 16,230,000 lekë i përket projektit MAPCULT dhe vlera prej 5,000,000 lekë transfertë nga Këshilli i Qarkut. Përqindja e realizimit të të ardhurave sipas evidencës së të ardhurave është 106 % por duke zbritur dy vlerat (16,230,000 leke dhe 5,000,000 leke) kjo përqindje realizimi shkon në 68 %. Sh.A Ujësjetës Kanalizime Përmet është caktuar si agjent tatimor për të mbledhur taksat dhe tarifave e popullatës sipas VKB nr.83 datë 02.12.2020 “Për nivelin e taksave e tarifave vendore për vitin 2021” dhe Akt Marrëveshjes nr.116 datë 18.01.2021. Për vitin 2021 nga vlera totale e arkëtuara, Sh.A Ujësjetës Kanalizime nuk ka derdhur për llogari të Bashkisë vlerën 6 753 809 lekë. Duke i shtuar vlerës të arkëtuara dhe këtë vlerë përqindja e realizimit shkon në 80%.

Ky mosrealizim i të ardhurave vjen edhe si pasojë e pandemisë CO-VID 19. Taksa e ndikimit në infrastrukturë nga ndërtimi i ri ka mosrealizimin më të madh në vlerën 8,573,000 lekë ose 86 % mosrealizim që në totalin e mosrealizimit zë rreth 48 % . Rezulton se tatimi i thjeshtuar mbi fitimin, është planifikuar duke mos patur një databazë të saktë për numrin e subjekteve të cilët gjatë vitit mbyllen dhe regjistrohen, nuk ka bazë të dhënash për subjektet të cilët në bazë të xhiros do paguajnë tatimin e fitimit. Taksa e mjeteve të përdorura është planifikuar sipas të dhënave historike pra nuk ka një databazë të saktë për numrin e mjeteve të përdorura që ka Bashkia Përmet. Taksa e kalimit e të drejtës në pronësi është planifikuar sipas të dhënave të realizimit të një viti më parë. Drejtoria e të Ardhurave, duke mos pasur një bazë të dhënash nuk ka bërë rakordime me Drejtorinë Rajonale Tatimore Gjirokastër (DRTGJ), Agjencinë Shtetërore të Kadastrës (ASHK) dhe Drejtorinë e Shërbimit të Transportit (DSHTR). *Veprimet dhe mosveprime bien në kundërshtim me Ligji nr. 9936, datë 26.06.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar, ligji nr. 139/2015, “Për*

vetëqeverisjen vendore”, neni 64, “Kompetencat dhe detyrat e kryetarit të Bashkisë”; ligji nr. 68/2017 datë 27.4.2017 “Për Financat e Vetëqeverisjes Vendore” i ndryshuar, neni 5, “Parime dhe rregulla të disiplinës fiskale dhe të financimit të funksioneve vendore”, neni 42, “Administrimi i mjeteve monetare”, pika 1, 2 dhe 4; neni 54, “Raportimi financiar” nënpika c, UMFE nr. 9 datë 20.03.2018, Kreu IV “Procedurat standarde për menaxhimin e të ardhurave” pika 200, UMFE nr. 8, datë 9.3.2018 “Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme”, Kreu III, pika 32, Kreu II pika 2/a, b; Ligji nr. 9632, datë 30.10.2006 “Për Sistemin e Taksave Vendore”, i ndryshuar, ligji nr. 9920, datë 19/5/2008 “Për Procedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar.

Kriteri: Ligji nr. 9936, datë 26.06.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar, ligji nr. 139/2015, “Për vetëqeverisjen vendore”, neni 64, “Kompetencat dhe detyrat e kryetarit të Bashkisë”; ligji nr. 68/2017 datë 27.4.2017 “Për Financat e Vetëqeverisjes Vendore” i ndryshuar, neni 5, “Parime dhe rregulla të disiplinës fiskale dhe të financimit të funksioneve vendore”, neni 42, “Administrimi i mjeteve monetare”, pika 1, 2 dhe 4; neni 54, “Raportimi financiar” nënpika c, UMFE nr. 9 datë 20.03.2018, Kreu IV “Procedurat standarde për menaxhimin e të ardhurave” pika 200, UMFE nr. 8, datë 9.3.2018 “Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme”, Kreu III, pika 32, Kreu II pika 2/a, b; Ligji nr. 9632, datë 30.10.2006 “Për Sistemin e Taksave Vendore”, i ndryshuar, ligji nr. 9920, datë 19/5/2008 “Për Procedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar.

Ndikimi/Efekt: Mos planifikim i saktë i treguesve në planin e të ardhurave shkakton mangësi dhe probleme në likuidimin e shpenzimeve të kryera nga institucioni, si dhe është shkak kryesor për krijimin e detyrimeve të prapambetura.

Shkaku: Mos njohja e situatës nga strukturat përgjegjëse, neglizhenca dhe mosrespektimi i akteve ligjore e nënligjore në fuqi.

Rëndësia: E lartë

Rekomandim: Kryetari i Bashkisë Përmet dhe struktura organizative e Sektorit të Taksave dhe Tarifave Vendore të marrin masa për një planifikim sa më realist të të ardhurave, mbështetur në realizimet faktike të viteve të mëparshëm dhe në numrin e taksapaguesve, me qëllim që të zvogëlohet sa më shumë diferenca midis planifikimit dhe realizimit të të ardhurave. Kjo shmang edhe marrjen e angazhimeve buxhetore mbi bazën e një plani të pa realizueshëm në fakt.

➤ **Agjentët tatimorë dhe rakordimet mujore me ta:**

Titulli gjetjes: Mangësitë e konstatuara në dokumentacionin mbi aktivitetin e Agjentëve Tatimorë.

Situata: Në rregulloren e brendshme të institucionit nuk është përcaktuar personi i cili duhet të ketë për detyrë ndjekjen e arkëtimeve nga agjentët tatimorë dhe mbajtjen e aktrakordimeve me ta.

Të ardhurat nga agjentët tatimorë (Drejtoria Rajonale Tatimore, në lidhje me TFTH; Drejtoria e Përgjithshme të Buxhetit, Drejtoria e Menaxhimit të Buxhetit, pranë Ministrisë së Financave, në lidhje me rentën minerare; AKSH-ja, në lidhje me taksën e ndikimit në infrastrukturë dhe DRSHTRR Përmet, në lidhje me taksën vjetore të mjeteve të përdorura) derdhen automatikisht në fund të çdo muaji, për llogari të Bashkisë Përmet dhe konfirmohen nga Dega e thesarit Përmet.

Pjesa më e rëndësishme e të ardhurave që vilen me agjentët tatimorë është Ujësjellës-Kanalizime sipas marrëveshjes së bashkëpunimit me nr. 116 prot., datë 18.01.2021 protokolluar në bashkinë Përmet. Është shumë e rëndësishme të theksohet se vjelja e këtyre të ardhurave ka pasur përmirësime pas kontraktimit me Agjentin Tatimor, por ka një shumë të

madhe debitorësh, e cila së pari duhet të përcaktohet nëse është mangësi e planifikimit apo problem në vjelje dhe më pas të vazhdohet me procedurat përkatëse.

- Për rentën minerare, e cila rrjedh nga eksportet nuk është bërë rakordimi periodik i rregullt mujor me Drejtorin e Doganave dhe mbahet korrespondencë me Ministrinë e Financave.

- Për rentën e cila rrjedh nga shitjet brenda vendit, mbahet korrespondenca me Ministrinë e Financave dhe Drejtorinë e Përgjithshme të Thesarit në kundërshtim me ligjin nr. 9920, datë 19.05.2008 “Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, neni 7 “Të drejtat dhe detyrimet e agjentit të mbajtjes së tatimit” dhe me ligjin nr. 9632, datë 30.10.2006, “Për sistemin e taksave vendore”, i ndryshuar, neni 15 “Parapagimi”, si dhe me UMF nr. 26, datë 04.09.2008 “Për taksat Kombëtare”

Konstatohet se sipas DTV Bashkia Përmet, mos arkëtimet nga ana e Drejtoria Rajonale Vendore ASHK Gjirokastrë, janë për shkak të anashkalimit të arkëtimit të këtyre detyrimeve për taksën e infrastrukturës, për të cilat nga Bashkia Përmet është kërkuar vazhdimisht në rrugë zyrtare që të mos i kryejnë veprimet e regjistrimit të pronës nga këto lloj subjektsh, pa paraqitur dokumentin e pagesës së kësaj takse. Për sa më sipër, Bashkia Përmet duhet të fillojë procedurat për të gjobitur Agjentin Tatimor ASHK në zbatim të dispozitës së mësipërme.

Gjithashtu Bashkia Përmet, duhet të marrë masa për evidentimin e diferencave të pa mbledhura sipas llojit të taksës/tarifës, të cilat përbëjnë mungesë të ardhurash për buxhetin e saj dhe të fillojë procedurat për gjobitjen e këtyre agjentëve tatimorë me 50% të shumës së plotë të taksave/tarifave të pa arkëtuara apo të shmangura sipas Nënin 117² të ligjit nr. 9920, dt. 19.5.2008, “Për Procedurat Tatimore”, ku parashikohet se “Dënimet për agjentët e mbajtjes së tatimit në burim, agjentët e taksave dhe agjentët e tarifave”.

Kriteri: Ligji nr. 9920, datë 19.05.2008 “Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, neni 7 “Të drejtat dhe detyrimet e agjentit të mbajtjes së tatimit” dhe me ligjin nr. 9632, datë 30.10.2006, “Për sistemin e taksave vendore”, i ndryshuar, neni 15 “Parapagimi”, si dhe me UMF nr. 26, datë 04.09.2008 “Për taksat Kombëtare”.

Ndikimi/Efekti: Mos njohja e situatës, çon në mungesë të ardhura për Bashkinë Përmet

Shkaku: Mungesa e bashkëpunimit dhe mos zbatimit të kuadrit ligjorë.

Rëndësia: E Lartë

Rekomandimi: Struktura organizative e Sektorit të Taksave dhe Tarifave Vendore, të marrë masa për të kryer rakordim periodik mujor me agjentët tatimor sipas formularit përkatës të miratuar nga Ministria e Financave, për të evidentuar gjendjen reale të të ardhurave që përfiton Bashkia Përmet nga taksat që mbledhen nga këta agjent. Në rast se agjentët tatimor nuk realizojnë saktë mbledhjen e të ardhurave, Bashkia Përmet të fillojë procedurat për penalizimin e tyre me 50% të shumës së plotë të taksave/tarifave të pa mbledhura apo të shmangura.

Titulli gjetjes: *KLSH-ja konstaton se nga struktura organizative e Sektorit të Taksave dhe Tarifave Vendore, Bashkia Përmet, nuk janë ndjekur të gjitha rrugët ligjore për arkëtimin e detyrimeve të pa arkëtuara (borxhi), dhe për të gjithë subjektet.*

Situata: Sipas të dhënave për strukturën organike të Drejtoria e Taksave dhe Tarifave Vendore Bashkia Përmet, konstatohet se nuk ka një të ngritur një strukturë përgjegjëse për menaxhimin e borxhit (debitorëve nga taksat/ tarifave vendore).

Referuar të dhënave të paraqitura nga ky sektor, detyrimet për taksat e tarifave vendore për subjektet fizik/juridik dhe abonentë familjare paraqitet si vijon:

² “Agjenti i mbajtjes së tatimit në burim, agjenti i taksave apo tarifave, që nuk arrin të mbajë, të llogarisë, të raportojë dhe të transferojë në Buxhetin e Shtetit tatimin në burim apo tatimet, taksat dhe tarifave të mbledhura, apo i shmangjet mbledhjes së tyre, detyrohet të paguajë gjobë të barabartë me 50 për qind të shumës së plotë të tatimit, taksës apo tarifës së pambledhura apo të shmangur.”

➤ **Detyrimet e familjarëve:**

Nga auditimi u konstatua se sipas VKB nr.83 datë 02.12.2020 “Për nivelin e taksave e tarifave vendore për vitin 2021” bashkia Përmet ka lidhur Akt Marrëveshje me Ndërmarrjen e Ujësjetllës Kanalizimeve Përmet për vjeljen e detyrimeve të familjarëve mbi bazën e kontratave të ujit të pijshëm që abonentët familjarë kanë, evidentimit dhe regjistrimit të abonentëve të rinj duke plotësuar regjistrin e taksapaguesve familjarë, gjë e cila ka shkaktuar edhe mangësitë e mëdha dhe një numër të lartë debitorësh në lidhje me këto detyrime.

- Njoftimet e bëra për familjarët, masat e mara dhe masat shtrënguese

Për arkëtimin e detyrimit që rezulton nga bizneset për (taksën e ndërtesës, tarifës së pastrimit, gjelbërimit dhe ndriçimit) janë ndjekur disa masa të mbledhjes me forcë të detyrimit

1.Me anë të shkresës nr.661/1 datë 31.05.2021 ju është dërguar subjekteve që nuk kanë paguar në afat detyrimet vendore Kërkesa për shlyerje detyrimesh .

2.Urdhër Kryetari nr.226 datë 24.06.2021 “Për mbledhje me forcë të detyrimeve tatimore” janë ngritur grupet e punës për mbledhjen me forcë të detyrimit tatimor në bashkëpunim me Policinë Bashkiake.

3.Shkresa nr.2959 datë 25.10.2021 “Kërkesë për shlyerje detyrimesh subjekteve debitorë” përmbajtja e së cilës shpjegon masat shtrënguese dhe niveli i kamatëvonesës që aplikohet.

4.Urdhërat e bllokimit të llogarisë me shkresën 2959/1 datë 09.11.2021.

5.Me VKB nr.3 datë 31.01.2022 janë miratuar “Masat shtrënguese të mbledhjes me forcë të detyrimit tatimor të pa mbledhur”, ky detyrim do të transferohet sipas pikës 88.4 të Udhëzimit nr.24 datë 02.09.2008 “Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, për tu mbledhur nga Sh.A Ujësjetllës Kanalizime.

Gjithashtu, rezulton se më datën **31.12.2021** për mos pagesën e detyrimeve tatimore janë debitorë për abonentët familjarë në vlerën 4,047,379 lekë, ndërsa detyrimet e vitit ushtrimor janë në vlerën 868,976 lekë sipas rakordimit me Drejtorinë e Financës. *Vlerë e cila përbën të ardhura të munguara për buxhetin e bashkisë Përmet*, nga mos arkëtimi i taksës dhe tarifave nga debitorët familjarë deri në datën **31.12.2021**. Veprime dhe mosveprime janë në kundërshtim me ligjit nr. 9920, datë 19.05.2008 “Për Procedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, Kreut XI-“Mbledhja me forcë e detyrimeve tatimore të papaguara”, të neneve 88 deri 104, të ligjit nr. 9920, datë 19.05.2008 “Për Procedurat Tatimore”, të ndryshuar. Më poshtë janë paraqitur të përmbledhura detyrimet e familjarëve për taksat dhe tarifafat vendore të vitit ushtrimor 2021.

Nr.	PER ABONETET FAMILJAR	VITI 2020		Viti 2021	
		Nr.sub	Vlera	Nr. Familje	Vlera
1	Taksa e tokës bujqësore		1,202,335		1,378,335
2	Tarifa pastrimi, gjelbrimi, ndriçimi e te tjera		1,321,200		1,501,176
3	Takse ndertese (objekt banimi)		654,886		1,167,886
	SHUMA		3,178,421		4,047,397

Burimi:Bashkia Përmet.

➤ **Taksa e tokës:**

Nga auditimi i dokumentacionit mbi planifikimin e taksës së tokës bujqësore për vitin 2021, u konstatua se kishte rezerva në planifikim, pasi sipas të dhënave të marra nga sektori i Pyjeve dhe Kullotave, Bujqësisë dhe Mbrojtjes së Konsumatorit dhe Bordit të Kullimit .mbi ndarjen e tokës bujqësore për familje dhe boniteti, evidentohet mos planifikim në vlerën 3,794 mijë lekë, konkretisht si vijon.

Nr	Njesia Administrative	Toke bujq. gjithsej Ha ne 1991	Nr. Fam. Qe kanmar AMTP	Sipërfaqja e tokesndar ne faket Ligji 7501	Kategoria e tokës ndar sipas ligjit 7501/ në hektar					Sipërfaqja e ndar sipas kategorive	Sipërfaqja e tokes se pandar	Sip. e tokesdhene me qira
					III	IV	V-VI-VII	VI	VII			
1	Petran		785				901					
2	Çarshove		168				920					

3	Frasher		32			630				
4	Piskove		366			1343				
Shuma						3794				
Çmimi sipas VKB						1000				
						lekë/ha /vit				

Burimi:Bashkia Përmet.

Konstatua se Bashkia Përmet nuk disponon të dhëna mbi sipërfaqen e AMTP të ndara sipas ligjit 7501 “Për tokën” çka do të thotë se planifikimi i taksës së tokës nuk është real. Kështu sipas të dhënave të pasqyrës rezultojnë se Bashkia Përmet nuk disponon të dhëna në mënyrë elektronike për sipërfaqja gjithsej e tokës së **ndarë sipas fshatrave dhe familjeve për njësit administrative Petran, Çarshove, Frasher dhe Piskove të ndara sipas kategorive.**

Për këtë sasi toke të ndarë, referuar boniteti të tokës sipas fshatrave dhe çmimit për bonitet të miratuara në paketat fiskale me VKB Planifikim i kësaj takse për vit ushtrimorë duhet të ishte në vlerën **3,794 mijë** lekë dhe jo në vlerën **2,435mijë lekë** sipas aneksit të sipërcituar, në fakt nga Struktura e taksave dhe tarifave vendore Bashkia Përmet është realizuar në vlerën **1,818 mijë lekë** Veprimet dhe mosveprimet janë në kundërshtim me nenin 20, 21 dhe 22 të ligjit nr. 9632, datë 30.10.2006 “Për Sistemin e Taksave Vendore” i ndryshuar.

➤ **Bizneset, regjistrimi dhe mbajtja e të dhënave:**

Administrimi i taksave vendore nuk bëhet me program, nuk janë të pasqyruara regjistrat, sipas aktiviteteve, njoftim detyrimet dhe pagesat, kjo si për subjektet fizik/juridik dhe abonentët familjarë. Nga të dhënat që kërkohen për auditim, konstatohet se informacionet që kërkohen të dhënat nuk dalin të analizuara për çdo zë tatimor që sektori i taksave dhe tarifave vendore Bashkia Përmet aplikon. Referuar të dhënave të marra nga Sektori i taksave dhe tarifave vendore Bashkia Përmet, situata e lëvizjes së subjekteve paraqitet si më poshtë:

Nr	Lloji Biznesit	Viti	Gjendja Në fillim	Regjistrime Reja	Mbyllur Aktivit	Gjendja në fund të Vitit
1	Biznesi Vogël	2021	370	21	13	378
2	Biznesi Madh	2021	53	5		58
(1+2)	Gjithsej	2021	423	26	13	436

Burimi:Bashkia Përmet.

➤ **Menaxhimi i borxhit nga taksat e tarifave vendore.**

Nga auditimi i të dhënave, rezultojnë se më datën 31.12.2021 për mos pagesën e detyrimeve tatimore janë debitorë subjektet e biznesit të vogël, biznesit të madh dhe subjekte shtetërore në vlerën **17,745,793 lekë**, vlerë e cila konsiderohet e ardhur e munguara për buxhetin e **Bashkisë Përmet, ndërsa vlera 4,352,783 lekë i përket vitit ushtrimor 2021.**

Referuar të dhënave të vënë në dispozicion grupit të auditimit të KLSH, konstatohet se, gjendja e debitorëve paraqitet si vijon:

Nr.	PER SUBJEKTET FIZIK/JURIDIK/SHTETOROR	DETYRIME SIPAS VITEVE		DETYRIME SIPAS VITEVE	
		Viti 2020		Viti 2021	
		Nr.sub	Vlera	Nr.sub	Vlera
1	Takse Ndërtesa	138	1,293,928	118	1,148,320
2	Takse Tabele	4	65,000	2	28,000
3	Tarife Pastrimi	146	2,164,003	131	2,024,500
4	Tarife Ndriçimi	129	597,008	122	526,560
5	Tarifa e Gjelbërimit	128	373,207	117	365,700
6	Te tjera		345,587		259,703
A	SHUMA		4,838,733		4,352,783
Sa prej tyre të mbyllura dhe status pasiv		35	211963	26	168,982
Te mbartura					13,224,028

Burimi: Bashkia Përmet

Sa me sipër ariet në konkluzionin se nga strukturat tatimore të bashkisë Përmet, për asnjë nga subjektet, ku megjithëse janë debitorë në vite dhe vlera të konsiderueshme, **pasi** janë njoftuar për pagesën e detyrimeve si dhe janë zbatuar një pjesë e procedurave për to, nuk është kërkuar **kallëzim penal** bazuar në nenin 181, “Mos pagimi i taksave dhe tatimeve”, të Kodit Penal të RSH, miratuar me ligjin nr. 7895, datë 27.01.1995 me ndryshime, ku përcaktohet se:

“Mospagimi i taksave dhe tatimeve brenda afatit të caktuar, me gjithë mundësinë e pagimit të tyre, nga personi ndaj të cilit janë marrë më parë masa administrative për këtë qëllim, dënohet me gjobë ose me burgim gjer në tre vjet.”

Këto veprime janë në kundërshtim me ligjin nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, i ndryshuar neni 9 “Të drejtat dhe përgjegjësitë” pika 1.3., ku përcaktohet se:

“1. Njësitë e vetëqeverisjes vendore kanë këto të drejta dhe përgjegjësi: 1.3. Të drejtën dhe përgjegjësinë e mbledhjes së të ardhurave dhe bërjes së shpenzimeve, sipas së cilës: a) krijojnë, mbledhin të ardhura dhe bëjnë shpenzime për përmbushjen e funksioneve të tyre; b) vendosin taksë vendore e tarifa për shërbimet, si dhe nivelin e tyre, në përputhje me legjislacionin në fuqi; c) hartojnë, miratojnë dhe zbatojnë buxhetin e tyre; ç) mbajnë llogaritë, në përputhje me legjislacionin në fuqi, dhe ofrojnë informacione ose raporte financiare për hartimin dhe zbatimin e buxhetit për qeverisjen qendrore ose shtetasit.”

Neni 35, “Të ardhurat që rrjedhin nga burimet e veta vendore”, me ligjin nr. 68/2017 “Për financat e vetëqeverisjes vendore” i ndryshuar, neni 3 pika 9 dhe 10, si dhe me ligjin nr. 9632, datë 30.10.20106 “Për sistemin e taksave vendore”, Kreu II, Kreu IV, Kreu V, Kreu VII, etj.

Për veprimet dhe mosveprimet e mësipërme mbajnë përgjegjësi:

- z. L. S., me pozicion ish/Përgjegjës Sektori i taksave dhe tarifave vendore;
- z. D. M. me pozicion Specialist Taksash dhe tarifave vendore;
- Z. K. K. me pozicion Specialist Taksash dhe tarifave vendore;
- Z. V. N. me pozicion ish/Specialist Taksash dhe tarifave vendore.

Kriteri: Pikat 3,4, 5 dhe 5, të nenin 45 – “Çregjistrimi i subjekteve tatimore” dhe Kreun XI-Mbledhja me forcë e detyrimit tatimor të papaguar, të ligjit nr. 9920, datë 19.05.2008 “Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë”, me ndryshimet dhe Udhëzimit nr. 24, datë 02.09.2008 “Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë”, me ndryshime; ligjin nr. 7895, datë 27.01.1995, me ndryshimet e mëvonshme, neni 181 -Mospagimi i taksave dhe tatimeve³.

Ndikimi/Efekti: Mos ndjekja e plotë e procedura për arkëtimin e detyrimeve, rrit nivelin e detyrimeve të paarkëtuara në fund të periudhave ushtrimore, si një e ardhur e munguar në buxhetin e bashkisë, ku në fund të vitit 2021 ka një vlerë afërsisht sa plani vjetore i të ardhurave të Bashkisë Përmet.

Shkaku: Mos njohja dhe mos zbatimi i kuadrit ligjorë në fuqi, si dhe mungesa e një strukturë organizative të përshtatshme.

Rëndësia: i lartë

Rekomandimi: Drejtoria e Taksave dhe Tarifave Vendore, Bashkia Përmet, bazuar në nenin 70 pika 3 “E drejta për të nxjerrë njoftimin e vlerësimit tatimor”, të ligjit nr. 9920, datë 19.05.2008 “Për Procedurat tatimore në R.SH”, i ndryshuar, të marrë masa për nxjerrjen e njoftim vlerësimit tatimor për debitorët duke ndjekur të gjitha rrugët për arkëtimin e detyrimeve për taksat dhe tarifave vendore në vlerën 22,459,166 **lekë**, duke ndjekur procedurat si më poshtë vijon:

e- Tu dërgohen bankave të nivelit të dytë urdhrat e bllokimit të llogarive bankare.

³ Mospagimi i taksave dhe tatimeve brenda afatit të caktuar, megjithëse mundësinë e pagimit të tyre, nga personi ndaj të cilit janë marrë më parë masa administrative për këtë qëllim, dënohet me gjobë ose me burgim gjer në tre vjet.

f- Të dërgohet në Drejtorinë Rajonale të Transportit, kërkesa për vendosjen e barrës siguroese (për mjetet) dhe në AKSH (për pasuritë e paluajtshme).

g- Në rast se bizneset private edhe pas njoftimeve zyrtare dhe dërgimit të urdhër bllokimeve në bankë nuk kryejnë pagesën e detyrimeve, pasi të merren masat administrative apo sekuestro, të bëhet kallëzim penal, bazuar në Kodin Penal të RSH, miratuar me ligjin nr. 7895, datë 27.1.1995 me ndryshimet e mëvonshme, neni 181 “Mospagimi i taksave dhe tatimeve”.

h- Drejtoria e të Ardhurave Vendore Bashkia Përmet, në bashkëpunim me Njësitë Administrative, të evidentojë listat emërore të debitorëve familjarë në mënyrë elektronike, duke të njoftojë nëpërmjet postës (dhe jo vetëm) familjet të cilët nuk kanë paguar detyrimet për taksën e tokës/ tarifën e pastrimit, ndriçimit, banesave dhe gjelbërimit.

➤ **Të ardhurat dhe vlerat debitore nga taksa e ndikimit në infrastrukturë:**

Nga auditimi i dokumentacionit që disponon Drejtoria e të Ardhurave, Bashkia Përmet në lidhje me legalizimet e ndërtimeve pa leje dhe listave që disponon për pagesën e taksës së ndikimit në infrastrukturë, konstatohet se nga Drejtoria Rajonale e ALUIZNIT Gjirokastër janë dërguar zyrtarisht me shkresë lista e qytetarëve shoqëruar me leje legalizimi dhe destinuar për regjistrim në ZVRPP (ASHK) Gjirokastër.

Konkretisht për periudhën deri më **31.12.2021**, sipas listave të vëna në dispozicion me leje legalizimi dhe kryqëzimi i tyre me personat që kanë bërë të mundur likuidimin e taksës së ndikimit në infrastrukturë, rezulton se detyrimi për këtë taksë është në vlerën **2,588,137 lekë** për 109 persona, e ardhur e munguar në buxhetin e Bashkisë Përmet. Në mënyrë të detajuar lista e debitorëve nga taksa e ndikimit në infrastrukturë paraqitet në aneksin nr. 4 pika 2.6 bashkëlidhur raportit të auditimit.

Drejtorja e Urbanistikës janë bërë njoftimet për subjektet dhe individët në të cilën parashikohen të gjitha masat shtrënguese për mbledhjen e detyrimeve me shkresën Nr.77 Prot datë 13.01.2022. janë bërë njoftimet për bashkëpunim me Agjencinë Shtetërore të Kadastrës (ASHK) dhe ALUIZNI Gjirokastër, për bllokimin e veprimeve në dhënien e certifikatës së pronësisë deri në kryerjen e pagesave të taksës së ndikimit në infrastrukturë me shkresën Nr. 146 Prot datë 18.01.2022.

➤ **Pajisja me autorizime e subjekteve që tregtojnë hidrokarbure dhe derivatet e tyre:**

Titulli gjetjes: *Lejimi i subjekteve që tregtojnë hidrokarbure me Licencë të bashkisë dhe papaguar tarifën në zbatim të VKM nr. 344, datë 19.04.2017.*

Situata: Sipas dokumentacionit të venë në dispozicion nga Drejtoria e Shërbimeve dhe e licencave, në lidhje me subjektet e tregtimit të karburanteve që ushtrojnë aktivitet në territorin e Bashkisë Përmet rezultojnë se : Në Bashkinë Përmet gjatë vitit 2021 kanë ushtruar aktivitetin e tregtimit me pakicë të karburanteve, gazit të lëngshëm të naftës, për automjetet, vajrave lubrifikantë dhe lëndëve djegëse për përdorim nga konsumatorët fundorë 6 subjekte .Nga të cilët: Subjekti E. sh.p.k ka pezulluar aktivitetin që prej muajit mars kjo sipas Proces- Verbalit nr.10 date 02.03.2022. M. & L. e ka pezulluar aktivitetin në datë 02.03.2021 sipas ekstraktit historik, 6 nga këto subjekte nuk e kanë kryer pagesën për përsëritjen e licencave në kundërshtim me VKM nr.970, datë 2.12.2015, për “Përcaktimin e procedurave dhe të kushteve për dhënien e licencave për tregtimin e naftës bruto dhe nënprodukteve të saj”, pika 14 dhe në kundërshtim me VKM nr. 344, datë 19.4.2017, “Për disa ndryshime dhe shtesa në VKM nr. 970, datë 2.12.2015, “Për përcaktimin e procedurave dhe të kushteve për dhënien e licencave për tregtimin e naftës bruto dhe nënprodukteve të saj”, pika 9. Të ardhurat e munguara janë në vlerën 3,300,000 lekë. Bashkia Përmet nuk ka aplikuar gjoba për fillimin e aktivitetit pa marrë licencën në kundërshtim me Paketën Fiskale të vitit 2021.

Kriteri: Në kundërshtim me nenin 35 të ligjin nr. 9632, datë 30.10.2006 “Për Sistemin e Taksave Vendore”, i ndryshuar, kapitulli II dhe kapitulli III, pika 4. e VKM nr. 170, datë

25.4.2002 “Për përcaktimin e procedurave dhe të kushteve për dhënien e lejeve e të autorizimeve për tregtimin e naftës, gazit e nënprodukteve të tyre”, i ndryshuar si dhe kapitulli II, pika 1; germa “b”, dhe pika 9, ndryshuar me VKM nr. 344, datë 19.04.2017, kapitulli II, pika 1; germa “b” dhe pika 9 dhe 15 të VKM nr. 970, datë 2.12.2015 “Për përcaktimin e procedurave dhe të kushteve për dhënien e licencave për tregtimin e naftës bruto dhe nënprodukteve të saj” i ndryshuar.

Ndikimi/Efekti: Mos ndjekja e procedurës për dhënien e Liçensë së tregtimit të karburanteve, çon në mungesë të ardhura për Bashkinë Përmet me vlerë **3,300,000 lekë**.

Shkaku: Mungesa e bashkëpunimit dhe mos ndjekja e të gjitha rrugëve administrative e ligjore për mos lejimin e ushtrimit të aktivitetit pa dokumentacion të rregullt.

Rëndësia: E lartë

Rekomandimi: Drejtoria e Taksave dhe Tarifave Vendore, të ndjekë të gjitha rrugët administrative e ligjore për arkëtimin e tarifës së pataksuar prej **3,300,000 lekë** ndajë **6** subjekteve, sipas pasqyrës Aneks nr. 4 pika 2.6 bashkëlidhur raportit të auditimit.

➤ **Të ardhurat nga kontratat e aseteve**

Titulli i gjetjes: Krijimi i debitorëve nga mos arkëtimi i nga dhënia me qira e aseteve të Bashkisë si troje, toka bujqësore.

Situata: Nga auditimi në lidhje me arkëtimin e të ardhurave nga dhënia me qira të ambienteve për periudhën 01.01.2021 deri me 31.12.2021, u konstatua se Bashkia Përmet ka lidhur 3 kontrata të reja “Për dhënien me qera të tokës bujqësore” të pandarë si dhe ka vazhduar me kontratat e mëparshme duke i rinovuar afatin sipas kontratave fillestare. Sipas dokumentacionit të vënë në dispozicion rezulton se bashkia procesi i administrimit dhe mbledhje së të ardhurave nga kontratat e qirave administrohet nga *Spektori i Menaxhimit të pronave dhe Strehimit i cili administron 21 kontrata në vlerë 3,548,165 lekë në vite, nuk kanë shlyer detyrimet e kontratës, 2 subjekte në vlerën gjithsej 781,938 lekë me pasojë të ardhura të munguara për buxhetin e njësisë vendore veprime në papajtueshmëri me nenin 12, të ligjit nr. 10296, datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, të ndryshuar dhe kushtet e kontratave të lidhura, VKM nr. 54, datë 5.2.2014 “Për përcaktimin e kriterëve, të procedurës e të mënyrës së dhënies me qira, enfiteozë apo kontrata të tjera të pasurisë shtetërore”; etj.*

Në mënyrë të detajuar paraqitet në aneksin nr. 5 pika 2.6 bashkëlidhur raportit të auditimit

Kriteri: Ligji nr. 7850, datë 29.7.1994 “Kodi Civil i Republikës së Shqipërisë” i ndryshuar; Ligji nr. 48/2014 “Për pagesat e vonuara në detyrimet kontraktore e tregtare”; VKM nr. 54, datë 5.2.2014 “Për përcaktimin e kriterëve, të procedurës e të mënyrës së dhënies me qira, enfiteozë apo kontrata të tjera të pasurisë shtetërore”; etj.

Ndikimi/Efekti: Ndikim negativ në buxhetin e Bashkisë Përmet në vlerën **781,938 lekë** (pa llogaritur kamatëvonesat).

Shkaku: Mos ndjekja e procedurave nga strukturat përgjegjëse. Mangësi në përcaktimin specifik të detyrave dhe mungesë e personelit përgjegjës.

Rëndësia: E lartë

Rekomandim: Bashkia Përmet të marrë masa për të llogaritur detyrimin total të papaguar (duke llogaritur kamatëvonesat) dhe të kërkojë në rrugë ligjore arkëtimin e vlerës prej **781,938 lekë**, duke llogaritur dhe shtuar vlerën e kamatëvonesave për të gjitha rastet e detyrimeve të pa arkëtuara në afat, duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative dhe procedurat e tjera në të gjitha shkallët e gjykimit ndaj debitorëve.

➤ **Të ardhurat nga kontratat e hapsirës publike**

Nga auditimi i dokumentacionit të disponueshëm në zyrën e taksave dhe tarifave vendore të Bashkisë Përmet u konstatua se për vitin **2021** janë arkëtuar të ardhura në vlerën formën e tarifave të qirasë nga 15 subjekte që shfrytëzojnë hapësirat publike, mbi bazë kontratash, akt-marrëveshjes dhe kërkesash të depozituara pranë Bashkisë Përmet, mbështetur në paketën

fiskale të miratuara me VKB-në nr.83 datë 02.12.2020, etj.

Për vitin 2021 ka pasur gjithsej 15 kontrata me persona fizikë për përdorim të hapësirave publike, për një vlerë totale prej 393,866 lekë të cilat janë likuiduar sipas kontratave. Në mënyrë të detajuar paraqitet në aneksin nr. 6 pika 2.6 bashkëlidhur raportit të auditimit.

(Për problemet e mësipërme është mbajtur akt-konstatimin nr. 3, datë 07.10.2022)

3. Auditim mbi vlerësimin e raportimit financiar, për të arritur në opinionin nëse pasqyrat financiare për vitin 2021, japin një paraqitje të vërtetë e të drejtë të pozicionit financiar, performancës financiare dhe fluksit të parasë, bazuar në kuadrin rregullator në fuqi.

3.1. Plotësia dhe saktësia në pasqyrimin e përmbajtjes së ngjarjeve ekonomike;

3.2. Plotësia e shënimeve në pasqyrat financiare për të dhënë një pamje të përgjithshme të pozicionit financiar, performancës financiare dhe fluksit të parasë;

3.3. Opinioni mbi pasqyrat financiare;

• Baza ligjore për mbajtjen e kontabilitetit dhe hartimin e pasqyrave financiare është:

Për vitin 2021 nga njësia shpenzuese “Aparati i Bashkisë Përmet” për hartimin e pasqyrave financiare dhe përgatitjen e llogarive vjetore është mbështetur në Udhëzimin e MFE nr.8 datë 09.03.2018 “Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme”, i ndryshuar. Lidhur me operacionet buxhetore, është rakorduar dhe konfirmuar nga Dega e Thesarit Kavajë si dhe nuk ka patur në asnjë rast kontestimi.

• Hartimi i pasqyrave financiare të konsoliduara.

Bashkia Përmet për vitin 2021 ka hartuar Pasqyrat Financiare vetëm njësinë shpenzuese Bashkia Përmet.

• Afatet dhe konfirmimi i pasqyrave financiare

Pasqyrat financiare janë të firmosura nga NA dhe NZ si dhe janë të dërguara në Degën e Thesarit Përmet për vitin ushtrimor 2021 me shkresë përcjellëse nr. 1017 prot. datë 31.03.2022, depozituar në Degën e Thesarit Përmet me nr. 160 prot., datë 31.03.2022.

Në cilësinë e Nëpunësit Autorizues është Kryetari Bashkisë Përmet dhe në cilësinë e Nëpunësit Zbatues është Drejtori i Financës.

• Rakordimi i pasqyrave financiare me thesarin dhe bankat e nivelit të dytë si dhe me treguesit e realizimit të buxhetit.

Për vitin 2021 nga verifikimi për çdo muaj i ditarit kontabël të bankës sipas natyrës për shpenzimet e klasës 6 dhe klasës 2 me akt rakordimin e thesarit mbi bazë ekstrakte banke (dokumenti i nxjerrjes së llogarisë nga thesari për çdo muaj) për shumat për çdo llogari dhe në total mujor e vjetor rezultoi se nuk ka diferenca. Për këtë janë përdorur ditari i bankës i mbajtur sipas natyrës për autorizimet buxhetore (çeljet) dhe përdorimi fondeve sipas llojit të shpenzimeve.

• Mënyra e mbajtjes së kontabilitetit dhe dokumentacionit bazë e justifikues si dhe sigurimi i informacionit kontabël, përgatitjen e llogarive për vlerësimin e gjendjes pasurore, financiare dhe rezultatit.

Për tu siguruar nëse, regjistrimet kontabël janë kryer në përputhshmëri ligjore dhe me saktësi u kryen testimet në regjistrimet në ditarët kontabël në lidhje me:

- mbështetjen në dokumente justifikuese, të verifikuara përsa i përket vlefshmërisë për t'u pranuar në kontabilitet (vlerësimi kontabël);

- mos ndryshueshmëria e regjistrimeve tashmë të kryera dhe e mbartësve të tyre;

- tërësinë e regjistrimeve në mënyrë kronologjike dhe sistematike deri në mbyllje të të ushtrimit vjetor.

Nëse informacioni kontabël mundëson, në të gjithë ciklin e tij, kontrollin rrjedhës dhe të mëvonshëm nëpërmjet:

- shqyrtimit të vlefshmërisë së një regjistrimi fillestar duke e krahasuar me dokumentin bazë justifikues;

- kontrollit të vlefshmërisë të një regjistrimi të kryer me anë të një dokumenti duke e krahasuar këtë dokument me dokumentet bazë justifikuese mbi të cilat është përgatitur;

- verifikimit të pajtueshmërisë së shumave të nxjerra nga regjistrimet kronologjike me regjistrimet në llogari (barazimi i lëvizjeve të ditarëve me ato të librit të llogarive) dhe verifikimit të pajtueshmërive të tjera aritmetike.

• ***Pohimet e testeve të kryera rreth mbajtjes së kontabilitetit të Aparatit Bashkisë***

Si rezultat i testeve të kryera pohojmë se:

- Kontabiliteti është mbajtur i plotë për të gjitha veprimet kontabël të rezultuara nga kryerja e veprimeve ekonomike, mbi bazën e dokumentacionit bazë dhe justifikues.

- Në këtë bashki, kontabiliteti është organizuar dhe mbahet në mënyrë informatike në program “Excel”.

- Nuk janë zbatuar drejt parimet e përgjithshme për përgatitjen e llogarive vjetore dhe mbajtjen e kontabilitetit, sipas përcaktimeve të dispozitave ligjore për kontabilitetin.

- Azhurnimet e veprimeve ekonomike janë në mënyrë kronologjike dhe kontabilizimet e tyre janë kryer në ditarët e bankës, të arkës, magazinës, të pagave etj por nuk janë mbajtur partitarët për llogaritë kreditore e debitorë. Nuk është mbajtur libri i madh apo libri centralizator për evidentimin e veprimeve kontabël të kryera, duke kaluar nga ditarët në fletë-kontabilizimet apo kartelat kontabël deri në bilancin vërtetues rezultuar nga prerja e artikujve kontabël. Gjithashtu nuk është mbajtur libri i veprimeve të ndryshme për evidentimin e sistemimeve të ndryshme në kartelat kontabël. Këto libra kontabël janë bartës të informacionit të regjistruar në mënyrë kronologjike dhe sistematike të efekteve të veprimeve të kryera, të marra nga dokumentet vërtetuese.

- Në tërësi organizimi i mbajtjes së kontabilitetit ka mundësuar nxjerrjen e gjendjeve të llogarive sipas klasave, nisur nga dokumentet bazë justifikuese, të cilat janë të dhëna bazë të hyra në kontabilitet.

- Plotësimi i dokumenteve bazë e justifikues është bërë në mënyrë të plotë, pasi përshkruajnë me vërtetësi veprimin ose ngjarjen, përmban të dhëna për shkakun e veprimit, datën dhe vendin e kryerjes, objektin, treguesit sasiore dhe ato të vlerës, personat që kanë urdhëruar dhe ekzekutuar veprimin me të dhënat e nevojshme që i japin dokumentit forcën e një prove ligjore ose administrative. Kështu: Dokumentet vërtetues si Urdhër-shpenzimi, fletë hyrje-daljet, mandat arkëtimet e pagesat, janë të hartuara me të gjitha elementet që kërkon formati i miratuar. Këto dokumente shoqërohen nga dokumente autorizues si me urdhrat apo vendimet e organeve drejtuese, kontratat, dokumentet kryesore të procedurave të prokurimit, akt-marrëveshjet etj. Bashkëlidhur këtij dokumentacioni janë dokumentet vërtetues të shpenzimit si faturat, listpagesat, situacionet e shpenzimeve, procesverbalet, shkresat etj.

- Informacioni kontabël është përgatitur mbi bazën e një kontabiliteti të quajtur të angazhimeve (ose në bazë të të drejtave të konstatuara), duke dhënë elementet e nevojshme për të vlerësuar gjendjen pasurore, gjendjen financiare dhe rezultatet e njësisë ekonomike.

• ***Baza e dhënies së opinionit së Raportimit Financiar. Pohimet mbi saktësinë e paraqitjes së zërave të pasqyrave financiare.***

Për dhënien e opinionit mbi pasqyrat financiare, u analizuan treguesit e pasqyrave financiare të Bashkisë për aktivitetin ekonomik - financiar 01.01.2021 deri më datën 31.12.2021.

Pasqyrat financiare janë përgatitur nga Drejtoria e Financës **Gjatë fazës së ekzekutimit në terren, u kryen teste të detajeve dhe teste thelbësore, nga ku u konstatua se, janë mbartur**

saktë tepricat e llogarive dhe se tepricat në çelje për vitin 2021 rakordojnë me tepricat në mbyllje të vitit 2020.

Nga verifikimi i gjendjes së llogarive të bilancit të vitit ushtrimor 2021 rezulton se, llogaritë e Aktivit dhe të Pasivit kuadrojnë me formatet anekse pjese e PF, si dhe llogaritë sintetike kuadrojnë me ato analitike.

Totali i Aktivit për vitin 2020 është në vlerën 976,772,057 lekë dhe për vitin 2021 është 1,262,476,632 lekë. Në mënyrë të detajuar paraqitet në aneksin nr. 1 pika 3 bashkëlidhur raportit të auditimit.

A. AKTIVE AFATSHKURTRA.

Klasa 5 “Mjete monetare dhe ekuivalentet e tyre” në mbyllje të vitit 2021 është në vlerën **92,206,899 lekë**, të cilat rakordojnë me rubrikën V “Teprica në fillim të vitit ushtrimor” dhe rubrikën VI “ Teprica e Likuiditeteve në fund të vitit ushtrimor” në Formatin nr.3 “Pasqyra e flukseve monetare (CASH-FLOË) sipas metodës direkte” .

- *Gjendja e llogarisë 520 “Disponibilitete në Thesar”* sipas bilancit në mbyllje të vitit 2021 është në vlerën **92,206,899 lekë**, gjendje të cilat rakordojnë me realizimin në fakt të fondeve sipas akt-rakordimit me Degën e Thesarit, si dhe rakordon me rubrikën analoge “Tepricën e likuiditeteve në fund të vitit ushtrimor” të Formatit nr.3 “Pasqyrë e flukseve monetare viti 2021” të paraqitur në tabelën e mëposhtme:

Nr. Reshti	Nr Rubrik e	PERMBAJTJA	Periudha Raportuse	Periudha Paraardhese
(a)	(b)	(c)	(1)	(2)
1	I	VEPRIMTARITE E SHFRYTEZIMIT	351,535,621	331,991,927
2	1	Akordim Fonde Buxhetore per shpenzime korente (+)	277,108,862	277,305,708
3	2	Arketime e te hyra(Cash), gjate vitit ushtrimor	74,426,759	54,686,219
4		Te Hyra nga Tatimet e Doganat tatimore e Doganore(+)	0	0
5		Te hyra nga Kontributet e Sig. shoq. e shendets(+)	0	0
6		Te hyra nga ardhurat jotatimore (+)	25,401,000	22,622,000
7		Te hyra, Sponsorizime nga te trete,(+)	1,033,441	769,440
8		Te hyra, nga kredi e huamarrje afatshkurter(+)		
9		Te hyra nga Mjetet ne ruajtje(+)	30,379,759	0
10		Te tjera, arketuar(+)	17,612,559	17,713,838
11	3	Pagesa per Detyrime e Shpenzime korente	259,328,722	350,431,759
12		Per detyrime e Shpenzime nga vitet e kaluara(-)		
13		Per detyrime e Shpenzime te viti ushtrimor(-)	259,328,722	350,431,759
14		Pagesat per mjetet ne ruajtje(-)		
15		Interesi I paguar(-)		
16		Tatime te paguara(-)		
17		Te tjera te paguara (-)		
18	II	VEPRIMTARITE E INVESTIMEVE	71,152,332	91,981,743
19		Akordim Fonde Buxhetore per shpenzime Kapitale (+)		
20		Te hyra nga Kredi dhe e huamarrje afatgjata(+)		
21		Te hyra nga shitja e Aktiveve Afatgjata (+)		
22		Te hyra nga interesat e huadhenies dhe nenhuadhenies(+)		
23		Pagesa per detyrime e Investime nga vitet e kaluara(-)		
24		Per detyrime e Investime te viti ushtrimor(-)	71,152,332	91,981,743
25		Huadhenie e Nenhuadhenie(-)		
26		Pjesmarrje ne kapitalin e vet(-)		
27			

28	III	TRANSFERTA E TE TJERA	0	0
29		Derdhje e Transferime te te Ardhurave ne Buxhet(-)		
30		Transferime ne buxhet te Fondevete pa perdorura(-)		
31		Levizje e brendshme e transfertu te tjera(+/-)		
32	IV	Rritja /Renia neto e Mjeteve monetare	422,687,953	423,973,670
33	V	Teprica ne fillim te vitit ushtrimor		
34	VI	Teprica e Likujditeteve ne fund te vitit ushtrimor	92,206,899	73,541,911

Burimi: Drejtoria e financës

Titulli gjetjes: Mos pasqyrimi i llogarisë 63 “Ndryshimi i gjendjeve të inventarit” në formatin nr.2 “Pasqyra e performancës financiare”.

Situata:

Në klasën 3 “Gjendja e inventarit qarkullues” të aktiveve qarkulluese paraqiten në mbyllje të vitit 2020 në vlerën 43,404,244 lekë dhe në mbyllje të vitit 2021 në vlerën 43,836,291 lekë, ku diferenca e tyre në rritje në vlerën prej 432,047 lekë. Vlerë e cila nuk rakordon me gjendjen e llogarisë 63 “Ndryshimi i gjendjeve të inventarit” në formatin nr.2 “Pasqyra e performancës financiare”. Veprimet dhe mosveprimet janë në kundërshtim me Udhëzimin e MFE nr.8 datë 09.03.2018 ”Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme”, i ndryshuar.

Kriteri:

Udhëzimin e MFE nr.8 datë 09.03.2018 ”Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme”, i ndryshuar

Ndikimi/Efekti: Nuk paraqet një panoramë të qartë të pasqyrave financiare.

Shkaku: Mos zbatim i kuadrit ligjorë për sistemin e llogarive.

Rëndësia: I lartë

Rekomandimi:

Drejtoria e Financës të marrë masa që në mbyllje të pasqyrave financiare të vitit 2022 të pasqyrohet sakt, llogaria 63 “Ndryshimi i gjendjeve të inventarit” në formatin nr.2 “Pasqyra e performancës financiare”.

- **Gjendja e llogarisë 31 “Materiale”** paraqitet në mbyllje të vitit 2020 në vlerën 6,814,145 lekë dhe në mbyllje të vitit ushtrimor 2021 në vlerën 5,632,292 lekë, me një diferencë në ulje për vitin ushtrimor prej 1,181,853 lekë, e cila përfaqëson pakësim të gjendjes së mallrave në fund të vitit 2021 e analizuar.

B	Klasa 3 "Inventaret Qarkullus"	Kodi IV	Kodi VII	Celje 01.01.2021	Shtesa	Pakësime
1	31 "Materiale"	3120	3120100	6,814,145		1,181,853

Burimi: Drejtoria e financës

- **Gjendja e llogarisë 32 “Inventari i imët ”** paraqitet në mbyllje të vitit 2020 në vlerën 36,590,099 lekë dhe në mbyllje të vitit ushtrimor 2021 në vlerën 38,203,999 lekë me një diferencë në rritje për vitin ushtrimor prej 1,613,900 lekë, e cila përfaqëson rritje të inventarit të imët për vitin 2021, e analizuar.

B	Klasa 3 "Inventaret Qarkullus"	Kodi IV	Kodi VII	Celje 01.01.2021	Shtesa	Pakësime
1	32 “Inventari I imet”	3270	3270100	6,814,145	1,613,900	

Burimi: Drejtoria e financës

Klasa 4 “Llogari të arkëtueshme” paraqiten në mbyllje të vitit 2020 në vlerën 57,020,315 lekë dhe në mbyllje të bilancit të vitit 2021 në vlerën 108,749,125 lekë, ku kemi shtim duke e krahasuar me vitin paraardhës, i cili ka ardhur si rezultat i mos kryerjes se pagesave ndaj kreditorëve të ndryshëm në lidhje me investimet dhe shërbimet e ndryshme.

- **Gjendja e llogarisë 468 “Debitorë të ndryshëm”,** e cila përfaqëson shumën e të drejtave të arkëtueshme nga të tretët, në mbyllje të vitit 2020 është në vlerën 33,198,811 lekë dhe në

mbyllje të vitit ushtrimor 2021 paraqitet në vlerën 53,438,709 lekë. Vlera e debitorëve në vitin 2021 në krahasim me vitin 2020 ka pësuar një rritje prej 20,239,898 lekë, në të cilën ka ndikuar rritja e debitorëve të taksave. Në vlerën e lartë të gjendjes së llogarisë së debitorëve ka ndikuar edhe gjendja e debitorëve lekë për detyrimet shpërblim dëmi të lëna nga KLSH në vite, për të cilat nuk janë ndjekur të gjitha hapat ligjore për arkëtimin e këtyre detyrimeve, duke kaluar afatet e kërkimit, në kundërshtim me Ligjit nr. 44/2015, datë 30.04.2015 “Kodi i Procedurave Administrative në Republikën e Shqipërisë” nenet 98-102, ligjin nr. 139/2015, datë 17.12.2015 “Për vetëqeverisjen vendore” nenet 21-33 dhe Udhëzimin e Ministrit të Financave nr. 30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”, pika 93.

-Gjendja e llogarisë 4342 “Operacione me shtetin, të drejta” (debitorë) më 31.12.2021 paraqitet në vlerën 61,259,054 lekë. Nga analiza e llogarisë **4342 “Operacione me shtetin, të drejta”** për vitin 2021 është e analizuar si vijon:

NR.	EMERTIMI	Gjendje 31.12.2021 e llog 4342
1	Paga Personeli llogaria 42	7,912,942
2	Tatim page tatim ne burim llogaria 431	350,565
3	Sigurimet Shoqërore llogaria 435	2,661,151
4	Sigurime Shëndetësore llogaria 436	512,738
5	Furnitorëllogaria.401-408	44,385,758
	Shuma	55,310,416

Nga analiza e llogarisë 4342 konstatohet se nuk rezulton diferencë midis vlerës pasqyruar në llogarinë **4342 “Operacione me shtetin, të drejta” dhe vlerës të pasqyruara në 5 (pesë) llogarive pasive**, pra në vitin 2021 është, e njëjtë me vlerën e pasqyruar në aktivin e pasqyrave të pozicionit financiar, në përputhje me Udhëzimin e MFE nr.8 datë 09.03.2018 ”Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme”, i ndryshuar.

Klasa 4 “Të tjera aktive afatshkurtra” e cila përbëhet nga :

Gjendja e llogarisë **486 “Shpenzime të periudhave të ardhshme”** paraqitet në mbyllje të vitit 2020 në vlerën 6,264,101 lekë dhe në mbyllje të vitit 2021 në vlerën 6,164,101 lekë. Gjendja e llogarisë 486 “Shpenzime të periudhave të ardhshme” në aktiv **rakordon** me gjendjen e llogarisë 467 “Kreditorë të ndryshëm” në pasiv e cila paraqitet në mbyllje të vitit 2020 në vlerën 6,264,101 lekë dhe në mbyllje të vitit 2021 në vlerën 6,164,101 lekë në përputhje me Udhëzimin e MFE nr.8 datë 09.03.2018 ”Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme”, Kreu III. “Procedurat për përgatitjen, paraqitjen dhe konsolidimin e pasqyrave financiare në njësitë e qeverisjes së përgjithshme” pika 42.

II. AKTIVE AFATGJATA MATERIALE

Auditimi i aktiveve afatgjata materiale

Objektivat e auditimit të aktiveve afatgjata materiale, janë që të sigurohemi se:

Aktivet ekzistojnë; ato i përkasin subjektit; janë të vlerësuara në mënyrë korrekte; janë regjistruar në mënyrë korrekte; është bërë mirë ndarja midis shpenzimeve dhe aktiveve të qëndrueshme; informacionet që ndodhen në aneksin përkatës janë të plota dhe korrekte.

2. Kontrolle të përgjithshme të llogarive dhe dokumenteve:

- Për auditimin e aktiveve **afatgjata materiale**, u kryen një numër kontrollesh të përgjithshme:
- U verifikua tabela e lëvizjeve të aktiveve **afatgjata materiale** në raport me gjëndjet dhe ndryshimin e tyre gjatë periudhës ushtrimore;
- U ekzaminua tabela e lëvizjeve, nëse ka ndodhur ndonjë variacion anormal mbi aktivet **afatgjata materiale**;
- U ekzaminuan të gjitha shpjegimet që janë paraqitur lidhur me shmangiet dhe përjashtimet e veçanta;

- U verifikua nëse parimet kontabël të ndjekura prej subjektit për vlerësimin dhe kontabilizimin janë konform parimeve të përgjithshme të pranura dhe udhëzimeve përkatëse;
- U verifikua nëse shifrat e çeljes rakordojnë me ato të mbylljes së ushtrimit të mëparshëm;
- U krahasuan investimet e realizuara gjate ushtrimit me ato të planifikuara në buxhet.

3. Disa nga parimet e zbatuara për auditimin e aktiveve afatgjata materiale:

a. Gjatë hyrjes se aktiveve në pronësinë e subjektit, duhet të sigurohemi se veprimet janë kryer në zbatim të kërkesave të UMF nr. 30, datë 27.12.2011 “Mbi menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”.

- Për Aktivet e blera janë kryer teste për 5 kampione në dokumentet bazë të hyrjes dhe kartelat analitike kontabel nëse janë kontabilizuar sipas vlerës së tyre të marrjes. (çmimit të blerjes shtuar shpenzimet e tjera të nevojshme për vënien në gjendje përdorimi të pasurisë);
- Për Aktivet e marra falas janë kryer teste për 4 kampione në dokumentet bazë të hyrjes dhe kartelat analitike kontabel nëse janë kontabilizuar duke i vlerësuar ato me vlerën e shitjes;
- Aktivet e sjella në subjekt (kalim kapital) janë kryer teste për 2 kampione në dokumentet bazë të hyrjes dhe kartelat analitike kontabel nga të tretët nëse kontabilizohen me vlerën e tyre të sjelljes.

b. Për inventarin, janë kryer teste për tu siguruar që subjekti:

- Proçedon për regjistrimin dhe vlerësimin e aktiveve të saj të qëndrueshme sipas rregullave kontabël përgjithësisht të pranura;
- Përdor referencat ose teknikat më të përshtatshme për natyrën e pasurisë (çmimi i tregut, tabelat e publikuara, treguesit specifike, etj.);
- Ka ruajtur të njëjtat rregulla vlerësimi nga një inventar në tjetrin.

Në formatin nr. 1 “**Aktivët Afatgjata Materiale**” në aktiv të bilancit paraqiten në vlerën neto, duke zbritur investimet (gjendjen e llog 231 “Investime”). Gjendja në total paraqitet në mbyllje të vitit 2020 në vlerën 809,670,336 lekë dhe në mbyllje të vitit 2021 në vlerën 794,308,160 lekë. Ndërsa sipas Formatit 7/b “Gjendja dhe ndryshimet e aktiveve afatgjata (kosto historike)” paraqiten në mbyllje të vitit 2021 në vlerën 794,308,160 lekë, të cilat janë të pasqyruara më poshtë sipas llogarive analitike.

- **Gjendja e llogarisë 202 “Studime dhe kërkime”** në aktiv të bilancit paraqitet në vlerën neto në mbyllje të vitit 2020 në shumën prej 452,091 lekë dhe në mbyllje të vitit 2021 në vlerën 459,486 lekë. Ndërsa sipas Formatit 7/b “Gjendja dhe ndryshimet e aktiveve afatgjata (kosto historike)” gjendja paraqitet në mbyllje të vitit 2021 në vlerën prej 7,302,172 lekë, ku diferenca në rritje prej 30,000 lekë i përket “Ndërtim i Ujësjetës Pacomit, Bashkia Përmet” duke i zbritur amortizimin e akumuluar. Sipas të dhënave kontabël, kjo llogari është e analizuar si vijon.

Nr	EMERTIMI	Vlera
1	Projekti I Ures Biovizhde	300,000
2	Prijekti I ures Psillotere	390,000
3	Projekti I rruges Dracove	400,000
4	Projekti I rruges Iliare Pellumbar	400,000
5	Projekti I rruges Vllaho Psillotere	399,999
6	Projekti I klanalit ushqyes Rezervuari Kendref	399,999
7	Projekti sistemim asfaltim rruga Biovizhde	400,000
8	Projekti sistemim asfaltim rruga Zhepe	400,000
9	Projekte te ndryshme 2015	4,212,174
	SHUMA 202	7,302,172

Burimi: Drejtoria e financës

Titulli gjetjes: Mbi kontabilizimin e llogarisë 202 “Studime dhe kërkime”.

Situata:

Nga analiza e kësaj llogarie, **konstatohet se:**

a) Vlera **7,302,172 lekë**, i përket 9 projekteve për investimet e kryera, për objekte të cilat kanë

përfunduar punimet dhe janë marrë në dorëzim nga Bashkia, vlerë e cila duhet të ishte sistemuar në llogaritë përkatëse të investimit të përfunduar si pjesë e kostos totale të objektit, sipas llogaris analitike.

b) Gjithashtu nga dokumentacioni i vënë në dispozicion nga sektori juridik rezulton se për vitin 2021 Bashkisë Përmet i është dhuruar projekti i Ndërtim i Ujësjiellit Pacomit, Bashkia Përmet sipas shkresës nr. 654 prot datë 11.03.2021 me vlerë 65,530,701 lekë, miratuar me VKB nr. 84 datë 18.03.2021 si dhe është hartuar nga zyra e urbanistikës “Projekti i punime shtesë në linjën kryesore stacion pompimi-depo për fshatrat Bodar dhe Kutal” në vlerën 6,698,035 lekë të cilat nuk janë bërë hyrje në magazinë si dhe nuk janë pasqyruar në kontabilitet në vitin ushtrimor. Kjo paraqitje e llogarisë 202 “Studime e kërkime” është bërë në kundërshtim; është në kundërshtim me Udhëzimet e MFE nr. 8, datë 9.3.2018 “Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme” i ndryshuar, Aneksi 1 “Analiza e detajuar e klasave të llogarive të kontabilitetit në sektorin publik” **Pika 2. Klasa 2**, “Aktivet afatgjata” (përbërja dhe trajtimi kontabël) e cila përcakton: “Trajtimet kontabël për AAGJM-në, lidhen me njohjen fillestare të aktivitetit.

Kriteri:

Udhëzimet e MFE nr. 8, datë 9.3.2018 “Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme” Aneksi 1 “Analiza e detajuar e klasave të llogarive të kontabilitetit në sektorin publik” **Pika 2. Klasa 2**, “Aktivet afatgjata” (përbërja dhe trajtimi kontabël) e cila përcakton: “Trajtimet kontabël për AAGJM-në, lidhen me njohjen fillestare të aktivitetit.

Ndikimi/Efekt: Nuk paraqet një panoramë të qartë të pasqyrave financiare.

Shkaku: Mos zbatim i kuadrit ligjorë për sistemin e llogarive

Rëndësia: I mesëm

Rekomandimi:

Drejtoria e Financës të marrë masa për sistemimin e llogarisë (202) “Studime dhe kërkime”, duke bërë që në këtë llogari të paraqitet vetëm vlera e projekteve, për të cilat investimet e lidhura me to nuk kanë përfunduar. Për projektet të cilat kanë përfunduar, vlerat të kapitalizohet sipas objekteve përkatëse dhe regjistrohen në llogaritë përkatësisë, si pjesë e kostos totale të objektit.

- **Gjendja e llog. 210 “Toka, Troje, Terrene”** paraqitet me vlerë neto si në mbyllje të vitit 2020 në shumën totale prej 5,827,067 lekë dhe në mbyllje të vitit 2021 në shumën totale prej 5,896,567 lekë. Ndërsa sipas Formatit 7/b “Gjendja dhe ndryshimet e aktiveve afatgjata (kosto historike)” në mbyllje të vitit 2021 në të njëjtën vlerë prej 5,896,567 lekë. Këto gjendje paraqiten të analizuar sipas vlerës kontabël si vijon:

Nr	EMERTIMI	Vlera
1	Masivi shkembor Zhepe	987,714
2	Qendra Cacrcove	985,186
3	Toka e terene 2015	3,831,167
4	Hipotekim nga zyra e aseteve viti 2020	23,000
5	Hipotekim nga zyra e aseteve viti 2021	69,500
	SHUMA	5,896,567

Burimi: Drejtoria e financës

Gjendja e llogarisë 211 “Pyje, Plantacione” paraqitet në vlerë neto në mbyllje të vitit 2020 paraqitet në vlerën 0 lekë dhe në mbyllje të vitit 2021 në vlerën 839,760 lekë, shtese vinë si rrjedhojë e pyllëzimit në sipërfaqe pyjore. Ndërsa sipas Formatit nr.7/B “Gjendja dhe ndryshimet e aktiveve afatgjata (kosto historike)” në mbyllje të vitit 2021 paraqitet në vlerë të njëjtë prej 839,760 lekë.

- **Gjendja e Llogarisë 212 “Ndërtesa Konstruksione”** paraqitet në vlerë neto në mbyllje të vitit 2020 në vlerën 482,500,197 lekë dhe në mbyllje të vitit 2021 në vlerën 461,929,171 lekë. Për vitin 2021 janë shtuar vlerat 12,688,140 për vlerën e Rikonstruksion Gjimnazi “Sami Frasheri”, vlera 2,476,400 lekë “Rikonstruksion Qendra Shëndetësore Petran” dhe vlera 2,211,740 leke “Rikonstruksion Qendra Shëndetësore Piskove” Ndërsa sipas Formatit nr.7/B “Gjendja dhe ndryshimet e aktiveve afatgjata (vlera historike)” në mbyllje të vitit 2021 është në vlerën 593,871,461 lekë. Pra kemi ulje në vlerën 131,942,290 lekë për vlerën e amortizimit. Analiza e gjendjes së kësaj llogarie në vitin 2021 paraqiten në mënyrë kontabël sipas aneksit nr. 2 pika 3 bashkëlidhur raportit të auditimit.

- **Gjendja e Llogarisë 213 “Rrugë, rrjete, vepra ujore”** paraqitet në vlerën neto në mbyllje të vitit 2020 në vlerën 257,782,187 lekë dhe në mbyllje të vitit 2021 në vlerën 264,221,237 lekë. Ndërsa sipas Formatit nr.7/B “Gjendja dhe ndryshimet e aktiveve afatgjata (vlerën historike)” paraqiten në mbyllje të vitit 2021 në vlerën 1,250,267,934 lekë. Gjatë vitit 2021 janë shtuar për vlerën 75,768,997 lekë “Rikonstruksion i rrjetit të ujësjellësve Rajonal”, për vlerën 1,586,994 lekë “Rikonstruksion kanali i ushqimit Qilarisht”, në vlerën 1,586,994 lekë, “Sistemim Asfaltim rrugët e Bashkisë Përmet”, për vlerën 16,862,000 lekë, “Ndërtim rrjeti ujitës Bodar Kutal”, për vlerën 23,159,637 leke, “Ndërtim ujësjellësi Pacomit” për vlerën 12,999,210 leke, dhe Super vizime në vlerën 961,156 leke. Amortizimi për vitin 2021 është llogaritur 986,046,697 leke. Analiza e gjendjes së kësaj llogarie në vitin 2021 paraqiten sipas aneksit nr. 3 pika 3 bashkëlidhur raportit të auditimit.

- **Gjendja e llogarisë 214 “Instalime teknike, makineri, pajisje, vegla pune”** në vlerë neto paraqitet në mbyllje të vitit 2020 në vlerën 26,820,398 lekë dhe në mbyllje të vitit 2021 në shumën 28,338,963 lekë. Gjatë vitit 2021 është shtuar në vlerën 3,679,159 lekë e cila është e analizuar sipas vlerës kontabël.

- **Gjendja e llogarisë 215 “Mjete Transporti”** në vlerën neto paraqite në mbyllje të vitit 2020 në vlerën 26,124,692 lekë dhe në mbyllje të vitit 2021 në vlerën 24,235,890 lekë. Ndërsa sipas Formatit nr.7/B “Gjendja dhe ndryshimet e aktiveve afatgjata (kosto historike)” paraqiten në mbyllje të vitit 2021 në vlerën 37,776,045 lekë, vlera e amortizimit te akumuluar është 13,540,155 leke. Analiza e gjendjes së kësaj llogarie dhe lëvizjet e këtyre aktiveve në fund të vitit 2021 paraqiten sipas aneksit nr. 4 pika 3 bashkëlidhur raportit të auditimit.

- **Gjendja e llogarisë 218 “Inventar Ekonomik”** në vlerën neto paraqitet në mbyllje të vitit 2020 në vlerën 10,615,795 lekë dhe në mbyllje të vitit 2021 në vlerën 8,846,572 lekë. Ndërsa sipas Formatit nr.7/B “Gjendja dhe ndryshimet e aktiveve afatgjata (kosto historike)” paraqitet në mbyllje të vitit 2021 në vlerën kontabël 37,217,766 lekë. Ndërsa vlera e amortizimit e përlllogaritur është në shumën 28,371,194 lekë.

- **Gjendja e aktiveve afatgjata** në vlerën bruto dhe neto si dhe ndryshimet për vitin 2021 paraqiten në Formatin nr.7/B “Gjendja dhe ndryshimet e aktiveve afatgjata (kosto historike)” të PF si më poshtë:

Në lekë

Nr. Jesh	Nr. Reference Llogarije	EMERTIMI	Teprica ne fillim			Shtesat gjate vitit		Paksimet gjate vitit		Teprica ne Fund		
			Kosto Historike	Amortizim Akumuluar	Teprica Neto	Kosto Historike	amortizimi	Kosto Historike	Amortizim	Kosto Historike	Amortizim Akumuluar	Teprica Neto
a	b	c	1	2	3	4	5	6	7	8	9	10
1	20	L. AAGJ/JO MATERIALE	7,272,172	6,820,081	381,148	30,000	0	0	-22,605	7,302,172	6,842,686	459,486
2	201	Prime te emisionit dhe rimbursimit te huave			0					0	0	0
3	202	Studime dhe kerkime	7,272,172	6,820,081	381,148	30,000			-22,605	7,302,172	6,842,686	459,486
4	203	Koncesione, patenta,licenca e tjera ngjashme			0					0	0	0
5	21- 28	II. AAGJ/ MATERIALE	1,887,984,625	1,078,314,289	798,667,723	79,032,856	0	299,394	-94,095,638	1,966,718,087	1,172,409,927	794,308,160
6	210	Toka,troje,Terene	5,827,067		5,827,067	69,500				5,896,567	0	5,896,567
7	211	Pyje,Kullota Plantacione	0		0	839,760				839,760	0	839,760
8	212	Ndertime e Konstruksione	585,183,321	102,683,124	481,910,566	8,688,140			-29,259,166	593,871,461	131,942,290	461,929,171
9	213	Rruge,rrjete,vepra ujore	1,184,598,937	926,816,750	251,334,045	65,668,997			-59,229,947	1,250,267,934	986,046,697	264,221,237
10	214	Instalime teknike,makineri,pajsje,vegla pun	37,468,789	10,648,391	27,654,469	3,679,159		299,394	-1,861,200	40,848,554	12,509,591	28,338,963
11	215	Mijete transporti	37,776,045	11,651,353	24,679,163	0			-1,888,802	37,776,045	13,540,155	24,235,890
12	216	Rezerva shtetore			0					0	0	0
13	217	Kashe pune e prodhimi			0					0	0	0
14	218	Inventar ekonomik	37,130,466	26,514,671	7,262,413	87,300			-1,856,523	37,217,766	28,371,194	8,846,572
15	24	Aktive te Qend.te trupezuara te demtuara			0					0	0	0
16	28	Caktime			0					0	0	0
17		TOTALI (I+ II)	1,895,256,797	1,085,134,370	799,048,871	79,062,856	0	299,394	-94,118,243	1,974,020,259	1,179,252,613	794,308,160

Burimi: Drejtoria e financës

Titulli i gjetjes: Regjistri analitik i aktiveve nuk është sipas formatit të përcaktuar.

Situata:

Amortizimi i AQ të Trupëzuara dhe të Patrupëzuara për aktivet afatgjatë jo materiale dhe materiale gjendje me 31.12.2021 në llogaritë: llog.202 “Studime dhe Kërkime” në vlerën 459,486 lekë, llog. 210 “Toka, Troje, Terrene” në vlerën 5,896,567 lekë, llog. 212 “Ndërtesa Konstruksione” në vlerën 461,929,171 lekë; llog. 213 “Rrugë, rrjete, vepra ujore” në vlerën 264,221,237 lekë; llog.214 “Instalime teknike, makineri, pajisje, vegla pune” në vlerën 28,338,963 lekë. Mungon regjistri analitik i aktiveve sipas formatit, ku për çdo aktiv të përmbajë të dhënat për veprimet ekonomike të kryera me to në vite si: viti i hyrjes, vendodhjen, përshkrimin e aktivitetit, vlerën e blerjes, vlerën e shpenzimeve kapitale të kryera në vitet e mëpashme që sjellin rritje të vlerës së aktivitetit, vlerën e akumuluar të amortizimit dhe vlerën e mbetur. Amortizimi i AAGJ është llogaritur për grup aktivesh ne total dhe jo aktiv për aktiv, duke mos përllogaritur saktësisht amortizimin, pasi aktive të ndryshme kanë vlerë të ndryshme amortizimi të akumuluar sepse kanë kohë (vite) të ndryshme përdorimi. Nga testimet e kryera mbi përqindjet e aplikuara të normës së amortizimit mbi totalin e vlerave të mbetura sipas llogarive të klasës 20 dhe 21 rezulton se ka pasaktësi në përllogaritjet e amortizimit vjetor të AAGJ Veprimet dhe mosveprimet janë në kundërshtim me Udhëzim e MFE nr. 8, datë 9.3.2018 “Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme” i ndryshuar, Kreu III “Procedurat për përgatitjen, paraqitjen dhe konsolidimin e pasqyrave financiare në njësitë e qeverisjes së përgjithshme”, pika 36, Aneksi 1 “Analiza e detajuar e klasave të llogarive të kontabilitetit në sektorin publik” Pika 2. Klasa 2, “Aktivet afatgjata” (përbërja dhe trajtimi kontabël). UMF nr. 30 datë 27.12.2011 “Për Menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik” kapitulli III, pika 30, kapitulli IV, pika 75.

Kriteri: Udhëzim e MFE nr. 8, datë 9.3.2018 “Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme” Kreu III “Procedurat për përgatitjen, paraqitjen dhe konsolidimin e pasqyrave financiare në njësitë e qeverisjes së përgjithshme”, pika 36, Aneksi 1 “Analiza e detajuar e klasave të llogarive të kontabilitetit në sektorin publik” Pika 2. Klasa 2, “Aktivet afatgjata” (përbërja dhe trajtimi kontabël). UMF nr. 30 datë 27.12.2011 “Për Menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik” kapitulli III, pika 30, kapitulli IV, pika 75.

Impakti: Mungesa e regjistrimit të AAGJ si dhe mos pasqyrim i saktë i vlerës neto të aktiveve afatgjata materiale nga përlllogaritja e gabuar e amortizimit me ndikim në informacionin kontabël që ofrojnë pasqyrat financiare në lidhje me plotësinë e vlerave të AAGJ, duke paraqitur risk në besueshmërinë dhe përdorimin e tyre nga subjektet e interesuara.

Shkaku: Nga Drejtoria Ekonomike nuk janë marrë masat e nevojshme në llogaritjen e saktë të amortizimit.

Rëndësia: I lartë

Rekomandimi: Drejtoria Ekonomike në Bashkinë Përmet të marrë masa për kryerjen e inventarizimit të AAGJM, të krijojë dhe të mbajë regjistrin analitik aktiveve, ku të përmbajë të dhënat për veprimet ekonomike të kryera me to në vite si: viti i hyrjes, vendodhjen, përshkrimin e aktivitetit, vlerën e blerjes, vlerën e shpenzimeve kapitale të kryera në vitet e mëpasshme që sjellin rritje të vlerës së aktivitetit, vlerën e akumuluar të amortizimit dhe vlerën e mbetur.

Të kryejë veprimet për përlllogaritjen e saktë të amortizimit aktiv për aktiv sipas të dhënave regjistrimit të aktiveve, duke aplikuar normat e amortizimit të miratuara me qëllim saktësimin e vlerës së mbetur të AAGJ dhe reflektimi i të gjithë ndryshimeve në kontabilitet nëpërmjet sistemeve kontabël, duke pasqyruar saktë dhe realisht gjendjet e AAGJ në llogaritë përkatëse të klasës 20 dhe 21 në pasqyrat financiare.

3.Nënrubrika, aktive afatgjata financiare, ku bëjnë pjesë referencat e llogarive 25 “Huadhënie e nën huadhënie” dhe 6 “Pjesëmarrje në kapitalin e vetë”, më 31.12.2020 paraqitet në vlerën 0 lekë dhe më 31.12.2021 paraqitet në vlerën 216,752,570 lekë. që i përket paraqitet si aksionare me 100% të aksioneve të Ujësjiellës Kanalizime Përmet SHA.

Pasivet afatshkurtra. Sipas pasqyrave financiare gjendja e llogarive kreditore në total paraqitet në mbyllje të vitit 2020 në vlerën 76,865,357 lekë dhe në mbyllje të vitit 2021 në vlerën 145,292,985 lekë dhe përbëhet nga llogaritë si vijon:

- **Gjendja e llogarisë 401- 408 “Furnitorë e llogari të lidhura me to”** përfaqëson detyrimet ndaj të tretëve për fatura të palikujduara. Kjo gjendje në pasiv të bilancit paraqitet në mbyllje të vitit 2020 në vlerën 13,320,458 lekë dhe në mbyllje të vitit 2021 në vlerën 44,385,758 lekë. sipas bilancit, në mënyrë të detajuar paraqitet në tabelën e mëposhtme:

Analiza e llogarisë 401 “Furnitorë e llogari të lidhura me to”

Nr.	Emri i Furnitorit	DETYRIMI 01.01.2021
1	A. M. riparime mjete AP	26,700
2	N. Q. gomat AP	18,000
3	Keshilltar+Kryetar	304,000
4	Mbremje poetike E. N.	100,000
5	Sporti G. B.	99,900
6	Arsimi ushqimet N.	240,309
7	Cerdhe Nika	66,090
8	Konvikti Nika	34,830
9	Pjese Kembimi A. M. MNZ	122,200
10	Pjese Kembimi A. M. BK	141,100
11	N. Q.gomat AP	366,288
12	N.	2,186,750
13	A. K.	4,149,036
14	H. Sistemim asfaltim rruge te ndr.	36,530,555
	Totali	44,385,758

Burimi: Drejtoria e financës.

- **Gjendja e Llogarisë 421 “Personel llogari të lidhur me to”.** paraqitet në fund të vitit 2021 në vlerën 7,912,942 lekë e cila rakordon me vlerën sipas listë pagesave të punonjësve të muajit Dhjetor për pagat që do të paguhet në Janar të vitit 2022.

- **Gjendja e llogarisë 431 “Detyrimet ndaj shtetit për tatim taksat”** paraqitet në fund të vitit 2021 në vlerën kontabël 350,565 lekë, e cila rakordon me vlerën sipas listë-pagesave të punonjësve të muajit dhjetor 2021 për detyrimet tatimit mbi pagën, që do të paguhet në janar të vitit 2022.

- **Gjendja e llogarisë 435 “Sigurime shoqërore”** paraqitet në fund të vitit 2021 në vlerën 2,661,151 lekë, sipas listë-pagesave të punonjësve të muajit dhjetor 2021 për detyrimet tatimit mbi pagën, që do të paguhet në janar të vitit 2022.

- **Gjendja e llogarisë 466 “Kreditorë për mjete në ruajtje”** përfshin garancitë e ngurtësuar për investime të kryera. Gjendja e kësaj llogarie paraqitet në mbyllje të vitit 2020 në vlerën 13,580,941 lekë dhe në mbyllje të vitit 2021 në vlerën 30,379,759 lekë. Për këtë gjendje të llog 466 është bërë raportimi në degën e Thesarit Përmet në mënyrë analitike, e cila paraqitet si vijon:

Nr.	Emertimi i objektit	Firma	Vlera ngurtësuar
1	Projekte per permiresimin e kushteve te banimitper komunitete te favorizuara Fshatrat Piskove e Pacomit .	N.	546,688
2	Rehabilitimi I rrjetit te ujesjellesit dhe rruget e brendeshme te fshatit Piskove	M.	1,349,364
3	Rikonst .Gjimnazi "S. Frasheri "	A.	3,867,065
4	Rikonstruksion ujesjellesat rajonal	H.	1,420,407
5	Ndertim ujesjellesi Pacomit	I.	649,961
6	Ndricim i Gurit te qytetit	A.	513,651
7	Kanali strembec	N.	987,188
8	Kanali ujites Kutal- Bodar	I.	1,325,012
9	pajisje	A.	27,306
10	Rezervuari Qilarisht		288,048
11	Shtese punimesh kanali ujites Kutal- Bodar		332,859
12	Rikonstruksion shkolla" Nonda Bulka"	H. shpk	2,617,292
13	Ngurtesim vila e pritjes	A.	153,000
14	Ngurtesimet e pullave	Drejt.Tatimeve	71,500
15	Ngurtesim projekti per mbjelljen e trendafilat te eger	B.	16,230,418
	TOTALI		30,379,759

Burimi: Drejtoria e financës.

Nga analiza e llogarisë 466 “Kreditorë për mjetet në ruajtje”, nuk jep informacion të plotë, pasi mungon afati i fillimit dhe mbarimit të garancisë së vlerës 5% të punimeve për subjektet private. Mungesa e këtij afati, nuk jep mundësi për ndjekjen e grafikut të kthimit të garancisë për investimet e marra në dorëzim në mënyrë përfundimtare dhe evidentimin e investimeve të pa përfunduara ende. Në pasqyrat financiare të vitit 2021 vlera e llogarisë 466 është në vlerën **30,379,759 lekë** *Veprimet dhe mosveprimet janë në kundërshtim me UMF nr. 8, datë 9.03.2018 “Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në Njësitë e Qeverisjes së Përgjithshme”, Kap. III, pikat 30, 50.*

Për sa është trajtuar në Akt konstatim, nga subjekti i audituar është paraqitur observacioni me shkresën nr. 3029 datë 14.10.2022, nga znj. E. K. në cilësinë e Drejtorit të Buxhet-Financës dhe znj. E. M. në cilësinë e përgjegjës në Drejtorin e Buxhet-Financës, protokolluar në KLSH me nr.802/3 datë 21.10.2022, ku janë shprehur komentet si më poshtë:

Observacion nga Subjekti i audituar: Ne nuk jemi dakort me konstatimin e sipërcituar pasi: **Gjendja e llogarisë 468 ‘Debitorë të ndryshëm ‘ (fq 27).** Nga Sektori i Financës është mbajtur një data base e plotë lidhur me debitorët dhe vlerën e paarkëtueshme deri në 31.12.2021 por pranë këtij sektori nuk është paraqitur urdhër për ndalesa apo veprime të tjera .

a)Gjendja e llogarisë 202 “Studime dhe kërkime” në vlerën prej 7,302,172 lekë është vlerë e mbartur nga Ish-komunat sot Njësi Administrative të Bashkisë Përmet. Kjo vlerë nuk është

bërë hyrje në magazinë dhe njëkohësisht nuk është bërë kontabilizimi në llogarinë 213 (llogaria rrugë, rrjete) pasi në Sektorin e Financës nuk është paraqitur një urdhër apo dosje projekti për të ngarkuar me vlerat përkatëse të çdo projekti veprat zë për zë.

b). Ky projekt nuk është bërë hyrje në magazinë dhe njëkohësisht nuk është bërë kontabilizimi në llogarinë 213 (llogaria rrugë, rrjete, vepra ujore) pasi në Sektorin e Financës nuk është paraqitur një urdhër apo dosje projekti për të ngarkuar me vlerat përkatëse objektin Ndërtim i Ujësjetillësit Pacomit.

Amortizimi: Është mbajtur rregjistri i aktiveve i detajuar sipas llogarive ekonomike për çdo grup aktivi, është llogaritur amortizimi për çdo grup aktivi me vete por të dhënat për datën e krijimit të çdo aktivi mungojnë pasi kështu janë transferuar nga ish-komunat sot Njësitë Administrative të Bashkisë Përmet dhe nuk ka ekspertë të fushës për të kryer rivlerësimin e aktiveve.

Oëndrimi i grupit të auditimit: Lidhur me observacionin e paraqitur nga ju nuk meren në konsiderat si vijon; **Së pari;** Bashkisë Përmet i është dhuruar projekti i Ndërtim i Ujësjetillësit Pacomit sipas shkresës nr. 654 prot datë 11.03.2021 me vlerë 65,530,701 lekë, miratuar me VKB nr. 84 datë 18.03.2021 si dhe është hartuar nga zyra e urbanistikës “Projekti i punime shtesë në linjën kryesore stacion pompimi-depo për fshatrat Bodar dhe Kutal” në vlerën 6,698,035 lekë për të cilat Drejtoria e Buxhet-Financëa ka bërë likuidimin e pjesshëm të faturave sipas kontratave të lidhura. **Së dyti;** Amortizimi i AAGJ është llogaritur për grup aktivesh në total dhe jo aktiv për aktiv, duke mos përlllogaritur saktësisht amortizimin, pasi aktive të ndryshme kanë vlerë të ndryshme amortizimi të akumuluar sepse kanë kohë (vite) të ndryshme përdorimi referuar Udhëzimit të MFE nr. 8, datë 9.3.2018 “Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme” i ndryshuar, Kreu III “Procedurat për përgatitjen, paraqitjen dhe konsolidimin e pasqyrave financiare në njësitë e qeverisjes së përgjithshme”, pika 36, Aneksi 1 “Analiza e detajuar e klasave të llogarive të kontabilitetit në sektorin publik” Pika 2. Klasa 2, “Aktivet afatgjata” (përbërja dhe trajtimi kontabël). UMF nr. 30 datë 27.12.2011 “Për Menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik” kapitulli III, pika 30, kapitulli IV, pika 75. **Së treti:** Drejtoria e Buxhet-Financëa së bashku me sektorin e taksave dhe tarifave vendore sektorin juridik ka detyrimin ligjor për të ndjekur të gjitha hapat ligjore për arkëtimin e këtyre detyrimeve, sipas Ligjit nr. 44/2015, datë 30.04.2015 “Kodi i Procedurave Administrative në Republikën e Shqipërisë” nenet 98-102, ligjin nr. 139/2015, datë 17.12.2015 “Për vetëqeverisjen vendore” nenet 21-33 dhe Udhëzimin e Ministrit të Financave nr. 30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”, pika 93.

- **Gjendja e llogarisë 467 “Kreditorë të ndryshëm”** paraqitet në mbyllje të vitit 2020 në vlerën 6,264,101 lekë dhe në mbyllje të vitit 2021 në vlerën 6,164,101 lekë. Për këtë gjendje të llog 467 është sipas rakordimit me degën e Thesarit Përmet në mënyrë të përmbledhur paraqitet si vijon;

Analiza e llogarisë 467 “Kreditorë të ndryshëm” dhe kundër partin llog 468

Kodi i detyrimit te prapamb.	Emerimi i detyrimit te prapamb.	Detyrimi prapambetur progresiv më 31.12.2020	Vlera e paguar gjatë vitit 2021 për detyrimin e prapambetur (vlera e paguar për kolonën 3)	Vlera e detyrimeve të trashëguara të pa paguara më 31.12.2021 (pa detyrimet e krijuara gjatë 2020)	Detyrim i prapambetur i krijuar vetëm gjatë vitit 2021 (situata më 31.12.2021)	Vlera totale e detyrimeve të prapambetur pa më 31.12.2021
1	2	3	4	5=3-4	6	7=5+6
4864100	Vendim gjyqësor	1,717	100	1,617	1,757	1,617
4864200	Mallra e sherbime	2,347	0	2,346	0	2,347
486400	Investime FZHR	2,200	0	2,200	0	2,200
	Totali	6,264	100	6,164	1,757	6,164

Detyrime te prapambetura nga FZHR (Ministrite e linjës)					
Detyrime në total	6,264	100	6,164	1,757	6,164

Inventarizimi i aktiveve për vitin 2021 Bashkia Përmet

Për vitin 2021, në Bashkinë Përmet, sipas procedurave të përcaktuara në Udhëzimin e Ministrisë së Financave nr.30, dt.27.12.2011“Për menaxhimin e aktiveve ne sektorin publik”, janë kryer procedura e inventarizimit si vijon:

Sipas urdhrit të Kryetarit nr.378, dt.08.11.2021 është ngritur komisioni për vlerësimin e aktiveve të vitit 2021 i përbërë nga 5 antarë, respektivisht: Për Komisionin e Bashkisë: zj. K. G. (specialiste finance-kryetare), zj. A. S. (antar- Specialist taksash), z. S. S. (anëtar- punonjës Bashkie), z. P. S. (Specialist taksash) dhe zj. V. N. (specialiste finance- anetare).

Komisioni i Inventarizimit ka kryer inventarizimin e aktiveve të ambienteve të zyrave, të ambienteve të përbashkëta të MNZ në të, kopshte , shkolla , konvikt , çerdhe, Nj.A, rrugët rurale si dhe automjeteve duke bërë edhe rakordimet me gjendjen kontabël dhe nuk janë konstatuar diferenca. Theksojmë se në këtë shumë janë përfshirë edhe materialet të cilat janë përgatitur për t’u nxjerrë jashtë përdorimit, gjatë viteve të mëparshme 2013 dhe 2014, 2015, 2016, të cituara më sipër, por ende deri më datën 31.12.2021 nuk janë kryer procedurat për nxjerrjen jashtë përdorimit.

Nga auditimi u konstatuan disa mangësi e shkelje në zbatimin e dispozitave ligjore pa ndikim në evidentimin e gjendjes reale të aktiveve në pasqyrat financiare të periudhës raportuese me hollësisht sa më poshtë;

1- Në momentin e fillimit të inventarizimit në objekt, anëtarët e komisionit të inventarizimit në asnjë rast nuk kanë përpiluar deklarata për konflikt të interesit me punonjësit me përgjegjësi materiale, ose që kanë në përdorim aktive dhe në rastet kur anëtar komisioni inventarizimi është përfshirë drejtuesi i njësisë që inventarizohet njëkohësisht edhe përgjegjës material, veprim në mospërputhje me ligjin nr. 9367, datë 07.04.2005 “Për parandalimin e konfliktit të interesave në ushtrimin e funksioneve publike” dhe UMF nr.30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”, pika 82.

2- Komisioni inventarizimit fizik në fillim të procesit, në asnjë rast nuk ka hartuar Aktrakordimin për të përcaktuar e fiksuar numrin rendor të fletëhyrjes dhe fletëdaljes së fundit e kontabilizuar, veprim në mospërputhje me UMF nr.30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”, pika 83.

3- Komisioni i inventarizimit ka firmosur fletët e inventarizimit të aktiveve dhe në këto fletë individuale janë bërë shënimet për aktivet që propozohen për vlerësim, si dhe shënimet të tjera lidhur me tepricën, mangësinë e aktiveve. Gjithashtu këto fletë janë të firmosura nga personi përgjegjës material, por komisioni në përfundim të procesit të inventarizimit, nuk ka hartuar raport me shkrim lidhur me inventarizimin fizik të aktiveve, vlerësimin e tyre paraprak, gjendjen e tyre fizike (aktivet e dëmtuara të cilat duhet më tej të vlerësohen nga komisioni i vlerësimit të aktiveve), kushtet e ruajtjes së aktiveve, diferencat nëse ka ose jo, dëmtimet, nëse ka ose jo. Për arsyet e mësipërme nuk është e qartë se në çfarë date ka përfunduar procesi i inventarizimit. Për sa më sipër ngarkohen me përgjegjësi anëtarët e komisionit të inventarizimit.

Mos hartimi i raportit përmbledhës është në kundërshtim me kërkesat e pikës nr.85, germa (c) e udhëzimit nr. 30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”, ku thuhet:

Komisioni i inventarizimit ka përgjegjësinë për...Të përpilojë një raport lidhur me inventarizimin fizik të aktiveve, vlerësimin paraprak lidhur me cilësinë dhe kushtet e ruajtjes së tyre, gjendjen fizike dhe vërejtjet lidhur me karakterin e diferencave e dëmtimeve të konstatuara, për shkaqet e tyre dhe personat përgjegjës, së bashku me gjithë dokumentacionin e inventarizimit, t’ia dorëzojë për veprime të mëtejshme Nëpunësit Autorizues.

Evidenca e aktiveve të qëndrueshme dhe regjistrimi i tyre në pronësi të Bashkisë Përmet

Titulli gjetjes: *Mos funksionimi i sektorit të menaxhimit të Aseteve si dhe e regjistrimit analitik të aktiveve të qëndrueshme dhe regjistrimi i tyre në pronësi të Bashkisë Përmet.*

Situata:

Për vitin 2021 struktura organizative është miratuar me Vendim të Kryetarit të Bashkisë nr. 07 date 20.01.2021, “Për miratimin e strukturës së administratës së bashkisë dhe të njësive shpenzuese në varësi të Bashkisë Përmet për vitin 2021” i ndryshuar. Konstatohet se në strukturën aktuale organizative të bashkisë Përmet është krijuar sektori i Menaxhimit dhe Administrimit të Aseteve i përberë nga 3 persona 1 përgjegjës dhe dy specialist. Nuk janë ngritur grupet e punës për përcaktimin e misionit dhe detyrat e tyre për administrimin e asetëve (toka, pyje, kullota, ndërtesa etj.), dhe për këtë arsye procesi i administrimit të tyre nuk është realizuar në përputhje me kërkesat e kuadrit rregullator në fuqi. Kjo strukturë duhet të realizonte marrjen në dorëzim të asetëve, zbatimin e procedurave të transferimit në NJQV, vënien në efikasitet të ndërtesave, tokës bujqësore produktive dhe jo produktive sipas sipërfaqeve faktikë, duke rritur mundësinë e të ardhurave nga dhënia me qira. Për të gjitha asetet nuk është hapur regjistër kontabël, në kundërshtim me kapitullin III “Regjistri i aktiveve dhe dokumentimi i lëvizjes së tyre”, pika 26 dhe 27 të UMF nr. 30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”.

Veprimet e mësipërme janë në kundërshtim me nenin 8, të ligjit nr. 8743, datë 22.02.2001 “Për pronat e paluajtshme të shtetit”, i ndryshuar, VKM nr. 500, datë 14.08.2001 “Për inventarizimin e pronave të paluajtshme shtetërore”, transferimin e pronave në njësitë e qeverisjes vendore”, Udhëzimin nr.3, datë 18.07.2002 “Për inventarizimin e pronave të paluajtshme të shtetit nga njësitë e qeverisjes vendore”, si dhe Udhëzimit të Ministrisë së Pushtetit Vendor dhe Decentralizimit nr. 15, datë 30.06.2003 “Për mënyrën e paraqitjes nga njësitë e qeverisjes vendore të kërkesave për transferim në pronësi të tyre, të pronave të paluajtshme publike”.

Nga auditimi i dokumentacioni dhe të dhënat përkatëse në lidhje me asetet e Bashkisë janë vënë në dispozicion me shkresa zyrtare nga AITPP-ja, nëpërmjet VKM-ve përkatëse, si vijon:

- **Bashkisë Përmet** me VKM nr.1032 datë 08.10.2009 “Për miratimin e listës përfundimtare të pronave të paluajtshme publike, shtetërore, që transferohen në pronësi ose në përdorim të Bashkisë Përmet të Qarkut Gjirokastër” – lista me 71 (shtatëdhjetë e një) fletë përfundon me nr. rendor 415 (katërqind e pesëmbëdhjetë).

- **Ish-Komuna Piskovë - sot Njësia Administrative Qendër Piskovë- Bashkia Përmet** me VKM nr.738 datë 16.10.2012 “Për miratimin e listës përfundimtare të pronave të paluajtshme publike, shtetërore, që transferohen në pronësi ose në përdorim të Komunës Qendër Piskovë të Qarkut Gjirokastër” – lista me 64 (gjashtëdhjetë e katër) fletë përfundon me nr. rendor 470 (katërqind e shtatëdhjetë).

- **Ish-Komuna Petran - sot Njësia Administrative Petran - Bashkia Përmet** me VKM nr.806 datë 06.10.2010 “Për miratimin e listës paraprake të pronave të paluajtshme publike, shtetërore, që transferohen në pronësi ose në përdorim të Komunës Petran të Qarkut Gjirokastër” – lista me 154 (njëqind e pesëdhjetë e katër) fletë përfundon me nr. rendor 1090 (një mijë e nëntëdhjetë).

- **Ish-Komuna Frashër - sot Njësia Administrative Frashër - Bashkia Përmet** me VKM nr.240 datë 25.04.2007 “Për miratimin e listës së inventarit të pronave të paluajtshme, shtetërore, në Komunën Frashër të Qarkut Gjirokastër” – lista me 33 (tridhjetë e tre) fletë përfundon me nr. rendor 156 (njëqind e pesëdhjetë e gjashtë).

- **Ish-Komuna Çarshovë - sot Njësia Administrative Çarshovë - Bashkia Përmet** me VKM nr.70 datë 02.02.2011 “Për miratimin e listës paraprake të pronave të paluajtshme publike, shtetërore, që transferohen në pronësi ose në përdorim të Komunës Çarshovë të Qarkut

Gjirokastrë” – lista me 151 (njëqind e pesëdhjetë e një) fletë përfundon me nr. rendor 1108 (një mijë e njëqind e tetë).

- Me shkresën nr.1731 prot datë 20.10.2016 nga Prefektura Gjirokastrë me procesverbalin e dorëzimit të aktiveve nr.3 janë dorëzuar pronat e paluajtshme shtetërore dhe aktivet e tjera të Sektorit PMNZSH-së.

- Procesverbal datë 15.03.2016 për marrjen në dorëzim të aseteve të paluajtshme të pajisjeve të Ndërmarrjes së Rrugëve Rurale në zbatim të VKM-së Nr.915 datë 11.11.2015.

- Me shkresën nr.448/5 prot datë 01.07.2016 nga Bordi Rajonal i Kullimit Fier u transferuan Asetet e Paluajtshme të Bordeve dhe Mjetet e Pajisjet.

Përsa i përket pronave të Kaluara me VKM në Njësitë Administrative (Qendër Piskovë, Petran, Frashër dhe Çarshovë) nuk janë kryer veprime për marrjen në dorëzim dhe pasqyrimin në inventar dhe kontabilitet; nuk është ngritur grup pune për përgatitjen e dokumentacionit teknik të aseteve në pronësi dhe në përdorim, për të realizuar regjistrimin e pronave pranë ZVRPP (ASHK) Përmet; nuk ka rakordim me ZVRPP (ASHK) Përmet, për asetet pronë e Komunës, pasi nuk është marrë në dorëzim harta treguese e objekteve pronë e Komunës; nuk ka të dhëna dhe rakordim për objektet e privatizuar dhe evidencë të pronarëve që nuk kanë shlyer troje; nuk kanë filluar procedurat për përgatitjen e dokumentacionit ligjor për verifikimin dhe regjistrimin e pronave të paluajtshme publike dhe marrjen në dorëzim të aseteve, si dhe nuk është aplikuar në ZVRPP për regjistrimin e tyre. Mosveprimet e mësipërme janë në shkelje të kërkesave të ligjit nr. 33-2012 “Për regjistrimin e pasurive të paluajtshme”, dhe UMF-së nr. 30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”, kap. III, pika 30 ku citohet: “Formati i regjistrimit të aktiveve hartohet në vartësi të llojit të tyre afatgjatë apo afatshkurtër si dhe grupit përkatës brenda llojit. Kërkesat minimale që duhet të përmbajë regjistri i aktiveve në vartësi të llojit, përfshijnë: datën e hyrjes ose të marrjes në dorëzim, përshkrimin e aktivitetit, vlerën e blerjes, datën e daljes në përdorim, datën e skadencës, vlerën e shpenzimeve kapitale të mëpasshme që sjellin rritjen të vlerës së aktivitetit, vendndodhjen, personin përgjegjës, vlerën e akumuluar të amortizimit, kohën e shërbimeve të mirëmbajtjes, vlerën e akumuluar të shpenzimeve të mirëmbajtjes, datën e daljes nga pronësia.” dhe pika 35/a ku citohet: “Dokumentet vërtetues- vërtetojnë kryerjen në fakt dhe në mënyrë kronologjike, të veprimeve ekonomike. Të tilla janë fletëhyrjet, faturat, situacionet e shpenzimeve, fletëdaljet mandate arkëtimet, mandate pagesat, procesverbalet dhe të tjera akte me natyrë verifikues shpenzimi.” si dhe neni 37 i ligjit 20/2020 “Për Përfundimin e Proceseve Kalimtare të Pronësisë në Republikën e Shqipërisë” Kreu IV.

Në mënyrë të përmbledhur pronat e kaluara me VKM dhe të regjistruara në ASHK paraqiten si më poshtë:

Nr.	Bashkia/ Njesite	Nr. Pronave në Inventar	Nr. i Praktikave të Certifikuara Deri Dhjetor 2020	Nr. Praktikave të Certifikuara 2021	Prona të pa Rregjistruara
1	Bashkia Përmet	415	1	0	414
2	NJA. Piskovë	470	0	0	470
3	NJA. Petran	1090	0	0	1090
4	NJA. Frashër	156	0	8	148
5	NJA. Çarshovë	1108	10	0	1098

Burimi: Bashkia Përmet

Në mënyrë të detajuar pronat të cilat janë regjistruar gjatë periudhës objekt auditimi në ASHK paraqiten në aneksin nr. 5 pika 3 bashkëlidhur raportit të auditimit.

Gjithashtu nga auditimi rezultoi se, për periudhën objekt auditimi janë pajisur me kartel pasurie në total 19 prona sipas aneksin nr. 5 pika 3 bashkëlidhur raportit të auditimit si dhe përpara vitit 2021 janë certifikuar 11 prona objekte inventari të cilat nuk janë të regjistruara në kontabilitet

dhe pasqyrat financiare në aktiv të Pasqyrës së Pozicionit Financiar, respektivisht për *10 pasuri me emërtim (Arë ose Pemtore) të certifikuara sipas kartelave të pasurisë dhe 1 objekte me emërtimin (Truall + Ndërtesë) i certifikuar sipas aneksit të sipërcituar. Veprime dhe mosveprime bien në kundërshtim me VKM nr. 510, datë 10.06.2015 “Për inventarizimin dhe hipotekimin e të gjitha pronave të paluajtshme dhe të luajtshme”, Kreu (VI) “Transferimi i pasurive dhe regjistrimi i pasurive të paluajtshme” dhe veprim në mospërputhje me UMF nr. 30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik” me ndryshime, Kreu (III), pika 35 dhe Kreu (II), pika (16).*

Për veprimet dhe mosveprimet e mësipërme ngarkohen me përgjegjësi:

1. z. S. Z. , me detyrë ish/Përgjegjës i Sektorit të Aseteve për periudhën e auditimit. 01.01.2021-31.12.2021.

2. z F. G. me detyrë specialist i Sektorit të Aseteve për periudhën e auditimit. 01.01.2021-31.12.2021.

Kriteri:

Baza ligjore mbi të cilën është vlerësuar situata e cila paraqet parregullsi janë; ligjit nr.8744, datë 22.2.2001 “Për transferimin e pronave të paluajtshme publike të shtetit në njësitë e qeverisjes vendore”, ligjin nr. 10296, datë 08.07.2010, “Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin”, me pika 26 dhe 27, të UMF nr. 30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”, të VKM nr. 529, datë 08.06.2011 “Për përcaktimin e kriterëve, të procedurës dhe të mënyrës së dhënies me qira, enfitozë apo kontrata të tjera të pasurisë shtetërore”, i ndryshuar, në mënyrë që kjo njësi vendore të mund të realizonte të ardhura nga vënia në funksion e këtyre Aseteve, si dhe të VKM nr. 500, datë 14.08.2001 “Për inventarizimin e pronave të paluajtshme shtetërore dhe transferimin e pronave në njësitë e qeverisjes vendore”, VKM nr. 510, datë 10.06.2015 “Për inventarizimin dhe hipotekimin e të gjitha pronave të paluajtshme dhe të luajtshme”, Kreu (VI) “Transferimi i pasurive dhe regjistrimi i pasurive të paluajtshme” ligjit 20/2020 “Për Përfundimin e Proceseve Kalimtare të Pronësisë në Republikën e Shqipërisë” Kreu IV.

Ndikimi/Efekti:

Mos regjistrimi në kontabilitet dhe deformim i informacionit financiar për sa i përket gjendjes kontabël të paraqitur në Pasqyrat e Pozicionit Financiar.

Shkaku:

Mungesa e sektorit të menaxhimit të Aseteve si dhe e regjistrit analitik të aktiveve të qëndrueshme dhe regjistrimi i tyre në pronësi të Bashkisë Përmet.

Rëndësia: E lartë

Rekomandimi

- Titullari i Bashkisë Përmet, nëpërmjet Sektorit të Aseteve në bashkëpunim me Drejtorinë e Planifikimit dhe Zhvillimit të Territorit (DPZHT), të marrë masa për krijimin e regjistri të pronave të paluajtshme të kaluara në pronësi, apo në përdorim të Bashkisë Përmet të marrë masa që të përgatisë dosjet me dokumentacionin e nevojshëm për regjistrimin e pasurive të paregjistruara në Drejtorinë Rajonale ASHK të pasurive të paregjistruara, ndërsa Drejtoria e Financës të përlllogarisë kostot për kryerjen e këtij shërbimi, buxhetimit, burimet e financimit me qëllim marrjen sa më parë të titujve të pronësisë të pasurive të paluajtshme.

- Kryetari i Bashkisë Përmet në cilësinë e Nëpunësit Autorizuar në bashkëpunim me Drejtorinë e Financës në cilësinë e Nëpunësit Zbatues, të ndërmarr të gjitha procedurat ligjore për vlerësimin e aktiveve të cilat janë pjesë e inventarit AAGJ të bashkisë, të certifikuara në ASHK, por pa vlerë respektive, me qëllim paraqitjen e vlerës së këtyre aktiveve në Pasqyrën e Pozicionit Financiar të njësisë publike vendore bashkia Përmet më 31.12.2021.

Analizë e llogarive sipas zërave të të ardhurave dhe shpenzimeve me klasifikim sipas natyrës ekonomike të pasqyruara në Formatin nr.2 “Pasqyra e performancës financiare” të PF të vitit 2021 paraqitet sipas aneksit nr. 5 pika 3 bashkëlidhur raportit të auditimit.

Analiza e llogarive të të ardhurave për vitin 2021, të cilat në total janë në vlerën **259,328,722** lekë si dhe referuar akt-rakordimit me Degën e Thesarin Përmet paraqitet në aneksin nr. 6 pika 3 bashkëlidhur raportit të auditimit

Gjendja e llogarisë sintetike **70 “Të ardhurat nga taksat dhe tatimet”** paraqitet në bilanc për vitin 2021 në vlerën 16,037,448 lekë, i cili kuadron me akt-rakordimin me Thesarin në këtë zë të ardhurash sipas kodifikimit të Thesarit.

a. Gjendja e llogarisë analitike **7002 “Tatim mbi Biznesin e vogël”** pasqyrohet në bilanc për vitin 2021 në vlerën 379,894 lekë e cila përfshin *taksën mbi Biznesin e vogël*, e cila rakordon me të njëjtin zë në akt-rakordimin me thesarin.

b. Gjendja e llogarisë **7020 “Tatim mbi pasurinë e paluajtshme”** pasqyrohet në bilanc për vitin 2021 në vlerën 6,936,610 lekë e cila përfshin *taksën mbi ndërtesën dhe truallin*, ecila rakordon me të njëjtin zë në akt-rakordimin me thesarin.

c. Gjendja e llogarisë **7035 “Taksa vendore mbi përdorimin e mallrave e lejim veprimtarie”** pasqyrohet në bilanc për vitin 2021 në vlerën 8,675,421 lekë e cila përfshin taksa e pastrimit, gjelbërimit, ndriçimit, zënie hapësire publike, qiratë për truallin etj.

- Gjendja e llogarisë **71 “Të ardhurat jo tatimore”** paraqitet në bilancin e 2021 në vlerën 14,175,490 lekë, i cila kuadron me akt-rakordimin me Thesarin në këtë zë të ardhurash sipas kodifikimit të Thesarit.

a. Gjendja e llogarisë **7109 “Të ardhura te tjera jo tatimore nga ndërmarrjet dhe pronësia”** paraqitet në bilancin e 2021 në vlerën 3,797,933 lekë, e cila përfshin taksën e ndikimit në infrastrukturë, taksën e tokës, qiratë nga kullotat dhe nga pyjet, i cili kuadron me akt-rakordimin me Thesarin në këtë zë të ardhurash sipas kodifikimit të Thesarit.

b. Gjendja e llogarisë **711 “Shërbimet Administrative dhe te Ardhura Sekondare”** paraqitet në bilancin e 2021 në vlerën 10,377,557 lekë, e cila përfshin tarifatat e parkimit, kamat vonesa, tarifa transporti, licenca etj. Kjo vlerë me akt-rakordimin me Thesarin në këtë zë të ardhurash sipas kodifikimit të Thesarit.

Titulli i gjetjes *Kontabilizimi i gabuar i llogarisë 7206 “Financim i pritshëm nga buxheti”.*

Situata:

Gjendja e llogarisë së fondeve **7206 “Financim i pritshëm nga buxheti”** në vlerën prej 0 lekë, e cila nuk rakordon me gjendjen e llogarisë 4342 “Operacione me shtetin (të drejta)” e cila paraqitet në vlerën 55,310,416 lekë, e cila edhe kjo është e pasaktë, pasi gjendja e kësaj llogarije sipas të dhënave të bilancit duhet të ishte në vlerën 55,310,416 lekë. Këto veprime janë në kundërshtim me detyrimeve në pasiv të bilancit janë të sakta dhe reale. Këto veprime janë në kundërshtim me Udhëzimin e MFE nr.8 datë 09.03.2018 “Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme” Aneksi 1 “Analiza e detajuar e klasave të llogarive të kontabilitetit në sektorin publik” **Pika 3.3** “Trajtimi kontabël dhe funksioni i llogarive të të tretëve (klasa 4) nën pika 8 “Llogaritë e marrëdhënieve me shtetin” në të cilën përcaktohet se:

Llogaria 4342, “Operacione me shtetin (të drejta)” është një llogari që në PF të sektorit publik paraqitet në rubrikën e të drejtave dhe përfaqëson detyrimin që shteti i ka institucionit për shpenzime të konstatuara gjatë periudhës ushtrimore, por ende të papaguara (grantet korrente apo kapitale merren nga buxheti i shtetit). Raste specifike të tilla mund të jenë këto (por jo vetëm) si: pagat dhe sigurimet shoqërore e shëndetësore apo ndonjë detyrim për tatimin mbi të ardhurat që konstatohen si shpenzime në muajin dhjetor të vitit, por paguhen nga buxheti i vitit të ardhshëm. Veprimet kontabël në lidhje me këtë llogari janë si më poshtë:

a) Gjatë konstatimit të shpenzimit është bërë veprimi: - Debitohen llogaritë respektive të klasës 6, “Shpenzime sipas natyrës”; - Kreditohen llogaritë e detyrimeve për konstatimin e detyrimit (42, 43, 40 e të tjera).

b) Në fund të periudhës duhet të bëhet veprimi: - Debitohet llogaria 4342, “Operacione me shtetin (të drejta)”; - Kreditohet llogaria 7206, “Financim i pritshëm nga buxheti”.

c) Me akordimin e fondeve vitin e ardhshëm dhe ekzekutimin e pagesës bëhet veprimi: - Debitohen llogaritë përkatëse të detyrimeve (klasa 4); - Kreditohet llogaria 520, “Disponibilitete në thesar”.

Kriteri: UMFE nr. 8, datë 9.3.2018 të MFE “Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme”.

Efekti: Të dhëna jo të sakta në pasqyrat financiare.

Shkaku: Mos zbatimi i kërkesave të UMFE nr. 8, datë 9.3.2018 të MFE “Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme”, gjatë hartimit të pasqyrave financiare.

Rekomandim: Drejtoria Financës të marrë masa për sistemimin e llogarisë 7206- Financim i pritshëm nga buxheti, në mënyrë që këto llogari të pasqyrojnë vlerën e saktë në pasqyrat financiare.

Mbi zbatimin e dispozitave ligjore që rregullojnë marrëdhëniet e punës (Paga dhe shpërblime etj, për Bashkinë Përmet).

-Testimi i llogarisë 600 “Pagat dhe shpërblime”

Për vitin 2021, numri i punonjësve, është miratuar me Vendim i Kryetarit të Bashkisë nr. 99 datë 30.12.2020. Miratuar në total numri 313 + 2 punonjësit të QKB = 315 punonjës gjithsej, në fakt janë paguar sipas listë pagesave gjithsej 308 punonjës , nuk ka tejkallim të numrit të punonjësve.

-Referuar kërkesave të VKM nr. 177 datë 08.03.2017, struktura e Bashkisë Përmet, është miratuar me Vendim nr.7 datë 20.01.2021 të Kryetarit të Bashkisë të sipërcituara.

Sipas listë pagesave të muajve janar dhe dhjetor 2021 konstatohet se është zbatuar struktura sipas vendimeve miratues.

Listë pagesat janë të firmosura nga Përgjegjësi i Financës Zj.E. M. dhe nga Specialistet e pagave Zj .K. K. dhe specialistja V. N..

Është përgatitur përmbledhësja e listë pagesave e cila është e firmosur nga Drejtori i Financës Zj .E. K. dhe nga Kryetari Bashkisë Zj.A. H., ose i deleguari i tij.

Janë mbajtur listë prezencat dhe janë të firmosura nga Përgjegjësi i Burimeve Njerëzore Zj.K. Ç. dhe nga Kryetari Bashkisë Zj.A. H. .

B. 2 - Hartimi i listë pagesave mbi bazën e listë prezencave të nënshkruara nga përpiluesi, për vitin 2021.

Me përzgjedhje u audituan listë pagesat e periudhës (Janar dhe Dhjetor 2021) dhe konstatohet se ato plotësohen konform rregullave të përcaktuara të cilat janë plotësuar mbi bazën e listë prezencave mujore të nënshkruara nga Kryetari i Bashkisë dhe nga Përgjegjësi i Burimeve Njerëzore është hartuar përmbledhësja në përputhje me ligjin nr. 7961, datë 12.07.1995,” Kodi i Punës”, i ndryshuar.

Ndalesat për tatimin mbi të ardhurat personale dhe kontributit të sigurimeve shoqërore të punonjësve të Bashkisë Përmet, janë në përputhshmëri me kërkesat e ligjit nr. 8438, datë 28.11.2008 "Për tatimin mbi të ardhurat", me ndryshime dhe ligjit nr. 9136, datë 11.09.2003 “Për mbledhjen e kontributeve të detyrueshme të sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore në RSH”.

-Referuar kërkesave të VKM nr. 177 datë 08.03.2017, struktura e Bashkisë Përmet, është

miratuar me Vendim të Kryetarit të Bashkisë të sipërcituara.

Sipas listë pagesave të muajve (Janar dhe Dhjetor 2021)konstatohet se është zbatuar struktura sipas vendimit miratues.

Listë pagesat janë të firmosura nga Përgjegjësi i Financës Zj.E. M. ,nga Specialistet e pagave. Është përgatitur përmbledhësja e listë pagesave e cila është e firmosur nga Drejtori i Financës dhe nga Kryetari Bashkisë;

Janë mbajtur listë prezencat dhe janë të firmosura nga Përgjegjëse i Burimeve Njerëzore Zj.K. Ç. dhe nga Kryetari Bashkisë Zj.A. H.

Përveç ndalesave të sigurimeve shoqërore dhe tatimit mbi pagë, nuk ka pasur ndalesa të tjera. Paraqitja në formë table e burimit të Financimit .

000/lekë

Periudha	Plan	Fakt	%	Burimi i financimit			
				Trans. e Pakush.	Të ardhura	Trans. e Kushtëzuar	Transfertë specifike
Viti 2021	185.828	172.069	92.6	96.596	15.642	2.842	56.990

Realizimi i fondit të pagave, sigurimeve shoqërore dhe fondit të veçantë

000/lekë

Nr.	Emërtimi	VITI 2021		
		Plani	Fakti	%
1	F. Pagave	153.264	146.788	
2	F. Sig. Shoq	25.528	24.281	
3	F. Veçantë	7.036	1.000	

Veprimet nëpërmjet magazinës

-Mbajtja e kontabilitetit për hyrjet dhe daljet e materialeve bëhej në ditarin e magazinës, në formë dokumentare. Çdo regjistrim kontabël bëhej sipas dokumentacionit bazë si flet-hyrjeve dhe fletë-daljeve të magazinës dhe faturave të shitësit. Dokumentacioni bazë ishte i konfirmuar nga magazinieri dhe marrësi në dorëzim. Nga verifikimi i disa veprimeve me zgjedhje rezultoi se veprimet ishin kontabilizuar saktë.

-Fletë daljet e magazinës janë hartuar dhe firmosur nga magazinieri, ku për mallra të ndryshëm ishin të shoqëruara me autorizim e plan-shpërndarje të miratuara.

- Nuk janë mbajtur të dhëna për aktivet për një pjesë të tyre si: viti i krijimit, shtesat dhe pakësimet për to, pra nuk është mbajtur një libër i mirëfilltë historik me të gjitha të dhënat e aktiveve të trupëzuara sipas modelit klasik të trajtuar më lart, domosdoshmëri kjo për të patur një evidentim dhe pasqyrë të plotë në mënyrë analitike të aktiveve në përputhje me gjendjet në llogaritë e bilancit në përputhje me kap III pika 30, të UMF nr. 30 datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”.

- Janë hapur kartela e zyrave inventarin ekonomik dhe objektet e inventarit të tërhequr nga magazina, në mënyrë që sektori ekonomik të sigurojë kontrollin e këtyre vlerave materiale gjatë kohës, që ata i kanë në ngarkim dhe të evidentojë nxjerrjen e përgjegjësishë në çdo rast të lëvizjeve, të shpërdorimeve, të dëmtimeve apo humbjeve.

(Për problemet e mësipërme është mbajtur akt-konstatimin nr. 4, datë 07.10.2022)

4. Auditim i zbatimit të rekomandimeve të lëna në auditimet e mëparshme.

Për kryerjen e verifikimit të zbatimit të rekomandimeve të lëna në auditimin e mëparshëm nga Kontrolli i Lartë i Shtetit, dërguar në Bashkinë Përmet me shkresën nr. 873/8 datë. 30.12.2021

1. Hartimi i programit (Plan veprimit) me persona përgjegjës dhe respektimi i afatit 20 ditore për zbatimin e rekomandimeve.

2. Realizimi programit (plan veprimi) e raportimi në KLSH për ecurinë e zbatimit të

rekomandimeve brenda afatit 6/mujor.

3. Statusi i rekomandimeve të lëna në auditimin e mëparshëm.

Titulli i gjetjes: *Bashkia Përmet për masat shpërblim dëmi është mjaftuar vetëm me nxjerrjen e urdhrave për zbatimin e rekomandimeve të lëna në auditimin e mëparshëm.*

Situata:

Për sa më poshtë në mbështetje të shkronjave (a) dhe (b) e nenit 15 “Të drejtat dhe detyrat e KLSH-së”, të ligjit nr. 154/2014 datë 27.11.2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollin e Lartë të Shtetit”, Kryetari i Kontrollit të Lartë të Shtetit me shkresën nr. 873/8 datë. 30.12.2021 i ka dërguar Bashkinë Përmet **Vendimin nr. 230, datë 30.12.2021**, për përmirësimin e gjendjes, janë rekomandojmë zbatimin e masave të mëposhtme.

a . Për përmirësimin e gjendjes janë rekomanduar 10 masa organizative, nga të cilat janë pranuar plotësisht 10 masa, nga të pranuarat janë zbatuar 6 masa dhe janë në proces zbatimi 4 masa organizative dhe nuk ka masa organizative të pa zbatuara.

b. Për shpërblim dëmi janë rekomanduar 3 masa me vlerë 806,823 lekë, deri me datë 07.10.2022, është arkëtuar vlera 338,321 lekë, si dhe është në proces vlera 468,503 lekë.

c.2. Për shpenzime në kundërshtim me principet e 3 E-të si dhe të ardhura të munguara është rekomanduar që të arkëtohet vlera 51,084,013 lekë si dhe të analizohet vlera 87,418,000 lekë. Nga verifikimi rezultoi se është analizuar vlera 87,418,000 lekë, dhe janë nxjerr përgjegjësit.

DREJTIMET E AUDITIMIT:

1.Hartimi i programit (Plan veprimit) dhe respektimi i afatit prej 20 ditë për kthimin e përgjigjes për zbatimin e rekomandimeve, siç është përcaktuar në nenin 15 shkronja (j) të ligjit nr.154/2014, datë 27.11.2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollin të Lartë të Shtetit”.

Nga verifikimi rezulton se KLSH ka dërguar në Bashkinë Përmet rekomandimet e auditimi me shkresën e saj nr. 873/8 datë. 30.12.2021, protokolluar në Bashkinë Përmet me shkresën nr. 3688 prot datë 31.12.2021, ndërsa nga Bashkia Përmet për zbatim e rekomandimeve të KLSH është kthyer përgjigje me shkresën e saj nr. 162 Prot. datë 19.01.2022. Pra përgjigja e Bashkisë për zbatimin e rekomandimeve të KLSH është bërë brenda 20 ditësh, pra brenda afatit ligjor të kthimit të përgjigjes prej 20 ditësh. Për zbatimin e rekomandimeve të KLSH nga Bashkia Përmet është hartuar Plan veprimi për zbatimin e rekomandimeve me shkresën nr. 21/1 prot datë 11.01.2022 dhe janë ngarkuar personat për zbatimin e rekomandimeve me afate konkrete.

Zbatuar

2. Respektimi i afatit ligjor prej 6 muajsh nga data e marrjes së njoftimit të raportit të auditimit, për raportimin në KLSH, të ecurisë së zbatimit të rekomandimeve të lëna nga auditimi i mëparshëm (pika 2 e nenit 30 të ligjit nr. 154/2014, datë 27.11.2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit.

Nga verifikimi rezulton se përfundimet e auditimit i janë dërguar subjektit të audituar Bashkisë Përmet, me shkresën e Kryetarit të KLSH nr. 873/8 datë. 30.12.2021 dhe duhet të raportonte në KLSH brenda 6 muajve ose brenda datës 30.06.2022.

Nga ana e Bashkisë Përmet me shkresën nr. 2000/1 datë 28.06.2022 është kthyer përgjigje mbi ecurinë e zbatimit të rekomandimeve të KLSH. Pra është zbatuar afati për raportimin në KLSH mbi ecurinë e zbatimit të rekomandimeve brenda 6 muajve nga data e njoftimit të Raportit përfundimtar të auditimit në KLSH janë shkëlur kërkesat e ligjit nr. 154/2014, datë 27.11.2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”, neni 30-Rekomandimet e KLSH-së dhe ecuria e zbatimit, pika 2, ku përcaktohet se: Subjekti i audituar,

brenda 6 muajve nga data e njoftimit të raportit të auditimit, i raporton Kontrollit të Lartë të Shtetit mbi ecurinë e zbatimit të rekomandimeve të dhëna.

Zbatuar

3-Mbi raportimin rregullisht në Këshillin Bashkiak të ecurisë të zbatimit të rekomandimeve të KLSH, siç përcaktohet në nenin 50 -Auditimi i jashtëm, pika 5, të ligjit nr. 68/2017, datë 27.04.2017 “Për financat e vetëqeverisjes vendore”.

Nga verifikimi rezulton se Bashkia Përmet ka hartuar planin e veprimit të zbatimit të rekomandimeve të dërguara nga KLSH me shkresën nr. 873/8 datë. 30.12.2021, dhe nuk ka raportuar rregullisht në këshillin e njësisë (këshillin bashkiak), në kundërshtim me ligjin nr. 68/2017, datë 27.04.2017 “Për financat e vetëqeverisjes vendore”, Neni 50-Auditimi i jashtëm ku përcaktohet se: 5. Për të gjitha raportet e auditimit të jashtëm, të kryera nga Kontrolli i Lartë i Shtetit apo auditues të tjerë ligjorë, kryetari i njësisë së vetëqeverisjes vendore përgatit një plan veprimi për zbatimin e rekomandimeve të raportit të auditimit dhe raporton rregullisht në këshillin e njësisë.

4. Realizimi i rekomandimeve për masa me karakter organizativ, sipas cilësimeve në planin e veprimeve të hartuar nga subjekti i audituar, duke pasqyruar punën e bërë të analizuar për rekomandimet e realizuara plotësisht, pjesërisht, në proces realizimi dhe sa nga rekomandimet nuk janë pranuar në mënyrë të detajuar paraqitet si vijon:

A. MASA ORGANIZATIVE:

Nga KLSH i janë rekomanduar Bashkisë Përmet 10 masa organizative, të cilat janë pranuar plotësisht, nga masat e pranuar janë zbatuar plotësisht 6 masë organizative, janë në proces zbatimi 4 masa organizative dhe nuk masa organizative të pa zbatuara Në mënyrë të detajuar realizimi i masave organizative paraqitet si më poshtë:

1. Gjetje nga auditimi: Nuk janë miratuar nga Këshilli i Bashkisë, tavanet përfundimtare të shpenzimeve të programit buxhetor afatmesëm brenda datës 20 korrik, në zbatim me kërkesat e ligjit nr. 68/2017 “Për financat e vetëqeverisjes vendore”, neni 37.

Mungon Plani i Masave dhe Veprimit, për fazën përfundimtare të përgatitjes së Programit Buxhetor Afatmesëm dhe Projektbuxhetit Vjetor për të gjithë periudhën e auditimit, ku të jenë përcaktuar aktivitetet që do të zhvillohen, afati, personat përgjegjës.

Ka mungesë të dokumenteve (dëgjesa publike, takime për llogaridhënie për zbatimin e buxhetit etj), të cilat të dokumentojnë se janë konsultuar me komunitetin dhe grupet e interesit.

Nuk ka mbledhje të dokumentuara të GMS, për të diskutuar rreth planifikimit dhe monitorimit të politikave strategjike, PBA, risqeve kryesore dhe çështjeve të tjera të menaxhimit financiar dhe kontrollit.

Nuk dokumentohet mbledhja e njësisë vendore dhe institucioneve të varësisë në lidhje me kërkesat e tyre buxhetore. Planifikimi Buxhetor Afatmesëm është kryer duke u mbështetur në PBA- të e viteve të mëparshme dhe jo mbi një analizë të mirëfilltë. Publikimi i dokumenteve në faqen zyrtare të bashkisë Përmet apo në vendime.al ka vonesa dhe mungesa në afatet e publikimit.

Ka diferenca midis treguesve të hartimit dhe zbatimit të buxhetit, përse i përket pjesës së të ardhurave të veta dhe shpenzimeve të tyre. Realizimi i buxhetit ndaj planit për vitin 2018 ka arritur 85.1 %, për vitin 2019 ka arritur në 85.9 % dhe në vitin 2020 ka arritur në 84.6 %.

-Detyrimet kreditore për fund vitin 2017, sipas pasqyrave financiare të raportimit për këtë vit, llogaritë 401-408 për vlerën 5,448,254 lekë.

-Detyrimet kreditore për fund vitin 2018, sipas pasqyrave financiare të raportimit për këtë vit, llogaritë 401-408 për vlerën 9,782,208 lekë.

-Detyrimet kreditore për fund vitin 2019, sipas pasqyrave financiare të raportimit për këtë vit, llogaritë 401-408 për vlerën 3,427,178 lekë.

(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.1 faqe 18-38 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

1.1 Rekomandim: Bashkia Përmet, të marrë masa për hartimin e një buxheti real, objektiv në realizimin e të ardhurave dhe shpenzimeve, për të mos krijuar diferenca midis parashikimit dhe realizimit të buxhetit si dhe të analizohet brenda muajit qershor të çdo viti zbatimi i buxhetit. Bashkia Përmet të marrë masa, të dokumentojë mbledhjet e strukturës dhe të institucioneve në varësi, duke parashtruar dhe kërkesat e tyre buxhetore.

Bashkia Përmet të marrë masa për publikimin e vendimeve të Këshillit Bashkiak në faqen zyrtare apo në vendime.al brenda 15 ditëve.

Grupi i Menaxhimit Strategjik duhet të mblidhet për të diskutuar rreth planifikimit dhe monitorimit të politikave strategjike, PBA, risqeve kryesore dhe çështjeve të tjera të menaxhimit financiar dhe kontrollit (të dokumentuara).

Të kryhet Plani i Masave dhe Veprimet, për fazën përfundimtare të përgatitjes së Programit Buxhetor Afatmesëm dhe Projektbuxhetit Vjetor për të gjithë periudhën e auditimit, ku të jenë përcaktuar aktivitetet që do të zhvillohen, afati, personat përgjegjës.

Menjëherë dhe në vijimësi

1.2. Nga verifikimi rezultoi se: Me Urdhërin nr.10 datë 13.01.2022 protokolluar me shkresën nr.78 datë 13.01.2022 Kryetar i Bashkisë ka ngritur Grupin e Menaxhimit Strategjik. Gjatë mbledhjeve që janë mbajtur nga ky grup është diskutuar rreth planifikimit dhe monitorimit të politikave strategjike, PBA-së, risqeve kryesore dhe çështjeve të tjera të menaxhimit financiar dhe kontrollit (të dokumentuara).

Në proces zbatimi

2. Gjetje nga auditimi: Detyrimet e prapambetura deri më datë 31.12.2020 janë në vlerën 14,666,184 lekë në kundërshtim me ligjin nr. 9936, datë 26.6.2008 "Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar, UMF nr. 5, datë 27.12.2014 "Për shlyerjen e detyrimeve të prapambetura". Ndër të cilat vlerën më të lartë të shpenzimeve të pa likuiduara i zënë investimet në vlerën 10,335,785 lekë ose 70.47 %. Detyrimi i papaguar në lidhje me investimet e kryera si ndërtimi i shkollës së mesme me subjekt "A." ShPK dhe rehabilitimi i banesave me subjekt "N." ShPK, faturat janë të muajt shkurt dhe maj 2020. Mallra dhe shërbime në vlerën 2,346,886 lekë ose 16 %, vlerë e pa likuiduar i cili i përket Operatorit të Shpërndarjes së Energjisë Elektrike (OSHEE), faturat e pa paguara të vitit 2007. Mbi arsyet e mos likuidimit të kësaj vlere, Bashkia Përmet deklaroi se i kanë dërguar shkresa OSHEE- s në lidhje me detajimin e këtij detyrimi, nga e cila nuk ka patur përgjigje. Në vlerën e detyrimeve të papaguara shfaqet edhe detyrimi 1,983,513 lekë ndaj detyrimeve të vendimeve gjyqësore ose 13.5 %, nga të cilat 554,334 lekë janë detyrime që nga viti 2012 dhe 2013. Detyrimet për vendimet gjyqësore kanë të bëjnë me detyrime ndaj punonjësve të larguar nga ky institucion. Nga totali i detyrimeve të vendimeve gjyqësore, vetëm 2 prej këtyre rasteve kanë kaluar me përmbarues. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.1 faqe 18-38 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

2.1 Rekomandim: Bashkia Përmet të ndërpresë praktikën e krijimit të detyrimeve të reja dhe të marrë masa për likuidimin e detyrimeve të prapambetura duke hartuar plan të detajuar për këtë qëllim.

Menjëherë dhe në vijimësi

2.2. Nga verifikimi rezultoi se: Në zbatim të këtij rekomandimi u bëjmë me dije se vlera e detyrimeve të mbetura është ulur gjatë vitit 2021 dhe 2022 pasi janë kryer këto pagesa:

Për investimin e kryer për ndërtimin e shkollës së mesme "Sami Frashëri" me subjekt "A." shpk janë kryer pagesat me Urdhër shpenzimi nr.673; 674 datë 05.08.2021 në vlerën 2,000,000 lekë dhe Urdhër shpenzimi nr.1035; 1036 datë 20.12.2021 në vlerën 2 000 000 lekë

Për investimin e kryer me objekt "Rehabilitimi dhe përforcimi i banesave ekzistuese në fshatin Piskovë dhe Pacomit" për subjektin "N. " shpk janë kryer pagesa me Urdhër Shpenzimi nr. 116; 117 datë 10.02.2022 në vlerën 2 186 750 lekë.

Shpenzimet gjyqësore kanë qënë 1,717,113 (faqja 45 e raportit përfundimtar të kontrollit). Nga kjo shumë është likujduar për periudhën raportuese vlera prej 714 404 lekë.

Në proces zbatimi

3. Gjetje nga auditimi: Më datë 31.12.2020, balanca e llogarisë 468 "Debitorë të ndryshëm" rezulton në vlerën 33,198,811 lekë për penalitete dhe kamatëvonesë. Në asnjë rast nuk janë evidentuar në llogaritë analitike, si për vitin 2018, 2019 dhe 2020, debitorët për taksat dhe tarifatat vendore, tokën bujqësore, për taksën e ndikimit në infrastrukturë, subjekteve që tregtojnë karburante dhe dhënies me qira të apartamenteve në kundërshtim me Ligjin nr. 9228, datë 29.4.2004, "Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare", Ligjin nr. 25/2018, datë 10.05.2018 "Për kontabilitetin dhe Pasqyrat Financiare" dhe Udhëzimin nr. 8. datë 09.03.2018 "Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme". Nga rakordimi me zyrën e Taksave dhe Tarifave të Bashkisë Përmet, janë evidentuar detyrimet për vitet 2018, 2019 dhe 2020. Pra nuk është pasqyruar vlera e saktë në llogarinë 468 "Debitorë të ndryshëm" dhe kundër partinë klasa 7 e llogarive "Të ardhurat", për rrjedhojë nuk janë njohur si të ardhura për vitin 2020, në vlerën 32,823,572 lekë. Nuk janë kryer kontabilizimet në lidhje me vlerën e:

- debitorëve familjarë për taksën e ndërtesës dhe taksën e shërbimit 6,697,803 lekë;
- debitorëve nga bizneset për taksat dhe tarifatat vendore 14,022,894 lekë dhe 1,897,248 lekë
- taksës së ndikimit në infrastrukturë 258,481 lekë;
- tokës bujqësore 5,007,646 lekë;
- subjekteve që tregtojnë karburante 3,200,000 lekë dhe 100,000 lekë gjoba të llogaritura;
- dhënies me qira të apartamenteve sociale 1,639,500 lekë.

Këto vlera janë mbajtur jashtë bilancit nga Drejtoria e Financës në regjistrat e tyre progresivisht.

Nga auditimi rezulton se OSHEE vazhdon vendosjen në faturën mujore të energjisë elektrike vlerën e tarifës së shërbimit të televizorit prej 100 lekë/muaj, në kontratat për ndriçim publik të rrugëve të qytetit edhe pse Bashkia Përmet i ka bërë kërkesë për mosvendosjen e kësaj tarife. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.2 faqe 38-51 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

3.1 Rekomandim: Nga Bashkia Përmet, nëpërmjet Nëpunësit Zbatues, të merren masa për të bërë sistemimet në kontabilitet të llogarisë 468 "Debitorë të ndryshëm" duke e debituar për vlerën 32,823,572 lekë. Gjithashtu të sistemohet e ardhura e akumuluar ndër vite nga taksat dhe tarifatat vendore, për secilin vit përkatës në llogarinë 1210 "Rezultat i mbartur i seksionit të funksionimit" të vitit në vazhdim.

Me mbylljen e bilancit të vitit 2021

3.2. Nga verifikimi rezultoi se: Në zbatim të këtij rekomandimi me mbylljen e bilancit të vitit 2021 janë kontabilizuar vlerat sipas urdhërit nr.75 datë 15.03.2022.

Zbatuar

4. Gjetje nga auditimi: Referuar ligjit nr. 9228, datë 29.04.2004 "Për Kontabilitetin dhe Pasqyrat Financiare", Udhëzimit nr. 8, datë 9.3.2018, "Për Procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në Njësitë e Qeverisjes së Përgjithshme" grupi auditues konstatoi se në Aktivitet Afatgjatë Financiare, llogaria 26 "Pjesëmarrja me kapitalin e vet" është në vlerën 0 lekë, vlerë e cila duhet të përfaqësojë vlerën e aksioneve që ka Ujësjellës Kanalizime Sh.a Përmet. Bashkia Përmet i vendosi në dispozicion grupit auditues Vendimin e Gjyqtarit të vetëm, më datë 02.04.1999 për miratimin e ekspertit kontabël, i cili do bënte dhe vlerësimin e kapitalit kontabël sipas ligjit 8237, datë 1.09.1997 "Për disa ndryshime në ligjin

7926, datë 20.04.1995 “Për transformimin e ndërmarrjeve shtetërore në shoqëri tregtare”, ndryshuar dhe me akte të tjera ligjore. Gjyqtari i vetëm ka vlerësuar kapitalin themeltar të shoqërisë prej 66,315,000 lekë, nga kjo vlera e trullit është 5,590,928 lekë, numri i aksioneve është 66,315 dhe vlera nominale e aksionit është 1000 lekë. Në llogarinë 26 nuk është përcaktuar dhe nuk është përditësuar vlera pasi është krijuar ndërmarrje “Ujësjetllës Kanalizime Përmet” Sha. (Më hollësisht trajtuar në pikën 2.2 faqe 38-51 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

4.1 Rekomandim: Nga Bashkia Përmet, nëpërmjet Nëpunësit Zbatues, të merren masa për të përditësuar në kontabilitet dhe për të regjistruar pjesëmarrjen 100% në kapitalin aksionar të Ujësjetllës Kanalizime Përmet Sh.a me vlerë kontabël **0 lekë** në debi të llogarisë 26 “Pjesëmarrje në kapitalin e vet” dhe kredi të llogarive financiare të klasës 5, për pjesëmarrjen me kapitalin e vet.

Me mbylljen e bilancit të vitit 2021

4.2. Nga verifikimi rezultoi se: Në përgjigje të shkresës nr. 134 datë 17.01.2022 Sh.A Ujësjetllës Kanalizimeve me shkresën nr.42 datë 02.02.2022 ka vënë në dispozicion dokumentacionin dhe të dhënat për të kryer rregjistrimet në kontabilitet të cilat janë kryer me mbylljen e bilancit 2021.

Zbatuar

5. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i procedurës së prokurimit me objekt: “Rikonstruksion i shkollës së mesme “Sami Frashëri”, Bashkia Përmet, të zhvilluar në vitin 2018, me fond limit 72,310,465.lekë, u konstatua se: Kualifikimi i OE “A. ” ShPK, nga Komisioni i Shqyrtimit të Ankesave (KSHA) është në kundërshtim me VKM nr. 42, datë 16.01.2008 “Për miratimin e rregullores për kriteret dhe procedurat e dhënies së licencave profesionale të zhatimit, klasifikimit dhe disiplinimit të subjekteve juridike që ushtrojnë veprimtari ndërtimi”, i ndryshuar.

OE “A. ” ShPK, detyrohej që brenda 30 ditëve, të kishte bërë zëvendësimin e drejtuesit ligjor të shoqërisë, në licencë, me personin e emëruar administrator sipas regjistrimit të bërë në Ekstraktin e QKB-së, ky veprim nuk është realizuar nga OE për më shumë se 9 (nëntë) muaj kalendarik.

Mos anulimi i procedurës është veprim në kundërshtim me nenin 24 pika 1 gërma (ç), nenin 46 pika 1 dhe nenin 53 pika 3 të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, dhe shpallja fitues e OE “A. ” ShPK, i cili nuk i plotëson kriteret e DT. (Më hollësisht trajtuar në pikën 2.3 faqe 51-93 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

5.1 Rekomandim: Nga ana e Bashkisë Përmet të merren masa për eliminimin e praktikave të shpalljes fitues të Operatorëve Ekonomikë që nuk plotësojnë kriteret e miratuara në Dokumentet e Tenderit.

Menjëherë dhe në vijimësi

5.2. Nga verifikimi rezultoi se: Me urdhërin nr. 19 datë 18.01.2022 është ngritur Komisioni Disiplinor duke analizuar shkeljet e konstatuara në Raportin Përfundimtar të Auditimit dhe me vendimet përkatëse në rubrikën D janë vendosur masa disiplinore përkatëse. Gjatë vitit 2021 janë ndjekur 45 trajnime në zoom dhe 5 me pjesëmarrje fizike. Referuar Planit të veprimit nr. 21/1 prot datë 11.01.2022 KVO ka marrë parasysh të gjitha rekomandimet e bëra nga KLSH-ja, në përzgjedhjen e ofertës më të mirë ekonomike.

Zbatuar

6. Gjetje nga auditimi: Kriteret për kualifikim dhe specifikimet teknike të hartuara nga Njësia e Prokurimit për procedurën e prokurimit “Rikonstruksion dhe ndërtim i urave në fshatrat Kutal, Verçisht dhe Zhepe”, i zhvilluar në vitin 2018, me fond limit 3,166,666. lekë, nuk kanë lidhje të ngushtë me objektin e prokurimit, në zbatim të kërkesave të nenit 46 të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, si dhe VKM-së nr. 914, datë 29.12.2014, “Për

miratimin e rregullave të prokurimit publik”, neni 26 dhe neni 61, “Hartimi dhe publikimi i dokumenteve të tenderit”, pika 2, paragrafi 2. Nuk janë argumentuar arsyet e përzgjedhjes së operatorëve ekonomikë të ftuar për pjesëmarrje. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.3 faqe 51-93 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

6.1 Rekomandim: Nga ana e Bashkisë Përmet, të merren masa për përcaktimin e Dokumenteve të Tenderit në përputhje me natyrën dhe volumin e punimeve dhe për eliminimin e këtyre praktikave. Të argumentohen arsyet e përzgjedhjes së operatorëve ekonomik të ftuar për pjesëmarrje në prokurimin publik.

Menjëherë dhe në vijimësi

6.2. Nga verifikimi rezultoi se: Referuar planit të veprimit nr. 21/1 prot datë 11.01.2022 Bashkia Përmet ka marrë masa për përcaktimin e DT në përputhje me natyrën dhe volumin e punimeve sipas LPP-së duke i pasqyruar në DST e publikuara në SPE gjatë vitit 2021

Zbatuar

7. Gjetje nga auditimi: Për procedurën e prokurimit me objekt: “*Projekte për përmirësimin e kushteve të banimit për komunitetet e pa favorizuara*” mungon argumentimi i kriterëve të veçanta të vendosura në DT nga Njësia e Prokurimit si dhe disa nga kriteret për kualifikim nuk janë në lidhje të ngushtë me objektin e prokurimit.

Kriteret për kualifikim dhe specifikimet teknike të hartuara për këtë prokurim nuk janë në përputhje me ligjin nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, neni 46, pika 1 dhe kërkesat e VKM-së 914, datë 24.12.2014 “Për rregullat e Prokurimit Publik” neni 26, pika 5. Mos anulimi i procedurës është veprim në kundërshtim me nenin 24 pika 1 gërma (ç), nenin 46 pika 1 dhe nenin 53 pika 3 të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik”, dhe shpallja fitues e BOE “E.” Shpk & “A.” Shpk, i cili nuk i plotëson kriteret e DT. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.3 faqe 51-93 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

7.1 Rekomandim: Nga ana e Bashkisë Përmet të merren masa për përcaktimin e DT në përputhje me natyrën dhe volumin e punimeve dhe për eliminimin e këtyre praktikave të shpalljes fitues të Operatorëve Ekonomikë që nuk plotësojnë kriteret e miratuara në DT.

Menjëherë dhe në vijimësi

7.2. Nga verifikimi rezultoi se: Referuar planit të veprimit nr. 21/1 prot datë 11.01.2022 Bashkia Përmet ka marrë masa për përcaktimin e DT në përputhje me natyrën dhe volumin e punimeve sipas LPP-së duke i pasqyruar në DST e publikuara në SPE gjatë vitit 2021.

Zbatuar

8. Gjetje nga auditimi: Në të gjitha rastet e audituara, procesverbalet/raporti përmbledhës dhe DT, nuk janë Protokolluar në Bashkinë Përmet. DT dhe shtojca për ndryshimin e DT nuk janë nënshkruar nga anëtarët e NJP. Veprime në kundërshtim me vendimin nr. 4, datë 19.6.2017 “Për miratimin e rregullores së njësuar të punës me dokumentet në autoritetet publike të Republikës së Shqipërisë”, neni 18, “*Normat tekniko-profesionale dhe metodologjike të shërbimit arkivor në Republikën e Shqipërisë*”;

-Nuk janë kryer trajnime të stafit të prokurimit publik, në kundërshtim me pikën 2, neni 61 të VKM r. 914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” e ndryshuar.

-Në dy raste, kualifikimi, shpallja fituese e operatorëve ekonomik nga KVO, si dhe lidhja e kontratës është kryer në kundërshtim me ligjin nr. 9643, datë 29.12.2006 “Për prokurimin publik” i ndryshuar. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.3 faqe 51-93 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

8.1 Rekomandimi: Titullari i Autoritetit Kontraktor, dhe Njësia e Prokurimit në çdo rast në zhvillimin e procedurave të prokurimit natyrën dhe volumin e punimeve lduke përshkruar procedurën e prokurimit publik në të gjithë fazat e realizimit.

Titullari i AK të marrë masa që ti kushtojë vëmendjen e duhur institucionale procesit të shqyrtimit dhe vlerësimit nga KVO, të dokumentacionit ligjor dhe administrativ të operatorëve

ekonomikë dhe ofertave të ofertuesve duke marrë masa për trajnimin e stafit mbi prokurimet publike, pasi në dy raste vlerësimi i ofertave konstatohet jo korrekt, me qëllim rritjen e efikasitetit në shpenzimet publike, duke zhvilluar procedura prokurimi në përmbushje të kriterëve ligjore, kapaciteteve ekonomike, financiare dhe profesionale, në përzgjedhjen e ofertës më të mirë ekonomike, duke siguruar që Autoriteti Kontraktor të pranojë oferta të cilat janë të përballueshme, të qëndrueshme, të pakushtëzuara dhe të plotësimit të nevojave të saj.

Menjëherë dhe Vazhdimisht

8.2. Nga verifikimi rezultoi se: Me urdhërin nr. 19 datë 18.01.2022 është ngritur Komisioni Disiplinor duke analizuar shkeljet e konstatuara në Raportin Përfundimtar të Auditimit dhe me vendimet përkatëse në rubrikën D janë vendosur masa disiplinore përkatëse. Gjatë vitit 2021 janë ndjekur 45 trajnime në zoom dhe 5 me pjesëmarrje fizike. Referuar Planit të veprimit nr. 21/1 prot datë 11.01.2022 KVO ka marrë parasysh të gjitha rekomandimet e bëra nga KLSH-ja, në përzgjedhjen e ofertës më të mirë ekonomike.

Zbatuar

9. Gjetje nga auditimi: Bashkia Përmet nuk ka marrë të gjitha masat e duhura për të bërë të mundur zbatimin e rekomandimeve të lëna nga KLSH në auditimin e fundit për shpërblim dëmi në vlerën 4,711,194 lekë dhe për 9 masa organizative që ende nuk janë zbatuar.

(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.4 faqe 93-98 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

9.1 Rekomandim: Kryetari i Bashkisë Përmet të analizojë me strukturat e bashkisë si dhe në Këshillin Bashkiak mos zbatimin e plotë të rekomandimeve të KLSH të dërguara me shkresat nr. 390/61 Prot., datë 22.10.2019 përkatës dhe hartimin e planeve specifike të punës për:

- Zbatimin e rekomandimeve për shpërblim dëmi në vlerën **4,199,595** lekë;
- Zbatimin e 5 rekomandimeve organizative që janë nxjerrë urdhrat përkatës por rezultojnë ende në proces zbatimi;
- Zbatimin e 2 rekomandimeve organizative që ende nuk janë zbatuar.

Menjëherë

9.2. Nga verifikimi rezultoi se: Në zbatim të rekomandimeve të KLSH-së të dërguara me shkresën nr. 390/61 Prot, datë 22.10.2019 rezulton se

Në zbatim të kontratës me objekt “Rijetëzim i Bllokut të banimit Tefta Tashko Koço, Elena Gjika, Vasil Papadhropulo” realizuar nga BOE R. shpk & V. shpk Bashkia Përmet me Ankimin nr. 1254 prot datë 23.05.2019 është në proces gjyqësor për vjeljen e këtij detyrimi në gjykatën Administrative të Apelit Tiranë.

- Në zbatim të kontratës me objekt “Rehabilitimi i rrjetit të ujësjellësit dhe rrugëve të brendshme të Fshatit Piskovë” realizuar nga OE “M. ” shpk Bashkia Përmet është në proces gjyqësor në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Gjirokastrë ku ka paraqitur prapësimet me nr.3338 Prot datë 25.11.2021 ku deri tani është në fazën e shqyrtimit gjyqësor.

Në proces zbatimi

10. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi dhe analizimi i komponentëve të MFK-së referuar Ligjit nr. 10296, datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, i ndryshuar si dhe Manualit të Menaxhimit Financiar dhe Kontrollit, miratuar me Urdhër të Ministrit të Financave nr. 108, datë 17.11.2016 **është konstatuar se:**

- Në Bashkinë Përmet nuk është hartuar “Harta e procesit të Menaxhimit të Burimeve Njerëzore”, për periudhën e auditimit, nuk ka një plan afatmesëm ose vjetor të trajnimeve.
- Në lidhje me Menaxhimin Financiar dhe Kontrollit nuk janë kryer trajnime për Grupin e Menaxhimit Strategjik (GMS- n).
- Bashkia Përmet nuk ka miratuar “Strategjinë e Menaxhimit të Riskut” si dhe nuk janë zhvilluar mbledhje të dokumentuara të grupit të punës për Menaxhimin Strategjik (GMS) për të diskutuar rreth çështjeve që lidhen me menaxhimin financiar dhe kontrollin, mbledhjet janë kryer nga GMS vetëm për Përgatitjen e Buxhetit Vjetor dhe Programit Buxhetor Afatmesëm. Bashkia Përmet nuk ka miratuar Plan Pune Vjetor lidhur me funksionimin e Grupit për

Menaxhimin Strategjik”. Nuk e kanë të gjithë punonjësit mundësinë e përdorimit të email- it zyrtar të institucionit duke qënë se sistemi ofron një numër të kufizuar adresash email-i.

- Në vitin 2018 janë kryer vetëm 40 trajnime dhe për vitin 2019 vetëm 46 trajnime për punonjësit. Në vitin 2020 janë kryer trajnime nëpërmjet Zoom (online). Burimet Njerëzore nuk kanë një data bazë me emrat e punonjësve dhe trajnimet e kryera për periudhën e auditimit.

- Nuk janë kryer trajnime për anëtarët e GMS-s në fushën e Menaxhimit të Riskut.

- Bashkia Përmet nuk ka patur në strukturën e saj Auditin e Brendshëm, e cila sjell mungesën e vlerësimeve specifike për sistemet e kontrollit të brendshëm.

- Bashkia nuk ka implementuar programe, sisteme për burimet njerëzore, për financën dhe për drejtoritë që mbledhin taksat. (*Më hollësisht trajtuar në pikën 2.5 faqe 98-103 të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

10.1 Rekomandim: Nga ana e Bashkisë Përmet të merren masa për zbatimin e të gjithë komponentëve të MFK-së:

- Të hartohet një plan afatmesëm ose vjetor të trajnimeve, “Harta e procesit të Menaxhimit të Burimeve Njerëzore”.

- Burimet Njerëzore të përpilojnë një data bazë me emrat e punonjësve dhe trajnimet e kryera nga ana e tyre si dhe të njoftojë punonjësit të ndjekin trajnime me qëllim zhvillimin e tyre profesional.

- Të kryejnë trajnime për anëtarët e GMS-s në fushën e Menaxhimit të Riskut.

- Grupi i Menaxhimit Strategjik të kryej trajnime mbi Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin.

- Të ngrihet në strukturën e Bashkisë Përmet auditin e brendshëm ose të miratojë një marrëveshje me bashki të tjera për realizimin e shërbimit të Auditimit të Brendshëm.

- Bashkia Përmet të miratojë “Strategjinë e Menaxhimit të Riskut”, të zhvillohen mbledhje të dokumentuara të Grupit të punës për Menaxhimin Strategjik (GMS) për të diskutuar rreth çështjeve që lidhen me menaxhimin financiar dhe kontrollin si dhe të miratohet Plan Pune Vjetore lidhur me funksionimin e Grupit për Menaxhimin Strategjik”.

- Të mundësohet për të gjithë punonjësit përdorimi i email-it zyrtar të institucionit.

Bashkia Përmet të implementojë program për burimet njerëzore, për financën dhe për drejtoritë që mbledhin taksat duke garantuar kështu shmangien e keqpërdorimit apo të abuzimit dhe cenimit të cilësisë.

Menjëherë dhe në vijimësi

10.2. Nga verifikimi rezultoi se: Në zbatim të këtij rekomandimi nga ana e Bashkisë është hartuar plani vjetor i trajnimeve për vitin 2022 me shkresën nr.1514/1 datë 20.05.2022 . Gjatë vitit 2021 janë ndjekur 45 trajnime në zoom dhe 5 me pjesëmarrje fizike. Grupi i Menaxhimit Strategjik ka kryer trajnime në fushën e Menaxhimit të Riskut dhe mbi Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin. Në strukturën e miratuar të vitit 2021 dhe 2022 është përcaktuar pozicioni i auditit të brendshëm dhe janë bërë 4(katër) herë shpallje për këtë pozicion por nuk ka shfaqur asnjë individ i kualifikuar interes. Janë pajisur me email zyrtar 8 punonjës përfshirë titullarin e Institucionit dhe kanë akses në e-mailin zyrtar të institucionit Kryetari, Nën/kryetarët, Sekretar i Pëgjithshëm dhe 4 drejtorët e drejtorive.

Në proces zbatimi

B. MASA PËR ULJEN E BORXHIT TATIMOR DUKE RRIUR PERFORMANCËN NË ARKËTIMIN E DETYRIMEVE PËR TATIM TAKSAT VENDORE, PËRFSHIRË DHE DETYRIMET NGA QIRADHËNIA.

1. Gjetje nga auditimi: Referuar ligjit 9632 “Për sistemin e taksave dhe tarifave vendore”, në vitet 2018- 2020 “Ujësjetllës Kanalizime Përmet” Sh.a, ka arkëtuar nga taksat dhe tarifat vendore vlerën 35,963,884 lekë, nga të cilat për vitet 2018 dhe 2019 “Ujësjetllës Kanalizime Përmet” Sha ka përfituar 10 % të shumës mujore të derdhur dhe 5 % në vitin 2020 të të ardhurave të arkëtuara. Ky subjekt i ka transferuar nëpërmjet bankës së nivelit të dytë, Bashkisë

në vlerën 22,252,444 lekë përkundrejt vlerës 32,9366,109 lekë që duhet të arkëtohet për llogari të institucionit. Detyrimi nga diferencat është rritur nga viti në vit dhe në 31.12.2020, ky detyrim është në vlerën **15,393,615 lekë, e ardhur e munguar në Bashkinë Përmet**. (Më hollësisht trajtuar në pikën 2.1 faqe 18-38 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

1.1 Rekomandimi: Bashkia Përmet të marrë të gjitha masat me qëllim arkëtimin e detyrimeve të prapambetura në vlerën totale **15,393,615 lekë** dhe të mos kemi rritje nga viti në vit të detyrimit të “Ujësjellës Kanalizime Përmet” Sh.a kundrejt Bashkisë Përmet.

Menjëherë dhe në vijimësi

1.2. Nga verifikimi rezultoi se: Në zbatim të këtij rekomandimi bashkia Përmet me shkresën nr.135 datë 17.01.2022 i është drejtuar Sh.A Ujësjellës Kanalizimeve për derdhjen e detyrimit dhe Sh.A Ujësjellës na është përgjigjur me shkresën nr.39 datë 02.02.2022.

Në proces zbatimi

2. Gjetje nga auditimi: Vlera e debitorëve nga bizneset deri më datë 31.12.2020 paraqitet 14,022,894 lekë, e cila përbëhet nga taksat dhe tarifat vendore të papaguara nga bizneset, e cila përbën borxh tatimor dhe mungesë të ardhurash për buxhetin e Bashkisë Përmet, referuar ligjit 9632 “Për sistemin e taksave dhe tarifave vendore”. Vlera e gjobave llogaritet në 1,897,248 lekë, e ardhur e munguar për buxhetin e Bashkisë Përmet. Në total llogaritet 15,920,142 lekë e ardhur e munguar për Bashkinë Përmet nga taksat dhe tarifat vendore të papaguara nga bizneset. Vlera e debitorëve nga familjarët deri më datë 31.12.2020 është 6,697,803 lekë, të ardhura të munguara për Bashkinë Përmet. Mbi këto debitorë familjarë nuk është aplikuar kamatëvonesë. Në lidhje me debitorët familjare, nuk disponojnë një database të saktë me të dhënat e tyre duke specifikuar taksat dhe tarifat që aplikohen, po ashtu nuk e kanë si format paraqitjen e informacionit të plotë ku të paraqitet debia për secilin vit duke filluar që nga vitet e mëparshme. Përdorimi i këtij formati ku të përmbliidhen informacionet e mësipërme do të mundësonte analizimin e të dhënave dhe pasqyrimin më të plotë të situatës me debitorët, për secilën nga taksat dhe tarifat e papaguara. Të dhënat e mbajtura në këto formate ekzistuese, paraqesin informacion të cunguar. (Më hollësisht trajtuar në pikën 2.1 faqe 18-38 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

2.1 Rekomandim: Drejtoria e Taksave dhe Tarifave vendore në Bashkinë Përmet, të marrë të gjitha masat me qëllim arkëtimin e detyrimeve të prapambetura në vlerën totale **22,617,945 lekë** dhe të ndjek hapat e tjera vijuese në masa shtrënguese. Në lidhje me debitorët familjare, Drejtoria e Taksave dhe Tarifave Vendore, të krijojnë një regjistër, një database të saktë me të dhënat e debitorëve familjarë, duke specifikuar taksat dhe tarifat që aplikohen, po ashtu të paraqesin informacion të plotë ku të specifikohet debia për secilin vit, duke filluar që nga vitet e mëparshme.

Menjëherë dhe në vijimësi

2.2. Nga verifikimi rezultoi se: Me anë të shkresës nr.133 datë 17.01.2022 i është kërkuar Sh.A Ujësjellës Kanalizimeve të na paraqesë listat e debitorëve familjarë. Me shkresën nr.40 datë 02.02.2022 Sh.A Ujësjellës Kanalizimeve na ka vënë në dispozicion listat e debitorëve familjarë.

Për subjektet debitore janë bërë njoftimet për mospagesën e detyrimeve vendore me shkresën nr. 856/1 datë 17.03.2022.

- ✓ Lista e arkëtimeve për detyrimet e prapambetura:
- ✓ Nga totali i subjekteve debitorë më poshtë u bashkëlidhim listën e subjekteve të cilët e kanë paguar në kohë detyrimin e tyre (lapsus në vlerën totale).
- ✓ Me VKB nr.3 datë 31.01.2022 janë miratuar masat shtrënguese të mbledhjes me forcë të detyrimeve tatimore të prapambetura.

Në proces zbatimi

3. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi rezultoi se për ndërtesat, të cilat janë në proces legalizimi, taksa e ndikimit në infrastrukturë e ndërtime të reja është 0.5 % e vlerës së investimit. Llogaritjet janë kryer në bazë të të dhënave të ndërtimeve që pajisen me leje legalizimi të dërguara nga ALUIZNI, me shkresa zyrtare. Bazuar në data bazën e vënë në dispozicion nga Drejtoria e Urbanistikës, në total ndërtesa të legalizuara nga viti 2015- 2020 rezultojnë të jenë në vlerën 8,503,787.90 lekë, ku vetëm 5,378,480.90 lekë janë paguar referuar VKM, nr. 860, datë 10.12.2014, “Për përcaktimin e mënyrës së mbledhjes dhe administrimit të të ardhurave për ndërtimet pa leje dhe vlerave të zbatueshme për legalizim” si dhe ligjit nr. 9632, datë 30.10.2006, “Për sistemin e taksave vendore”, të ndryshuar, neni 22. Taksa e ndikimit në infrastrukturë e pa paguar deri më datë 31.12.2020 është në vlerën 3,125,307 lekë, duke krijuar mungesë të të ardhurave në Bashkinë Përmet. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.1 faqe 18-38 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

3.1 Rekomandim: Drejtoria e Urbanistikës të bashkëpunojë me Aluizni-n që ta ketë data bazën e plotë përsa i përket aplikuesve dhe të dhënave të tyre.

Menjëherë dhe në vijimësi

3.2 Rekomandim: Drejtoria e Urbanistikës të marr masa administrative e ligjore për arkëtimin e taksës së ndikimit në infrastrukturë për **vlerën 3,125,307 lekë**. Gjithashtu, nga strukturat e Bashkisë Përmet të bashkëpunohet me Agjencinë Shtetërore të Kadastrës (ASHK) dhe ALUIZNI Gjirokastër, për bllokimin e veprimeve në dhënien e certifikatës së pronësisë deri në kryerjen e pagesave të taksës së ndikimit në infrastrukturë.

Menjëherë dhe në vijimësi

3.3. Nga verifikimi rezultoi se: Në zbatim të këtij rekomandimi nga Drejtoria e Urbanistikës janë bërë njoftimet për subjektet dhe individët në të cilën parashikohen të gjitha masat shtrënguese për mbledhjen e detyrimeve me shkresën Nr.77 Prot datë 13.01.2022.

Në zbatim të këtij rekomandimi nga Drejtoria e Urbanistikës janë bërë njoftimet për bashkëpunim me Agjencinë Shtetërore të Kadastrës (ASHK) dhe ALUIZNI Gjirokastër, për bllokimin e veprimeve në dhënien e certifikatës së pronësisë deri në kryerjen e pagesave të taksës së ndikimit në infrastrukturë me shkresën Nr. 146 Prot datë 18.01.2022. Deri në momentin e verifikimit është arkëtuar vlera **612,699 lekë** duke mbetur pa u arkëtuar vlera **2,512,608 lekë**.

Në proces zbatimi

4. Gjetje nga auditimi: Referuar Ligjit nr. 9632, datë 30.10.2006 “Për sistemin e taksave vendore”, i ndryshuar, vlera e debisë me 31.12.2020, bazuar në listat e vendosura në dispozicion nga Zyra e Tatim Taksave është 5,007,646 lekë, e ardhur e munguar për Bashkinë Përmet. Njësia administrative Piskovë shfaqet më problematike përsa i përket detyrimeve të prapambetura në vlerën 1,943,439 lekë dhe më pak problematike shfaqet njësia administrative Frashër me vlerën e detyrimit 256,716 lekë. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.1 faqe 18-38 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

4.1 Rekomandim: Zyra e Tatim Taksave të marr masa me qëllim arkëtimin e detyrimeve në shumën **5,007,646 lekë**.

Menjëherë dhe në vijimësi

4.2. Nga verifikimi rezultoi se: Në zbatim të këtij rekomandimi është rinjoftuar popullata për detyrimet e prapambetura dhe për periudhën raportuese është arkëtuar vlera prej 369,605 lekë për Njësia administrative Piskovë dhe për Njësia Administrative Frashër janë arkëtuar 25,000 lekë. duke mbetur pa u arkëtuar vlera prej 4,613,041 lekë.

Në proces zbatimi

5. Gjetje nga auditimi: Në Bashkinë Përmet operojnë 6 subjekte të cilat tregtojnë karburant dhe gaz, 4 nga këto subjekte nuk e kanë kryer pagesën për përsëritjen e liçencave në kundërshtim me VKM nr.970, datë 2.12.2015, për “Përcaktimin e procedurave dhe të kushteve

për dhënien e licencave për tregtimin e naftës bruto dhe nënprodukteve të saj”, pika 14 dhe në kundërshtim me VKM nr. 344, datë 19.4.2017, “Për disa ndryshime dhe shtesa në VKM nr. 970, datë 2.12.2015, “Për përcaktimin e procedurave dhe të kushteve për dhënien e licencave për tregtimin e naftës bruto dhe nënprodukteve të saj”, pika 9. Të ardhurat e munguara janë në vlerën 3,200,000 lekë. Bashkia Përmet nuk ka aplikuar gjoba për fillimin e aktivitetit pa marrë licencën në kundërshtim me Paketën Fiskale të vitit 2020, të miratuar me VKB nr. 101, datë 19.12.2019 ku specifikohet se gjoba për fillim e aktivitetit pa marrë licencën është 20,000 lekë. Në total gjobat rezultojnë të jenë në vlerë 100,000 lekë mungesë të ardhurash për Bashkinë Përmet. (Më hollësisht trajtuar në pikën 2.1 faqe 18-38 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

5.1 Rekomandim: Sektori i Shërbimeve të marrë masa në mbledhjen e detyrimeve në vlerën **3,300,000 lekë** si dhe të aplikojë gjoba për fillim e aktivitetit pa marrë licencën në rast mospagese pasi mbaron afati i saj.

Menjëherë dhe në vijimësi

5.2. Nga verifikimi rezultoi se: Në zbatim të këtij rekomandimi Bashkia Përmet me shkresat përkatëse ka njoftuar subjektet respektive si vijon:

- Subjektit K. shpk me NIPT L.....U Njoftim për shlyerje detyrimesh të prapambetura me shkresën nr.1187 prot datë 13.04.2022.
- Subjektit M. & L. shpk me NIPT L.....N Njoftim për shlyerje detyrimesh të prapambetura me shkresën nr.1188 prot datë 13.04.2022.
- Subjektit E. shpk me NIPT K.....F Njoftim për shlyerje detyrimesh dhe pajisjen me Licensë për ushtrim aktiviteti me shkresën nr.1189 prot datë 13.04.2022. Ka dërguar shkresë për rishikim detyrimesh dhe i është kthyer përgjigje me shkresën nr.1789 prot datë 07.06.2022.
- Subjektit S. shpk me NIPT K.....V Njoftim për shlyerje detyrimesh dhe pajisjen me Licensë për ushtrim aktiviteti me shkresën nr.1190 prot datë 13.04.2022.

Deri në momentin e verifikimit nuk është ndërmarr asnjë procedur tjetër ligjore për arkëtimin e detyrimeve si dhe aplikimin e penalteteve për fillim e aktivitetit pa marrë licencën.

Në proces zbatimi

6. Gjetje nga auditimi: Me Vendim të Këshillit Bashkiak nr. 8, datë 04.03.2016, “Për miratimin e dhënies me qira të apartamenteve sociale të pallateve me numër pasurie 93/3 dhe 83/3, në pronësi të Bashkisë Përmet”, kanë lidhur kontratë me Bashkinë 23 individë mbi marrjen me qira të 6 objekteve të saj. Të 23 përfituesit kanë lidhur një kontratë me Bashkinë Përmet, ku është përcaktuar se qeraja duhet të paguhet brenda datës 10 të muajit pasardhës. Kontratat janë lidhur për një afat 5 vjeçar nga 2016- 2021. Në periudhën e audituar 2018- 2020 janë arkëtuar nga Bashkia Përmet 1,690,000 lekë. Deri më 31.12.2020 duhet të paguheshin sipas kontratës së lidhur, 55 muaj qera në vlerën 4,262,500 lekë në total, ndërkohë deri më 31.12.2020 janë paguar në total 2,623,000 lekë me një diferencë prej **1,639,500 lekë, të ardhura të munguara për Bashkinë Përmet.** Grupi auditues mori në analizë të gjitha këto kontrata, nga të cilat mungojnë kontratat e lidhura me: D. Ç. , Y. R., S. C. dhe V. B.. (Më hollësisht trajtuar në pikën 2.1 faqe 18-38 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

6.1 Rekomandim: Sektori i Shërbimeve në bashkëpunim me Zyrën Juridike të marrë masa për ndjekjen dhe për detyrimin në vlerën **1,639,500 lekë.**

Menjëherë dhe në vijimësi

6.2. Nga verifikimi rezultoi se: Në zbatim të këtij rekomandimi Bashkia po ndjek procedurat e privatizimit dhe detyrimi i prapambetur është shpërndarë në vitet që do të kryhet së bashku me pagesën për privatizimin e banesave, procedurë e cila është miratuar me VKB-ja nr.36 datë 30.05.2022.

Në proces zbatimi

C. MASA PËR SHPËRBLIM DËMI

Bazuar në ligjin nr. 154, datë 27.11.2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit” neni 15 shkronja (b) dhe (c) -Të drejtat e KLSH, dhe mbështetur në nenet 98-102, të ligjit nr. 44, datë 30.04.2015 “Kodi i procedurave administrative në Republikën e Shqipërisë”, nenet 21-33, të Ligjit nr. 139, datë 17.12.2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, **nga Titullari i njësisë publike**, të nxirren aktet administrative përkatëse dhe të kërkohet në rrugë ligjore (Padi Gjyqësore), duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative dhe procedurat e tjera në të gjitha shkallët e gjykimit, me qëllim kërkimin për shpërblimin e dëmit. Nëpunësi zbatues të ndjekë procesin me qëllim shpërblimin e dëmit në vlerën **806,824.61 lekë pa Tvsh**, si më poshtë:

Nga verifikimi rezultoi se vlera 806,824 lekë është kontabilizuar dhe pasqyruar në llogarinë 468 –debitorë të Pasqyrave Financiare më datën 31.12.2021 (bilanci vjetor 2021) vlera prej 806,824 lekë. Janë rekomanduar 3 masa shpërblim dëmi në vlerë 806,823 lekë, deri me datë 07.10.2022, është arkëtuar vlera 338,321 lekë, si dhe është në proces vlera 468,503 lekë.

Në mënyrë tabelore rekomandimet, arkëtimet dhe natyra e rasteve të mos realizimit paraqiten në pasqyrën e mëposhtme:

Nr	Emër Mbiemër/Subjekti	Numri rekomandimit sipas shkre (Vendimit)	Natyra e Shkeljes	Rekomanduar Gjithsej në Lekë	Nuk Pranohen nga Subjekti	Janë pranuar Në Lekë	Nga të pranuarat:			
							Arkëtuar Deri 07.10.22	Në Proces Arkëtim	Në Proces Gjyqësor	Nisur Njoftime e s'kanë Paguar
a	B	c	d	1	2	3 (2-1)	4	5	6	7
1	A. K. SHPK	1.1	Punimeve pakryera.	338,321		338,321	338,321			
2	“H. ” & “R. ” SHPK	2.1	Punimeve pakryera	182,542		182,542	0			182,542
3	“H. ” SHPK	3.1	Punimeve pakryera	285,960		285,960	0			285,960
				806,824		806,824	338,321			468,503

1. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i zbatimit të punimeve civile të kontratës me objekt “Rikonstruksion i shkollës së mesme “Sami Frashëri”, Bashkia Përmet, me vlerë të kontratës (me Tvsh) 81,490,378.838 lekë, me nr. prot., datë 01.03.2019, fituar nga OE “A” Shpk, rezultuan diferenca në volume pune të pa kryera në fakt në vlerën **338,321.77 lekë pa TVSH**, në zërat “FV Ulluk shkarkimi vertikal me llamarinë xingate Ø100mm”, “FV Kasetë shkarkimi me llamarinë xingato” e “F.V.bordura betoni 15x30cm (në perimetrin e shkollës përreth sheshit)”. Veprimet e mësipërme janë në kundërshtim me kontratën e sipërmarrjes së punimeve. (Më hollësisht trajtuar në pikën 2.3 faqe 51-93 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

1.1. Rekomandim: Nga Bashkia Përmet të merren masa për arkëtimin e vlerës prej **338,321 lekë pa TVSH** nga OE “A. ” ShPK, në cilësinë e sipërmarrësit në kontratën me nr. 547 prot., datë 01.03.2019, me objekt: “Rikonstruksion i shkollës së mesme “Sami Frashëri”, Bashkia Përmet, vlerë që përfaqëson dëm ekonomik ndaj buxhetit të shtetit dhe njësisë vendore, si pasojë e likuidimit të punimeve të pakryera.

Menjëherë

1.2. Nga verifikimi rezultoi se: Nëpunësi Autorizues në zbatim të detyrimeve të konstatuar nga KLSH-ja dhe sipas kontratës së sipërmarrjes me nr. 547 prot., datë 01.03.2019, ka nxjerr Vendimin nr.43 datë 08.02.2022, “Për nisjen e procedurave administrative dhe ligjore për

kthimin e detyrimit në vlerën 338,321 lekë”, nga OE “A. ” ShPK. Me shkresën nr.744 prot datë 04.03.2022 është njoftuar OE “A. ” ShPK për arkëtimin vullnetar të detyrimit. Deri në datën e verifikimit 07.10.2022, është arkëtuar detyrimi sipas mandat pagesës së datës 24.03.2022 pranë R.Bank.

Zbatuar

2. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i zbatimit të punimeve civile të kontratës me objekt **“Sistemim asfaltim i rrugëve të Bashkisë Përmet dhe të Njësive Administrative”, Bashkia Përmet**, me vlerë të kontratës (me TVSH) 94,712,204 lekë, me nr. 3270 prot., datë 24.12.2018, fituar nga BOE “H. ” & “R. ” ShPK, rezultuan diferenca në volume pune të pakryera në fakt në vlerën **182,542.84 lekë pa TVSH**, në zërat “Mbushje me çakëll/ose zhavor lumi pas murit” dhe “Ndërtim mur betoni m-200”. Veprimet e mësipërme janë në kundërshtim me kontratën e sipërmarrjes së punimeve. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.3, faqe 51-93 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

2.1. Rekomandim: Nga Bashkia Përmet të merren masa për arkëtimin e vlerës prej **182,542 lekë pa Tvsh** nga “H. ” & “R. ” Shpk, në cilësinë e sipërmarrësit në kontratën me nr. ... prot, datë 24.12.2018, me objekt: **“Sistemim asfaltim i rrugëve të Bashkisë Përmet dhe të Njësive Administrative”, Bashkia Përmet**, vlerë që përfaqëson dëm ekonomik ndaj buxhetit të shtetit dhe njësisë vendore, si pasojë e likuidimit të punimeve të pakryera.

Menjëherë

2.2. Nga verifikimi rezultoi se: Nëpunësi Autorizues në zbatim të detyrimeve të konstatuar nga KLSH-ja dhe sipas kontratës së sipërmarrjes me nr. ... prot, datë 24.12.2018, ka nxjerr Vendimin nr..43/1 datë 08.02.2022, “Për nisjen e procedurave administrative dhe ligjore për kthimin e detyrimit në vlerën 182,542 lekë”, nga BOE “H. ” shpk & “R. ” shpk. Me shkresën nr.746 prot datë 04.03.2022 është njoftuar BOE “H. ” shpk & “R. ” shpk për arkëtimin vullnetar të detyrimit. Deri në datën e verifikimit 07.10.2022, nuk është ndërmar asnjë procedur tjetër ligjore në arkëtimin e detyrimit.

Në proces zbatimi

3. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i zbatimit të punimeve civile të kontratës me objekt **“Rikonstruksion e ndërtime të urave në fshatrat Zhepe, Kutal, Verçisht” Bashkia Përmet**, me vlerë të kontratës (me Tvsh) 81,490,378.838 lekë, me nr. ... prot., datë 04.06.2018, rezultuan diferenca në volume pune të pakryera në fakt në vlerën **285,960 lekë pa Tvsh**, në zërat “Përgatitje e montim litarë çeliku d=14mm”, “F.V Morseta”, “F.V Tiranda d=1mm” e “F.V. Kavallota Veprimet e mësipërme janë në kundërshtim me kontratën e sipërmarrjes së punimeve. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.3 faqe 51-93 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

3.1 Rekomandim: Nga Bashkia Përmet të merren masa për arkëtimin e vlerës prej **285,960 lekë pa TVSH** nga kontraktori “H. ” ShPK, sipas kontratës me numër 1363 prot., datë 04.06.2018, me objekt: **“Rikonstruksion e ndërtime të urave në fshatrat Zhepe, Kutal, Verçisht ” Bashkia Përmet**, vlerë që përfaqëson dëm ekonomik ndaj buxhetit të shtetit dhe njësisë vendore, si pasojë e likuidimit të punimeve të pakryera.

Menjëherë

3.2. Nga verifikimi rezultoi se: Nëpunësi Autorizues në zbatim të detyrimeve të konstatuar nga KLSH-ja dhe sipas kontratës së sipërmarrjes me nr. ... prot., datë 04.06.2018, ka nxjerr Vendimin nr..43/2 datë 08.02.2022, “Për nisjen e procedurave administrative dhe ligjore për kthimin e detyrimit në vlerën 285,960 lekë”, nga OE “H. ” ShPK. Me shkresën nr.745 prot datë 04.03.2022 është njoftuar OE “H. ” për arkëtimin vullnetar të detyrimit. Deri në datën e verifikimit 07.10.2022, nuk është ndërmar asnjë procedur tjetër ligjore në arkëtimin e detyrimit.

Në proces zbatimi

C. MASA PËR ELIMIMIN E EFEKTEVE NEGATIVE TË KONSTATUARA NË ADMINISTRIMIN E FONDEVE PUBLIKE DHE PËR MENAXHIMIN ME EKONOMICITET, EFICENCE DHE EFEKTIVITET TË FONDEVE PUBLIKE

Nga auditimi i procedurave të prokurimit publik për vitet 2018-2020, janë konstatuar 2 procedura prokurimi me shkelje të akteve ligjore e nënligjore të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006, “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, të cilat kanë çuar në përdorimin e fondeve publike me ndikim negativ për vlerën **87,418 mijë lekë** duke mos u udhëhequr nga qëllimi kryesor i ligjit për prokurimet publike, ai i sigurimit të dobishmërisë maksimale të fondeve, të cilat nuk çënojnë thelbin e zbatimit të kontratës, procedura të cilat deri më tani kanë sjellë pasoja me efekte negative:

1.Gjetje nga auditimi:

A. Nga auditimi i procedurës së prokurimit me objekt: “**Rikonstruksion i shkollës së mesme “Sami Frashëri”, Bashkia Përmet**, të zhvilluar me urdhër prokurimi nr. 248 prot., datë 30.10.2018, me fond limit **72,310,465 lekë** pa TVSH, marrin pjesë 11 OE dhe janë skualifikuar 10 OE, të fituar nga OE “A. ” ShPK me vlerë të ofertës **68,672,247.365** lekë pa TVSH, ka rezultuar se Komisioni i Shqyrtimit të Ankesave (KSHA) ka vlerësuar dhe kualifikuar në kushtet kur asnjë nga OE pjesëmarrës nuk ka plotësuar kërkesat për kualifikim të DT, duke mos anuluar procedurën e prokurimit.

Nga ana e KSHA-së është vepruar në kundërshtim me VKM nr. 42, datë 16.01.2008, dhe ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006, “Për prokurimin publik”, i ndryshuar dhe mosveprimet e saj janë shkaktuar shpenzime në kundërshtim me parimin 3 E-ve në vlerën **81,490,378.838 lekë me Tvsh**, ndikim negativ në buxhetin e Bashkisë Përmet në përdorimin e fondeve publike. (Më hollësisht trajtuar në pikën 2.3 faqe 51-93 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

B. Nga auditimi i procedurës së prokurimit me objekt: “**Projekte për përmirësimin e kushteve të banimit për komunitet të pafavorizuara**”, **Bashkia Përmet**, me urdhër prokurimi nr. 159, datë 01.08.2018, me fond limit 5,028,293 lekë pa Tvsh, marrin pjesë 4 OE dhe janë skualifikuar 3 OE, të fituar nga BOE “A. ” Shpk & “E. ” Shpk, me vlerë të ofertës **4,939,996 lekë pa Tvsh**, ka rezultuar se KVO ka vlerësuar dhe shpallur fituesin në kushtet e mosplotësimit të kërkesave për kualifikim në DT, duke mos anuluar procedurën e prokurimit. Nga ana e KVO-së është vepruar në kundërshtim me ligjin nr. 9643, datë 20.11.2006, “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, veprime me pasojë shpenzime në kundërshtim me parimin 3 E-ve në vlerën **5,927,995 lekë me Tvsh**, ndikim negativ në buxhetin e Bashkisë Përmet në përdorimin e fondeve publike.

(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.3 faqe 51-93 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

1.1.Rekomandimi: Kryetari i Bashkisë Përmet, të analizojë dhe të nxjerrë përgjegjësitë për kualifikimin e operatorëve ekonomike të cilat nuk plotësojnë kriteret e kërkesave kualifikuese të DT, me pasojë përdorimi me paligjshmëri të fondeve publike për vlerën **87,418 mijë lekë me TVSH**, të konsiderojë faktin se kualifikimi i operatorëve ekonomikë të cilët nuk plotësojnë kriteret e DT, përveçse është shkelje e kuadrit rregullator në fuqi, përbën edhe risk real për shpenzimet e njësisë publike, pasi këta operatorë për shkak të mangësive nuk japin siguri për kryerjen me sukses dhe cilësi të kushteve të kontratës

Menjëherë dhe Vazhdimisht.

1.2. Nga verifikimi rezultoi se: Në zbatim të këtij rekomandimi me urdhërin nr. 19 datë 18.01.2022 u ngrit Komisioni Disiplinor për të analizuar shkeljet e konstatuara në Raportin Përfundimtar të Auditimit vlerësimin e shkallës së përgjegjësisë për çdo nëpunës të atakuar dhe marrjen e masave disiplinore përkatëse.

Zbatuar

D. MASAT DISIPLINORE

KLSH mbështetur në nenin 15, ligjit nr. 154/2014, datë 27.11.2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”; gjerat (b, c, ç) e nenit 58 “Llojet e masave disiplinore” të ligjit nr. 152/2013 “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar; VKM nr. 115, datë 05.03.2014 “Për përcaktimin e procedurës disiplinore dhe të rregullave për krijimin, përbërjen e vendimmarrjen në komisionin disiplinor në shërbimin civil; neni 37 të ligjit nr. 7961, datë 12.07.1996 “Kodi i punës në Republikën e Shqipërisë”; shkronja (b) e nenit 9 “Masa disiplinore”, të kontratës individuale dhe shkronja (k) e nenit 64 të ligjit nr. 139/2015 datë 17.12.2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, i rekomandojmë Kryetarit të Bashkisë Përmet t’i kërkojë Komisionit Disiplinor pranë Institucionit, që bazuar në performancën e secilit punonjës dhe shkeljeve të konstatuara në Raportin Përfundimtar të Auditimit të KLSH-së, të vlerësojë shkallën e përgjegjësisë për çdo nëpunës të atakuar dhe marrjen e masave disiplinore përkatëse.

Nga verifikimi rezultoi se me urdhërin nr. 19 date 18.01.2022 është ngritur Komisioni Disiplinor dhe ka bere verifikimin rast pas rasti të konstatimeve të KLSH, dhe sipas vendimit nr. 19/1-19/4 datë datë 19.01.2022 ka vendosur “Dhënie masë disiplinore ” për 4 persona si me poshtë:

1. **z. F. L.** me vendimin nr.19/1 datë 19.01.2022 është vendosur mase disiplinore “Vërejtje me shkrim.
2. **z. T. K.** me vendimin nr.19/2 datë 19.01.2022 është vendosur mase disiplinore “Vërejtje me shkrim”.
3. **z. L. S.** me vendimin nr.19/3 datë 19.01.2022 është vendosur mase disiplinore “Vërejtje”.
4. **z. E. M.** me vendimin nr.19/4 datë 19.01.2022 është vendosur mase disiplinore “Vërejtje”.

Shënim Punonjësit e tjerë që kanë qënë pjesë e KVO-ve në procedurat e prokurimit “Rikonstrukcion i shkollës së mesme “Sami Frashëri” Bashkia Përmet dhe “Projekte për përmirësimin e kushteve të banimit për komunitete të pafavorizuara”, apo pjesë e strukturave të tjera për të cilët janë lënë rekomandime nuk janë më punonjës pranë Bashkisë Përmet.

Zbatimi i rekomandimeve për Bashkinë Përmet (Formulari nr. 12), në mënyrë tabelore paraqitet:

Nr	Lloji i Rekomandimit	Rekomandimet Gjithsej në numër	Nga këto:				Nga rekomandimet gjithsej sa me dëme ekonomike								
			Pranuar në numër	Zbatuar në numër	Zbatuar pjesërisht në numër	Pazbatuar në numër	Rekomanduar		Pranuar		Zbatuar/apo proces zbatimi		Ne Proces Civil apo Penal ne 00/lek	Pazbatuar (Pa fill proced)	
							Nr. pers	Në 000/lekë	Nr. pers.	Në 000/lekë	Nr. pers.	Në 000/lekë		Nr. pers	Në 000/lekë
a	b														
II.	MASA ORGANIZATIVE (Gjithsejt, Ne vlere)	10	10	6	4										
III.	MASA SHPERBLIM DEMI	3	3	1		3	806	3	806	3	806				
	(Nga te cilat nuk janë kontabilizuar, ne Finance)														
IV.	MASA DISIPLINORE		4	4											
	(Nga te cilat nuk jane nxjere urdhrat,vendimi)														
V.	MASA ADMINISTRATIVE														
	Nga të cilat:														
	Gjobat e Inspektoriateve														
	Gjobat e APP														

KONKLUZIONE DHE REKOMANDIME:

Në përfundim të procesit të auditimit në Bashkinë Përmet për zbatimin e rekomandimeve të KLSH paraqitur me shkresën e saj nr. 873/8 datë. 30.12.2021, konstatohet se pjesa më me peshë e tyre është e pazbatuar, duke parë punën e pamjaftueshme të bërë në drejtim të zbatimit të tyre, **rikërkojmë** të vazhdojnë procedurat ligjore, si më poshtë:

A. MASA ORGANIZATIVE:

Nga KLSH i janë rekomanduar Bashkisë Përmet 10 masa organizative, të cilat janë pranuar plotësisht, nga masat e pranuara janë zbatuar plotësisht 6 masë organizative, janë në proces zbatimi 4 masa organizative dhe nuk masa organizative të pa zbatuara në mënyrë të detajuar realizimi i masave organizative paraqitet si më poshtë:

1.1. Gjetje nga auditimi: Nuk janë miratuar nga Këshilli i Bashkisë, tavanet përfundimtare të shpenzimeve të programit buxhetor afatmesëm brenda datës 20 korrik, në zbatim me kërkesat e ligjit nr. 68/2017 “Për financat e vetëqeverisjes vendore”, neni 37.

Mungon Plani i Masave dhe Veprimet, për fazën përfundimtare të përgatitjes së Programit Buxhetor Afatmesëm dhe Projektbuxhetit Vjetor për të gjithë periudhën e auditimit, ku të jenë përcaktuar aktivitetet që do të zhvillohen, afati, personat përgjegjës.

Ka mungesë të dokumenteve (dëgjesa publike, takime për llogaridhënie për zbatimin e buxhetit etj), të cilat të dokumentojnë se janë konsultuar me komunitetin dhe grupet e interesit.

Nuk ka mbledhje të dokumentuara të GMS, për të diskutuar rreth planifikimit dhe monitorimit të politikave strategjike, PBA, risqeve kryesore dhe çështjeve të tjera të menaxhimit financiar dhe kontrollit.

Nuk dokumentohet mbledhja e njësisë vendore dhe institucioneve të varësisë në lidhje me kërkesat e tyre buxhetore. Planifikimi Buxhetor Afatmesëm është kryer duke u mbështetur në PBA- të e viteve të mëparshme dhe jo mbi një analizë të mirëfilltë. Publikimi i dokumenteve në faqen zyrtare të bashkisë Përmet apo në vendime.al ka vonesa dhe mungesa në afatet e publikimit.

Ka diferenca midis treguesve të hartimit dhe zbatimit të buxhetit, përse i përket pjesës së të ardhurave të veta dhe shpenzimeve të tyre. Realizimi i buxhetit ndaj planit për vitin 2018 ka arritur 85.1 %, për vitin 2019 ka arritur në 85.9 % dhe në vitin 2020 ka arritur në 84.6 %.

-Detyrimet kreditore për fund vitin 2017, sipas pasqyrave financiare të raportimit për këtë vit, llogaritë 401-408 për vlerën 5,448,254 lekë.

-Detyrimet kreditore për fund vitin 2018, sipas pasqyrave financiare të raportimit për këtë vit, llogaritë 401-408 për vlerën 9,782,208 lekë.

-Detyrimet kreditore për fund vitin 2019, sipas pasqyrave financiare të raportimit për këtë vit, llogaritë 401-408 për vlerën 3,427,178 lekë.

(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.1 faqe 18-38 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

1.1.1 Rekomandim: Bashkia Përmet, të marrë masa për hartimin e një buxheti real, objektiv në realizimin e të ardhurave dhe shpenzimeve, për të mos krijuar diferenca midis parashikimit dhe realizimit të buxhetit si dhe të analizohet brenda muajit qershor të çdo viti zbatimi i buxhetit.

Bashkia Përmet të marrë masa, të dokumentojë mbledhjet e strukturës dhe të institucioneve në varësi, duke parashtruar dhe kërkesat e tyre buxhetore.

Bashkia Përmet të marrë masa për publikimin e vendimeve të Këshillit Bashkiak në faqen zyrtare apo në vendime.al brenda 15 ditëve.

Grupi i Menaxhimit Strategjik duhet të mblidhet për të diskutuar rreth planifikimit dhe monitorimit të politikave strategjike, PBA, risqeve kryesore dhe çështjeve të tjera të menaxhimit financiar dhe kontrollit (të dokumentuara).

Të kryhet Plani i Masave dhe Veprimet, për fazën përfundimtare të përgatitjes së Programit Buxhetor Afatmesëm dhe Projektbuxhetit Vjetor për të gjithë periudhën e auditimit, ku të jenë përcaktuar aktivitetet që do të zhvillohen, afati, personat përgjegjës.

Menjëherë dhe në vijimësi

1.1.2. Nga verifikimi rezultoi se: Me Urdhërin nr.10 datë 13.01.2022 protokolluar me shkresën nr.78 datë 13.01.2022 Kryetar i Bashkisë ka ngritur Grupin e Manaxhimit Strategjik. Gjatë mbledhjeve që janë mbajtur nga ky grup është diskutuar rreth planifikimit dhe monitorimit të politikave strategjike, PBA-së, risqeve kryesore dhe çështjeve të tjera të menaxhimit financiar dhe kontrollit (të dokumentuara).

Në proces zbatimi

2.2. Gjetje nga auditimi: Detyrimet e prapambetura deri më datë 31.12.2020 janë në vlerën 14,666,184 lekë në kundërshtim me ligjin nr. 9936, datë 26.6.2008 "Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar, UMF nr. 5, datë 27.12.2014 "Për shlyerjen e detyrimeve të prapambetura". Ndër të cilat vlerën më të lartë të shpenzimeve të pa likuiduara i zënë investimet në vlerën 10,335,785 lekë ose 70.47 %. Detyrimi i papaguar në lidhje me investimet e kryera si ndërtimi i shkollës së mesme me subjekt "A." ShPK dhe rehabilitimi i banesave me subjekt "N." ShPK, faturat janë të muajt shkurt dhe maj 2020. Mallra dhe shërbime në vlerën 2,346,886 lekë ose 16 %, vlerë e pa likuiduar i cili i përket Operatorit të Shpërndarjes së Energjisë Elektrike (OSHEE), faturat e pa paguara të vitit 2007. Mbi arsyet e mos likuidimit të kësaj vlere, Bashkia Përmet deklaroi se i kanë dërguar shkresa OSHEE- s në lidhje me detajimin e këtij detyrimi, nga e cila nuk ka patur përgjigje. Në vlerën e detyrimeve të papaguara shfaqet edhe detyrimi 1,983,513 lekë ndaj detyrimeve të vendimeve gjyqësore ose 13.5 %, nga të cilat 554,334 lekë janë detyrime që nga viti 2012 dhe 2013. Detyrimet për vendimet gjyqësore kanë të bëjnë me detyrime ndaj punonjësve të larguar nga ky institucion. Nga totali i detyrimeve të vendimeve gjyqësore, vetëm 2 prej këtyre rasteve kanë kaluar me përmbarues. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.1 faqe 18-38 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

2.2.1 Rekomandim: Bashkia Përmet të ndërpresë praktikën e krijimit të detyrimeve të reja dhe të marrë masa për likuidimin e detyrimeve të prapambetura duke hartuar plan të detajuar për këtë qëllim.

Menjëherë dhe në vijimësi

2.2.2. Nga verifikimi rezultoi se: Në zbatim të këtij rekomandimi u bëjmë me dije se vlera e detyrimeve të mbetura është ulur gjatë vitit 2021 dhe 2022 pasi janë kryer këto pagesa:

Për investimin e kryer për ndërtimin e shkollës së mesme "Sami Frashëri" me subjekt "A." shpk janë kryer pagesat me Urdhër shpenzimi nr.673; 674 datë 05.08.2021 në vlerën 2,000,000 lekë dhe Urdhër shpenzimi nr.1035; 1036 datë 20.12.2021 në vlerën 2 000 000 lekë.

Për investimin e kryer me objekt "Rehabilitimi dhe përforcimi i banesave ekzistuese në fshatin Piskovë dhe Pacomit" për subjektin "N." shpk janë kryer pagesa me Urdhër Shpenzimi nr. 116; 117 datë 10.02.2022 në vlerën 2 186 750 lekë.

Shpenzimet gjyqësore kanë qënë 1,717,113 (faqja 45 e raportit përfundimtar të kontrollit). Nga kjo shumë është likuiduar për periudhën raportuese vlera prej 714 404 lekë.

Në proces zbatimi

3.9. Gjetje nga auditimi: Bashkia Përmet nuk ka marrë të gjitha masat e duhura për të bërë të mundur zbatimin e rekomandimeve të lëna nga KLSH në auditimin e fundit për shpërblim dëmi në vlerën 4,711,194 lekë dhe për 9 masa organizative që ende nuk janë zbatuar.

(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.4 faqe 93-98 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

3.9.1 Rekomandim: Kryetari i Bashkisë Përmet të analizojë me strukturat e bashkisë si dhe në Këshillin Bashkiak mos zbatimin e plotë të rekomandimeve të KLSH të dërguara me

shkresat nr. 390/61 Prot., datë 22.10.2019 përkatës dhe hartimin e planeve specifike të punës për:

- Zbatimin rekomandimeve për shpërblim dëmi në vlerën **4,199,595** lekë;
- Zbatimin e 5 rekomandimeve organizative që janë nxjerrë urdhrat përkatës por rezultojnë ende në proces zbatimi;
- Zbatimin e 2 rekomandimeve organizative që ende nuk janë zbatuar.

Menjëherë

3.9.2. Nga verifikimi rezultoi se: Në zbatim të rekomandimeve të KLSH-së të dërguara me shkresën nr. 390/61 Prot, datë 22.10.2019 rezulton se

Në zbatim të kontratës me objekt “Rijetëzim i Bllokut të banimit Tefta Tashko Koço, Elena Gjika, Vasil Papadhropulo” realizuar nga BOE R. shpk&V. shpk Bashkia Përmet me Ankimin nr. 1254 prot datë 23.05.2019 është në proces gjyqësor për vjeljen e këtij detyrimi në gjykatën Administrative të Apelit Tiranë.

- Në zbatim të kontratës me objekt “Rehabilitimi i rrjetit të ujësjellësit dhe rrugëve të brendshme të Fshatit Piskovë” realizuar nga OE “M. ” shpk Bashkia Përmet është në proces gjyqësor në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Gjirokastrë ku ka paraqitur prapësimet me nr. Prot datë 25.11.2021 ku deri tani është në fazën e shqyrtimit gjyqësor.

Në proces zbatimi

4.10. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi dhe analizimi i komponentëve të MFK-së referuar Ligjit nr. 10296, datë 08.07.2010 “*Për menaxhimin financiar dhe kontrollin*”, i ndryshuar si dhe Manualit të Menaxhimit Financiar dhe Kontrollit, miratuar me Urdhër të Ministrit të Financave nr. 108, datë 17.11.2016 **është konstatuar se:**

- Në Bashkinë Përmet nuk është hartuar “Harta e procesit të Menaxhimit të Burimeve Njerëzore”, për periudhën e auditimit, nuk ka një plan afatmesëm ose vjetor të trajnimeve.

- Në lidhje me Menaxhimin Financiar dhe Kontrollit nuk janë kryer trajnime për Grupin e Menaxhimit Strategjik (GMS- n).

- Bashkia Përmet nuk ka miratuar “Strategjinë e Menaxhimit të Riskut” si dhe nuk janë zhvilluar mbledhje të dokumentuara të grupit të punës për Menaxhimin Strategjik (GMS) për të diskutuar rreth çështjeve që lidhen me menaxhimin financiar dhe kontrollin, mbledhjet janë kryer nga GMS vetëm për Përgatitjen e Buxhetit Vjetor dhe Programit Buxhetor Afatmesëm. Bashkia Përmet nuk ka miratuar Plan Pune Vjetor lidhur me funksionimin e Grupit për Menaxhimin Strategjik”. Nuk e kanë të gjithë punonjësit mundësinë e përdorimit të email- it zyrtar të institucionit duke qënë se sistemi ofron një numër të kufizuar adresash email-i.

- Në vitin 2018 janë kryer vetëm 40 trajnime dhe për vitin 2019 vetëm 46 trajnime për punonjësit. Në vitin 2020 janë kryer trajnime nëpërmjet Zoom (online). Burimet Njerëzore nuk kanë një data bazë me emrat e punonjësve dhe trajnimet e kryera për periudhën e auditimit.

- Nuk janë kryer trajnime për anëtarët e GMS-s në fushën e Menaxhimit të Riskut.

- Bashkia Përmet nuk ka patur në strukturën e saj Auditin e Brendshëm, e cila sjell mungesën e vlerësimeve specifike për sistemet e kontrollit të brendshëm.

- Bashkia nuk ka implementuar programe, sisteme për burimet njerëzore, për financën dhe për drejtoritë që mbledhin taksat. (*Më hollësisht trajtuar në pikën 2.5 faqe 98-103 të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

4.10.1 Rekomandim: Nga ana e Bashkisë Përmet të merren masa për zbatimin e të gjithë komponentëve të MFK-së:

- Të hartohet një plan afatmesëm ose vjetor të trajnimeve, “Harta e procesit të Menaxhimit të Burimeve Njerëzore”.

- Burimet Njerëzore të përpilojnë një data bazë me emrat e punonjësve dhe trajnimet e kryera nga ana e tyre si dhe të njoftojë punonjësit të ndjekin trajnime me qëllim zhvillimin e tyre profesional.

- Të kryejnë trajnime për anëtarët e GMS-s në fushën e Menaxhimit të Riskut.

- Grupi i Menaxhimit Strategjik të kryej trajnime mbi Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin.
 - Të ngrihet në strukturën e Bashkisë Përmet auditi i brendshëm ose të miratojë një marrëveshje me bashki të tjera për realizimin e shërbimit të Auditimit të Brendshëm.
 - Bashkia Përmet të miratojë “Strategjinë e Menaxhimit të Riskut”, të zhvillohen mbledhje të dokumentuara të Grupit të punës për Menaxhimin Strategjik (GMS) për të diskutuar rreth çështjeve që lidhen me menaxhimin financiar dhe kontrollin si dhe të miratohet Plan Pune Vjetore lidhur me funksionimin e Grupit për Menaxhimin Strategjik”.
 - Të mundësohet për të gjithë punonjësit përdorimi i email-it zyrtar të institucionit.
- Bashkia Përmet të implementojë program për burimet njerëzore, për financën dhe për drejtoritë që mbledhin taksat duke garantuar kështu shmangien e keqpërdorimit apo të abuzimit dhe cenimit të cilësisë.

Menjëherë dhe në vijimësi

4.10.2. Nga verifikimi rezultoi se: Në zbatim të këtij rekomandimi nga ana e Bashkisë është hartuar plani vjetor i trajnimeve për vitin 2022 me shkresën nr.1514/1 datë 20.05.2022 . Gjatë vitit 2021 janë ndjekur 45 trajnime në zoom dhe 5 me pjesëmarrje fizike. Grupi i Menaxhimit Strategjik ka kryer trajnime në fushën e Menaxhimit të Riskut dhe mbi Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin. Në strukturën e miratuar të vitit 2021 dhe 2022 është përcaktuar pozicioni i auditit të brendshëm dhe janë bërë 4(katër) herë shpallje për këtë pozicion por nuk ka shfaqur asnjë individ i kualifikuar interes. Janë pajisur me email zyrtar 8 punonjës përfshirë titullarin e Institucionit dhe kanë akses në e-mailin zyrtar të institucionit Kryetari, Nën/kryetarët, Sekretar i Pëgjithshëm dhe 4 drejtorët e drejtorive.

Në proces zbatimi

C. MASA PËR SHPËRBLIM DËMI

Bazuar në ligjin nr. 154, datë 27.11.2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit” neni 15 shkronja (b) dhe (c) -Të drejtat e KLSH, dhe mbështetur në nenet 98-102, të ligjit nr. 44, datë 30.04.2015 “Kodi i procedurave administrative në Republikën e Shqipërisë”, nenet 21-33, të Ligjit nr. 139, datë 17.12.2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, nga **Titullari i njësisë publike**, të nxirren aktet administrative përkatëse dhe të kërkohet në rrugë ligjore (Padi Gjyqësore), duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative dhe procedurat e tjera në të gjitha shkallët e gjyqimit, me qëllim kërkimin për shpërblimin e dëmit. Nëpunësi zbatues të ndjekë procesin me qëllim shpërblimin e dëmit në vlerën **806,824.61 lekë pa Tvsh**, si më poshtë:

Nga verifikimi rezultoi se vlera 806,824 lekë është kontabilizuar dhe pasqyruar në llogarinë 468 –debitorë të Pasqyrave Financiare më datën 31.12.2021 (bilanci vjetor 2021) vlera prej 806,824 lekë. Janë rekomanduar 3 masa shpërblim dëmi në vlerë 806,823 lekë, deri me datë 07.10.2022, është arkëtuar vlera 338,321 lekë, si dhe është në proces vlera 468,503 lekë.

Në mënyrë tabelore rekomandimet, arkëtimet dhe natyra e rasteve të mos realizimit paraqiten në pasqyrën e mëposhtme:

Nr	Emër Mbiemër/Subjekti	Numri rekomandimit sipas shkre (Vendimit)	Natyra e Shkeljes	Rekomanduar Gjithsej në Lekë	Nuk Pranohej nga Subjekti	Janë pranuar Në lekë	Nga të pranuarat:			
							Arkëtuar Deri 07.10.22	Në Proces Arkëtim	Në Proces Gjyqësor	Nisur Njoftime e s'kanë Paguar
a	B	c	d	1	2	3 (2-1)	4	5	6	7
1	A. K. SHPK	1.1	Punimeve të pakryera.	338,321		338,321	338,321			

2	“H. ” & “R. ” SHPK	2.1	Punimeve pakryera të	182,542	182,542	0		182,542
3	“H. ” SHPK	3.1	Punimeve pakryera të	285,960	285,960	0		285,960
				806,824	806,824	338,321		468,503

1.2. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i zbatimit të punimeve civile të kontratës me objekt “Sistemim asfaltim i rrugëve të Bashkisë Përmet dhe të Njësisë Administrative”, Bashkia Përmet, me vlerë të kontratës (me TVSH) 94,712,204 lekë, me nr. 3270 prot., datë 24.12.2018, fituar nga BOE “H. ” & “R. ” ShPK, rezultuan diferenca në volume pune të pakryera në fakt në vlerën **182,542.84 lekë pa TVSH**, në zërat “Mbushje me çakëll/ose zhavor lumi pas murit” dhe “Ndërtim mur betoni m-200”. Veprimet e mësipërme janë në kundërshtim me kontratën e sipërmarrjes së punimeve. (Më hollësisht trajtuar në pikën 2.3, faqe 51-93 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

2.1. Rekomandim: Nga Bashkia Përmet të merren masa për arkëtimin e vlerës prej **182,542 lekë pa Tvsh** nga “H. ” & “R. ” Shpk, në cilësinë e sipërmarrësit në kontratën me nr. ... prot, datë 24.12.2018, me objekt: “Sistemim asfaltim i rrugëve të Bashkisë Përmet dhe të Njësisë Administrative”, Bashkia Përmet, vlerë që përfaqëson dëm ekonomik ndaj buxhetit të shtetit dhe njësisë vendore, si pasojë e likuidimit të punimeve të pakryera.

Menjëherë

*1.2.2. Nga verifikimi rezultoi se: Nëpunësi Autorizues në zbatim të detyrimeve të konstatuar nga KLSH-ja dhe sipas kontratës së sipërmarrjes me nr. 3270 prot, datë 24.12.2018, ka nxjerr Vendimin nr..43/1 datë 08.02.2022, “Për nisjen e procedurave administrative dhe ligjore për kthimin e detyrimit në vlerën **182,542 lekë**”, nga BOE “H. ” shpk & “R. ” shpk. Me shkresën nr.746 prot datë 04.03.2022 është njoftuar BOE “H. ” shpk & “R. ” shpk për arkëtimin vullnetar të detyrimit. Deri në datën e verifikimit 07.10.2022, nuk është ndërmarrë asnjë procedur tjetër ligjore në arkëtimin e detyrimit.*

Në proces zbatimi

2.3. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i zbatimit të punimeve civile të kontratës me objekt “Rikonstruksion e ndërtime të urave në fshatrat Zhepe, Kutal, Verçisht” Bashkia Përmet, me vlerë të kontratës (me Tvsh) 81,490,378.838 lekë, me nr. 1363 prot., datë 04.06.2018, rezultuan diferenca në volume pune të pakryera në fakt në vlerën **285,960 lekë pa Tvsh**, në zërat “Përgatitje e montim litarë çeliku d=14mm”, “F.V Morseta”, “F.V Tiranda d=1mm” e “F.V. Kavallota Veprimet e mësipërme janë në kundërshtim me kontratën e sipërmarrjes së punimeve. (Më hollësisht trajtuar në pikën 2.3 faqe 51-93 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

2.3.1 Rekomandim: Nga Bashkia Përmet të merren masa për arkëtimin e vlerës prej **285,960 lekë pa TVSH** nga kontraktori “H. ” ShPK, sipas kontratës me numër ... prot., datë 04.06.2018, me objekt: “Rikonstruksion e ndërtime të urave në fshatrat Zhepe, Kutal, Verçisht ” Bashkia Përmet, vlerë që përfaqëson dëm ekonomik ndaj buxhetit të shtetit dhe njësisë vendore, si pasojë e likuidimit të punimeve të pakryera.

Menjëherë

*2.3.2. Nga verifikimi rezultoi se: Nëpunësi Autorizues në zbatim të detyrimeve të konstatuar nga KLSH-ja dhe sipas kontratës së sipërmarrjes me nr. 1363 prot., datë 04.06.2018, ka nxjerr Vendimin nr..43/2 datë 08.02.2022, “Për nisjen e procedurave administrative dhe ligjore për kthimin e detyrimit në vlerën **285,960 lekë**”, nga OE “H. ” ShPK. Me shkresën nr.745 prot datë 04.03.2022 është njoftuar OE “H. ” për arkëtimin vullnetar të detyrimit. Deri në datën e verifikimit 07.10.2022, nuk është ndërmarrë asnjë procedur tjetër ligjore në arkëtimin e detyrimit.*

Në proces zbatimi

Kriteri:

Ligji Nr. 154, datë 27.11.2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit” neni 15, “Të drejtat e KLSH”, germa j), *ligjit nr. 10296, datë 08.07.2010 “Mbi menaxhimin financiar dhe kontrollin” me ndryshime.*

Shkaku:

Mos ndjekja e gjitha procedurave për të bërë të mundur arkëtimin e vlerës **468,503** lekë.

Ndikimi/Efekti:

Ndikon në të ardhurat e buxhetit të Bashkisë Përmet.

Rëndësia: E Lartë

Rekomandim: Kryetari i Bashkisë Përmet të analizojë situatën e mos zbatimit plotësisht të rekomandimeve të dërguara nga KLSH-ja me shkresën nr. 873/8 datë. 30.12.2021, duke nxjerrë përgjegjësitë e personave përgjegjës, si dhe të hartojë plan pune të veçantë e të marrë të gjitha masat e duhura ligjore për zbatimin e plotë të tyre, respektivisht:

a-Për 4 masa organizative në process zbatimi;

b-Për 2 masë shpërblim dëmi në vlerën **468,503** lekë;

V. GJETJET DHE REKOMANDIMET

Për përmirësimin e gjendjes rekomandojmë marrjen e masave si më poshtë:

A. MASA ORGANIZATIVE

1.Gjetje nga auditimi: Në drejtim të vlerësimit të sistemit të menaxhimit financiar dhe kontrollit të brendshëm, konstatohet se nga Bashkia Përmet, nuk ka njohje dhe nuk është zbatuar ligji 10296, datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, konkretisht:

- Nuk është ngritur një sistem efektiv i menaxhimit financiar dhe kontrollit të brendshëm, gjë e cila është reflektuar në mangësinë e plotë të rregullave të shkruara për funksionimin e institucionit.

- Nga ana e titullarit nuk është hartuar një strategji e menaxhimit të riskut për vitin 2021, manuali dhe harta e proceseve të punës, gjurma e auditimit e cila duhet të përfshinte të paktën proceset kryesore që kontribuojnë në arritjen e objektivave të njësisë.

Nga ana e nëpunësit autorizues, nuk janë analizuar dhe përditësuar kontrollet që synojnë minimizimin e riskut dhe dokumentimin e tij, si dhe nuk janë regjistruar dhe raportuar masat e marra për parandalimin e këtyre fenomeneve.

- Në strukturën organizative nuk janë planifikuar pozicione me status “ekselent” dhe pozicione me status të “Grup i veçantë” në zbatim të Urdhrit të Kryeministrit si dhe vendosjen e një sistemi komunikimi që të ofrojë informacionin e duhur për të gjithë punonjësit, menaxherët e lartë dhe titullarin e njësisë.

- Gjithashtu, u konstatua se një numër i konsiderueshëm punonjësish, kanë rregulluar marrëdhënien e punës sipas dispozitave të Kodit të Punës, ndërkohë që pozicionet e tyre të punës, evidentohen si pozicione me status “Nëpunës Civil” dhe për rrjedhojë rekrutimi i tyre është bërë në kundërshtim me ligjin. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 1, faqe 19-25 të Raportit të Auditimit)*

1.1.Rekomandimi: Kryetari i Bashkisë Përmet, në cilësinë e Titullarit të Institucionit, Nëpunësit Autorizues, si dhe Kryetarit të GMS-së, të hartoj strategjinë e riskut si dhe për aktivitetet dhe proceset kryesore të punës që zhvillohen në institucion, të hartohet gjurma e auditimit dhe harta e proceseve të punës.

1.2.Rekomandimi:Sektori i Burimeve Njerëzore të marrë masa për rregullimin e pozicioneve të punës që trajtohen me status të nëpunësit civil, në të cilat janë emëruar punonjës sipas “Kodin

e Punës”, të njoftojë DAP për procedurat e konkurrimit, duke zbatuar procedurat e përcaktuara në ligjin për Nëpunësin Civil si dhe të planifikoj pozicione me status “Ekselent” dhe pozicione me status të “Grup i veçantë” në zbatim të Urdhrit të Kryeministrit si dhe vendosjen e një sistemi komunikimi që të ofrojë informacionin e duhur për të gjithë punonjësit, menaxherët e lartë dhe titullarin e njësisë.

Menjëherë dhe në vijimësi

2. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i zbatimit të veprimtarisë së Njësisë së Auditit të Brendshëm, u konstatua se për vitet 2021 Bashkia Përmet nuk ka Njësi të Auditit të Brendshëm dhe nuk ka lidhur kontratë me institucion tjetër për realizimin e këtij shërbimi. Veprime dhe mosveprime bien në kundërshtim me nenin 49 të ligjit 68/2017 “Për financat e vetëqeverisjes vendore”, si dhe pikën 1 të VKM nr.83, datë 03.02.2016 “Për miratimin e kritereve të krijimit të Njësisë të Auditimit të brendshëm në sektorin publik”, ku përcaktohet se në çdo njësi të vetëqeverisjes vendore krijohet Njësia e Auditimit të Brendshëm. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 1, faqe 19-25 të Raportit të Auditimit)*

2.1.Rekomandimi: Kryetari i Bashkisë Përmet të marrë masa për organizimi i shërbimit të auditimit të brendshëm në bashki, duke krijuar Njësinë e Auditimit të Brendshëm brenda strukturës organizative të Bashkisë.

Në vijimësi

3. Gjetje nga auditimi: Realizimi i shpenzimeve buxhetore për vitin 2021 me të ardhurat e veta (pa transfertën e pakushtëzuar) të Bashkisë Përmet ka diferenca të dukshme me vlerën e planifikuar. Planifikimi i shpenzimeve me të ardhurat e veta ka vlerën 471,855 mijë lekë, ndërsa realizimi 379,372 mijë lekë, ose në masën 78.7%. Niveli i realizimit të investimeve të planifikuara, i cili është zëri më kryesor i buxhetit në lidhje me ndikimin që ka në ofrimin e të mirave publike ndaj komunitetit, është akoma më i ulët se mesatarja e realizimit të buxhetit. Ky zë është planifikuar në vlerën 129,211 mijë lekë, realizuar 71,122 mijë lekë, ose në masën 51 %. Ky mos realizim vjen si rezultat i mosrealizimit të të ardhurave, që do të thotë se nga Bashkia Përmet në fillim të vitit buxhetor planifikohen angazhime buxhetore, duke mos u mbështetur në planifikime realiste të të ardhurave të veta nga taksat dhe tarifatat vendore dhe ky planifikim nuk korrigjohet gjatë vitit, duke mos përshtatur shpenzimet buxhetore të miratuara me të ardhurat reale të realizuara. Gjithashtu edhe gjatë vitit 2021 nuk është bërë analiza e zbatimit të buxhetit brenda muajit qershor dhe nuk është dalë në konkluzion nëse duhej rishikuar ose jo buxheti vjetor 2021. Veprimet dhe mosveprimet e mësipërm janë në kundërshtim me pikën (a) të nenit 5, si dhe nenin 46 të ligjit nr. 68/2017 “Për financat e vetëqeverisjes vendore” ku thuhet: “Kryetari i njësisë së vetëqeverisjes vendore analizon zbatimin e buxhetit jo me vonë se data 30 qershor e çdo viti dhe, në rast se është e nevojshme, harton e propozon në këshillin e njësisë së vetëqeverisjes vendore ndryshimet në buxhet. Procedurat e shqyrtimit, miratimit dhe zbatimit të ndryshimeve u nënshtrohen të njëjtave rregulla të përcaktuara në nenet 5 dhe 40 të këtij ligji”. *(Më hollësisht trajtuar në pikën nr.2.4, faqe 25-36 të Raportit të Auditimit)*.

3.1.Rekomandim: Kryetari i Bashkisë, Drejtoria e Financës dhe Buxhetit, si dhe Drejtoria e të Ardhurave Vendore, të marrin masa për një planifikim të studiuar të buxhetit, duke u mbështetur mbi parashikime të studiuar dhe realiste të të ardhurave. Mbi bazën e këtyre të ardhurave të parashikohet edhe plani shpenzimeve publike, me qëllim që këto shpenzime të kenë burime financimi të sigurta për tu realizuar.

Menjëherë dhe në vijimësi

4. Gjetje nga auditimi: Bashkia Përmet në datën 01.01.2021 ka pasur si çelje të vitit ushtrimor detyrime të prapambetura progresive vlerën 6,264 mijë lekë, e cila ka si burim financimi të ardhurat e veta. Në planin e buxhetit vjetor 2021 është planifikuar për likuidim gjatë këtij viti vlera 2,000 mijë lekë, në datën 31.12.2021 vlera e detyrimeve të prapambetura me burim financimi të ardhurat e veta, krahasuar me këtë vlerë në fillim të vitit ushtrimor (01.01.2021),

është ulur me 100 mijë lekë, ose në masën prej 1.5% duke ngelur pa u arkëtuar vlera 6,164 mijë lekë.

Për sa më sipër rezulton se marrja e angazhimeve buxhetore pa pasur fonde në dispozicion, e cila ka çuar në krijimin e detyrimeve të prapambetura është në kundërshtim me kërkesat e Udhëzimit të MFE nr.9, datë 20.03.2018 “Për procedurat standarde të zbatimit të buxhetit”, pika 153-162, Rubrika - Marrja e angazhimit dhe kryerja e shpenzimeve publike, detyrimet kontraktuale midis palëve, nenin 52 të ligjit nr.9936, datë 26.6.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, UMF nr. 5, datë 27.12.2014 “Për shlyerjen e detyrimeve të prapambetura”, pikat 82-91. Në mënyrë të detajuar deturimet e prapambetura paraqiten në aneksin nr. 2 pika 2.4 bashkëlidhur projekt raportit të auditimit. *(Më hollësisht trajtuar në pikën nr.2.4, faqe 25-36 të Raportit të Auditimit).*

4.1.Rekomandim: Kryetari i Bashkisë Përmet dhe Drejtoria e Financës dhe Buxhetit të marrin masa për likuidimin e detyrimeve ndaj të tretëve brenda afatit 30 ditor nga momenti i ardhjes së faturës. Lidhja e kontratës të bëhet vetëm pasi fondi të jetë në dispozicion në llogarinë e thesarit të autoritetit kontraktor, duke eliminuar në këtë mënyrë shkakun e krijimit të detyrimeve të reja prapambetura. Gjithashtu të merren masa për likuidimin e detyrimeve të prapambetura të krijuara në vitet e mëparshme.

Menjëherë dhe në vijimësi

5. Gjetje nga auditimi: Në strukturën organizative të Sektorit të Taksave dhe Tarifave Vendore, Bashkia Përmet nuk është krijuar Sektori i Masave Shtrënguese si një nga sektorët më të rëndësishëm në STV Bashkia Përmet, pasi evidentohet se një numër i lartë i detyrimeve të pa arkëtuara (debitor), në vlerën 22,459,166 lekë, nga e cila: subjekte fizik/juridik në vlerë 17,745,793 lekë, si dhe abonentë familjarë në vlerë 4,047,397 lekë, Gjoha të ndryshme 665,976 lekë. Në rregulloren e brendshme të institucionit nuk është përcaktuar personi i cili duhet të ketë për detyrë ndjekjen e arkëtimeve nga agjentët tatimorë dhe mbajtjen e aktrakordimeve me ta, në lidhje me TFTH; Drejtoria e Përgjithshme të Buxhetit, Drejtoria e Menaxhimit të Buxhetit, pranë Ministrisë së Financave, në lidhje me rentën minerare; AKSH-ja, në lidhje me taksën e ndikimit në infrastrukturë dhe DRSHTRR Përmet, në lidhje me taksën vjetore të mjeteve të përdorura) derdhen automatikisht në fund të çdo muaji, për llogari të Bashkisë Përmet dhe konfirmohen nga Dega e thesarit Përmet. Veprimet dhe mosveprimet janë në kundërshtim me pikën (ç) të nenit 5 të ligjit nr. 9632, datë 30.10.2006 “Për sistemin e taksave vendore” i ndryshuar dhe në Kreun XI- “Mbledhja me forcë e detyrimit tatimor të papaguar”, nenet 88 – 104, të ligjit nr. 9920, datë 19.5.2008 “Për Procedurat Tatimore në RSH” me ndryshime, neni 7 “Të drejtat dhe detyrimet e agjentit të mbajtjes së tatimit” dhe me ligjin nr. 9632, datë 30.10.2006, “Për sistemin e taksave vendore” i ndryshuar, neni 15 “Parapagimi”, si dhe me UMF nr. 26, datë 04.09.2008 “Për taksat Kombëtare” *(Më hollësisht trajtuar në pikën nr.2.6, faqe 37-46 të Raportit të Auditimit).*

5.1.Rekomandimi: Kryetari i Bashkisë Përmet të marrë masa për të krijuar Sektori i Masave Shtrënguese, plotësimin e stafit me specialit të fushës dhe përshtatja e strukturës sipas natyrës së menaxhimit të të ardhurave.

5.2.Rekomandimi: Struktura organizative e Sektorit të Taksave dhe Tarifave Vendore, të marrë masa për të kryer rakordim periodik mujor me agjentët tatimor sipas formularit përkatës të miratuar nga Ministria e Financave, për të evidentuar gjendjen reale të të ardhurave që përfiton Bashkia Përmet nga taksat që mbledhen nga këta agjent. Në rast se agjentët tatimor nuk realizojnë saktë mbledhjen e të ardhurave, Bashkia Përmet të fillojë procedurat për penalizmin e tyre me 50% të shumës së plotë të taksave/tarifave të pa mbledhura apo të shmangura.

Menjëherë dhe në vijimësi

6. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi u konstatuan diferenca midis planifikimit dhe realizimit

të të ardhurave. Për vitin 2021, është planifikuar si e ardhur vlera 57,032 mijë lekë dhe është realizuar në vlerën 60,277 mijë lekë, të ardhurat paraqiten të realizuara ndaj planit fillestar në masën 106 %. Ky tejkallim i planit të të ardhurave vjen si rezultat i dy transfertave respektivisht vlera prej 16,230,000 lekë i përket projektit MAPCULT dhe vlera prej 5,000,000 lekë transfertë nga Këshilli i Qarkut. Përqindja e realizimit të të ardhurave sipas evidencës së të ardhurave është 106 % por duke zbritur dy vlerat (16,230,000 leke dhe 5,000,000 lekë) kjo përqindje realizimi shkon në 68 %. Mosrealizim i të ardhurave vjen edhe si pasojë e mos planifikimit të saktë të taksës së ndikimit në infrastrukturë nga ndërtimi i ri në vlerën 8,573,000 lekë ose 86 % e mosrealizim. Rezulton se tatimi i thjeshtuar mbi fitimin, është planifikuar duke mos patur një bazë të dhënash të saktë për numrin e subjekteve të cilët gjatë vitit mbyllen dhe regjistrohen, për subjektet të cilët në bazë të xhiros do paguajnë tatimin e fitimit. Taksa e mjeteve të përdorura është planifikuar sipas të dhënave historike, pra nuk ka një bazë të dhënash të saktë për numrin e mjeteve të përdorura që ka Bashkia Përmet. Taksa e kalimit e të drejtës në pronësi është planifikuar sipas të dhënave të realizimit të një viti më parë. Sektori i të Ardhurave, duke mos pasur një bazë të dhënash nuk ka bërë rakordime me Drejtorinë Rajonale Tatimore Gjirokastrë (DRTGJ), Agjencinë Shtetërore të Kadastrës (ASHK) dhe Drejtorinë e Shërbimit të Transportit (DSHTR). Veprimet dhe mosveprime bien në kundërshtim me Ligji nr. 9936, datë 26.06.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar, ligji nr. 139/2015, “Për vetëqeverisjen vendore”, neni 64, “Kompetencat dhe detyrat e kryetarit të Bashkisë”; ligji nr. 68/2017 datë 27.4.2017 “Për Financat e Vetëqeverisjes Vendore” i ndryshuar, neni 5, “Parime dhe rregulla të disiplinës fiskale dhe të financimit të funksioneve vendore”, neni 42, “Administrimi i mjeteve monetare”, pika 1, 2 dhe 4; neni 54, “Raportimi financiar” nën-pika c, UMFE nr. 9 datë 20.03.2018, Kreu IV “Procedurat standarde për menaxhimin e të ardhurave” pika 200, UMFE nr. 8, datë 9.3.2018 “Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme”, Kreu III, pika 32, Kreu II pika 2/a, b; Ligji nr. 9632, datë 30.10.2006 “Për Sistemin e Taksave Vendore”, i ndryshuar, ligji nr. 9920, datë 19/5/2008 “Për Procedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar. *(Më hollësisht trajtuar në pikën nr.2.6, faqe 37-346 të Raportit të Auditimit).*

6.1.Rekomandim: Kryetari i Bashkisë Përmet dhe struktura organizative e Sektorit të Taksave dhe Tarifave Vendore të marrin masa për një planifikim sa më realist të të ardhurave, mbështetur në realizimet faktike të viteve të mëparshëm dhe në numrin e taksapaguesve, me qëllim që të zvogëlohet sa më shumë diferenca midis planifikimit dhe realizimit të të ardhurave.

Menjëherë dhe në vijimësi

7. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi rezultoi se në klasën 3 “Gjendja e inventarit qarkullues” të aktiveve qarkulluese paraqiten në mbyllje të vitit 2020 në vlerën 43,404,244 lekë dhe në mbyllje të vitit 2021 në vlerën 43,836,291 lekë, ku diferenca e tyre në rritje në vlerën prej 432,047 lekë. Vlerë e cila nuk rakordon me gjendjen e llogarisë 63 “Ndryshimi i gjendjeve të inventarit” në formatin nr.2 “Pasqyra e performancës financiare”. Veprimet dhe mosveprimet janë në kundërshtim me Udhëzimin e MFE nr.8 datë 09.03.2018 “Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme”, i ndryshuar. *(Më hollësisht trajtuar në pikën nr.3, faqe 46-64 të Raportit të Auditimit).*

7.1.Rekomandim: Drejtoria e Financës të marrë masa që në mbyllje të pasqyrave financiare të vitit 2022 të pasqyrohet saktë llogaria 63 “Ndryshimi i gjendjeve të inventarit” në formatin nr.2 “Pasqyra e performancës financiare”.

Në mbyllje të pasqyrave financiare 2022

8. Gjetje nga auditimi: Gjendja e llogarisë 202 “Studime dhe kërkime” në aktiv të bilancit në mbyllje të vitit 2021 ka vlerën 459,486 lekë, ndërsa sipas Formatit 7/b “Gjendja dhe ndryshimet

e aktiveve afatgjata (kosto historike)” gjendja paraqitet në mbyllje të vitit 2021 në vlerën prej 7,302,172 lekë, ku diferenca në rritje prej 30,000 lekë i përket “Ndërtim i Ujësjellësit Pacomit, Bashkia Përmet” duke i zbritur amortizimin e akumuluar. Nga analiza e kësaj llogarie, konstatohet se: a) Vlera 7,302,172 lekë, i përket 9 projekteve për investimet e kryera, për objekte të cilat kanë përfunduar punimet dhe janë marrë në dorëzim nga Bashkia, vlerë e cila duhet të ishte sistemuar në llogaritë përkatëse të investimit të përfunduar si pjesë e koston totale të objektit, sipas llogaris analitike. b) Gjithashtu nga dokumentacioni i vënë në dispozicion nga sektori juridik rezulton se për vitin 2021 bashkisë Përmet i është dhuruar projekti i Ndërtim i Ujësjellësit Pacomit, Bashkia Përmet sipas shkresës nr. 654 prot datë 11.03.2021 me vlerë 65,530,701 lekë, miratuar me VKB nr. 84 datë 18.03.2021 si dhe është hartuar nga zyra e urbanistikës “Projekti i punime shtesë në linjën kryesore stacion pompimi-depo për fshatrat Bodar dhe Kutal” në vlerën 6,698,035 lekë të cilat nuk janë bërë hyrje në magazinë si dhe nuk janë pasqyruar në kontabilitet në vitin. Kjo paraqitje e llogarisë 202 “Studime e kërkime” është bërë në kundërshtim; është në kundërshtim me Udhëzim e MFE nr. 8, datë 9.3.2018 “Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme” i ndryshuar, Aneksi 1 “Analiza e detajuar e klasave të llogarive të kontabilitetit në sektorin publik” Pika 2. Klasa 2, “Aktivet afatgjata” (përbërja dhe trajtimi kontabël) e cila përcakton: “Trajtimet kontabël për AAGJM-në, lidhen me njohjen fillestare të aktivitetit. (Më hollësisht trajtuar në pikën nr.3, faqe 46-64 të Raportit të Auditimit).

8.1.Rekomandim: Drejtoria e Financës të marrë masa për sistemimin e llogarisë (202) “Studime dhe kërkime”, duke bërë që në këtë llogari të paraqitet vetëm vlera e projekteve, për të cilat investimet e lidhura me to nuk kanë përfunduar. Për projektet të cilat kanë përfunduar, vlerat të kapitalizohet sipas objekteve përkatëse dhe regjistrohen në llogaritë përkatësisë, si pjesë e koston totale të objektit.

Menjëherë dhe në vijimësi

9. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i AQ të trupëzuara dhe të patrupëzuara për aktivet afatgjatë jo materiale dhe materiale, rezulton se më 31.12.2021 këto llogari kanë vlerat si vijon: llog.202 “Studime dhe Kërkime” në vlerën 459,486 lekë, llog. 210 “Toka, Troje, Terrene” në vlerën 5,896,567 lekë, llog. 212 “Ndërtesa Konstruksiione” në vlerën 461,929,171 lekë; llog. 213 “Rrugë, rrjete, vepra ujore” në vlerën 264,221,237 lekë; llog.214 “Instalime teknike, makineri, pajisje, vegla pune” në vlerën 28,338,963 lekë. Për të gjitha llogarit e sipërcituara mungon regjistri analitik i aktiveve sipas formatit, ku për çdo aktiv të përmbajë të dhënat për veprimet ekonomike të kryera me to në vite si: viti i hyrjes, vendodhjen, përshkrimin e aktivitetit, vlerën e blerjes, vlerën e shpenzimeve kapitale të kryera në vitet e mëpasshme që sjellin rritje të vlerës së aktivitetit, vlerën e akumuluar të amortizimit dhe vlerën e mbetur. Amortizimi i AAGJ është llogaritur për grup aktivesh në total dhe jo aktiv për aktiv, duke mos përlllogaritur saktësisht amortizimin, pasi aktive të ndryshme kanë vlerë të ndryshme amortizimi të akumuluar sepse kanë kohë (vite) të ndryshme përdorimi. Nga testimet e kryera mbi përqindjet e aplikuara të normës së amortizimit mbi totalët e vlerave të mbetura sipas llogarive të klasës 20 dhe 21 rezulton se ka pasaktësi në përlllogaritjet e amortizimit vjetor të AAGJ Veprimet dhe mosveprimet janë në kundërshtim me Udhëzim e MFE nr. 8, datë 9.3.2018 “Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme” i ndryshuar, Kreu III “Procedurat për përgatitjen, paraqitjen dhe konsolidimin e pasqyrave financiare në njësitë e qeverisjes së përgjithshme”, pika 36, Aneksi 1 “Analiza e detajuar e klasave të llogarive të kontabilitetit në sektorin publik” Pika 2. Klasa 2, “Aktivet afatgjata” (përbërja dhe trajtimi kontabël). UMF nr. 30 datë 27.12.2011 “Për Menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik” kapitulli III, pika 30, kapitulli IV, pika 75. (Më hollësisht trajtuar në pikën nr.3, faqe 46-64 të Raportit të Auditimit).

9.1.Rekomandim: Drejtoria Ekonomike në Bashkinë Përmet të marrë masa për kryerjen e inventarizimit të AAGJM, të krijojë dhe të mbajë regjistrin analitik aktiveve, ku të përmbajë të

dhënat për veprimet ekonomike të kryera me to në vite si: viti i hyrjes, vendodhjen, përshkrimin e aktivitetit, vlerën e blerjes, vlerën e shpenzimeve kapitale të kryera në vitet e mëpasshme që sjellin rritje të vlerës së aktivitetit, vlerën e akumuluar të amortizimit dhe vlerën e mbetur.

Të kryejë veprimet për përlllogaritjen e saktë të amortizimit aktiv për aktiv sipas të dhënave regjistrit të aktiveve, duke aplikuar normat e amortizimit të miratuara me qëllim saktësimin e vlerës së mbetur të AAGJ dhe reflektimi i të gjithë ndryshimeve në kontabilitet nëpërmjet sistemeve kontabël, duke pasqyruar saktë dhe realisht gjendjet e AAGJ në llogaritë përkatëse të klasës 20 dhe 21 në pasqyrat financiare.

Menjëherë dhe në vijimësi

10. Gjetje nga auditimi: Nga verifikimi i dokumentacionit financiar dhe analiza e të dhënave rezultojnë se në fund të vitit 2021 Bashkia Përmet administrohet pronat e transferuara me VKM në Njësitë Administrative (Qendër Piskovë, Petran, Frashër dhe Çarshovë), për të cilat nuk janë kryer veprime për marrjen në dorëzim dhe pasqyrimin në inventar dhe kontabilitet; nuk është ngritur grup pune për përgatitjen e dokumentacionit teknik të aseteve në pronësi dhe në përdorim, për të realizuar regjistrimin e pronave pranë ZVRPP (ASHK) Përmet; nuk ka rakordim me ZVRPP (ASHK) Përmet, për asetet pronë e Komunës, pasi nuk është marrë në dorëzim harta treguese e objekteve pronë e Komunës; nuk ka të dhëna dhe rakordim për objektet e privatizuar dhe evidencë të pronarëve që nuk kanë shlyer troje; nuk kanë filluar procedurat për përgatitjen e dokumentacionit ligjor për verifikimin dhe regjistrimin e pronave të paluajtshme publike dhe marrjen në dorëzim të aseteve, si dhe nuk është aplikuar në ASHK për regjistrimin e tyre. Mosveprimet e mësipërme janë në shkelje të kërkesave të ligjit nr. 33-2012 “Për regjistrimin e pasurive të paluajtshme”, dhe UMF-së nr. 30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”, kap. III, pika 30 si dhe neni 37 i ligjit 20/2020 “Për Përfundimin e Proceseve Kalimtare të Pronësisë në Republikën e Shqipërisë” Kreu IV. (Më hollësisht trajtuar në pikën nr.3, faqe 46-64 të Raportit të Auditimit).

10.1.Rekomandim: Titullari i Bashkisë Përmet, nëpërmjet Sektorit të Aseteve në bashkëpunim me Drejtorinë e Planifikimit dhe Zhvillimit të Territorit (DPZHT), të marrë masa për krijimin e regjistrit të pronave të paluajtshme të kaluara në pronësi, apo në përdorim të Bashkisë Përmet si dhe të përgatisë dosjet me dokumentacionin e nevojshëm për regjistrimin e pasurive të paregjistruara në Drejtorinë Rajonale ASHK .

Menjëherë dhe në vijimësi

11. Gjetje nga auditimi: Nga verifikimi i dokumentacionit financiar dhe analiza e të dhënave rezultojnë se në fund të vitit 2021 janë pajisur me kartel pasurie në total 19 prona sipas aneksin nr. 5 pika 3 bashkëlidhur projekt raportit të auditimit, si dhe përpara vitit 2021 janë certifikuar 11 dhe gjatë vitit 2021 janë certifikuar 8 prona objekte inventari të cilat nuk janë të regjistruara në kontabilitet dhe pasqyrat financiare në aktiv të Pasqyrës së Pozicionit Financiar. Veprime dhe mosveprime bien në kundërshtim me VKM nr. 510, datë 10.06.2015 “Për inventarizimin dhe hipotekimin e të gjitha pronave të paluajtshme dhe të luajtshme”, Kreu (VI) “Transferimi i pasurive dhe regjistrimi i pasurive të paluajtshme” dhe veprim në mospërputhje me UMF nr. 30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik” me ndryshime, Kreu (III), pika 35 dhe Kreu (II), pika (16). (Më hollësisht trajtuar në pikën nr.3, faqe 46-64 të Raportit të Auditimit).

10.1.Rekomandim: Kryetari i Bashkisë Përmet në bashkëpunim me Drejtorinë e Financës në, të ndërmarr të gjitha procedurat ligjore për vlerësimin e aktiveve të cilat janë pjesë e inventarit AAGJ të bashkisë, të certifikuar në ASHK, por pa vlerë respektive, me qëllim paraqitjen e vlerës së këtyre aktiveve në pasqyrën e pozicionit financiar të njësisë publike vendore.

Menjëherë dhe në vijimësi

12. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i pasqyrave financiare dhe analiza e të dhënave rezulton se në fund të vitit 2021 gjendja e llogarisë 7206 “Financim i pritshëm nga buxheti” paraqitet në vlerën 0 lekë, e cila nuk rakordon me gjendjen e llogarisë 4342 “Operacione me shtetin (të drejta)”, e cila paraqitet në vlerën 55,310,416 lekë, e cila edhe kjo është e pasaktë, pasi gjendja e kësaj llogaritje sipas të dhënave të bilancit duhet të ishte në vlerën 55,310,416 lekë. Veprimet dhe mosveprimet janë në kundërshtim me Udhëzimin e MFE nr.8 datë 09.03.2018 “Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme” Aneksi 1 “Analiza e detajuar e klasave të llogarive të kontabilitetit në sektorin publik” Pika 3.3 “Trajtimi kontabël dhe funksioni i llogarive të të tretëve (klasa 4) nën-pika 8 “Llogaritë e marrëdhënieve me shtetin” (Më hollësisht trajtuar në pikën nr.3, faqe 46-64 të Raportit të Auditimit).

12.1.Rekomandim: Drejtoria e Financës të marrë masa për sistemimin e llogarisë 7206- Financim i pritshëm nga buxheti, në mënyrë që këto llogari të pasqyrojnë vlerën e saktë në pasqyrat financiare.

Në mbyllje të pasqyrave financiare 2022

13. Gjetje nga auditimi: Për zbatimin e rekomandimeve për përmirësimin e gjendjes nga auditimi i fundit të kryer në Bashkinë Përmet sipas shkresës nr. 873/8 datë. 30.12.2021 të KLSH-së, u konstatua se:

Bashkia Përmet për zbatimin e rekomandimeve të KLSH, ka kthyer përgjigje me shkresën nr. 162 prot. datë 19.01.2022 brenda afatit 20 ditor dhe me shkresën nr. 2000/1 datë 28.06.2022 ka raportuar brenda 6 muajve nga data e njoftimit të raportit të auditimit mbi zbatimin e rekomandimeve sipas pikës 2 të nenit 30 të ligjit nr. 154/2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”.

Nga verifikimi i zbatimit të detyrave të lënë nga auditimi i fundit, u konstatua se:

a. Për përmirësimin e gjendjes janë rekomanduar 10 masa organizative, nga të cilat janë pranuar plotësisht 10 masa, nga të pranuarat janë zbatuar 6 masa dhe janë në proces zbatimi 4 masa organizative dhe nuk ka masa organizative të pa zbatuara.

b. Për shpërblim dëmi janë rekomanduar 3 masa me vlerë **806,823 lekë**, deri me datë 07.10.2022, është arkëtuar vlera **338,321 lekë**, si dhe është në proces vlera **468,503 lekë**.

c. Për shpenzime në kundërshtim me principet e 3 E-të si dhe të ardhura të munguara është rekomanduar që të arkëtohet vlera **51,084,013 lekë** si dhe të analizohet vlera **87,418,000 lekë** vlerë e cila është analizuar dhe janë nxjerr përgjegjësit.

Sa më sipër rezulton se për masat shpërblim dëmi Bashkia Përmet është mjaftuar vetëm me nxjerrjen e vendimeve për kryerjen e ndalesave, pa u shoqëruar me padi gjyqësore për arkëtimin e vlerave të rekomanduara, për pasojë ndaj personave shkaktarë nuk kanë filluar kryerja e ndalesave, duke u bërë përgjegjës për kalimin e mundshëm të afateve ligjore të kërimit të dëmit të përcaktuara në nenin 115, të Kodit Civil në R.SH, me ndryshime. Veprimet dhe mosveprimet janë në kundërshtim me nenin 15 germa (c) dhe (ç), si dhe nenin 30, të ligjit nr. 154/2014 miratuar në datën 27.11.2014, “Për Organizimin dhe Funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”, ligjit nr. 10296, datë 08.07.2010 “Mbi menaxhimin financiar dhe kontrollin” me ndryshime. (Më hollësisht trajtuar në pikën nr. 4 faqe 65-85 të Raportit të Auditimit).

13.1. Rekomandimi: Kryetari i Bashkisë Përmet të analizojë situatën e mos zbatimit plotësisht të rekomandimeve të dërguara nga KLSH-ja me shkresën nr. 873/8 datë. 30.12.2021, duke nxjerrë përgjegjësitë e personave përgjegjës, si dhe të hartojë plan pune të veçantë e të marrë të gjitha masat e duhura ligjore për zbatimin e plotë të tyre, respektivisht:

a-Për 4 masa organizative në process zbatimi;

b-Për 2 masë shpërblim dëmi në vlerën **468,503 lekë**;

Menjëherë dhe në vazhdimësi

B. MASA PËR ELEMENIMIN E EFEKTEVE NEGATIVE TË KONSTATUARA NË ADMINISTRIMIN E FONDEVE PUBLIKE DHE PËR MENAXHIMIN ME EKONOMICITET, EFICENCE DHE EFEKTIVITET TË FONDEVE PUBLIKE. (TËARDHURA TË MUNGUARA)

1. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i zbatimit të buxhetit lidhur me likuidimin e detyrimeve të prapambetura rezulton se Bashkia Përmet për zbatimin e vendimeve gjyqësore me objekt dëmshpërblim page për largime nga puna të punonjësve, për vitin 2021 ka shpenzuar vlerën **1,512,720 lekë**, për 13 raste, të cilat përbëjnë shpenzime pa ekonomicitet, eficiencë dhe efektivitet, pasi praktikisht për një pozicion pune paguhen dy persona. Nga praktikat e mësipërme të likuidimit u përzgjedhën për auditim mbi saktësinë dhe plotësinë e dokumentacionit financiar dhe ligjor, 29 prej tyre rezulton se ka mbetur pa u likuiduar vlera **9,998,558 lekë**, vlerë e cila nuk është kontabilizuar në pasqyrat financiare të vitit 2021. Në mënyrë të detajuar detyrimet e prapambetura paraqiten në aneksin nr. 2 pika 2.4 bashkëlidhur projekt raportit të auditimit. Gjithashtu konstatohet se në 13 raste për likuidimet e subjekteve të mësipërme janë nxjerrë urdhrat përkatës nga titullari i institucionit, por nuk janë analizuar nga Kryetari i Bashkisë dhe nuk është kërkuar prej tij nxjerrja e përgjegjësive administrative për këto vendime. Analizimi i arsyeve të humbjeve të vendimeve gjyqësore dhe nxjerrja e përgjegjësive administrative për to, do të ndikonte pozitivisht në korrigjimin e praktikave të gabuara të ndjekura nga njësia vendore në proceset e largimit të punonjësve nga puna dhe për çështje të tjera gjyqësore, evidentimin e procedurave të bëra gabim, në kundërshtim me kuadrin rregullator në fuqi, e si rezultat shmangien e tyre në të ardhmen dhe uljen e shpenzimeve financiare negative në buxhet. Veprime dhe mosveprime janë në kundërshtim me pikën nr. 60, të UMFE nr. 9, datë 20.03.2018, “Për procedurat standarde të zbatimit të buxhetit”, i ndryshuar. (Më hollësisht trajtuar në pikën nr.2.4, faqe 25-36 të Raportit të Auditimit).

1.1.Rekomandimi: Kryetari i Bashkisë Përmet të analizojë të gjitha rastet e vendimeve gjyqësore që do të zbatohet, me qëllim përcaktimin e shkaqeve që kanë sjellë humbjen e çështjes gjyqësore. Rezultatet e analizës të shërbejnë për shmangien në të ardhmen të procedurave të gabuara të ndjekura për çështjen e largimit të punonjësve nga puna dhe çështje të tjera, me qëllim uljen e efekteve negative financiare në buxhet si dhe kontabilizimin e plotë të vlerës **9,998,558 lekë**.

Menjëherë dhe në vijimësi

2. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi rezulton se Drejtoria e Taksave dhe Tarifave Vendore, nuk ka marrë masa të plota për arkëtimin e debitorëve, pasi në datën 31.12.2021 rezulton një vlerë e pa arkëtuar prej **22,459,166 lekë**, e ardhur e munguar për buxhetin e Bashkisë Përmet, e krijuar nga mos pagesa e kategorisë së taksapaguesve familjarë dhe privat, respektivisht; - vlera **17,745,793 lekë**, i përket subjekteve privat (biznesit i vogël, biznesit të madh dhe subjekte shtetërore) dhe vlera **4,047,397 lekë** i përket abonentët familjar dhe gjoba në vlerën **665,976 lekë**, ndërsa detyrimet e subjekteve dhe familjarëve të vitit ushtrimor 2021 janë në vlerën **5,390,741 lekë**. Veprimet e mos veprimet e mësipërme janë në kundërshtim me Pikat 3,4, 5 dhe 5, të nenin 45 – “Çregjistrimi i subjekteve tatimore” dhe Kreun XI-Mbledhja me forcë e detyrimit tatimor të papaguar, të ligjit nr. 9920, datë 19.05.2008 “Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë”, me ndryshimet dhe Udhëzimit nr. 24, datë 02.09.2008 “Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë”, me ndryshime; ligjin nr. 7895, datë 27.01.1995, me ndryshimet e mëvonshme, neni 181 -Mospagimi i taksave dhe tatimeve. (Më hollësisht trajtuar në pikën nr.2.6, faqe 37-46 të Raportit të Auditimit).

2.1.Rekomandimi: Drejtoria e Taksave dhe Tarifave Vendore, Bashkia Përmet, bazuar në nenin 70 pika 3 “E drejta për të nxjerrë njoftimin e vlerësimit tatimor”, të ligjit nr. 9920, datë 19.05.2008 “Për Procedurat tatimore në R.SH”, i ndryshuar, të marrë masa për nxjerrjen e njoftim vlerësimit tatimor për debitorët duke ndjekur të gjitha rrugët për arkëtimin e

detyrimeve për taksat dhe tarifatat vendore në vlerën **22,459,166 lekë**, duke ndjekur procedurat si më poshtë vijon:

i- Tu dërgohen bankave të nivelit të dytë urdhrat e bllokimit të llogarive bankare.

j- Të dërgohet në Drejtorinë Rajonale të Transportit, kërkesa për vendosjen e barrës siguruese (për mjetet) dhe në AKSH (për pasuritë e paluajtshme).

k- Në rast se bizneset private edhe pas njoftimeve zyrtare dhe dërgimit të urdhër bllokimeve në bankë nuk kryejnë pagesën e detyrimeve, pasi të merren masat administrative apo sekuestro, të bëhet kallëzim penal, bazuar në Kodin Penal të RSH, miratuar me ligjin nr. 7895, datë 27.1.1995 me ndryshimet e mëvonshme, neni 181 “Mospagimi i taksave dhe tatimeve”.

l- Drejtoria e të Ardhurave Vendore Bashkia Përmet, në bashkëpunim me Njësitë Administrative, të evidentojë listat emërore të debitorëve familjarë në mënyrë elektronike, duke të njoftojë nëpërmjet postës (dhe jo vetëm) familjet të cilët nuk kanë paguar detyrimet për taksën e tokës/ tarifën e pastrimit, ndriçimit, banesave dhe gjelbërimit.

Menjëherë dhe në vijimësi

3. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i kategorie të bizneseve për tregtimin e naftë bruto dhe nënprodukteve të saj si dhe pajisjen me lejet përkatëse të tregtimit dhe pagesat e tyre, rezultojnë se gjatë vitit 2021 kanë ushtruar aktivitetin e tregtimit me pakicë të karburanteve, gazit të lëngshëm të naftës, për automjetet, vajrave lubrifikantë dhe lëndëve djegëse për përdorim nga konsumatorët fundorë 6 subjekte, nga të cilët: Subjekti E. ShPK ka pezulluar aktivitetin që prej muajit mars kjo sipas Proces- Verbalit nr.10 date 02.03.2022. M. & L. e ka pezulluar aktivitetin në datë 02.03.2021 sipas ekstraktit historik, 6 nga këto subjekte nuk e kanë kryer pagesën për përsëritjen e licencave. Veprime dhe mosveprime bien në kundërshtim me VKM nr.970, datë 2.12.2015, për “Përcaktimin e procedurave dhe të kushteve për dhënien e licencave për tregtimin e naftës bruto dhe nënprodukteve të saj”, pika 14 dhe në kundërshtim me VKM nr. 344, datë 19.4.2017, “Për disa ndryshime dhe shtesa në VKM nr. 970, datë 2.12.2015, “Për përcaktimin e procedurave dhe të kushteve për dhënien e licencave për tregtimin e naftës bruto dhe nënprodukteve të saj”, pika 9. Të ardhurat e munguara janë në vlerën 3,300,000 lekë. Bashkia Përmet nuk ka aplikuar gjoba për fillimin e aktivitetit pa marrë licencën në kundërshtim me Paketën Fiskale të vitit 2021. *(Më hollësisht trajtuar në pikën nr.2.6, faqe 37-46 të Raportit të Auditimit).*

3.1.Rekomandimi: Sektori i Taksave dhe Tarifave Vendore, të ndjekë të gjitha rrugët administrative e ligjore për arkëtimin e tarifës së pataksuar prej **3,300,000 lekë** ndaj 6 subjekteve, sipas pasqyrës Aneks nr. 4 pika 2.6 bashkëlidhur raportit të auditimit.

Menjëherë dhe në vijimësi

4. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi në lidhje me arkëtimin e të ardhurave nga dhënia me qira të ambienteve për periudhën 01.01.2021 deri me 31.12.2021, u konstatua se Bashkia Përmet ka lidhur 3 kontrata të reja “Për dhënien me qira të tokës bujqësore” të pandarë si dhe ka vazhduar me kontratat e mëparshme, duke i rinovuar afatin sipas kontratave fillestare. Sipas dokumentacionit të vënë në dispozicion rezultojnë se procesi i administrimit dhe mbledhje së të ardhurave nga kontratat e qirave administrohet nga *Sektori i Menaxhimit të pronave dhe Strehimit, i cili* administron 21 kontrata në vlerë 3,548,165 lekë në vite, prej të cilave nuk kanë shlyer detyrimet e kontratës 2 subjekte **në vlerën gjithsej 781,938 lekë me pasojë të ardhura të munguara për buxhetin e njësisë vendore**. Veprimet dhe mosveprimet janë në papajtueshmëri me nenin 12, të ligjit nr. 10296, datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, të ndryshuar dhe kushtet e kontratave të lidhura, VKM nr. 54, datë 5.2.2014 “Për përcaktimin e kriterëve, të procedurës e të mënyrës së dhënies me qira, enfitozoë apo kontrata të tjera të pasurisë shtetërore”; etj. Në mënyrë të detajuar paraqitet në aneksin nr. 5 pika 2.6 bashkëlidhur projekt raportit të auditimit. *(Më hollësisht trajtuar në pikën nr.2.6, faqe*

37-46 të Raportit të Auditimit).

4.1.Rekomandimi: Bashkia Përmet të marrë masa për të llogaritur detyrimin total të papaguar (duke llogaritur kamatëvonesat) dhe të kërkojë në rrugë ligjore arkëtimin e vlerës prej **781,938 lekë**, duke llogaritur dhe shtuar vlerën e kamatëvonesave për të gjitha rastet e detyrimeve të pa arkëtuara në afat, duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative dhe procedurat e tjera në të gjitha shkallët e gjykimit ndaj debitorëve.

Menjëherë dhe në vijimësi

C. MASA DISIPLINORE

KLSH mbështetur në ligjin nr. 154/2014, datë 27.11.2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”, neni 15 germa b, c dhe ç, ligjin nr. 152/2013 “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar, neni 59 “Kompetenca dhe procedura për masat disiplinore”, pika 1 dhe pika 4 germa b, VKM-në nr. 115, datë 05.03.2014 “Për përcaktimin e procedurës disiplinore dhe të rregullave për krijimin, përbërjen e vendimmarrjen në komisionin disiplinor në shërbimin civil”, ligjin nr. 7961, datë 12.07.1996 “Kodi i punës në Republikën e Shqipërisë”, neni 37, “Masa disiplinore”, **i rekomandon Kryetarit të Bashkisë Përmet** t’i kërkojë Komisionit Disiplinor pranë institucionit, që bazuar në performancën e secilit punonjës dhe shkeljeve të konstatuara në Raportin Përfundimtar të Auditimit të KLSH-së, të vlerësojë shkallën e përgjegjësisë për çdo nëpunës të adresuar dhe të sigurojë marrjen e masave disiplinore përkatëse.

VI. ANEKSET

Aneksi nr. 1 pika 2.2 Tabela e ndryshimeve të buxheteve viti 2021

000/lekë

Periudha buxhetore	Buxheti Fillestar		Ndryshime gjate viteve		Ku kanë ndodhur ndryshimet e buxheteve				
	Nr/ datë	Vlera	Nr/ datë	Vlera	Pakësuar artik (me emër)/ shtuar artikull (me emër)				
					SHTESA art.	shuma	PAKSIME art.	shuma	
Viti 2021	Nr.99 datë 30.12.2020	334,619	Nr.12, 02.02.2021	600	600+601, paga dhe sigurime				
					602-609 ShP. te tjera	600	609,FE	600	
					230+231, investime				
			Nr.13, dt.03.03.2021	2,073	600+601, paga dhe sigurime	1,881			2,073
					602-606, ShP. operative	192			
			Nr.22, dt.14.04.2021	100	602, ShP. operative	100	609, FR	100	
			Nr.29, dt.14.04.2021	30	230	30	609, FR	30	
			Nr.34, dt.02.06.2021	406	602, ShP. operative	406	602	135	
						231	271		
			Nr.66,dt 29.09.2021	130	606	130	609,FR	130	
			Nr.67,dt 29.09.2021	10	606	10	609,FR	10	
			Nr.73,dt 01.11.2021	5,000	231	5,000			
			Nr.75,dt 01.11.2021	60	606	60	609,FR	60	
Nr.79,dt 01.11.2021	960	602		602	740				
		231	960	231,FE	220				
	9,369		9,369		4,369				

Burimi: Bashkia Përmet

Shënim: Ndryshimet e tjera buxhetesh për bashkinë Përmet për vitin 2021 vetëm brenda grupit të shpenzimeve (brenda Programit 1110 dhe nuk ka qene nevoja për vendim këshl. Bashkiak kjo në mbështetje të Udhëzimit nr.9 dt.20.03.2018”Për procedurat standarte të zbatimit të Buxhetit” pika 100 germa “b” dhe “c” ndërmjet zërave të shpenzimeve kapitale, brenda të njëjtit program, miratohen nga Kryetari i Njësisë së Qeverisjes Vendore, Pra është bërë vetëm me Shtesë nga ana Kryetarit për Degën e Thesarit Përmet.

Aneksi nr. 2 pika 2.4 i faturave të pa likuajuara nga investimet, mallrat dhe shërbimet si dhe nga vendimet gjyqësorë si vijon:

Faturat e pa likuajuara në datën 31.12.2021 për investimet (Nga të ardhurat e veta)

Nr.	Emërtimi i i Objektivit	Emërtimi i Subjektit	Data e lidhjes së kontratës	Numri dhe data e faturës	Numër serial fature	Vlera e kredisë (detyrimit) ne 31.12.2019	Shtesat gjate vitit 2021	Shlyerjet gjatë vitit 2021	Vlera e detyrimit me 31.12.2021
1	Sistemim asfaltim rruge te ndryshme Bashkia Permet	H.	24.12.2018	Fat.nr...,dt.09.12.2021				0	21,195,351

2	Rikonstruksion gjimnazi Sami Frasheri	A. K.	01.03.2019	Fat.nr.....dt.07.02.2020	472406				4,149,036
3	Rehabilitim i banesave te komunitetit Egjyptian fshati Piskov e Pacomit	N.	03.12.2019	Fat.nr.....dt.01.05.2020	790152				2,186,750
Totali i detyrimit									27,531,137

Burimi: Bashkia Përmet

Faturat e pa likuiduara në datën 31.12.2021 për investimet (Nga granti)

Nr.	Emërtimi i i Objektivit	Emërtimi i Subjektit	Data e lidhjes së kontratës	Numri dhe data e faturës	Numër serial fature	Vlera e kredisë (detyrimit) ne 30.06.2017	Shtesat gjate periudhës korrik-dhjetor 2021	Shlyerjet gjatë vitit 2021	Vlera e detyrimit me 31.12.2021
1	Sistemim asfaltim rruge te ndryshme Bashkia Permet	H.	24.12.2018	Fat.nr...,dt.09.12.2021				0	15,335,204
Totali i detyrimit									15,335,204

Burimi: Bashkia Përmet

Faturat e pa likuiduara në datën 31.12.2021 për mallrat dhe shërbimet (Nga të ardhurat e veta)

Nr.	Emërtimi i i Objektivit	Emërtimi i Subjektit	Data e lidhjes së kontratës	Numri dhe data e faturës	Numër serial fature	Vlera e kredisë (detyrimit) ne 31.12.2019	Shtesat gjate vitit 2021	Shlyerjet gjatë vitit 2021	Vlera e detyrimit me 31.12.2021
1	Riparime mjetesh viti 2021	A. M.	30.04.2021	15/2021,dt.28.12.2021					26,700
2	Riparime e vendosje goma mjetet viti 2021 B.Permet	N. Q.	30.08.2021	182/2021,dt.29.12.2021					18,000
3	Sporti table basketbolli	G.		11/2021,dt 30.12.2021					99,900
4	Keshilltaret								299,000
Totali i detyrimit									443,600

Burimi: Bashkia Përmet

Faturat e pa likuiduara në datën 31.12.2021 për mallrat dhe shërbimet (Nga granti)

Nr.	Emërtimi i i Objektivit	Emërtimi i Subjektit	Data e lidhjes së kontratës	Numri dhe data e faturës	Numër serial fature	Vlera e kredisë (detyrimit) ne 30.06.2017	Shtesat gjate periudhës korrik-dhjetor 2021	Shlyerjet gjatë vitit 2021	Vlera e detyrimit me 31.12.2021
1	Riparime mjetesh viti 2021	A. M.	30.04.2021	../2021,dt.28.12.2021					263,300
2	Riparime e vendosje goma mjetet viti 2021 B.Permet	N. Q.	30.08.2021	../2021,dt.29.12.2021					366,288
3	Mbremje Poetike	E. N.		../2021,dt.30.12.2021					100,000
4	Ushqimet kopshti ,cerdhe konvikt,viti 2022	N.	26.02.2021	../2021,DT.30.12.2021					341,229

Totali i detyrimit										1,070,817
---------------------------	--	--	--	--	--	--	--	--	--	------------------

Burimi: Bashkia Përmet

Të paraqitet në mënyrë analitike lista e vendimeve gjyqësore të ardhura në financë dhe likuidimet e kryera prej saj për dëmshpërblim page, për punonjësit e larguar nga puna.

Në lekë

Nr	Emri I kreditorit	Vendim gjyqësor nr.date	Objekti i Vendimit	Vlera e detyrimit sipas vendimit të gjyqësorit	Gjendja e palikujduara 31.12.2020	Vendime të vitit 2021	Ardhuara gjate	Detyrimi total	Likujduar në vitin 2021	Gjendja e palikujduara 31.12.2021
						Nr dhe data e vendimit	Vlera e vendimit			
0	1	2	3	4	5	6	7	8=5+7	9	10=8+9
1	J. B.	20-2020-345/97 16.07.2020	Dëmshpërblim page	307,400	207,400	-	-	207,400	165,320	42,080
